

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

# PAVARËSIA E KOSOVËS DHE SFIDAT E SHTETNDËRTIMIT

Simpozium shkencor ndërkombëtar  
(17 maj 2018)

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSIVIENSIS  
SECTION OF SOCIAL SCIENCES

# KOSOVA INDEPENDENCE AND STATE BUILDING CHALLENGES

International Scientific Symposium  
(17 May 2018)

Editor: Correspondent member Justina Shiroka-Pula,  
Secretary of the Section of Social Sciences



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

# PAVARËSIA E KOSOVËS DHE SFIDAT E SHTETNDËRTIMIT

Simpozium shkencor ndërkombëtar  
(17 maj 2018)

Redaktor: Anëtare korrespondente Justina Shiroka-Pula,  
Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore



Copyright © ASHAK

**KËSHILLI ORGANIZUES:**

Akademik Jusuf BAJRAKTARI, kryetar

Anëtar korrespondent Frashër DEMAJ, sekretar

Akademik Ali ALIU, anëtar

Anëtare korrespondente Gjyljeta MUSHKOLAJ, anëtare

Anëtar korrespondent Muhamedin KULLASHI, anëtar

**ORGANIZING COUNCIL:**

Academician Jusuf BAJRAKTARI, President

Correspondent member Frashër DEMAJ, secretary

Academician Ali ALIU, member

Correspondent member Gjyljeta MUSHKOLAJ, member

Correspondent member Muhamedin KULLASHI, member

## PËRMBAJTJA

<b>Justina Shiroka-Pula</b> FJALA E HAPJES.....	7
<b>Jusuf Bajraktari</b> DIMENSIONI HISTORIK I PAVARËSISË SË KOSOVËS.....	9
<b>Beqir Meta</b> KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR I REZISTENCËS PAQËSORE TË SHQIPTARËVE TË KOSOVËS I UDHËHEQUR NGA PRESIDENTI RUGOVA NË VITET E '90-ta .....	27
<b>Ksenofon Krisafi</b> RAMBUJE, HAP VENDIMTAR DREJT PAVARËSISË SË KOSOVËS.....	43
<b>Muhamedin Kullashi</b> EVOLUIMI I OPINIONIT PUBLIK NDËRKOMBËTAR RRETH PAVARËSISË SË KOSOVËS .....	61
<b>Arsim Bajrami</b> KONSTITUCIONALIZMI KOSOVAR PAS SHPALLJES SË PAVARSISË DHE SFIDAT E NDËRTMIT TË TIJ .....	83
<b>Laszlo Markusz</b> PIKËPAMJA HUNGAREZE MBI PAVARËSINË E KOSOVËS.....	107
<b>Sonja Biserko</b> SFIDAT REGJIONALE PËR SHTETNDËRTIMIN E KOSOVËS .....	137
<b>Frashër Demaj</b> SHPALLJA E PAVARËSISË SË KOSOVËS DHE NJOHJA NDËRKOMBËTARE .....	143
<b>Esmeralda Osmani-Kolaneci</b> LIRIA DHE DEMOKRACIA NË REALITETIN E KOSOVËS NË DEKADËN E PARË DHE SFIDAT PËR TË ARDHMEN .....	161
<b>Justina Shiroka-Pula</b> SFIDAT DHE RRITJA EKONOMIKE NË KOSOVË NË PERIUdhËN 2008-2018.....	169



*Fjala e hapjes*

*Justina Shiroka-Pula, Anëtare Korrespondente  
Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore (SSHSH)*

*Prishtinë, 17.05.2018*

Kam nderin, që në emër të Seksionit të Shkencave Shoqërore të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të mbaj fjalën hyrëse në hapjen e punimeve të simpoziumit shkencor ndërkombëtar *“Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit”*.

Ky simpozium, në vitin e dhjetë të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, është planifikuar nga Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe është mbështetur edhe nga seksionet e tjera dhe nga organet vendimmarrëse të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Është vlerësuar se tema *“Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit”* paraqet një temë shumë aktuale dhe të rëndësishme dhe një kontribut të rëndësishëm për të ardhmen e vendit.

Në përvjetorin e 10-të të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, nuk do ta harrojmë dhe nuk do ta lëmë pa e përkujtuar edhe të kaluarën, e cila është një dimension tjetër i jetës sonë të lavdishme, orientimin properëndimor të rezistencës civile dhe përkushtimin e rezistencës së armatosur në Kosovë, të cilat shënuan një kthesë historike për ta arritur mbështetjen e duhur politike, dhe që në fakt janë kontribuues në krijimin e shtetit të Kosovës.

Kosova ka qenë e administruar nga Kombet e Bashkuara deri në shpalljen e Pavarësisë, më 17.02.2018. Tani jemi shtet i pavarur, sovran dhe i njohur nga shumica e shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara.

Natyrisht, në këtë dhjetëvjetor të pavarësisë, s’ka se si të mos e kujtojmë kontributin e miqve të mëdhenj të Kosovës, kongresmenëve dhe diplomatëve amerikanë, si dhe të miqve nga të gjitha vendet e tjera aleate, për rolin dhe përkushtimin e tyre aktiv për Kosovën.

Mirëpo, tani do ta shikojmë të tashmen dhe të ardhmen. Këto dy dimensione duhet të jenë synim për të pasur një të ardhme të ndritshme dhe perspektive, e cila mund të arrihet me politikë aktive vendore dhe në bashkëpunim me të gjithë ata që ndihmuan në krijimin e shtetit tonë.

Siç edhe mund ta vërejmë nga pjesëmarrësit në këtë simpozium, intelektualë e diplomatë, ekspertë të fushave të ndryshme, që ndërlihen

me temën e shtruar për trajtim në simpozium, është e qartë se tema për sfidat dhe shtetndërtimin e Kosovës ngjall gjithmonë interes dhe është një temë në të cilën ka çka të trajtohet e çka të thuhet.

Në punimet e këtij simpoziumi do të trajtohen aspektet më vitale të jetës socio-politike, historike, juridike, analitike dhe ekonomike të shtetndërtimit. Jemi të sigurt se profesionistët dhe ekspertët pjesëmarrës, me trajtimin e gjithanshëm të temës, do të vënë në dukje të arriturat e deritashme dhe pikat ku kemi ngecur dhe ku duhet të punojmë për të përmirësuar gjërat.

Po kështu, do të japim sugjerimet tona për rrugën që duhet ndjekur për një të ardhme më të prosperuar të Republikës së Kosovës.

Më lejoni gjithashtu të them se kjo konferencë është iniciuar dhe është përparuar me përkushtimin dhe seriozitet nga akademik Jusuf Bajraktari, nënkryetar i ASHAK-ut. Prandaj, me këtë rast, i shpreh falënderimin tim Akademikut Bajraktarit dhe këshillit organizativ për organizimin e kësaj konference, shumë të rëndësishme për Akademinë dhe për Kosovën.

Andaj, Zonja dhe zotërinj, e deklaroj të hapur simpoziumin shkencor ndërkombëtar “*Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit*”. Referuesve dhe pjesëmarrësve ju urojë suksese dhe punë të mbarë.

Ju faleminderit

# DIMENSIONI HISTORIK I PAVARËSISË SË KOSOVËS

**Jusuf Bajraktari**

## **Përmbledhje**

*Rrugëtimi i gjatë i ideve dhe i lëvizjeve çlirimtare nëpër dallgët e trazuara të interesave të gërshetuara në Ballkan, shpeshherë i ka detyruar elitat dhe protagonistët e ndryshëm të adaptohen edhe me rrethana kundërthënëse shoqërore vetëm e vetëm për të ruajtur synimin madhor – arritjen e pavarësisë si parakushtin themelor për konsolidimin dhe përparimin e shtetit kombëtar.*

*Këto ide të ligjshme e të natyrshme identifikohen me aktivitetet politike dhe kryengritjet e vazhdueshme nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Lidhja e Pejës (1899), Konferenca e Ambasadorëve e 1913 në Londër, Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, Konferenca e Mukjes, Lidhja e Dytë e Prizrenit, Konferenca e Bujanit, demonstratat e vitit 1968 e 81, Kushtetuta e vitit 1974, Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut, Kushtetuta e Kaçanikut, Sensibilizimi dhe ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës, Lufta e UÇK-së e deri te Shpallja e Pavarësisë së Kosovës.*

*Lufta në Kosovë dhe zgjidhja e krizës së saj shënuan fundin e konflikteve të përgjakshme në ish-Jugosllavi. Me Kosovën shtet i pavarur dhe sovran i shpallur më 17 shkurt 2008, është formësuar përfundimisht harta politike e Ballkanit dhe krijimi i postulateve për një jetë të re e të barabartë të popujve të tij.*

**Fjalët çelës:** *Kosova, Serbia, Pavarësia e Kosovës, diplomacia ndërkombëtare, SHBA, BE, Kuvendi i Kosovës*

Në ngjarjet jubilarë historike siç është 10-vjetori i pavarësisë së Kosovës, është e natyrshme që t'i kujtojmë me pietet të thellë ngjarjet historike dhe përpjekjet e bëmat e brezave, të cilët gjatë shekujve nuk kursyen mundin, djersën, gjakun dhe vlerat e tyre njerëzore për t'i dalë zot Dardanisë antike dhe Kosovës së sotme. Një vend nderi në këtë kuadër kanë dëshmorët e lirisë, luftëtarët a kauzës kombëtare ndër vite dekada e shekuj për të dalë te lufta e fundit dhe luftëtarët e UÇK-ës, të personifikuar me figurën e veçantë, simbolin e sakrificës Adem Jasharin. Gjithashtu është nder i veçantë i brezit tonë të kujtojmë edhe elitën intelektuale të kohërave duke filluar së paku nga periudha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit kur u bë përpjekja më serioze për formimin e shtetit kombëtar e deri te çlirimi i Kosovës me 1999. Në këtë vijimësi historike kujtojmë edhe mendje ndriturit, anëtarët e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës si Prof. Ali Hadrin, Prof. Fehmi Aganin, Prof. Gazmend Zajmin, Presidentin historik Dr. Ibrahim Rugova dhe bashkëpunëtorët e tij të cilët ditën të endin, në kohë shumë të vështira me kujdes e pedanteri fijet e penjve në pëlhurën e bukur që simbolikisht njëjtësohet me hartën e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran.

Dimensioni historik i Pavarësisë së Kosovës është teme komplekse dhe kërkon angazhim të studiuesve të disiplinave të ndryshme të shkencave sociale dhe jo vetëm, të cilët me përkushtim do t'i elaborojnë të gjitha elementet dhe faktet historike që do mundësojnë ngritjen e një projekti monumental në përkujtim të sakrificave kombëtare për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Është shumë me rëndësi të analizojmë gjithanshëm faktorët relevantë të cilët gjatë historisë e kanë kondicionuar dhe herë-herë fuqizuar idenë e Pavarësisë së Kosovës, e cila fatmirësisht u jetësua me dinjitet të plotë, pikërisht para dhjetë vjet e tre muaj. Ideja për perspektivën e Kosovës ka ndryshuar dhe ka marrë formë e dimensione të ndryshme duke filluar që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e cila ishte organizata e parë politike dhe ushtarake në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.<sup>1</sup> Ajo kishte një program të avancuar politik për

---

<sup>1</sup> Më gjerësisht shih: Aleks Buda, “*Shqipëria në vitet e Krizës Lindore 1877-1881*”, Studime Historike nr. 3, Tiranë 1967, f. 103. 15 Zija Xholi, “Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare në vitet 30-70 të shekullit XIX”, Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881, Tiranë, 1979, f. 83.; Ali Hadri, “Rëndësia historike e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878-1881”, Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 1878-1881, Tiranë, 1979, f. 138; Shyqri Ballvora, “Koncepti i territorit në

kohën, në bazë të të cilit u vunë themelet e kombit modern shqiptar dhe të afirmimit të ideve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Në funksionimin e saj 1878-1881 Lidhja arriti të afirmonte kërkesat e shqiptarëve për autonomi e shtet kombëtar edhe në qarqet diplomatike ndërkombëtare sidomos në kryeqytetet e Fuqive të Mëdha si në Londër, Paris, Berlin, Romë dhe Vjenë.<sup>2</sup>

Edhe pas shuarjes së Lidhjes aktivitetet kombëtare për çlirimin e Vilajetit të Kosovës dhe vilajeteve të tjera shqiptare vazhduan në trajtë dhe dimensione të tjera. Ideologët e vlerësuan të nevojshme hapjen e shkollave në gjuhën shqipe për të arsimuar gjenerata e breza në frymën kombëtare si dhe për të zhdukur analfabetizmin e thellë nga i cili mund të dilej vetëm përmes shkollës kombëtare. Këto përpjekje rezultuan me hapjen e shkollës së parë shqipe në kohën e Rilindjes Kombëtare në Korçë të drejtuar nga Pandeli Sotiri një nga intelektualët e kohës.

---

Programin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881, Tiranë, 1979, f. 153; Kristo Frashëri, Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881, Tiranë, 1998. Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Tiranë, 1989, Lidhja e Prizrendit 1878-1881, Tiranë 1956; Skënder Rizaj, Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1877-1885, Prishtinë 1998, Dokumentet angleze mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe fillimin e copëtimit të Ballkanit 1877-1885, Prishtinë 1996; Iliaz Rexha, Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane, Prishtinë 1978, Kristaq Prifti, Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane, Tiranë 1978; Beqir Meta, Ferit Duka, Marenglen Verli, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, në dokumentet austro-hungareze, 1878, vëllimi I, Tiranë-Prishtinë 2008; Ali Hadri, “Lidhja e Prizrenit”, Konferenca Shkencore me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Prishtinë 1981; Xhafer Belegu, Lidhja e Prizrenit, Tiranë, 1939; Shyqri Ballvora, “Lidhja e Prizrenit dhe Çështja e Autonomisë së Shqipërisë”, Studime Historike Nr. 2, Tiranë, 1965; Masar Rizvanolli, Lidhja e Prizrenit 1878-1881, Prishtinë 1978; Lufta e Serbisë dhe Malit të Zi për pushtimin e tokave shqiptare gjatë Krizës Lindore 1875-1881, Gjakovë, 2007; Jusuf Bajraktari, Gjakova me rrethinë 1878-1912, Prishtinë 1998; Marjan Prenkaj, Prizreni dhe rrethina në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX, Prishtinë 1998; Shkelzen Raça, Marrëdhëniet Shqiptaro-Greke 1829-1881, Prishtinë 1990; Jusuf Buxhovi, Kongresi i Berlinit 1878, Prishtinë 2008; Хађивасилевич, Јован, Арбанаска Лига, Београд, 1909; Bernard Stull, “Albansko pitanje”, RAD, Jugoslovenske Akademije Znanosti i Umjetnosti, Zagreb, 1959; Храбак, Богомил, Призренска Арбанашка Лига 1878-1881, Београд 1998; Kristaq Prifti, Lidhja Shqiptare e Prizrenit në Dokumente Osmane, Tiranë 1978; Frasher Demaj, Britania e Madhe dhe çështja shqiptare 1875-1913, Prishtinë 2010; Noel Malkolm, Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë 1998; Ramiz Abdyl, Lidhja Shqiptare e Prizrenit në burimet angleze, Libri I dhe II, Prishtinë 2004.

<sup>2</sup> Kristaq Prifti, “Misioni i dy shqiptarëve në Evropë (Abdyl Frashri dhe Mehmet Ali Vrioni)”, Studime Historike 3-4, Tiranë 2006, f. 132.

Rrugëtimi i gjatë i ideve dhe lëvizjeve çlirimtare nëpër dallgët e trazuara të interesave të gërshetuara në Ballkan, shpeshherë i ka detyruar elitat dhe protagonistët e ndryshëm të adaptohen edhe me rrethana kundërthënëse shoqërore vetëm e vetëm për të ruajtur synimin madhor – arritjen e pavarësisë si parakushtin themelor për konsolidimin dhe përparimin e shtetit kombëtar.

Këto ide të ligjshme e të natyrshme identifikohen me kryengritjet e vazhdueshme nga Lidhja e Pejës (1899), Lëvizja arsimore e kulturore me Kongresin e Manastirit 1908<sup>3</sup> dhe Kongresin e Elbasanit më 1909 e deri te Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë, e vitit 1911 në Malësinë e Madhe dhe kryengritja e përgjithshme e vitit 1912 e cila, lindi dhe morri flakë të pandalshme në Kosovë për t'u përhapur gjithandej në viset shqiptare. Kryengritja e vitit 1910 në Kosovë e ideuar dhe udhëhequr nga ideologë e tribunë popullorë, si Hasan Prishtina, Isa Boletini, Idriz Seferi, Bajram Curri dhe personalitete të tjera, ndryshoi kahen e rrjedhave të mëvonshme historike. Kjo kryengritje mobilizoi gjithë shqiptarët përparimtarë rreth kauzës kombëtare duke ndikuar kështu që Kosova të jetë gjenerator i zhvillimeve politike dhe kryengritëse me qëllim të formimit të shtetit kombëtar shqiptar.<sup>4</sup> Kauza e arritjes së qëllimeve politike e kombëtare përmes kryengritjeve vazhdoi në Malësinë e Madhe ku pas sukseseve të kryengritësve malësorë në vitin 1911 në majën e Bratilës në Deçiq u ngrit flamuri kombëtar. Kurse Kryengritja e Përgjithshme e vitit 1912 i mobilizoi shqiptarët nga jugu në veri dhe lindja në perëndim të trojeve shqiptare rreth kauzës së përbashkët, çlirimit nga Perandoria Osmane dhe formimit të shtetit kombëtar.

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë pavarësisht rrethanave të vështira u deklarua mbi parimin e bashkimit të të gjitha vilajeteve në një shtet të vetëm mirëpo fatin e shqiptarëve e përcaktuan kryesisht faktorët e jashtëm dhe interesat gjeopolitike e gjeostrategjike të Fuqive të Mëdha. Vendime e Konferencës së Ambasadorëve në Londër brenda shtetit shqiptar njohën afërsisht një gjysmë shteti shqiptar me rreth 28.000 km<sup>2</sup> kurse rreth 24.000 km<sup>2</sup> gjeografi dhe banorë shqiptarë në trojet e veta mbeten jashtë shtetit kombëtar të pushtuar nga Serbia, Mali i Zi dhe Greqia. Jashtë kornizave të shtetit kombëtar mbeti edhe Kosova

<sup>3</sup> Shih: Shaban Demiraj & Kristaq Prifti, Kongresi i Manastirit ngjarje me rëndësi në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare (me rastin e 70-vjetorit të tij), Tiranë: “8 Nëntori”, 1978, f.70-74.

<sup>4</sup> Frashër Demaj, Britania e Madhe dhe çështja shqiptare 1875-1913, (ribotim) Prishtinë 2017, f. 255.

pavarësisht përpjekjeve të pareshtura për të qenë pjesë e shtetit të përbashkët kombëtar.

Përpjekjet e Kosovës vazhduan edhe gjatë periudhës së luftës së Parë Botërore 1914-1918. Rol të rëndësishëm në luftën për çlirim dhe bashkim kombëtar në Kosovë dhe në vise të tjera pati Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës (KMKK) i cili tubonte në këtë forum figurat më të rëndësishme kombëtare të kohës si: Hoxhë Kadri Prishtina, Hysni Curri, Halim Gostivari Bedri Pejani etj.

Komiteti kishte miratuar edhe programin e vet si dokument politik të konceptuar në tri pika kryesore në të cilat përmbledheshin kërkesat kombëtare të shqiptarëve dhe përfaqësimi i tyre diplomatik përmes një delegacioni që do të mbronte interesat e shqiptarëve në forumet nderkombëtare.

Lëvizjet çlirimtare, në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare vazhduan edhe në periudhën midis dy Luftërave dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore duke kulmuar me organizimin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe të Konferencës së Bujanit<sup>5</sup> në të cilat u morën vendime historike për të ardhmen e Kosovës dhe të popullit shqiptar. Pas mbetjes së Kosovës në Jugosllavi filloi një fazë e re historike e cila karakterizohet me dhunë e terror të ushtruar ndaj shqiptarëve në Kosovë nga ana e Serbisë dhe e Jugosllavisë. Ky terrorizim ndikoi në fuqizimin e lëvizjes kombëtare në Kosovë dhe shumica e personaliteteve që merreshin me aktivitete kombëtare kaluan në ilegalitet. Mos pajtueshmëria e shqiptarëve me gjendjen e krijuar dhe të drejtat e tyre të mohuara në Jugosllavi ndikoi në organizimin e demonstratave të vitit 1968 në të cilat u kërkuan të drejtat qytetare e kombëtare të shqiptarëve. Jugosllavia e gjendur nën presionin e shqiptarëve u detyrua që të lejonte miratimin e Kushtetutës së vitit 1974 sipas së cilës avancoheshin të drejtat e shqiptarëve në Kosovë por statusi i Kosovës si një krahinë autonome nuk i përmbushte kërkesat e shqiptarëve. Sidoqoftë mbi bazën e Kushtetutës së vitit 1974 u krijuan institucione të rëndësishme politike, shoqërore, arsimore e shkencore si institucione autonome u shtua numri i shkollave në gjuhën shqipe, u hap Universiteti i Prishtinës, u themeluan Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Institutet Shkencore etj. Me Kushtetutën e vitit 1974 u krijua baza politike dhe juridike që Kosova në një moment të volitshëm politik të përcaktohej

---

<sup>5</sup> Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Dosja Konferenca e Bujanit, Rezoluta e Konferencës së Bujanit (8 fq).

për mëvetësinë e saj. Demonstratat e vitit 1981 ishin vazhdimësi e përpjekjeve të shqiptarëve për të realizuar pikësynimet e tyre.

Më 23 mars 1989 me suprimimin antikushtetues të autonomisë së Kosovës nga ana e Serbisë u godit procesi i ngritjes cilësore të mëvetësisë dhe subjektivitetit të avancuar të Kosovës brenda Jugosllavisë. Ky akt përveç tendencës ndaj shqiptarëve, shënoi edhe fillimin e shpërbërjes së RSFJ-së. Shqiptarët në mbrojtje të autonomisë dhe të drejtave të tyre organizuan protesta e demonstrata në të cilat pati edhe të vrarë, të plagosur, të arrestuar dhe të dënuar me shumë vite burgim.

Në këtë situatë Kosova u godit në disa drejtime, prej të cilave tri janë më të rëndat dhe vendimtare për likuidimin e autonomisë si: rrënimi i pushtetit shtetëror, shkatërrimi i ekonomisë dhe shembja e veprimtarive shoqërore si: shëndetësia, arsimi, shkenca, kultura etj.<sup>6</sup>

Pra, dhuna dhe represioni serb në Kosovë u shtua që nga akti antikushtetues i Kuvendit të Republikës së Serbisë me të cilin ishte mohuar autonomia e KSA të Kosovës që ishte e garantuar me Kushtetutën e vitit 1974. Këto ndryshime antikushtetuese i dhanë mundësi Serbisë të shpallte “krijimin e Serbisë unike”. Në këto rrethana, përderisa në Beograd festohej, në Kosovë shqiptarët po manifestonin indinjatën dhe kundërshtimin e tyre përmes protestave dhe demonstratave. Gjatë protestave të marsit e prillit 1989 u vranë 30, u plagosën qindra të tjerë, u rrahën dhe u arrestuan mijëra shqiptarë. Shqiptarët e burgosur trajtoheshin nga sigurimi shtetëror serb dhe instancat e tjera të ndjekjes në mënyrat më çnjerëzore. Qëllimi ishte që të arrestuarit dhe të burgosurit të pranonin se iu takonin grupeve të ndryshme ilegale separatiste e terroriste që luftonin kundër “shtetit ligjor të Serbisë dhe Jugosllavisë”. Torturat ishin nga më të ndryshmet duke filluar që nga maltretimet psikike, rrahja në pjesë të ndjeshme të trupit, heqja e thonjve nga mishi, futja e gjilpërave nëpër trup, varja me kokë teposhtë dhe metoda të tjera të torturës. Një formë tjetër e dhunës dhe e represionit serb ndaj shqiptarëve ishte edhe helmimi masiv i nxënësve dhe i studentëve shqiptarë me helme të luftës në periudhën mars-maj 1990<sup>7</sup>.

Si kundër përgjigje e suprimimit të autonomisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK), delegatët legjitim të

<sup>6</sup> Esat Stavileci, “Ndryshimet kushtetuese dhe likuidimi i autonomisë”, në Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual, Tiranë 1996, f.293.

<sup>7</sup> Frashër Demaj, *Afrim Gjuraraj, Jeta dhe Vepra*, Prishtinë 2009, f. 62.

Kuvendit të Kosovës u mbledhën më 2 korrik 1990 për të mbajtur seancë parlamentare. Parlamenti i Kosovës ishte i rrethuar me pjesëtarë të sigurimit shtetëror e policë në gjendje gatishmërie. Delegatët shqiptarë nuk u lejuan të futeshin në ndërtesë. Kështu ata në hyrje të Parlamentit të Kosovës miratuan Deklaratën Kushtetuese sipas së cilës Kosova shpallej Republikë në kuadër të federatës apo konfederatës së Jugosllavisë, varësisht për cilën nga këto variante do të vendosnin subjektet kushtetuese të Jugosllavisë (Sllovenia, Kroacia, Bosnje dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia, Kosova, Vojvodina dhe Maqedonia)<sup>8</sup>.

Tri ditë pas shpalljes së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Serbisë suprimoi Kuvendin e Kosovës, Qeverinë e Kosovës, organet administrative e gjyqësore, mbylli Radiotelevizionin e Prishtinës (i vetmi medium në gjuhën shqipe në Kosovë), ndaloi gazetën “Rilindja”, të vetmen në gjuhën shqipe, goditi rëndë sistemin arsimor, kulturor, ekonomik, shëndetësor, bankar etj. Përfaqësuesit e popullit të Kosovës vazhduan ta qojnë deri në fund vullnetin e sovranit.

Më 7 shtator në Kaçanik delegatët e Kuvendit të Kosovës miratuan Kushtetutën e Republikës së Kosovës siç njihet ndryshe Kushtetuta e Kaçanikut<sup>9</sup>. Bazuar në këtë Kushtetutë më 26-30 shtator të vitit 1991 u organizua Referendumi për Kosovën Shtet i Pavarur dhe Sovran. Më 24 maj 1992 u mbajtën zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale në Kosovë. Në këto zgjedhje morën pjesë parti shqiptare, boshnjake dhe turke<sup>10</sup>. U konstituua Parlamenti i Kosovës me 115 deputetë, u zgjodh qeveria e Kosovës dhe President i Republikës së Kosovës u zgjodh Dr. Ibrahim Rugova<sup>11</sup>. Këto institucione për

<sup>8</sup> Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë, më tej AIHP, Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990.

<sup>9</sup> AIHP, Kushtetuta e Republikës së Kosovës e miratuar më 7 shtator në Kaçanik.

<sup>10</sup> AIHP, Materiali zgjedhor i zgjedhjeve parlamentare te vitit 1992. Këto zgjedhje Serbia i konsideronte ilegale dhe paralele kurse shqiptaret i konsideronin si zgjedhje legjitime ne bazë të cilave krijuan institucionet e pavarura kosovare.

<sup>11</sup> Ibrahim Rugova u lind më 2 dhjetor 1944 në fshatin Cerrcë, komuna e Istogut, në Kosovë.

Më 10 janar 1945, komunistët jugosllavë ia pushkatojnë babanë e tij Ukë Rugova dhe gjyshin Rustë Rugova, që kishte qenë luftëtarë të njohur kundër çetave çetnike që po depërtonin gjatë Luftës së Dytë Botërore në krahinën e Rugovës.

Më 1996, Dr. Ibrahim Rugova u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Arteve dhe të Shkencave të Kosovës.

Po në këtë vit ai u shpall doktor nderi i Universitetit të Parisit VIII në Paris. Për afro dy dekada, Dr. Rugova punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës si hulumtues i letërsisë.

popullsinë Kosovës (hiq serbët) ishin legjitime, por nuk u njohën nga bashkësia ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe shpalljen e Republikës së Kosovës<sup>12</sup>. Sidoqoftë dr. Ibrahim Rugova u njoh dhe u trajtua si lider i shqiptarëve të Kosovës dhe kjo i dha mundësi që të bënte sensibilizimin e çështjes së Kosovës në skenën politike e publike ndërkombëtare.

Sfidat e sensibilizimit dhe ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës dhe sigurimi i përkrahjes për pavarësinë e Kosovës ishin të mëdha. Vështirësitë më të shumta vinin nga paradigma e krijuar nga tri momente definuese: e para, sepse bashkësia ndërkombëtare fillimisht ishte kundër zhbërjes së ish-Jugosllavisë dhe përpiqej me çdo kusht ta ruante atë; e dyta, çështja e Kosovës shihej e reduktuar në çështjen e të drejtave të njeriut; dhe e treta, sepse në perceptimet e hershme ndërkombëtare Kosova shihej si çështje e brendshme e Serbisë<sup>13</sup>.

Pavarësisht rrethanave, me filozofinë e sensibilizimit, pretendohet krijimi i aleancës me SHBA-të, si superfuqi e vetme dhe po ashtu si shtet që i pari tregoi mirëkuptim dhe përkrahje për çështjen

Dr. Rugova është zgjedhur kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës më 1988, i cili u bë bërthamë e fuqishme e lëvizjes shqiptare që po kundërshtonte sundimin komunist serb/jugosllav në Kosovë.

Dr. Rugova u zgjodh më 23 dhjetor 1989 kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), partisë së parë politike në Kosovë që e sfidoi drejtpërdrejt regjimin komunist në fuqi.

LDK-ja u bë shpejt forca politike prijëse në Kosovë, duke mbledhur shumicën e popullit, edhe pse në ndërkohë u shfaqën në skenë edhe parti e grupe të tjera.

Deklarata e Pavarësisë (2 korrik 1990), shpallja e Kosovës Republikë dhe miratimi i kushtetutës së saj (7 shtator 1990), referendumi popullor për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës mbajtur në fund të shtatorit të vitit 1991, qenë prelude për zgjedhjet e para shumëpartiake për Kuvendin e Kosovës dhe zgjedhjet presidenciale në Republikën e Kosovës më 24 maj 1992.

LDK-ja fitoi shumicën dërrmuese të deputetëve në Kuvend, në të cilin përfaqësoheshin edhe tri parti të tjera, ndërsa Dr. Ibrahim Rugova u zgjodh Kryetar i Republikës së Kosovës me shumicë të votave.

Dr. Ibrahim Rugova u rizgjodh Kryetar i Republikës së Kosovës në zgjedhjet e mbajtura në mars të vitit 1998. Partia e tij, LDK, fitoi shumicën e vendeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës në atë vit.

Nën udhëheqjen e Rugovës, LDK-ja fitoi 58% të votave të elektoratit në zgjedhjet lokale, të sponsorizuara ndërkombëtarisht, në Kosovën e pasluftës, në tetor të vitit 2000. Vdiq më 21 janar 2006.

<sup>12</sup> Arkivi i Kosovës-Agjencia Shtetërore e Arkivave të Republikës së Kosovës, më tej (AK)-(AShARK), Referendumi për Kosovën Shtet i Pavarur dhe Sovran 26-30 shtator të vitit 1991.

<sup>13</sup> Edita Tahiri, *Diplomacia e Kosovës në periudhën e okupimit*, Kumtesë e lexuar në Simpoziumin shkencor “Çlirimi i Kosovës”, mbajtur më 12 qershor 2009 në Prishtinë, f. 7.

e Kosovës, vënia e lidhjeve me kryeqendrat e Evropës, me vendet më të zhvilluara në botë, si dhe kontaktet dhe lobizimet me të gjitha institucionet relevante botërore, si Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), Bashkimin Evropian (BE), NATO, OSBE, Këshillin e Evropës (KE), Parlamentin Evropian (PE), etj<sup>14</sup>.

Sensibilizimi i çështjes së Kosovës pavarësisht pengesave që i bënte në vazhdimësi diplomacia serbe i dha rezultatet e veta sepse çështja e Kosovës dhe e shqiptarëve në Jugosllavi, nga një problem i marginalizuar dhe i papërfillur po shndërrohej gradualisht në një çështje të pazgjidhur ndërkombëtare dhe me kalimin e kohës nëse nuk do të zgjidhej drejt do të bëhej si një bombë e kurdisur për rajonin e Ballkanit. Pasojat e moszgjidhjes së çështjes së Kosovës dhe të shqiptarëve në Jugosllavi u vërejtën sidomos në kohën e dezintegritimit të këtij shteti që pikërisht në Kosovë e filloi fundin e ekzistencës së tij.

Lëvizja për pavarësi e viteve të 1990-ta, e udhëhequr nga dr. Ibrahim Rugova ishte një projekt madhor kombëtar shqiptar që rezultoi nga fuqia mendore e elitës intelektuale e politike shqiptare si kundërpërgjigje ndaj okupimit të Kosovës nga Serbia. Intelektualë e akademikë të mobilizuar rreth interesit kombëtar, përballë represionit shtetëror serb ishin të bindur se ishte momenti i duhur për të realizuar të drejtat e tyre kombëtare. Kjo dëshmoi se okupimi jo vetëm që nuk arriti ti gjunjëztojë shqiptarët, por përkundrazi ripërtëriu fuqinë dhe potencialet e tyre për organizimin e lëvizjes për liri, pavarësi dhe demokraci<sup>15</sup>. Shqiptarët e kishin hartuar edhe projektin rezervë përveç dy opsioneve të më hershme politike (federatë apo konfederatë), ku përfshihej opsioni i bashkimit kombëtar si një zgjidhje e natyrshme që mund të bëhej e mundur në rast të hapjes së çështjes e kufijve në Ballkan.<sup>16</sup>

Për sa i takon zgjidhjes me negociata të çështjes së Kosovës, platforma kosovare përmbante dy parime kryesore: që negociatat të jenë të ndërmjetësuara nga një palë ndërkombëtare me fuqi garantuese, duke kërkuar rolin udhëheqës të SHBA-ve në bashkëpunim me BE-në; dhe që negociatat të zhvillohen mbi parimin e mos prejjudikimit të statusit final. Përkrahje u kërkuar po ashtu për implementimin e diplomacisë preventive,

<sup>14</sup> Po aty

<sup>15</sup> Po aty

<sup>16</sup> AIHP, QIK (Qendra Informativ e Kosovës), Shih "Deklarata politike e Këshillit Koordinues të Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi" e miratuar me 12 tetor 1991, Albanian Democratic Movement in Former Yugoslavia, Documents: 1990-1993, Kosova Information Center, Prishtina 1993, 21-23.

përkatësisht për vendosjen e forcave parandaluese të NATO-s, si kontribut për ndaljen e spastrimeve etnike dhe shmangien e luftës, që rrezikonte të përhapej në gjithë rajonin si dhe për një protektorat ndërkombëtar mbi Kosovën, si zgjidhje kalimtare. Arsye pse kosovarët kërkonin forcat e NATO-s dhe jo të OKB-së, lidhej me faktin se OKB-ja kishte dështuar në Bosnje, ndërkohë që besueshmëria në NATO kishte mbetur shpresa e vetme<sup>17</sup> për popullsinë shumicë të Kosovës. Gjithashtu shqiptarët e shihnin te SHBA-të partnerin e fuqishëm i cili historikisht i kishte ndihmuar popujt e shtetet në nevojë. Këtë e simbolizonte edhe shembulli i presidentit Wudrou Wilson në përkrahje të shqiptarëve në momentet vendimtare pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, në Konferencën e Paqes të Versajës (1919).

Vulën e ndërkombëtarizimit dhe të trajtimit të çështjes së Kosovës si një problem ndërkombëtar e bëri politika amerikane dhe Presidenti **George H. W. Bush** duke dalë me qëndrimin e “vijës së kuqe” për Kosovën në fund të vitit 1992. Politika e “vijës së kuqe” e njohur edhe si “Kërcënim i Krishtlindjeve” ia bëri të qartë Serbisë dhe Jugosllavisë se në rast të përshkallëzimit të dhunës në Kosovë, Serbia do të ballafaqohet me përgjigjen e vendosur amerikane. Një mbështetje e tillë e fuqishme amerikane hapi perspektiva të mëdha ndërkombëtare për Kosovën ndërkohë që Serbia u ballafaqua me realitetin e ri për Kosovën, e cila tashmë po fitonte besimin e aleatit të madh amerikan<sup>18</sup> dhe të shteteve të fuqishme evropiane të cilat për një kohë të gjatë kishin shfaqur rezerva ndaj kërkesave dhe çështjes së shqiptarëve në Jugosllavi. SHBA-të pavarësisht nëse në pushtet ishin republikanët apo demokratët kishin konsistencë në qëndrimet e tyre diplomatike ndaj çështjes së Kosovës dhe zgjidhjes së këtij problemi që mund të merrte përmasa ndërkombëtare.

Në vazhdim të përkrahjes amerikane për Kosovën, në janar 1997 presidenti Bill Clinton shpalli Kosovën si prioritet të politikës së jashtme amerikane, ngjarje kjo që paralajmëroi zhvillime përcaktuese për fatin e Kosovës. Reagimi i Serbisë ishte i menjëhershëm duke përshkallëzuar dhunën dhe provokimet e hapura për luftë të armatosur<sup>19</sup> dhe nga ana tjetër shteti serb bënte përpjekje të pareshtura diplomatike

<sup>17</sup> Edita Tahiri, punim i cit. f. 5.

<sup>18</sup> Po aty

<sup>19</sup> Bill Clinton, *Jeta ime*, Tiranë, 2005; "Biography of William J. Clinton"; *Between Hope and History: Bill Clinton, Meeting America's Challenges for the 21st Century*, Published by Random House in September 1996; Bill Clinton, *Giving: How Each of Us Can Change the World*, Published by Knopf in September 2007.

përmes partnerëve dhe aleatëve të vet që të bllokonte proceset senzibilizuese të Kosovës dhe takimet e liderëve kosovarë në nivelet më të larta të politikëbërjes ndërkombëtare. Serbia ishte e interesuar që ta marginalizonte problemin dhe kërkesat e shqiptarëve t'i trajtonte si çështje të brendshme të Serbisë në kuadrin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Pavarësisht këtyre përpjekjeve, në dhjetor 1997 ministrat e jashtëm të NATO-s deklaruan se interesi i Aleancës për stabilitetin e Ballkanit nuk qëndronte vetëm në Bosnjë e Hercegovinë por në gjithë rajonin përfshirë këtu edhe Kosovën. Gjatë gjysmës së dytë vitit 1997 dhe vitit 1998 luftimet midis forcave ushtarake e policore serbe dhe UÇK-së morën përmasa të mëdha. Rezistenca e fuqishme e UÇK-së dhe dëmet e herëpashershme që i shkaktonin trupave serbe si në njerëz ashtu edhe në teknikë, ndikuan që kjo e fundit të hakmerrej në popullsinë civile. Gjatë vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999, u vranë rreth 2.000 shqiptarë dhe 400.000 prej tyre civilë të pafajshëm u detyruan që të linin shtëpitë e tyre dhe të zhvendoseshin në zonat me të sigurta brenda Kosovës (kryesisht në male) dhe një numër i konsiderueshëm u larguan nga Kosova për tu vendosur përkohësisht në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe në vendet e tjera të Evropës e me gjerë. Kjo valë e shpërnguljes mori përmasa sidomos pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, me ç'raste Serbia shtoi dhunën, vrasjet dhe dëbimet e shqiptarëve. Numri i refugjatëve shqiptarë brenda një periudhe relativisht të shkurtër kapte shifrën rreth 800.000 veta. Qëllimi i Millosheviqit ishte që nëpërmes valës së refugjatëve të provokonte kaos në Maqedoni dhe në Shqipëri, për ta destabilizuar kështu para së gjithash Maqedoninë, për të rrezikuar zonën vendimtare për marshim dhe furnizim të NATO-s<sup>20</sup> dhe për ta shpërqendruar vëmendjen nga Kosova me hapjen e ndonjë vatre të dytë krize.

Më 12 qershor 1998, ministrat e mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO-s vendosën që Aleanca në vazhdimësi të bëjë vlerësimin dhe masat që duhet ndërmarrë në rast të përshkallëzimit të situatës në Kosovë<sup>21</sup>. Ata e konsideronin Kosovën shumë herë më të rrezikshme se Bosnjën për shkak të implikimit të mundshëm të shteteve ballkanike si: Shqipëria, Mali i Zi, Turqia, Greqia. Ishte shumë me rrezik edhe shtrirja e konfliktit dhe luftës në Maqedoni vend ky në të cilin jetonin një numër

<sup>20</sup> Joschka Fischer, *Vitet kuq-gjelbër, politika e jashtme gjermane nga Kosova deri më 11 shtator*, Prishtinë 2007, f. 169.

<sup>21</sup> Po aty

i konsiderueshëm i shqiptarëve etnikë në trojet e veta (rreth 30% e popullsisë) të cilët ishin të diskriminuar nga qeveria e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

Më 18 tetor 1998, zyrtarët me të lartë të NATO-s, përfshirë këtu sekretarin e përgjithshëm Havier Solana, kryetarin e komitetit ushtarak gjeneral Claus Nauman dhe komandantin suprem të forcave aleate për Evropë gjeneralin Wesli Clark, vizituan Beogradin më qëllim që t'i jepnin mesazhin Millosheviqit se nëse ai nuk do të zbatonte kërkesat dhe marrëveshjet me bashkësinë ndërkombëtare NATO ishte gati që të ndërhynte ushtarakisht. Pra, mesazhi dhe vendosmëria e strukturave më të larta përfaqësuese politike dhe ushtarake të NATO-s ishte shumë i qartë pavarësisht se i drejtoheshin një njeriu që ishte dëshmuar si nacionalist radikal dhe si njeri që nuk respektonte marrëveshjet e arritura në mes palëve.

Krahas këtyre aktiviteteve Grupi i Kontaktit dërgoi në Beograd diplomatit amerikan Richard Hollbruk për të gjetur një zgjidhje diplomatike dhe për t'i dhënë fund krizës. Presidenti Millosheviq, pranoi që t'i tërhiqte forcat ushtarake dhe policore nga Kosova dhe të lejonte hyrjen e 2.000 vëzhguesve të paarmatosur të OSBE-së, mision të cilit do t'i printe ambasadori William Walker. Misioni do ta bënte monitorimin dhe tërheqjen e forcave të Millosheviqit dhe do të mbikëqyrte situatën në përgjithësi. Nga ana tjetër Milosheviq përmes vartësve të tij, gjeneralëve të ushtrisë dhe policisë, vazhdoi sulmet dhe intensifikoi luftën kundër shqiptarëve. Në emër të ndjekjes së “terroristëve shqiptarë” forcat serbe terrorizonin popullsinë civile kryesisht nëpër fshatra. Këto masa dhune dhe terrori më 15 janar të vitit 1999 rezultuan me një masakër të pazakontë në fshatin Reçak të Shtimes, ku nga forcat ushtarake e policore serbe u masakruan me shumë së 45 shqiptarë. Midis tyre ishin tri gra, një fëmijë dhe shumë pleq. Prej të ekzekutuarve, 11 kufoma u gjetën nëpër shtëpi, 23 afër dhe në një hendek në fshat kurse të tjerat në pika të ndryshme të fshatit. Shumë trupa të pajetë dyshohej se ishin vrarë nga afër, pra ishin ekzekutuar meqë ata kishin plagë plumbi në kokë dhe në zverk<sup>22</sup>. Kjo masakër fal ambasadorit Walker sensibilizoi gjithë botën. Më 16 janar 1999 Wiliam Walker kishte deklaruar: “Pasi mbërrita në Reçak, banorët e tij më çuan në vendin ku me tmerr të madh pashë kufomat e 20 njerëzve, të cilat me sa duket kishin mbetur atje ku ishin ekzekutuar. Megjithëse unë pashë vetëm 20 kufoma, kryesisht pleq të vrarë nga afër

---

<sup>22</sup> Po aty

me të shtëna në ballë dhe në kokë, vëzhgues të tjerë kanë gjetur kufoma të tjera. Edhe pse nuk jam jurist, ajo që pashë më bën të përcaktoj pa ngurrim këtë rast si masakër, si krim kundër njerëzimit<sup>23</sup>. Këto akte të dhunës dhe masakrave ndaj civilëve shqiptarë kishin për qëllim që të fusnin frikën dhe për pasojë të bënin spastrimin etnik të Kosovës. Këto nuk ishin reagime spontane të serbëve, por një aksion që ishte planifikuar prej kohësh dhe me shumë kujdes<sup>24</sup>. Si pasojë e kësaj situatë pati propozime sidomos nga diplomatë amerikanë që të radikalizohen masat në kuptimin diplomatik, por të mos përjashtohet mundësia për ndërhyrje të menjëhershme ushtarake për ta ndalur Millosheviqin, i cili nuk donte ta kuptonte gjuhën diplomatike të SHBA dhe BE. Në këtë këmbëngulje Millosheviqi llogariste edhe në ndihmën e Rusisë e cila e përkrahte vazhdimisht politikën e tij ndaj shqiptarëve.

Në këto kushte Grupi i Kontaktit (Francë, Gjermani, Itali, Britani e Madhe, Rusi dhe SHBA), kërkoi nga Millosheviqi dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës të ndërprisnin luftimet dhe të takoheshin në Rambuje të Francës për të gjetur një zgjidhje dhe për të arritur një marrëveshje. Takimi u organizua në dy faza. Faza e parë, u organizua prej 6 deri më 23 shkurt 1999 në Rambuje, kurse faza e dytë e bisedimeve u mbajt më 15 deri më 18 mars 1999 në Paris. Në këto bisedime shqiptarëve ju ofrua Autonomi e gjerë nën garancinë e NATO-s por jo edhe pavarësi e plotë, kurse serbëve ju propozua që të pranonin këtë Autonomi të Kosovës por jo edhe sovranitetin e saj. Në këtë kuptim statusi përfundimtar i Kosovës mbetej i hapur për tu zgjidhur me kalimin e kohës kur të krijoheshin kushte dhe rrethana të përshtatshme për dialog politik. Në fazën e dytë të bisedimeve delegacioni kosovar i pranoi propozimet e Grupit të Kontaktit, kurse delegacioni serb i refuzoi ato. Sekretarja e shtetit zonja Albright e bëri të qartë qëndrimin se nëse nuk do të ketë marrëveshje do të ketë pasoja për të dyja palët “nëse Serbia nuk e pranon marrëveshjen do të bombardohet nga NATO, ndërsa, nëse Kosova nuk e pranon, do të humb aleatët dhe do të izohet ndërkombëtarisht”<sup>25</sup>.

<sup>23</sup> Po aty

<sup>24</sup> Joschka Fischer, *Vitet kuq-gjelbër, politika e jashtme gjermane nga Kosova deri më 11 shtator*, Prishtinë 2007, f. 168.

<sup>25</sup> Më gjerësisht shih, Albright, Madeleine *Madam Secretary: A Memoir*, 2003; "Biography at The Washington Post". Washingtonpost.com. 1999-12-15. <http://www.washingtonpost.com/wp-srv/politics/govt/admin/albright.htm>. Retrieved 2009-06-22; Official biography at State Department site; Portrait of Madeleine Albright; Madeleine Albright, onja sekretare Autobiografi, Shtëpia botuese Dudaj, Tiranë, 2004.

Pas dështimit të Konferencës së Rambujesë e cila konsiderohet si përpjekje e fundit në vargun e gjatë të tentativave të pasuksesshme diplomatike për Kosovën, vendimi i NATO-s për ta përdorur forcën si mjet për zgjidhjen e krizës në Kosovë mbeti opsion i vetëm<sup>26</sup>. Tani të gjithë ishin të bindur se e vetmja mënyrë për t'i dhënë fund dëbimeve, vrasjeve e masakrimeve, pra gjenocidit që po bënte Millosheviqi ndaj shqiptarëve ishte ndërhyrja ushtarake e NATO-s.

Duke parë qartë këtë situatë, ministrat e mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO-s i dhanë pëlqimin dhe fuqinë sekretarit të përgjithshëm të Aleancës Javier Solana, duke autorizuar të ndërmerre vendimin për sulme eventuale ushtarake kundër Serbisë. Ky akt e bëri edhe më të besueshme mundësinë e ndërhyrjes së trupave të NATO-s, me që autoriteti i vendimmarrjes nga një institucion prej 19 anëtarësh kaloi te një person i vetëm. Nga ana tjetër edhe Javier Solana e dinte se Millosheviqi është tip politikani diktator e gënjeshtar të cilit nuk i besohet se nuk i mban premtimet dhe fjalët e dhëna, madje as kur ato janë marrëveshje të firmosura të cilat obligojnë palët nënshkruese. Madje kur Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Solana i kishte thënë Millosheviqit gënjeshtar, ky i fundit iu kishte përgjigjur “Po, keni të drejtë unë gënjej, por kjo është normale, këtë e bën secili”<sup>27</sup>.

Më 21 mars 1999, tri ditë para fillimit të operacionit, ambasadori Hollbruk shkoi në Beograd që të paralajmëronte Millosheviqin për herë të fundit. Një ditë me vonë, Slobodan Millosheviqi në vend së të pranonte vërejtjet ndërkombëtare me dashamirësi, ai ju bëri sfidë të hapur përpjekjeve diplomatike të SHBA-ve dhe faktorit ndërkombëtar në përgjithësi.

Më 23 mars 1999, ambasadori Richard Hollbruk<sup>28</sup> u largua nga Beogradi, i dëshpëruar sepse nuk kishte mundur të arrijë asnjë

<sup>26</sup> Edita Tahiri, *Konferenca e Rambujesë*, Pejë 2001, f. 79.

<sup>27</sup> Wesley K. Clark, vep e cit, f. 142.

<sup>28</sup> Richard Charles Albert Holbrooke (24 prill 1941 - 13 dhjetor 2010) ishte një diplomat amerikan, redaktor reviste, profesor dhe bankier investimesh. Ai ishte i vetmi person që ka mbajtur pozitën e Ndihmës Sekretari i Shtetit për dy rajone të ndryshme të botës (Azia 1977-1981 dhe Evropë 1994-1996). Nga viti 1993 deri më 1994, ai ishte Ambasadori i SHBA në Gjermani. Hollbruk së bashku me ish-Kryeministri suedez Karl Bildt, ndërmjetësuan marrëveshjen e paqes mes palëve ndërluftuese në Bosnje që çoi në nënshkrimin e Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit, në vitin 1995. Hollbruk ishte një pretendenti kryesor për të pasuar Warren Christopher si Sekretar i Shtetit por në vend të tij u zgjodh Madeleine Albright. Nga viti 1999 deri 2001, Hollbruk shërbeu ambasador amerikan në Kombet e Bashkuara.

marrëveshje konkrete për zgjidhjen e krizës dhe e kishte të qartë se kokëfortësia e Millosheviqit do të sillte pasoja për vetë Serbinë dhe rajonin. Millosheviqi mendonte së NATO, nuk do ta sulmonte Serbinë me që amerikanët dhe aleatët e tjerë nuk do të rrezikonin të prishnin marrëdhëniet me Rusinë për shkak të Kosovës. Kjo dhe idetë e tjera të Millosheviqit dhe të diplomacisë serbe dolën të mos jenë të sakta se sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Havier Sollana, e urdhëroi gjeneralin amerikan Wesli Clark të fillonte operacionin ushtarak bombardues të koduar me emrin “Forca Aleate” mbi ish Jugosllavinë. Përveç sulmeve ajrore Aleanca ishte e përgatitur edhe për variantin “B” që nënkuptonte operacion tokësor, pavarësisht se kjo ishte një çështje delikate. Kishte zëra në NATO që mendonin se është shumë herët të merret vendimi për operacion tokësor luftarak dhe së dyti ishte rrezik që anëtarët e NATO-s të mos mund të binin dakord për një operacion luftarak tokësor<sup>29</sup>. Nga ana tjetër nevojitej pajtimi i të gjithë anëtarëve për një “PO” e cila do të mundësonte sulmin ndaj trupave serbe e jugosllave të stacionuara në zona të ndryshme. Gjithashtu shtete si Greqia dhe ndonjë tjetër aleate e Serbisë mund të hezitonte që të dërgonte ushtarë për të luftuar kundër trupave serbe<sup>30</sup>. Ndërhyrja tokësore barte me vete edhe rrezikun e vrasjes së ushtarëve të NATO-s për të cilën edhe humbja e një ushtari të vetëm ishte domethënëse dhe me konotacione negative.

Pavarësisht vështirësive në marrjen e vendimit, goditjet e para kundër caqeve serbe u shënuan në orën 20 të datës 24 mars 1999, kur aeroplanët e NATO-s fluturuan mbi qiellin e Kosovës dhe të “RFJ”. Objektivat kryesore të NATO-s gjatë këtij operacioni ishin: t’i sulmonin caqet dhe forcat ushtarake e të sigurisë së Serbisë dhe të Jugosllavisë, ti shkatërronte element e tyre mbështetës, ti paaftësonte kapacitete ushtarake me të cilat dhunohej popullsia civile, të mbështes misionin e trupave ushtarake, të siguronte mbështetje për organizatat civile humanitare ndërkombëtare të cilat do të ndihmonin popullsinë në nevojë e cila ishte ekspozuar dhunës dhe terrorit policor e ushtarak etj.

Aleanca Veri atlantike ishte e vendosur që të mos ti ndërpriste sulmet ajrore nëse Millosheviqi nuk do ti plotësonte kushtet e shtruar nga NATO. Ndër kushtet me të rëndësishme të NATO-s drejtuar Serbisë dhe Jugosllavisë ishin: ndërprerja në Kosovë të gjitha veprimeve ushtarake, vrasjeve, dhunës dhe shtypjes, tërheqja nga

<sup>29</sup> Paskal Milo, *Kosova nga Rambuje në Pavarësi*, Tiranë 2009, 133.

<sup>30</sup> Po aty

Kosova e forcave ushtarake, policore dhe paramilitare, të pranohej që në Kosovë të vendoset një prani ushtarake ndërkombëtare ku roli i NATO-s do të ishte prijatar, të pranonte kthimin e refugjatëve të shpërngulur nga shtëpitë dhe pronat e veta, të jepte siguri së do të punonte për të realizuar Marrëveshjen e Rambujes<sup>31</sup>.

Pas 78 ditë të bombardimeve NATO u arrit që të gjunjëzohet makineria ushtarake e policore të Millosheviqit. Në ndërkohë u arrit Marrëveshja e Kumanovës me 9 qershor 1999. Më 12 qershor 1999, forcat e NATO-s me emrin “KFOR” u futen në Kosovë dhe filluan operacionin mbrojtja e bashkuar. KFOR u vendos në gjithë territorin e Kosovës duke u bërë kështu përgjegjësi kryesor për paqen dhe sigurinë brenda Kosovës.

Në Kosovë u vendos protektorati ndërkombëtar, UNMIK-u si administratë ndërkombëtare e administrimit civil dhe NATO-KFORI si forcë mbrojtëse e Kosovës për të garantuar paqen, sigurinë dhe stabilitetin e Kosovës dhe gjithë rajonit.<sup>32</sup>

Pas kthimit nga Italia, presidenti Rugova si një nga liderët më të pranuar në Kosovë kërkonte nga SHBA dhe Bashkimi Evropian që të parat të njohin pavarësinë formale të Kosovës sepse siç shprehej ai Kosova de fakto është e pavarur.<sup>33</sup>

Pavarësisht kërkesës bashkësia ndërkombëtare nuk e konsideronte Pavarësinë e Kosovës vetëm si një akt formal por si një proces të vështirë politik që do të ishte i gjatë dhe i mundimshëm. Mbi këto parime SHBA dhe BE kishin vendosur që me këtë çështje të merrej Presidenti finlandez Marti Ahtisari i cili organizoi një varg konsultimesh e negociatash për të propozuar në fund statusin përfundimtar të Kosovës.

Presidenti Ahtisari pasi që përfunduan negociatat e Vjenës, në nëntor të vitit 2006, kur edhe ishte mbyllur procesi i diskutimeve, filloi hartimin e raportit përfundimtar dhe planit të tij për statusin final të Kosovës. Ai ndërmori një varg aktivitete diplomatike nëpër qendra të rëndësishme të politikbërjes si: Bruksel, Uashington, Moskë, Berlin,

<sup>31</sup> Dr. Gëzim Mustafaj, “Intervenimi i NATO-s, Sfidat dhe rezultatet”, Fejton nr. 3, Epoka e Re, Prishtinë 5 shkurt 2011.

<sup>32</sup> Ibrahim Rugova, Realizimi i shtetit të Kosovës është i pa evitueshëm, Intervistë në “Bota sot” më 12 prill 2000.

<sup>33</sup> Ibrahim Rugova, Njohja e pavarësisë ia heq popullit të Kosovës drojën për ardhmërinë e vet, “Zëri” 31 dhjetor 2002 dhe 1, 2 e 3 janar 2003.

Paris, Londër, madje edhe në Pekin, me qëllim të koordinimit me palët e interesuara.<sup>34</sup>

Institucionet e Kosovës treguan maturi politike dhe ishin në koordinim të plotë me qëndrimet e miqve të Kosovës.<sup>35</sup> I pari që publikisht kishte përmendur se Kosova duhet të pavarësohet, ishte Presidenti i SHBA-së Gjorgj (W) Bush, me 10 qershor 2007 në vizitën e tij që i kishte bërë Shqipërisë. Bush në mes tjerash kishte deklaruar: “... dialogu në lidhje me arritjen e pavarësisë për Kosovën, nuk mund të zgjasë përgjithmonë... është më mirë shpejt, sesa më vonë të thuhet (...) kjo është mjaft, Kosova është e pavarur...”<sup>36</sup>

Në anën tjetër diplomati amerikan Nicholas Burns e bëri shumë të qartë mesazhin e presidentit Bush kur tha: “SHBA-ja pranon të flasë vetëm për datën kur do të bëhet Kosova e pavarur, dhe jo për atë se a duhet të marrë pavarësinë”.<sup>37</sup>

Në këtë vazhdimësi përpjekjesh diplomatike e deklaratash politike të Kosovës, Serbisë dhe akterëve politik të cilët kishin interesat e tyre të caktuara në Kosovë, ishte vendimtarë vendimi i SHBA pas së cilës u rreshtuan edhe shtetet më të fuqishme të BE të cilat tashmë e kishin marrë vendimin për të ardhmen e Kosovës. Kështu më 17 shkurt 2008, përfundoi rrugëtimi i gjatë, sfidat, pritshmeritë dhe dilemat rreth statusit të Kosovës. Institucionet e Kosovës si Presidenca dhe Qeveria të mobilizuara morën pjesë në Kuvendin historik ku përfaqësuesit e popullit e shpallën Kosovën shtet sovran dhe të pa varur.

Kosova në 10-vjetorin e shpalljes së pavarësisë numëron një varg të arriturash të konsiderueshme por edhe ngecje e sfida si në planin e brendshëm po ashtu edhe në politikën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

<sup>34</sup> Po aty.

<sup>35</sup> Paskal Milo, vep e cit. fq, 246.

<sup>36</sup> Dario Malnar, vep e cit. fq, 320.

<sup>37</sup> Po aty.

Jusuf BAJRAKTARI

## HISTORICAL DIMENSION OF KOSOVA INDEPENDENCE

### Summary

*The long journey of ideas and liberation movements through the tumultuous swells of the interests intertwined in the Balkans, has often forced the various elites and protagonists to adapt even to conflicting social circumstances only to preserve the major goal - achieving independence as a fundamental precondition to the consolidation and advancement of the nation state.*

*These legitimate and natural ideas are identified in the long chain of political activities and uprisings, from the Albanian League of Prizren and the League of Peja (1899) to the 1913 London Conference of Ambassadors, from the Kosova National Defense Committee, the Mukje Conference, the Second Prizren League and Bujan Conference, to the demonstrations of 1968 and 81, the Constitution of 1974, Constitutional Declaration of July 2, Constitution of Kacanik, awareness-building and internationalization of the Kosova issue, KLA War, until the Declaration of Independence of Kosova.*

*The Kosova War and the resolution of its crisis marked the end of the bloody conflicts in the former Yugoslavia. With Kosova an independent and sovereign state proclaimed on 17 February 2008, the political map of the Balkans has taken its final shape, and the postulates for a new and equal life of its peoples have finally been established.*

**Key words:** *Kosova, Serbia, Kosova Independence, International Diplomacy, US, EU, Kosova Assembly*

# KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR I REZISTENCËS PAQËSORE TË SHQIPTARËVE TË KOSOVËS I UDHËHEQUR NGA PRESIDENTI RUGOVA NË VITET E '90-TA

**Beqir Meta**

## **Përmbledhje**

*Kjo kumtesë do të trajtojë kontekstin ndërkombëtar të rezistencës paqësore të shqiptarëve të Kosovës në vitet 90-të.*

*Analiza që do të bëhet synon të krahasojë avantazhet dhe disavantazhet e gjendjes së shqiptarëve në vitet 90-të me situatën ndërkombëtare në Ballkan dhe në Evropë.*

*Për të analizuar situatën dhe natyrën e marrëdhënieve ndërkombëtare në Evropë dhe Ballkan i jam referuar literaturës përkatëse, kryesisht të huaj më relevante dhe njëkohësisht më të re.*

*Analiza synon të zbulojë ata faktorë që ndikonin mbi çështjen shqiptar dhe mënyra se si ndikonin ato.*

*Në përputhje me këtë analizë do të jepen gjykime edhe për formën e rezistencës që zgjodhën shqiptarët, dimensionet, shtrirjen, mesazhet ndërkombëtare e kombëtare që dha ajo, forcën e saj dhe impaktin kombëtar e ndërkombëtar të saj.*

*Parahistoria dhe preludi i fillimit të kësaj rezistence do të analizohen për të krahasuar dimensionet e saj me thellësinë historike të rezistencës shqiptare.*

*Roli i dr. Ibrahim Rugovës dhe i lidërshiptit të asaj kohe do të analizohen në kontekstin e këtyre shtjellimeve që përcaktuam më lart.*

**Fjalët çelës:** Kosova, Rugova, Ballkani, Evropa, Diplomacia.

Konflikti në Kosovë në fund të viteve 90-të ishte një konflikt shekullor midis shqiptarëve dhe serbëve, i cili e kishte filluesën qysh prej Luftërave Ballkanike (tetor 1912), kur Serbia pushtoi Kosovën, pushtim i cili u sanksionua me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër (korrik 1913). Shqiptarët rezistuan përreth një shekull dhe mbetën gjithmonë shumicë dërrmuese në Kosovë. Gjatë “Luftës së Ftohtë” midis regjimit serb në Kosovë dhe shqiptarëve të Kosovës (1989-1997) ishte rritur “një gjeneratë e re e Republikës së Kosovës”, e cila faktikisht nuk kishte se çfarë të humbiste.<sup>1</sup>

Në këtë kumtesë do të përpiqemi të trajtojmë se cila ka qenë rrjedha e marrëdhënieve ndërkombëtare që e shoqëroi rezistencën paqësore të shqiptarëve në vitet 90-të, si dhe ndikimet e kushtëzimet e saj mbi këtë rezistencë.

Në kuadër të shpërbërjes së RSFJ-së, Kosova, sikurse edhe republikat e tjera, më 21 dhjetor 1991 parashtrori një kërkesë për njohjen ndërkombëtare të pavarësisë tek kryesuesi i Konferencës për Jugosllavinë, Lordi P. Carrington, dhe tek ministrat e Jashtëm të 12 shteteve anëtare të Komunitetit Evropian. Qeveria e Republikës së Kosovës zyrtarisht nuk mori as përgjigje pozitive e as negative, gjë që në përgjithësi u interpretua si refuzim i kërkesës për pavarësinë e Kosovës.<sup>2</sup>

Më 27 prill 1992 u konstituua “Republika Federale e Jugosllavisë” – RFJ-ja e Miloševićit – e përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi, e cila pretendonte të ishte pasardhëse ligjore e Jugosllavisë së dikurshme”.<sup>3</sup> Në kushtetutën e saj, Kosova në mënyrë të vetëkuptueshme trajtohej si pjesë e Serbisë, madje nuk përmendej

<sup>1</sup> Sipas revistës serbe NIN, e cila citon hulumtimet e US Information Agency (USIA), në atë kohë thuhej se “94 për qind e shqiptarëve [paskan qenë] të gatshëm të vdesin për arritjen e caqeve të tyre”. Solobadan Relić: Čiji je interes Kosova? [Në interes të kujt është Kosova?] në: NIN, 19 mars 1998, f. 9. Në anën tjetër anketat në anën serbe e qartësojnë ftohjen kolektive dhe armiqësore të serbëve me shqiptarët dhe dominimin e stereotipeve raciste gjatë vlerësimit të tyre. Shih. Ivana Lazić: Brak sa Albancem [Martesa me shqiptarin], në: Naša Borba, 21/22 mars 1998.

<sup>2</sup> Arben Hajrullahu, *Paqja afatgjatë në Ballkanin Perëndimor përmes integritit në BE- Procesi i Integritit në BE si mundësi për tejkalimin e konfliktit serbo-kosovar*, Prishtinë: 2015, f.85.

<sup>3</sup> Službeni list BRJ [Gazeta Zyrtare e RFJ-së], nr. 1/1992. Përkthimi në anglisht në: Yugoslav Law, 2-3/1992. Ekstrakte të tij në gjermanisht e J. Marko: “Der Minderheitenschutz in den jugoslawischen Nachfolgenstaaten” [Mbrojtja e pakicave në shtetet pasardhëse jugosllave], Bon, 1996, f. 249 v.

asnjëherë të vetme.<sup>4</sup> Pretendimi i këtij “shteti të rithemeluar” për të qenë pasardhës ligjor i RSFJ-së u refuzua megjithatë nga Komisioni i Badinterit.<sup>5</sup> Krijesa shtetërore e RFJ-së së Milošević-it, e cila në fakt ishte krijimi i një “Serbie të Madhe”, nuk i plotësonte kriteret e njohjes, madje ky shtet nuk kishte parashtruar kurrfarë kërkesë zyrtare për njohje si “pasardhëse ligjore” e RSFJ-së.<sup>6</sup>

Në procesin e dezintegritimit të hapësirës së dikurshme jugosllave, reagimi i bashkësisë ndërkombëtare ndaj konfliktit të Kosovës për një kohë të gjatë përbëhej nga deklaratat politike me synime dhe kërkesa pa efekt ndaj Beogradit, në vend që të inicioheshin masa konkrete të mbështetjes për politikën dhe rezistencën paqësore të kosovarëve. Një përjashtim në këtë sjellje pasive paraqet vetëm “gjuha më e qartë” e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila kishte të bënte vetëm me *modusin* e ndaljes së konfliktit në Kosovë. “Më 27 dhjetor 1992, presidenti amerikan në largim, George Bush, premtoi se SHBA-ja nuk do të lejojë që Kosova të bëhet një Bosnje e dytë”. Duke pranuar raportet e inteligjencës në lidhje me një goditje të planifikuar serbe në Kosovë, ai kërcënoi me sulme të njëanshme ajrore kundër caqeve strategjike në Serbi. Presidenti Clinton e rifuqizoi këtë paralajmërim në shkurt 1993”.<sup>7</sup>

<sup>4</sup> Arben Hajrullahu, *Paqja afatgjatë në Ballkanin Perëndimor përmes integritimit në BE ...*, Prishtinë: 2015, f.85.

<sup>5</sup> *Po aty*, f.85. Sipas këtij autori: Në ekspertizën nr. 9, dt. 4 korrik 1992 (International Legal Materials, më tutje: ILM) 31/1992, f. 1523-5, Komisioni i Badinterit thotë se të gjitha republikat e dikurshme jugosllave qenkan shtete pasardhëse të RSFJ-së së dikurshme dhe asnjë shtet nuk mund të pretendojë vetë të drejtat e deritanishme të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare. Në ekspertizën nr. 10, dt. 4 korrik 1992 ILM 31/1992, f. 1525 v, Komisioni i Badinterit konstaton mes tjerash, se RFJ-ja e Milošević-it qenka një shtet i ri dhe njohja e RFJ-së së Milošević-it u orientuaka sipas kriterëve të njohjes së Komunitetit Evropian (shiko për këtë direktivat e BE-së për njohjen e shteteve të reja në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik nga 16 dhjetori 1991, në: ILM 1992, f. 1486 v., si dhe Deklaratën e BE-së rreth njohjes së republikave jugosllave nga 16 dhjetori i 1991; në ILM 1992, f. 1485 v.) më tutje OKB-ja, Këshilli i Evropës dhe Konferenca e atëhershme për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (më tutje: KSBE) në frymën e rekomandimeve të Komisionit të Badinterit kanë refuzuar po ashtu pretendimin e kontinuitetit të RFJ-së Milošević-it.

<sup>6</sup> *Po aty*, f.85.

<sup>7</sup> Howard Clark: *Civil Resistance in Kosova*, Londër etj. 2000, f. 89. Edhe gazeta serbe “Borba” raportonte më 1 mars 1993 për një letër të presidentit amerikan Bill Clinton dërguar presidentit serb S. Milošević, në të cilin i pari e paralajmëronte nga përdorimi i dhunës në Kosovë dhe theksonte se “[...] në rast të një konflikti në Kosovë, të shkaktuar përmes veprimeve të palës serbe, SHBA-të do të ishin të

Studiuesit japin edhe arsyet e këtij kërcënimi. Sipas tyre, në krishtlindjet e vitit 1992, Kosova u deklarua si vija e kuqe nga Presidenti George Bush, sepse kapërcimi i saj (konflikti në Kosovë) do të kërcënonte rëndë interesat amerikane dhe do ta detyronte SHBA të përdorte forcën ushtarake.

Katër muaj më vonë, Sekretari i Shtetit i Administratës Clinton, Warren Christopher, deklaroi në mënyrë më specifike: Ne jemi të shqetësuar se, nëse dhuna serbe zgjerohet drejt Kosovës, ajo do të fuste në konflikt vende të tjera në rajon: Shqipërinë, Greqinë, Turqinë. Kështu detyra e SHBA është të parandalojnë zgjerimin e konfliktit që do të përfshinte aleatët tanë të NATO-s dhe të çonte pjesë të gjera të Evropës në luftë dhe ndoshta, siç ka ndodhur më parë, kjo do të eskalonte në një luftë botërore.<sup>8</sup>

Deklarata amerikane u përjetua si një mesazh shprese për shqiptarët dhe ka nxitur angazhimin në një rezistencë aktive kundër regjimit serb. Pra ky element ndërkombëtar ishte ndikues tek forcimi dhe mbajtja gjallë e rezistencës paqësore, por edhe inkurajim për rezistencë të armatosur.

Megjithatë, gjatë luftërave midis serbëve dhe kroatëve, binte në sy mungesa e ndërhyrjes amerikane, e cila ishte logjike dhe e justifikuar, në periudhën e parë pas rënies së komunizmit. Në fakt ky qëndrim ishte në kontrast me skenarët e përgatitur nga NATO gjatë viteve 70-të. Në këto dokumente strategjike parashikohej që, nëse pas vdekjes së Titos, Jugosllavia do të kthehej në një zonë shëri midis dy superfuqive SHBA dhe NATO, duhej të ndërhnin me të gjitha mjetet.<sup>9</sup>

Eksperienca e SHBA, si një fuqi e madhe industriale me lidhje politike dhe ekonomike me Evropën, dëshmonte se ngjarjet e këtij shekulli sugjeronin që një sfidim madhor kundër demokracisë liberale në Evropë, herët ose vonë do t'i vinte interesat amerikane në rrezik.

---

gatshme të dërgojnë njësitë ushtarake kundër serbëve në Kosovë dhe madje edhe në vetë Serbi”. Shiko Archiv der Gegenwart nga 3 marsi 1993, f. 37627.

<sup>8</sup> Stephen Engelberg, *Weighing Strikes in Bosnia, US Warns of Wider War*, The New York Times, 25 prill 1993; Mark Danner, “Endgame in Kosova: Ethnic Cleansing and American Amnesia”, në botimin: *Kosova: Contending Voices on Balkan Interventions*, Edited by William Joseph Buckley, f. 69.

<sup>9</sup> François Hesibourg, “The Future of the Atlantic Alliance: Whither NATO, Whether NATO”? Në botimin U.S. *Security in an Uncertain Era*, edited by Brad Roberts, MIT Press, Cambridge, Massachusetts, London, England, pp. 100.

Kështu ishte interes vital i SHBA që të ruante dhe mbronte liberalizmin politik dhe ekonomik në Evropën Perëndimore.<sup>10</sup> Kjo ishte dhe shpresa e madhe e shqiptarëve se SHBA do të ndërhyjnë për mbrojtjen e tyre dhe do të përkrahnin aspiratat dhe lëvizjen e tyre paqësore për pavarësi, e cila gjithsesi në atë kohë ishte vërtetë dilema më e madhe e kombit tonë.

Parandalimi i rreziqeve, të cilat mund të ktheheshin në kërcënime serioze, duke përdorur mjete diplomatike, ekonomike, institucionale dhe mjeteve të tjera të ngjashme me to, ishte kyç për agjendën e re të sigurimit evropian. Njëri prej këtyre rreziqeve (nga studiuesit renditej i tretë) parashikohej të ishte akomodimi i vendeve të reja evropiane në Koncertin Evropian. Këtu përfshiheshin edhe vendet e reja të Ballkanit postkomunist.

Ngjarjet në Jugosllavi ishin shqetësuese se, të paktën, mund të involvonin në konflikt tre shtete ballkanike (Shqipërinë, Bullgarinë dhe Hungarinë), të cilat do të implikonin edhe komunitetin ndërkombëtar. Kjo mund të çonte në kolapsin e demokracive të reja në Budapest, Pragë dhe Varshavë, pasi do të agravonte gjendjen ekonomike dhe tensionet sociale brenda tyre.

Rikthimi i të kaluarës dhe frika ndaj së ardhmes kishte shfaqjet e saj edhe në vendet perëndimore. Rasti i lëvizjes së Jean Marie Le Pen ishte më spektakolari në këtë drejtim.

### *Konferenca për Jugosllavinë në Londër*

Përgjatë gjithë viteve 90-të, simpatia perëndimore e krijuar për rezistencën civile në Kosovë nuk u shndërrua asnjëherë në mbështetje politike konkrete për ta zgjidhur këtë çështje. Luftëra të përgjakshme zhvilloheshin në Kroaci dhe Bosnje, ndërsa bashkësia ndërkombëtare ishte e paqartë se cili do të ishte fundi i Jugosllavisë. Bashkësia ndërkombëtare, për dallim nga qasja më serioze ndaj situatës në vendet ku luftohej dhe kryheshin masakra, në Kosovë mjaftohej me retorikë mbështetëse. Natyrisht që diplomacia perëndimore mendohej t'i menaxhonte prirjet e shoqërisë kosovare, disa rezoluta ndërkombëtare dhe qëndrime të miratuara në forume të ndryshme, jo vetëm që e dënonin dhunën e regjimit serb, por politikisht synonin t'i jepnin sinjale shpresëdhënëse durimit të shoqërisë në Kosovë.

Rezistenca paqësore kosovare u stërzgjat me vite dhe nuk po prodhonte rezultatet e pritura. Deri në verën e vitit 1992 Kosova kishte

---

<sup>10</sup> *Po aty*, pp.101.

një vëmendje sipërfaqësore të opinionit publik ndërkombëtar dhe të disa politikanëve perëndimorë. Ky qëndrim ndërkombëtar dukej mirë në formë, por asgjë nuk po ndodhte në substancë. Në fakt, Kosova ishte përjashtuar qëllimisht nga mekanizmat ndërkombëtarë që merreshin me procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë.

Veçmas, në dy konferenca ndërkombëtare në vitet 90-të u dëshmuar qartë se rezistenca paqësore për arritjen e qëllimeve politike po rezultonte si një pritje naive. E para ishte Konferenca e Londrës, e cila u përjetua si fyerje dhe injorim nga ana kosovare. Ajo nuk ishte fare pjesë e një procesi ndërkombëtar. Fillimisht, në vitin 1992 u formësua bindja se Kosova do të ftohej në Konferencën për Jugosllavinë, e cila do të mbahej në Londër, në muajin gusht.<sup>11</sup> Ftesa erdhi për Ibrahim Rugovën, që në atë kohë ishte zgjedhur kryetar i Kosovës. Mirëpo, siç thotë Marc Weller, ishte “një letër, që me siguri do të jetë unikalë në historinë diplomatike”.<sup>12</sup>

Në fakt delegacioni i Kosovës nuk mori pjesë në punimet e konferencës, meqë nuk ishte i ftuar i barabartë me të tjerët. Me gjithë mospjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në konferencë, për delegacionin e Kosovës ishte organizuar një dhomë e veçantë, e emëruar si “sallë dëgjimi” (*salla d'ecoute*).<sup>13</sup> Nga aty, nëpërmjet televizorit, mund të përcillehin punimet e konferencës. Delegacioni kosovar kishte rastin të bisedonte herë pas here me Lordin Carrington, që ishte udhëheqës i Konferencës së Londrës dhe me diplomatë të tjerë, duke shtruar kërkesat e tij. Mirëpo Kosova nuk ishte temë në këtë ngjarje diplomatike. Një trajtim serioz i saj nuk ndodhi.

Megjithëse kjo atëherë dukej zhgënjyese, e vështruar nga largësia tashmë mbi 25 vjeçare, duhet theksuar se kjo rezistencë paqësore po e bënte punën e saj me shumë efikasitet: ajo po e fuste në agjenda ndërkombëtare çështjen e Kosovës, po rriste simpatinë perëndimore dhe përkrahjen ndaj saj; po krijonte bindjen absolute se çështja e Kosovës ishte një problem që nuk mund të neglizhohej gjatë dhe kërkonte zgjidhje të shpejtë e substanciale. Por rezistenca paqësore po

---

<sup>11</sup> Për konferencat e para që u organizuan për t'i zgjidhur çështjet e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe Kosovës, shih: Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Prishtinë: Koha, 2009, f. 93-127.

<sup>12</sup> Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Prishtinë: Koha, 2009, f. 103.

<sup>13</sup> *Po aty*, f. 104.

ndikonte edhe në formimin dhe forcimin e ndjenjave kombëtare të opinionit shqiptar brenda dhe jashtë Kosovës.

### *Marrëveshja e Dejtonit*

Ngjarja tjetër e dytë ishte Konferenca e Dayton-it, e cila do të merrej me përfundimin e luftës së përgjakshme në Bosnje e Hercegovinë. Në të gjitha konferencat dhe mekanizmat, bashkësia ndërkombëtare do të merrej me temat e pavarësimit të Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjës dhe Maqedonisë. Por Bosnja, e cila ishte pavarësuar dhe njohur ndërkombëtarisht, përballej me një luftë të përgjakshme. Kështu Dayton-i do të fokusohet vetëm në ndaljen e luftës dhe përcaktimin e arkitekturës së ardhshme politike të Bosnjës.

Në Dayton Kosova nuk u ftua fare. Regjimi serb vazhdonte të bënte shkelje masive kundër popullatës civile, të cilat u konfirmuan nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dhe mekanizma të tjera ndërkombëtare. Për më tepër, në Dayton, Millosheviqi u pa si faktor paqëje dhe stabiliteti rajonal. Diplomatat perëndimorë ishin mirënjohës për angazhimin e tij në “paqebërjen” dhe për qasje “konstruktive” karshi rajonit. Kjo gjë e forcoi më shumë regjimin e tij.<sup>14</sup> Mirëpo, fundi i luftës që u arrit në Bosnjë nuk do të thoshte edhe fundi i konfliktit në Kosovë.

Dayton-i shkaktoi zemërim më të madh se sa mendohej në Kosovë dhe pas kësaj do të bëhej një kthesë historike. Do të zveniteshin shpresat se pavarësia mund të arrihej vetë nëpërmjet rezistencës paqësore dhe konflikti do të shkonte drejt përshtetëzimit të tij. Shpejt, kriza e Kosovës u shndërrua në një luftë të re dhe të përgjakshme. A ka qenë një situatë reale historike mundësia e pjesëmarrjes së Kosovës në Dayton, apo vetëm një pritje e gabuar, kjo mbetet një çështje debati ende sot.<sup>15</sup> Por ne jemi të mendimit se, duke studiuar rrethanat dhe kundërshtitë e mëdha ndërkombëtare që kishte zgjidhja e krizës jugosllave, këto mundësi për një zgjidhje totale nuk ekzistonin, pasi kërcënimi i paqes botërore ishte tepër i madh.

Marrëveshja e Dejtonit<sup>16</sup> pra pati efektin e një katalizatori ndaj situatës së “Luftës së Ftohtë” që ekzistonte në Kosovë që nga viti 1989,

<sup>14</sup> Noel Malcolm, *Kosova: A short History*, London, Macmillan, 1998, f. 353.

<sup>15</sup> Enver Hoxhaj, *Ngritja e një shteti...*,

<sup>16</sup> Marrëveshja e Dejtonit ndali luftën në Bosnje dhe Hercegovinë (prill 1992- nëntor 1995) dhe “çimentoi spastrimet etnike”, zhvendosjen masive të popullatës, ndarjen e Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës në dy përkatësisht tri territore etnikisht “të pastra”. Përveç kësaj, mbi bazën e kësaj marrëveshjeje, “qeveritë e

por edhe ndaj strategjive politike të shqiptarëve të Kosovës. Në këtë marrëveshje u injoruan përpjekjet paqësore kosovare për ta ndaluar konfliktin në mënyrë të civilizuar. Në pamje të jashtme dukej sikur, në nivel ndërkombëtar, politika pa dhunë, e ndjekur nga I. Rugova, u kuptua më shumë si dobësi e kosovarëve dhe jo si shans që konflikti, edhe pse në një proces disi më të gjatë, të zgjidhej sipas vullnetit të popullit dhe sipas rregullave të pranuarra përgjithësisht të së drejtës ndërkombëtare. Segmente të shoqërisë kosovare, përmes kësaj, kuptuan se njohja ndërkombëtare e të drejtës për një Kosovë të pavarur, të synuar përmes strategjisë së rezistencës paqësore, do të shtyhej derisa të ishin të gatshme që të bënin më shumë për çështjen e tyre, e thënë troç, të merrnin armët në duar.

Marrëveshja e Dejtonit e bëri të qartë se komuniteti ndërkombëtar nuk do të sanksiononte ndonjë ndryshim në kufijtë e Jugosllavisë. Ky qëndrim u konsiderua si një hipokrizi e gjallë nga shqiptarët e Kosovës, të cilët mendonin se serbët e Bosnjës u lejuan të krijonin Republikën Serbska, madje atyre iu krijua mundësia që të krijonin lidhje konfederative me Serbinë. Atëherë pse shqiptarët nuk duhet të kishin republikën e tyre të Kosovës në kuadrin e Jugosllavisë? Shqiptarët e kuptuan se ata gjendeshin në këtë pozitë humbëse, sepse deri në këtë kohë, nuk i kishin mbështetur kërkesat e tyre me armë.<sup>17</sup> Sigurisht kjo ishte një goditje për shpresat pacifiste se çështja do të zgjidhej me mjete legale.

Pavarësisht deklaratave të panumërta për shkeljen e të drejtave të njeriut, komuniteti ndërkombëtar vijoi ta injoronte çështjen e vetëvendosjes së Kosovës, duke këmbëngulur se problemi i Kosovës ishte një problem i brendshëm i Jugosllavisë. Rrjedhimisht, shqiptarët duhej të rivlerësonin qëndrimin e tyre politik. Të bindur se politika e tyre pasive gjatë luftërave në Jugosllavi u kishte mohuar atyre ftesën për pjesëmarrje në bisedimet për paqe, shumë shqiptarë të Kosovës tashmë ishin të vendosur të parandalonin ndonjë zgjidhje kompromisi që ato nuk e donin. Ata mësuan nga Dejtoni se fitorja e serbëve të Bosnjës kishte ardhur nga lufta. Shumë shqiptarë tashmë forcuan

---

përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në luftë në Zagreb dhe Beograd shpëtuan kryesisht pa kushtëzime”. U. Schneckener: “Regulierung ethnischer Konflikte in Südosteuropa. Die Politik der Anerkennung” [Rregullimi i konflikteve etnike në Evropën Juglindore. Politika e njohjes], në: Internationale Politik –Europa Archiv 9/1999, f. 11.

<sup>17</sup> Miranda Vickers, *Kosova, the illusive state*, f. 99.

bindjen se komunitetit ndërkombëtar kuptonte vetëm gjuhën e konfliktit të armatosur dhe jo rezistencën paqësore.<sup>18</sup>

Për më tepër, ngjarjet që rrodhën më tej në Kosovë treguan se negociatorët perëndimorë, së paku sipas vlerësimit të S. Milošević-it, në mënyrë indirekte, kishin hyrë në një lloj tregtie këmbimi me të: “Stabiliteti dhe paqja në Bosnjë” në këmbim të “dorës së lirë në Kosovë”. Kështu, përveçse marrëveshja e Dejtonit nuk e “shpërbleu” strategjinë politike paqësore të I. Rugovës, krijoi përshtypjen se u pranua politika agresive e udhëheqësit serb S. Milošević-it.<sup>19</sup> Mes të tjerash kjo ndodhi, sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk dëshironin të rrezikonin procesin e Dejtonit për “arsye pragmatike” të zgjidhjes së kësaj situatë të koklavitur dhe sepse sipas këndvështrimit amerikan bëhej fjalë, para së gjithash, për një çështje të Evropës.

Ky “mospreokupim” me problemin stimuloi edhe vështrimin e bashkësisë ndërkombëtare që doli se ishte më tepër optimist se realiteti, sipas të cilit konflikti i Kosovës ishte zbutur, sepse dy palët në konflikt nuk kishin hapësira fërkimi dhe shqiptarët u besonin mjeteve paqësore dhe pasive.<sup>20</sup>

Rezistenca paqësore shqiptare bazohej në premisën se shoqëria kosovare duhet të ishte e duruar, derisa bashkësia ndërkombëtare të siguronte një zgjidhje të favorshme për Kosovën. Pas Dayton-it, kjo rezultoi të ishte iluzion, sepse nga aspekti i jashtëm dukej se askush nuk merrej me këtë çështje. Megjithatë logjikisht nuk ishte kështu: unë mendoj se ishte kryesisht çështje e strategjisë politike që Kosova ishte lënë e fundit në radhë. Dhe kjo ka plot arsye për t’u analizuar. Kur të hapen arkivat ndërkombëtare, jam i bindur se ne historianët do të

<sup>18</sup> *Po aty*, f. 99.

<sup>19</sup> J. Reuter raportonte se si në fillim të vitit 1992 qarkullonte thashethemja se Perëndimi paskësh lidhur një “ujdi” me S. Milošević-in, “Për miratimin e tij për stacionimin e helmetave të kaltra në Krajinë [në atë kohë territore të kontrolluara nga serbët përreth qytetit Knin në Kroaci] presidenti i atëhershëm serb paska marrë premtimin se problemi i Kosovës nuk do të vendoset në agjendën ndërkombëtare”. J. Reuter, “Die internationale Gemeinschaft und der Krieg im Kosova” [Bashkësia ndërkombëtare dhe lufta e Kosovës], në: *Südosteuropa* 7-8/1998, f. 282.

<sup>20</sup> Arben Hajrullahu, *Paqja afatgjatë në Ballkanin Perëndimor përmes integritimit në BE...*, f. 87. Autori referon: Stefan Troebst: *Chronologie einer gescheiterten Prävention: Vom Konflikt zum Krieg im Kosova, 1989-1999* [Kronologjia e një prevencioni të dështuar: Nga konflikti deri te lufta në Kosovë, 1989-1999], në: *Osteuropa* 8/1999, f. 779.

shohim se rezistenca paqësore ka qenë efektive dhe ka kryer misionin historik që i takonte.

Gjithsesi, atëherë dukej se vlerave të kësaj rezistence, si vetëpërmbytja dhe durimi, gradualisht u erdhi fundi. Pritja në pakufi për shmangien e konfliktit të armatosur, ndonëse kishte shërbyer për të ndërkombëtarizuar gradualisht problemin dhe për të shmangur konfliktin, në një periudhë kur Perëndimi, ndoshta nuk mund ose nuk ishte i përgatitur të ndërhynte, nuk mund të vijonte më tej. Pamundësia për të përfshirë Kosovën në Marrëveshjen e Dayton-it shërbeu si një moment kthese për zhvillimet e brendshme.<sup>21</sup>

Diplomati amerikan, Richard Holbrooke, arkitekti i kësaj marrëveshjeje, nuk thotë asgjë thelbësore në kujtimet e tij mbi mospërfshirjen e Kosovës në këtë konferencë.<sup>22</sup> Supozohet se një nga arsytet pse Kosova u përjashtua nga tryeza e negociatave ishte frika se Millosheviqi nuk do të bashkëpunonte për përfundimin e luftës në Bosnjë, si dhe mund të tërhiqej nga tavolina e bisedimeve. Sido që të jetë, mospjesëmarrja në këtë konferencë ishte mesazhi më i qartë se rezistenca paqësore dhe civile për të siguruar mbështetje ndërkombëtare në zgjidhjen e çështjes së Kosovës nuk kishte më kredibilitet.<sup>23</sup>

Por një mendim disi më të ndryshëm ka shprehur studiuesi Marc Danner, i cili thekson se në Dayton, kriza e Kosovës në të vërtetë nuk u anashkalua, por vetëm u shty. Në fakt këtë mendim e ka shfaqur me forcë edhe ambasadori Richard Holbrooke.<sup>24</sup> Nga analiza që mund t'u bëjmë sot ngjarjeve, ky duket edhe interpretimi më i drejtë.

### *Qëndrimi i shteteve të BE-së dhe Parlamentit Evropian ndaj Kosovës pas Dayton-it*

Pas Dayton-it, disa nga shtetet më të mëdha të BE-së filluan ta shikonin RFJ-në e Milošević-it si krijesë shtetërore legjitime dhe e njohën atë më 1996. Ky hap ishte juridikisht tejet i diskutueshëm, sepse nuk ishin të pranishme parakushtet e nevojshme sipas standardeve

<sup>21</sup> Howard Clarck, *Civil Resistance in Kosova*, London, Pluto Press, 2000, f. 112-151.

<sup>22</sup> Holbrooke përmend Kosovën vetëm në rastin e fillimit të luftës në vitet 1998-1999, shih: Richard Holbrooke, *To End a War*, New York: Random House, 1999, f. 234, 358-359.

<sup>23</sup> M. Weller, *Shtetësia e kontestuar*, f. 143.

<sup>24</sup> M. Danner, *Endgame in Kosova...*, f. 69; Richard Holbrooke, *To end a War*, New York: Random House, 1998, p. 357.

evropiane për një njohje, si sundimi i ligjit, demokracia etj.<sup>25</sup> Përmes njohjes së RFJ-së së Milošević-it u zhvendos shumë larg edhe mundësia e një ndaljeje “paqësore” të konfliktit midis Kosovës dhe Serbisë. Kështu gjendja në Kosovë nuk u përmirësua as para e as pas njohjes; e kundërta, ajo eskaloi vazhdimisht më tutje. Dukej sikur ky përkeqësim nuk ishte relevant për qeveritë e shteteve anëtare të BE-së, të cilat më 1996 lidhën marrëdhënie diplomatike me RFJ-në e Milošević-it.<sup>26</sup>

Por në këto momente kritike pati edhe zhvillime ndërkombëtare në një kahe tjetër. Parlamenti Evropian që nga viti 1989 në rezoluta dhe deklarata të shumta<sup>27</sup> kishte tërhequr vërejtjen se mënyra e veprimit të

<sup>25</sup> Franca dhe Britania e Madhe më 10 prill 1996 lidhën të parat marrëdhëniet diplomatike me RFJ-në e Milošević-it. Paskan më 16 prill 1996 Austria, më 17 prill 1996 Gjermania dhe vende të tjera të BE. Shiko: Archiv der Gegenwart 66/1996, f. 40974.

Parakushtet e nevojshme sipas standardeve evropiane për njohjen e shteteve të reja sovrane, si sundimi i ligjit ose demokracia, këtu nuk ishin kurrsesi të plotësuara. Kështu për shembull, në një rekomandim për nevojën e një ndaljeje të shpejtë të konfliktit rreth ardhmërisë së Kosovës (GZ. Nr. C 078 nga 18 marsi 1996, f. 0015) të Parlamentit Evropian, pra afro një muaj para njohjes së RFJ-së së Milošević-it, nga ana e shteteve anëtare të BE-së u theksua:” 1. [...], njohja e plotë diplomatike e Republikës së re Federative të Jugosllavisë [do të duhet...] të varet nga ajo se as është arritur një rregullim i gjerë dhe i kënaqshëm midis Slobodan Milošević-it dhe përfaqësuesve të zgjedhur të popullit të Kosovës [...], gjë që megjithatë nuk u mor në konsideratë nga qeveritë përkatëse kombëtare të shteteve anëtare të BE-së.

<sup>26</sup> Në vitin 1996 u shfuqizuan sanksionet e shqiptuara më 1991 kundër Serbisë dhe Malit të Zi deri në një “mur të jashtëm” (përrjashtim nga tregjet ndërkombëtare financiare). Caku i përrjashtimit nga tregjet financiare ishte që të imponoheshin reforma të brendshme demokratike dhe të ekonomisë së tregut, të zbatoheshin Marrëveshja e Dejtonit dhe të gjendej një zgjidhje e problemit të Kosovës.

Përmes njohjes së RFJ-së Milošević-it, qeveritë perëndimore shpresonin mes tjerash, se afro 500.000 shqiptarët e Kosovës të dëbuar midis viteve 1989 dhe 1996, të cilët qëndronin në shtetet e BE-së, kryesisht pa status definitiv, të mund t'i kthenin prapë në atdheun e tyre. Kjo megjithatë në pjesën më të madhe nuk u zbatua, sepse krahas keqtrajtimit të qëllimta nga ana e organeve shtetërore për çdo shqiptar të Kosovës të kthyer, Serbia kërkonte nga qeveritë perëndimore një lloj kompensimi.

<sup>27</sup> Krahe. Rezolutat e Parlamentit Evropian për këtë kohë nga viti 1989 deri te njohja e Jugosllavisë: Vendim rreth gjendjes në Kosovë në jug të Jugosllavisë, 13 prill 1989; në: GZ. Nr. C 120/204; Vendim rreth të drejtave të njeriut në Kosovë, 12 korrik 1990, në: GZ. Nr. C 231/175; Vendim rreth të drejtave të njeriut në Kosovë, 12 korrik 1990, në: GZ. Nr. C 231/175; Vendim rreth Kosovës, 11 tetor 1990, në: GZ. Nr. C 284/129; Vendim rreth krizës në Kosovë, 21 shkurt 1991, në: GZ. Nr. C 72/131; Vendim rreth gjendjes në Jugosllavi, 11 shtator 1991, në: GZ. Nr. C 72/131; Vendim rreth ngjarjeve në Jugosllavi, 10 tetor 1991, në: GZ. Nr. C

Serbisë përballë Kosovës nuk kishte kurrfarë mbulese kushtetuese; kishte dënuar “ndjekjen brutale dhe raciste të shqiptarëve në Kosovë”<sup>28</sup>, si dhe shkeljet e tjera të së drejtave të njeriut nga ana e Serbisë. Në një rezolutë<sup>29</sup> lidhur me njohjen e RFJ-së së Milošević-it nga ana e disa shteteve anëtare të BE-së, Parlamenti Evropian konstatonte: “*Parlamenti Evropian [...] i brengosur që Kosova më 1989 ka humbur statusin e saj kushtetues si njësi federale dhe që situata e të drejtave të njeriut dhe kushtet e jetesës pastaj janë përkeqësuar shumë, [...] insiston që Beogradi të nisë negociata me përfaqësuesit e zgjedhur të Kosovës, para se BE-ja të normalizojë marrëdhëniet e saj diplomatike me Jugosllavinë dhe të shfuqizojë të gjitha sanksionet ekzistuese ekonomike; Shpreh keqardhjen për njohjen e ngutur diplomatike të Republikës Federale të Jugosllavisë nga ana e disa shteteve anëtare; [...]”.* Ky ishte një shembull domethënës për *dërgimin e sinjaleve të ngatërruara*. Në njërën anë dënohej politika e Serbisë nga ana e Parlamentit Evropian, në anën tjetër, ajo njihej nga shtetet anëtare të tij. BE-ja vepronte kështu në mënyrë kontradiktore dhe pa koncept të qartë.<sup>30</sup> Edhe Serbia nga ana e saj po i dërgonte sinjale të ngatërruara bashkësisë ndërkombëtare, sepse diplomatët serbë shpeshherë betoheshin se dëshironin të përfundonin politikën e dhunës në Kosovë, ndërsa në terrenin bënin krejt të kundërtën.

Konflikti shqiptaro-serb dukej qartë se nuk kishte pajtueshmëri, për faktin se Serbia nuk e donte Kosovën si njësi federale në përbërje të një shteti që dominohej prej saj. Kështu, ndonëse shqiptarët mund të detyroheshin të kënaqeshin vetëm me rikthimin e autonomisë së vitit 1974, çka do të preferohej nga Evropa për të shmangur rreziqet që i vinin paqes nga zgjidhjet më radikale, Serbia nuk pranonte as këtë kompromis, i cili kërkonte lëshimin më minimal prej saj. Thuajse e gjithë politika serbe ishte për një zgjidhje radikale. Kështu komandanti i NATO-s, Wesley Clark, i cili shkoi në Beograd dhe takoi Milosheviqin për të implementuar rezolutat e OKB-s, do të mbetej i

---

280/127; Vendim rreth krizës në Kosovë, 9 prill 1992, në GZ.Nr. C 125/228; Vendim rreth zgjerimit të konfliktit në Jugosllavinë e dikurshme, 19 nëntor 1992, në: GZ.Nr. C 337/196; Vendim rreth gjendjes në Jugosllavinë e dikurshme, 18 prill 1996, në: GZ.Nr. C 141/216.

<sup>28</sup> Pika I e vendimit rreth krizës në Kosovë, 9 prill 1992, në: GZ. Nr. C 125/228 të Komisionit Evropian.

<sup>29</sup> Vendim rreth gjendjes në Jugosllavinë e dikurshme, 18 prill 1996, në GZ. Nr. C. 141/216.

<sup>30</sup> W. Petritsch, K. Kaser, R. Pichler: *Kosova, Kosova, Mythen, Daten, Fakten* [Kosova, mite, data, fakte], Klagenfurt etj. 1999, f. 195 v.

shokuar nga deklarata e tij “për të qëruar hesapet”<sup>31</sup> njëherë e mirë me shqiptarët, çka nënkuptonte vendosmërinë e tij për të realizuar spastrimin etnik. Perëndimi kuptoi se Serbia kishte vendosur të luftonte o për gjithçka, o për asgjë.

Dështimi i Fuqive Perëndimore në Konferencën e Daytoni-it për ta zgjidhur krizën e Kosovës jo vetëm shkaktoi zhgënjimin e shqiptarëve dhe rriti e fuqizoi rrymën politike që mendonte se format civile e paqësore të rezistencës nuk qenë të mjaftueshme<sup>32</sup>, por sipas disa studiuesve, ky dështim ndryshoi edhe kursin politik të SHBA-s, të cilët filluan gradualisht të toleronin e më tej të përkrahnin radikalizmin e situatës në Kosovë. Jenz Reuter pohon: në Washington po rritej ndjenja dhe po forcohej gjykimi se po afrohej momenti kur Millosheviqi duhej të përballej me një kryengritje të armatosur të shqiptarëve, e cila mund t’i lëvizte gjërat përpara.<sup>33</sup>

Amerikanët po lëviznin në këtë drejtim edhe për faktin se, mesa duket, nuk po gjenin përkrahjen e duhur të BE-s për të mbështetur rezistencën paqësore të shqiptarëve. Duhet shënuar këtu se në fillim të viteve 90-të disa kancelari evropiane i kishin bërë presion qeverisë shqiptare që të mbyllte dy kampe të stërvitjes së paraushtarakeve nga Kosova, të cilët funksiononin me kërkesën dhe dijeninë e udhëheqësit të Kosovës, I. Rugova.<sup>34</sup>

### *Rezistenca paqësore si prelude i rezistencës së armatosur*

Pas kësaj, rezistenca e armatosur, e cila vepronte edhe më parë në Kosovë, por që filloi të marrë formë nën udhëheqjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), u shfaq si një aktor i ri në skenën politike. Në fakt UÇK ishte themeluar në fillim të viteve 90-të, duke ndërmarrë disa aksione të herëpashershme, por publikisht ajo do të paraqitej për herë të parë më 28 nëntor 1997.<sup>35</sup> Masakrimi më 1 mars 1998 i 29 anëtarëve të familjes Ahmeti në Qirez të Drenicës nga njësitë speciale serbe ishte pararendëse e një gjenocidi të egër serb, por që kaloi pa u popullarizuar siç duhej në opinionin publik. Këtë opinion do ta

<sup>31</sup> Wesley Clark: *Të bësh luftë moderne*, Zëri, Prishtinë: 2003, f. 182-187.

<sup>32</sup> Timothy Garton Ash: *Cry, the dismembered Country*, The New York Review of Books, 14.01.1999.

<sup>33</sup> Jenz Reuter: *Zur Geschichte der UÇK: in Der Kosova Konflikt, Ursachen, Verlauf, Perspektiven*, f. 171.

<sup>34</sup> Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s...*, f.

<sup>35</sup> Tim Judah, *Kosova: War and revenge*, New Haven and London: Yale University Press, 2000, f. 99-163.

shokonte dhe zgjonte pak ditë më vonë rezistenca heroike e Jasharajve të prirë nga Ademi dhe masakrimi i 26 pjesëtarëve të kësaj familje. Kjo u shoqërua me marshimin nga Prishtina drejt Drenicës së 5.000 shqiptarëve, shumica gra, në mbështetje të familjeve të masakruara. Pas këtyre ngjarjeve, UÇK-ja vazhdoi kryengritjen e armatosur me një përkrahje të gjerë popullore. Adem Jashari u shndërrua në simbolin e saj.

Ndodhi ajo çfarë ishte përsëritur në historinë e Kosovës: dështimi i një lëvizjeje të moderuar për të arritur qëllimet politike dhe zëvendësimi i saj me krahun dhe konceptin e luftës së armatosur. Kjo lëvizje fitoi shpejt vëmendjen ndërkombëtare dhe u bë vendimtare në proceset politike. Ajo vendosi komunikim të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit kryesorë të bashkësisë ndërkombëtare dhe u angazhua për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Ishte një përsëritje e asaj çfarë kishte ndodhur shpeshherë gjatë historisë në botë. Ndryshimi i madh ndodh vetëm nëpërmjet luftës çlirimtare. Vetëm forca mund të përmbysë sisteme të padrejta dhe të largojë regjime shtypëse. Nxitja e angazhimi ushtarako-humanitar ndërkombëtar ishte pjesë e platformës politike të kësaj lëvizjeje.

Konflikti në Kosovë po zhvillohej në një kohë kur procesi i globalizmit ishte në ngjitje dhe institucionet ndërkombëtare të sigurisë po diskutonin për një skemë të re strukturimi, në përputhje me procesin demokratizues të mbarë botës, i cili ishte kthyer tashmë në ideologji globale. Por ky proces ishte në vetvete kundërthënës, sepse ai po ndeshje me praktikën e vjetra të vendimmarrjes, të cilat ishin kthyer në një pengesë kryesore për zbatimin efikas të diplomacisë preventive.

Si konkluzion mund të theksojmë se rezistenca paqësore e shqiptarëve të Kosovës, e parë në kontekstin ndërkombëtar dhe atë brenda shtetit jugosllav u zhvillua në kohën e duhur, në mënyrën e duhur dhe arriti rezultatet maksimale që mund të arrinte një rezistencë paqësore në rrethana të tilla të brendshme e të jashtme.

Ajo ndërkombëtarizoi në një nivel të lartë problemin e Kosovës, duke e shtruar si një problem të mprehtë që kërkonte zgjidhje; shtyn për një fazë shumë të favorshme thellimin e konfliktit të armatosur në Kosovë. Duke e renditur në kohë shpërthimin e konfliktit, në fundin e shpërbërjes së Jugosllavisë, ajo shmangu masakra edhe më të rënda se sa ato që do pësonin shqiptarët në vitet 1998-1999, shmangu madje edhe rrezikun e spastrimit etnik. Në fillimin e viteve 90-të komuniteti ndërkombëtar nuk ishte i përgatitur t'u dilte përpara këtyre ngjarjeve katastrofike. Fundi i viteve 90-të ishte shumë më i favorshëm për të

ndaluar këto tragjedi. SHBA shumë më të involvuara në konfliktin jugosllav, shtetet e BE-së dhe Aleatët e NATO-s shumë më të vendosur për të parandaluar këtë.

Rezistenca paqësore e drejtuar nga Dr. Ibrahim Rugova rriti në nivele të paimagjinuara më parë simpatinë dhe mbështetjen e opinionit përfundimor ndaj shqiptarëve dhe të drejtave të tyre; rezistenca paqësore e diskreditoi përfundimisht shovinizmin serb në Europë dhe në botë.

Nga ana tjetër ajo arriti suksese edhe brenda faktorit shqiptar: E organizoi shoqërinë kosovare në një lëvizje masive politike patriotike, e pashembullt më parë në histori, krijoi institucione politike, arsimore, kulturën etj. shtetërore në formë paralele, rriti ndjenjat patriotike të shqiptarëve në Republikën e Shqipërisë, Maqedoni, Mal të Zi dhe në Diasporë.

Të gjitha këto ishin arritje epokale, ndonëse nuk ishin vetë zgjidhja e problemit. Ato ishin parakushte dhe një domosdoshmëri që të kalohej në fazën tjetër, në rezistencën e armatosur, e cila gjithashtu mund të thuhet se u zhvillua në kohën dhe mënyrën e duhur.

Rezistenca paqësore ishte parapërgatitja e gjithanshme, preludi, parakushti, dhe gjithashtu legjitimimi politik e moral i rezistencës së armatosur.

Beqir META

INTERNATIONAL CONTEXT OF THE PEACEFUL  
RESISTANCE OF KOSOVA ALBANIANS LED BY  
PRESIDENT RUGOVA IN THE 1990s

**Summary**

*This paper will address the international context of Kosova Albanians' peaceful resistance in the 1990s.*

*The analysis is intended to compare the advantages and disadvantages of the situation of Albanians in the 1990s with the international situation in the Balkans and Europe.*

*To analyze the situation and nature of international relations in Europe and the Balkans, I have referred to the relevant literature, predominantly international, relevant and recent sources.*

*The analysis aims to reveal those factors that influenced the Albanian issue and how they influenced it.*

*In line with this analysis, judgments will also be given on the form of resistance chosen by Albanians, the dimensions, extent, international and national messages it delivered, its strengths and its national and international impact.*

*The prehistory and prelude to the beginning of this resistance will be analyzed to compare its dimensions with the historical depth of the Albanian resistance.*

*The role of Dr. Ibrahim Rugova and of the leadership of the time will be analyzed in the context of the above elaborations.*

**Key words:** *Kosova, Rugova, Balkans, Europe, Diplomacy.*

# RAMBUJE, HAP VENDIMTAR DREJT PAVARËSISË SË KOSOVËS

**Ksenofon Krisafi**

## **Përmbledhje**

*Marrëveshja e Rambujesë përbën një ndër hapat e rëndësishëm konstitutivë në rrugëtimin e gjatë historik të popullit shqiptar të Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë. Prandaj edhe punimi ynë fokusohet në evidentimin e rëndësisë së pamohueshme si dhe në analizën e disa prej aspekteve juridiko-ndërkombëtare të kësaj marrëveshjeje. Ajo vlerësohet si një nga momentet pararendës, si zanafilla e një procesi embrional njohjeje ndërkombëtare, i cili do të inkurajonte nisma e veprimtari juridiko-kushtetuese dhe juridiko-ndërkombëtare, që do të çonin drejt themelimit të shtetit të pavarur të Kosovës. Ky akt ndërkombëtar, produkt i një diplomacie intensive nga ana e faktorit relevant ndërkombëtar dhe bashkëpunimit të elitës politike kosovare, forcoi bindjen e ndërkombëtarëve se kishte ardhur koha e korrigjimit të padrejtësisë së madhe historike të shek.. XX ndaj shqiptarëve. Duket se tashmë fuqitë e mëdha ishin ndërgjegjësuar për domosdoshmërinë e trajtimit të popullit shqiptar të Kosovës, sipas standardeve moderne. Ato u bindën për domosdoshmërinë e shkëputjes së lidhjeve të panatyrshme me Serbinë dhe ish-Jugosllavinë, për fillimin e procesit të pavarësimin të tij dhe integrimin në komunitetin e kombeve dhe shoqërive të lira politike.*

*Shqiptarët e Kosovës dëgjuan aleatët e mëdhenj, SHBA dhe BE, që këmbëngulnin për nënshkrimin e marrëveshjes së Rambujesë dhe patën kurajon të shpërfillnin edhe ndonjë “këshillë” paternaliste, me tone kërcënuese për të mos e nënshkruar, duke dëshmuar intuitë politike të admirueshme. Me firmën e tyre i bënë vendit të vet shërbimin më të madh, e kthyen konferencën dhe marrëveshjen e Rambujesë në preludin e pavarësisë së Kosovës. Tërhoqën mbi vete bekime dhe vlerësime pozitive për largpamësinë, kurajon dhe maturinë e treguar. Vendimet e Rambujesë i hapën rrugën zyrtarizimit juridik të lirisë dhe më tej pavarësisë së Kosovës. Ngjarjet morën një drejtim fatlum, që mund të cilësohet pa hezitim, magjik. Qëndrimi obstruksionist, antishqiptar për të mos e firmosur marrëveshjen bëri që Serbia ta humbiste përfundimisht Kosovën, e cila shpëtoi njëherë e mirë nga zgjedha e saj.*

*Në optikën juridiko-ndërkombëtare Rambuje u bë pikënisja e lindjes së shtetit më të ri evropian, pasi për herë të parë u legjitimuan si palë me të*

*drejta të barabarta përfaqësuesit e popullit të Kosovës. Çështja kosovare e mbetur pezull për rreth një shekull, mori dimensione të reja. Diplomacia perëndimore njohu dhe konfirmoi paritetin e palëve dialoguese. Kosovarët gëzuan të drejtën e tyre natyrore për të mbrojtur interesat politike, për të negociuar dhe për të vendosur fatin e vendit të vet.*

**Fjalët çelës:** *Marrëveshja e Rambujesë, Kosova, Shqiptarët, Diplomacia, SHBA, BE*

Në dekadën përmbyllëse të shekullit të kaluar, në fokusin e diplomacisë euroatlantike, u shfaq shqetësimi i veçantë për zhvillimet tragjike në hapësirën e ish-Jugosllavisë. E prirë për të ndikuar në rikthimin e paqes dhe qetësimin e situatave, në zvogëlimin e pasojave dhe moslejimin e përhapjes së luftës në vendet përreth, ajo pati rastin që të vlerësonte luftërat e pareshtura të popullit shqiptar të Kosovës për liri dhe shkëputje nga Serbia. Duket se ishte bindur për domosdoshmërinë e trajtimit sipas standardeve moderne.

1.- Në vijim të përpjekjeve për zgjidhjen e saj, në ditët e para të shkurtit 1999, u mblodh në Paris Konferenca e Rambujesë, ku merrnin pjesë delegacionet zyrtare të Kosovës dhe të Serbisë.<sup>1</sup> Të asistuar edhe

<sup>1</sup> Konferenca Ndërkombëtare e Rambujesë i zhvilloi punimet në dy faza: 6-23 shkurt dhe 14-19 mars 1999. Delegacioni Kosovar përbëhej nga: Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Ramë Buja, Azem Sylja, Xhavit Haliti (UÇK); Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Edita Tahiri, Bujar Bukoshi, Idriz Ajeti (LDK); Rexhep Qose, Hydajet Hyseni, Bajram Kosumi, Mehmet Hajrizi (LBD); si dhe të pavarurit Blerim Shala, Veton Surroi. Tre prej anëtarëve të delegacionit kosovar, Ramë Buja, Jakup Krasniqi dhe Azem Sylja, për arsye sigurie, për shkak të rrethanave të veçanta, kërkuan që të udhëtonin të armatosur. Kurse Hashim Thaçi ndoqi një itinerar të zgjedhur prej tij, përmes të cilit mbërriti në Rambuje pak orë pasi ishin zhvilluar ceremonitë formale të hapjes së konferencës. Shih Qosja, Rexhep, - *Paqja e përgjakshme, Konferenca Ndërkombëtare për Kosovën*, Toena, Tiranë, 1999, f. 23, Klinton, Bill, - “Ne luftën, ju paqen”, “Albania”, Tiranë 2000. Bill, Clinton, - *Jeta Ime*, Dudaj, Tiranë, 2005; Milo, Paskal, - *Kosova nga Rambuje në Pavarësi*, Toena, Tiranë, 2009; Hoxhaj, Enver, - *Ngritja e një shteti*, Botimet Dudaj, Tiranë 2016, Ukshini, Sylë, - *Kosova në politikën e jashtme të BE-së, 1991-2007*, LOGOS A, 2008, f.199, Goxhaj, Dilaver R. - *Drama e UÇK dhe e Adem Demaçit, Analizë e politikës së UÇK, 7 mars 1998-2 mars 1999*, Tiranë, 2014, f. 5. Delegacioni serb kryesohej nga zëvendëskryeministri serb Ratko Marković (Ratko Marković) dhe kishte në përbërje dy zëvendëskryeministrat jugosllavë, Nikola Šainović - Nikola Šainović, (i cili sipas përgjimeve të transmetuara nga Washington Post, dilte i përfshirë në urdhërin e forcave të sigurisë për masakrën e Reçakut, për çka u arrestua në 2 maj 2003, nën akuzën e krimeve të luftës) dhe Vladan Kutleshić (Vladan Kutlešić), Vladimir Shtambuk, si dhe 2 shqiptarë kolaboracionistë, 1 boshnjak, 1 goran, 2 turq, 1 rom, 1 egjiptian,

nga përfaqësuesit e ShBA, e Britanisë së Madhe, e Gjermanisë, e Italisë, e Rusisë, e Austrisë etj., ata do të negocionin për situatën tepër të rënduar që ishte krijuar në Kosovë, e cila rrezikonte të përhapej dhe të intoksikonte situatat në rajon e më gjerë.

Ishte hera e parë që përfaqësuesit e Kosovës, me status të njohur e të pranuar juridikisht, viheshin ballë përballë me përfaqësuesit e Serbisë, në prani të faktorit ndërkombëtar.

Rëndësinë e veçantë që i ishte kushtuar kësaj ngjarjeje e dëshmoi niveli shumë i lartë i inaugurimit të konferencës,<sup>2</sup> bashkëkryesimi nga ministrat e jashtëm të Francës dhe Britanisë së madhe, Vedrin dhe Kuk, zhvillimi i bisedimeve nën kujdesin e Grupit të Kontaktit<sup>3</sup>, si dhe udhëheqja e tyre bashkërisht nga ambasadori amerikan Kristofer Hill, austriaku Wolfgang Petriç - BE si dhe ambasadori rus Boris Majorski, tregonin.

Konferencën e ndoqi nga afër dhe një delegacion zyrtar nga Shqipëria. Duke iu qëndruar pranë anëtarëve të delegacionit të Kosovës, kujdesej për t'iu ofruar çdo ndihmë të nevojshme si dhe për t'iu përcjellë këshilla vëllazërore. Për shqiptarët kudo që janë ndodhur Kosova është konsideruar gjithmonë pjesë e natyrshme dhe shumë e rëndësishme e trungut të shtetit shqiptar. Kështu ka ndodhur që prej Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Rilindjes Kombëtare. Filozofia dhe konceptet themelore të rilindasve të mëdhenj, Abdyl Frashëri, Sami Frashëri etj., projektues, drejtues dhe ideologë të së ardhmes politike të Shqipërisë, sikurse edhe themeluesit të shtetit të parë modern shqiptar, Ismail Qemalit, përshkoheshin nga ideja se Shqipëria do të ishte shteti që do të përfshinte territoret dhe popullsinë shqiptare të katër vilajeteve ballkanike osmane. Në koherencë me këtë frymë Kosova dhe trojet e tjera etnike shqiptare do të mbeteshin kurdoherë pjesë e padiskutueshme e politikës së jashtme të çdo qeverie të shtetit shqiptar, pas 28 nëntorit 1912. Madje Kushtetuta shqiptare e vitit 1998, e ka të konsakruar shprehimisht “aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar”, mbrojtjen e të drejtave “kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë

---

të konsideruar si përfaqësues të minoriteteve në Kosovë. Shih, Semo, Marc,-  
*“Conférence de Rambouillet sur le Kosovo. Tensions au château. Démarrées dans des pièces séparées, les négociations s'annoncent difficiles”*, në *Libération*, 8 février 1999, si dhe sipas Hill, Christopher - *Pararojë, Jeta në vijën e frontit të diplomacisë amerikane*, botim i UETPRESS, Tiranë, 2016, f. 186.

<sup>2</sup> Punimet u çelën në mbrëmjen e 6 shkurtit 1999 nga presidenti francez, Zhak Shirak.

<sup>3</sup> ShBA, Francë, Britani e Madhe, Gjermani, Itali, Rusi.

kufijve të saj”.<sup>4</sup> Në përmbushje të këtij detyrimi sublim shpirtëror, kombëtar e konstitucional, qeveria shqiptare e asaj kohe, që ndiqte me preokupim të veçantë zhvillimet dramatike në Kosovë, simptomat e të cilave paralajmëronin befasi të pakëndshme, me pasoja të paparashikuara, nuk reshti përpjekjet për të sensibilizuar opinionin e gjerë publik botëror si dhe për të vënë në lëvizje organizatat dhe institucionet ndërkombëtare. Pas ndërhyrjesh të pareshtura në forumet e OKB dhe organizatave të tjera, në seancën plenare të 2 tetorit 1998, të sesionit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB, ministri i jashtëm shqiptar, Paskal Milo, duke e vlerësuar gjendjen në Kosovë tepër të rëndë dhe të rrezikshme, deklaroi se “...Milosheviqi ka urdhëruar në fakt zbatimin e një politike të spastrimit etnik kundër shqiptarëve... Qeveria shqiptare dënon me vendosmëri këtë politikë dhe deklaroi haptas se Milosheviqi duhet të përgjigjet për krimin e gjenocidit. Ne kërkojmë me ngut krijimin e mekanizmave të kontrollit dhe të ndihmës nga ana e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë dhe ndërhyrjen e menjëhershme ushtarake nga ana e NATO-s...”<sup>5</sup>

Drejtuesit e faktorëve politikë të Kosovës dhe vetë populli kosovar, kanë vlerësuar asistencën e vazhdueshme dhe të kualifikuar, të ofruar me përkushtim e preokupim të veçantë nga qeveria, institucionet dhe nga personalitetet shqiptare për gjetjen e zgjidhjeve më optimale, sipas rekomandimeve që vinin nga Uashingtoni, Brukseli dhe nga shtetet e tjerë.

2.- Bisedimet në Rambuje nisën kur në Kosovë bëhej luftë, vriteshin njerëz, derdhej gjak, kryheshin masakra, kur prej disa muajsh kishte filluar dëbimi i popullsisë civile shqiptare dhe zhvillimet në terren po precipitonin me shpejtësi drejt një katastrofe humanitare. Serbia po kryente akte të pashembullt gjenocidi, krime kundër njerëzimit. Organizimi i konferencës dëshmonte se në një tjetër front, në atë të diplomacisë dhe të politikës botërore, punohej intensivisht për gjetjen e një zgjidhjeje institucionale, politike e juridike. Konferenca

<sup>4</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2017, f. 7, 11.

<sup>5</sup> *Communiqué de Presse*, AG/809, 2 octobre 1998, Assemblée générale, Plénière, *L'Albanie demande l'intervention militaire de l'OTAN au Kosovo et la mise en accusation de Milosevic pour crimes de guerre*, 1998/ 10/ 02. Në fillim të fjalës së vet Ministri i Punëve të Jashtme, Paskal Milo, përshkroi situatën e rënduar të ngjarjeve të dhunshme në shtatorin e vitit 1998 në Shqipëri gjatë përpjekjeve për grusht shteti, duke thënë se “ka tre javë që Shqipëria gjendet në qendër të vëmendjes së bashkësisë ndërkombëtare për shkak të ngjarjeve të dhunshme që synojnë të përmbysin institucionet e brishta demokratike. Ne kemi vlerësuar gjerësisht dhe falënderojmë bashkësinë ndërkombëtare për mbështetjen që na dha në këto kohë të vështira.” AMPJ, Fondi i OKB, Misioni Gjenevë, Dosja e vitit 1998.

me rezultatet e saj të rëndësishme do të shndërrohej në një ngjarje madhore për të ardhmen e Kosovës, edhe pse nuk kanë munguar vlerësimet dyshuese dhe ngandonjëherë nihiliste për rolin dhe vlerat e saj. Fjala vjen anglezët James Pettifer dhe Miranda Vickers, kanë mendimin se “Konferenca e Rambujesë në themel, ishte një përpjekje e bashkësisë ndërkombëtare për të nxjerrë gështenjat serbe nga zjarri i Kosovës dhe një komplot kundër UÇK-së.”<sup>6</sup>

Në fillimet e diskutimeve për situatat traumatike në Kosovë, qëndrimet e diplomacisë botërore, nuk ishin unike jo vetëm në kancelaritë europiane, por as brendapërbrenda Departamentit të Shtetit të ShBA, aleatit më besnik e më të fuqishëm të Kosovës dhe të shqiptarëve. Sekretarja e Shtetit Medlinë Ollbrajt, qysh në nisje të krizës, mendonte se vetëm forca mund t'i jepte zgjidhjen e duhur konfliktit ndërmjet serbëve dhe kosovarëve, sepse, siç pohonte ajo, Milosheviqi nuk ishte vetëm një ndër elementet e problemit, ai ishte vetë problemi.<sup>7</sup> Diplomati amerikan Riçard Hollbruk, sikurse edhe diplomacia europiane, shpresonte se ekzistonin ende mundësi për marrëveshje. Masakra e Reçakut,<sup>8</sup> obstruksionizmi mesjetar i Milosheviqit dhe politika e tij konfliktuale me Perëndimin ndikuan përfundimisht për zgjidhjen e çështjes përmes alternativës së Ollbrajt-it.

Në këtë kontekst të përgjithshëm politiko-diplomatik dhe nën ndikimin e një realiteti të përgjakshëm që ishte mbjellë në tokën e Kosovës, do të zhvilloheshin negociatat në Rambuje.

3.- Grupi i Kontaktit kishte vendosur që bisedimet për arritjen e paqes të ishin më tepër një ballafaqim midis liderëve shqiptarë të Kosovës - përfaqësues të disa prej subjekteve politike dhe të UÇK-së dhe përfaqësuesve të qeverisë serbe. Ato do të zhvilloheshin nën një lloj “diktati”, nëpërmjet imponimit për pranimin e dokumentit të titulluar

<sup>6</sup> Pettifer, J. & Vickers, M. - *Çështja shqiptare. Riformësimi i Ballkanit*, Tiranë, 2007, f.325-326.

<sup>7</sup> Ivo H. Daalder et Michael E. O'Hanlon, *Winning ugly, NATO's War to Save Kosova*, Brookings, p. 69

<sup>8</sup> William Walker, shef i Misionit të Vëzhguesve të OSBE në Kosovë, i pranishëm në vend ka dëshmuar me shkrim se: Në një përroskë sipër fshatit, pashë trupin e parë. Ai ishte i mbuluar nga një batanije dhe kur e kthyen mbrapsht, vura re se ai nuk kishte kokë në trupin e vet...Më tej ishin tre trupa të tjerë... me plagë në kokë dhe gjak në veshjet e tyre... kudo pashë vrima plumbash në kokat dhe trupat e tyre. Më thanë se kishte trupa kudo. Inspektorët dhe gazetarët më pyetën nëse doja t'i shihja, por iu përgjigja jo, kisha parë mjaft. Citohet nga Ivo H. Daalder, Michael E. O'Hanlon, *Winning Ugly: NATO's War to Save Kosova*, pages 63-64. Brookings Institution Press, 2001. ISBN 0815716966.

“*Non-Negotiable Principles/Basic Elements*”. Ishte vendosur që palët do të kishin të drejtë të diskutonin vetëm deri në 20% të përmbajtjes së tij. Këtë mesazh e përcolli ministri britanik, Kuk, i cili kishte një rol të dyfishtë. Si përfaqësues i Grupit të Kontaktit të Ballkanit, duhet të këmbëngulte për arritjen e planit të paqes, ndërsa si përfaqësues i NATO-s, duhet ta impononte pranimin e tij duke mos kursyer edhe kërcënimin nëpërmjet bombardimeve mbi Serbi. Dokumenti mbi të cilin do të bisedohej, ishte versioni i tetë ose i nëntë, i planit të paqes, paraqitur nga i dërguari i posaçëm amerikan, Hill. Ai mbështetej në disa parime bazë, ndër të cilat ndërkombëtarët kishin avancuar paraprakisht se zgjidhja do të respektonte paprekshmërinë e sovranitetit dhe integritetit territorial të Jugosllavisë. Kosovës do t’i akordohej një autonomi e lartë vetëqeverisjeje,<sup>9</sup> duke i dhënë mundësinë që të kishte organet e veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Jugosllavia duhej të pranonte veprimin ndërkombëtar dhe të siguronte mbështetje të plotë gjatë zbatimit të marrëveshjes. Pas një periudhe kalimtare trevjeçare do të përcaktohej statusi përfundimtar i Kosovës. Në atë kohë pjesëmarrësit mendonin që edhe në rast se do të arrihej pajtimi, statusi përfundimtar nuk të mund të zgjidhej në Rambuje.<sup>10</sup>

<sup>9</sup> Për këtë zgjidhje shprehej që në qershorin e 1998 edhe një përfaqësues i NATO-s, i cili thoshte se zgjidhja politike e krizës bazohej në formulën: “jo *status quo*, as edhe pavarësi, por një autonomi e gjerë.” Sipas, *La crise en Kosove et ses conséquences en Albanie*, (AFP 3.6)

<sup>10</sup> Çështjet kryesore për të cilat bisedohej në Rambuje trajtoheshin në projektin e Marrëveshjes së përkohshme për paqe dhe vetëqeverisje në Kosovë, Rambuje - Francë/23 shkurt 1999. Ai ishte përgatitur nga Grupi i Kontaktit së bashku me përfaqësuesit e ShBA, BE dhe të Federatës së Ruisë dhe iu ishte vënë në dispozicion delegacioneve e të dyja palëve, për ta diskutuar dhe për ta nënshkruar, nëse do të binin dakord. Projekti trajtonte deri në hollësi çështje të tilla si parimet, masat e ndërtimit të besimit, kushtetuta, parimet e vetëqeverisjes demokratike në Kosovë, kuvendi, presidenti i Kosovës, qeveria dhe organet administrative, gjyqësori, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, bashkësitë nacionale, komunat, përfaqësimi, sigurimi publik policor dhe civil, policia komunale, akademia policore e përkohshme, komisionet për jurisprudencë penale, operacionet policore në Kosovë, sigurimi i kufijve ndërkombëtarë, arrestimi dhe ndalimi, administrimi i drejtësisë, zhvillimi dhe mbikëqyrja e zgjedhjeve, kushtet e zgjedhjeve, roli i OSBE-së, komisioni qendror i zgjedhjeve, çështjet ekonomike, ndihma humanitare, rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik, institucionet, përgjegjësitë dhe pushtetet, statusi i misionit implementues, procesi i implementimit, ombudsmeni, juridiksioni, mandati dhe detyrat, ndërprerja e armiqësive, rirreshtimi, tërheqja dhe demilitarizimi i forcave, forcat e ushtrisë jugosllave, forcat e tjera, kolonitë e miratuara të ushtrisë jugosllave - MUP, operacionet dhe pushteti i KFOR-it, kontrolli kufitar, kontrolli i lëvizjeve ajrore, themelimi i komisionit të përbashkët ushtarak, lirimi i të burgosurve,

Shihet se marzhi maksimal i projektit të ndërkombëtarëve për të ardhmen e Kosovës, nuk i tejkalonte caqet e organizimit në formën e një krahine me autonomi të zgjeruar ose në variantin më të avancuar, autonomi substanciale, nën suazën e ish-Jugosllavisë ose Serbisë. Zgjidhja e projektuar ishte larg alternativës së themelimit të një Kosove të pavarur. Diplomacia europiane dhe ajo e ShBA pranonin lënien e saj brenda ish-Jugosllavisë. Synimi themelor i delegacionit kosovar ishte sanksionimi juridiko-ndërkombëtar i shkëputjes nga ish-Federata Jugosllave, dalja si shtet i pavarur dhe njohja si subjekt më vete i së drejtës ndërkombëtare. Prandaj shqiptarët ndjeheshin të trishtuar dhe të alarmuar nga zërat për statusin e autonomisë substanciale. Serbët që, me sa duket, nuk e morën seriozisht preokupimin maksimal dhe paralajmërimet e vazhdueshme të perëndimorëve, refuzuan kërkesën për vendosjen e ushtarakëve të NATO-s në krahinë.

4.- Krahas negociatave me serbët, anëtarët e delegacionit shqiptar, me propozim të zonjës Ollbrajt, u përfshinë në diskutime edhe midis tyre, në përfundim të të cilave realizuan një arritje të rëndësishme, nënshkruan, aktin e themelimit të një qeverie të përkohshme të Kosovës. Emërtimi i saj Qeveria e Unitetit, përmbante në vetvete simbolikën e ndërgjegjësimit dhe vendosmërisë së faktorit politik shqiptar për unitet dhe përgjegjshmëri për fatet e vendit. Veprimtaria e saj do të shërbente ndër të tjera edhe për zbatimin e vendimeve të Rambujesë, arritjen e shpejtë të paqes në Kosovë si dhe për të garantuar faktorin ndërkombëtar për seriozitetin e shqiptarëve për angazhimet që ata po merrnin në Rambuje.

Faktori ndërkombëtar ndërmori hapa të tjerë mbështetës për inkurajimin e këtij faktori, le të themi koheziv në zhvillimin e mëtejshëm të çështjes së Kosovës, çka i shërbente natyrisht edhe të ardhmes së qëndrueshme të rajonit ballkanik. Një prej tyre ishte takimi i kryeministrit britanik, Toni Bler me përfaqësuesit e qeverisë së Përkohshme të Kosovës, në ambasadën britanike në Tiranë, gjatë vizitës së tij në Shqipëri, më 18 maj 1999. Ai iu ritheksoi interlokutorëve të vet nevojën për unitetin e faktorit shqiptar me referencë të drejtpërdrejtë Marrëveshjen e Rambujesë.<sup>11</sup>

5.- Me qenë se bisedimet në Rambuje po zgjateshin, një pjesë e delegacionit Kosovar vendosi të kthehej në atdhe. Anëtarët e tij ishin të

---

bashkëpunimi, lajmërimi i komandave ushtarake, pushteti përfundimtar për interpretim, statusi i forcave implementuese multinacionale, amendamentet, vlerësimet gjithëpërfshirëse dhe dispozitat përfundimtare, hyrja në fuqi, etj.

<sup>11</sup> Blair, Toni,- *Për Shqiptarët*, "ALBPAPER", Tiranë, 2005, f. 142.

bindur se në ato kohë, në Rambuje, po merreshin vendimet më të mira të mundshme për t'i dalë zot popullit dhe vendit. Tashmë, në një unitet institucional qëllimesh, dëshirash dhe aspiratash, me vendosmërinë e frymëzuar nga zhvillimet pozitive në Konferencë dhe në terren në Kosovë, duhej punuar për t'iu shpjeguar njerëzve në vend rrugën e gjatë dhe vështirësitë e panumërta që duheshin kapërcyer për të arritur drejt paqes.

Edhe serbët u kthyen në shtëpi, veçse, sikurse shprehet Kristofer Hill, jo për paqen, por t'u përgatitur për luftë.<sup>12</sup>

Presidenti amerikan Klinton, që e ndiqte me preokupim zhvillimin e takimit të Rambujesë, e vlerësoi pozitivisht qëndrimin e shqiptarëve dhe deklaroi se ndjehej shumë i kënaqur që ata kishin rënë dakord të nënshkruanin marrëveshjen e paqes. I drejtoi shprehje inkurajuese edhe Millosheviqit që të bënte të njëjtën gjë, por paralajmëroi që “nëse serbët refuzojnë, nuk na mbetet zgjidhje tjetër përveç forcës.”<sup>13</sup>

Më 13 mars delegacioni i Kosovës u rikthye në Paris për vazhdimin e negociatave dhe nënshkrimin e Marrëveshjes. U rikthyen edhe të dërguarit e Millosheviqit.

Medlin Ollbrajt vazhdonte t'ju drejtohej përfaqësuesve të të dyja palëve duke iu kërkuar me këmbëngulje arritjen e marrëveshjes. Delegatëve kosovarë iu thoshte na ndihmoni duke e nënshkruar dokumentin që t'ju ndihmojmë. Ndërkohë që, në atë kohë, në Tiranë kishte për fat të keq ndonjë politikan, siç ishte Sali Berisha, që nga papërgjegjshmëria, nga paaftësia apo për motive të tjera, në mënyrë të pashpjegueshme, i drejtohej delegacionit kosovar të mos e nënshkruante marrëveshjen, madje duke e kërcënuar se një veprim i tillë do të ishte firmosja e mbarimit të Kosovës.<sup>14</sup> Por Kosova, Shqipëria dhe shqiptarët vazhdonin të këmbëngulnin për të kundërtën. Dëshirës së tyre iu bashkua ato ditë edhe një zë i fuqishëm dhe tepër autoritar, Ismail Kadareja. I preokupuar për fatin e Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi, duke vlerësuar sjelljet dhe qëndrimet e disa prej politikanëve shqiptarë, mbajtur prej tyre në Rambuje, Kosovë e Shqipëri, ai thoshte se “... një pjesë e “liderëve”, si në Shqipëri, si në Kosovë, nuk heqin dorë nga mburrjet. Ngrehalucë të pandreqshëm,

<sup>12</sup> Hill, Christopher,- *Pararobjë, Jeta në vijën e frontit të diplomacisë amerikane*, botim i UETPRESS, Tiranë, 2016, f. 192-193..

<sup>13</sup> Sipas Milo, Paskal - *Ditari i një Ministri të Jashtëm, Konflikti i Kosovës 1997-2001*, Toena, Tiranë, 2009, f. 173.

<sup>14</sup> Halili, Përparim - *Marrëveshja e Rambujesë, si luajti Sali Berisha misionin në interes të serbëve dhe i cilësoi tradhtarë ata që do të firmosnin Pavarësinë e Kosovës*, Gazeta Sot, 03/08/2013.

krejtësisht të pandjeshëm ndaj dramës së popullit, ... njëri mburret se është ai që e ka në dorë ç' do të vendoset në Rambuje, se po të mos dojë ai, e të mos shkojë ai, gjithçka duhet të priset. E një tjetër që nuk ka shkelur kurrë në Kosovë, jep mësim patriotike, bën thirrje që në emër të kësaj apo asaj, Kosova të bëhet shkrumb e hi... Dhe është gjithmonë populli shqiptar që paguan, që mjerohet, që digjet e kullon gjak. Kurse këta “biznesmenë të lirisë” s'pësojnë kurrë asgjë...”<sup>15</sup> Me ndjenjën e qortimit të thellë ai e përmbyllte mendimin e vet, duke thënë se “një pjesë e “liderëve” shqiptarë, si në Shqipëri, si në Kosovë e gjetkë, kanë nevojë të ngutshme të qytetërohen. Ata janë shumë larg nivelit të përfaqësimit që meriton populli shqiptar. Ky popull është i varfër, është i rreckosur, por është drama e tij e rëndë që kërkon, ashtu si çdo tragjedi, një nivel të lartë të përfaqësimit... Në qoftë se “liderët” shqiptarë e ndiejnë se janë të paaftë të kuptojnë peshën e përgjegjësisë që kanë, ata duhet t'ua lenë vendin të tjerëve. Gjithmonë do të ketë njerëz që do ta kuptojnë më mirë këtë popull, që do të kenë më shumë dhembshuri për të, me fjalë të tjera, që do ta prijnë siç duhet.”<sup>16</sup>

Shqiptarët e shpërfillën “këshillën” ultimative, kërcënuese për të mos e nënshkruar marrëveshjen e Rambujesë. Patën urtësinë dhe maturitetin politik t'i besonin diplomacisë euro-atlantike dhe fjalëve të Ismail Kadaresë dhe, në ceremoninë e organizuar në qendrën Kleber, në Paris, më 19 mars 1999, nënshkruan marrëveshjen e Rambujesë. Pas kësaj ngjarjet morën një drejtim fatlum, që mund të cilësohet pa hezitim, magjik. Me firmën e tyre mbi tekstin e marrëveshjes ata i bënë vendit të vet shërbimin më të madh, e kthyen Rambujenë në preludin e pavarësisë dhe tërhoqën mbi vete bekime dhe vlerësime pozitive për kurajon dhe maturinë e treguar. Negociatat dhe nënshkrimi i marrëveshjes i hapën rrugën zyrtarizimit juridik të lirisë dhe më tej pavarësisë së Kosovës.

Në ceremoninë e nënshkrimit të Marrëveshjes<sup>17</sup> mori pjesë vetëm delegacioni shqiptar i Kosovës, dy ndërmjetësit ndërkombëtarë, përfaqësuesit e ShBA dhe ata të BE-së.<sup>18</sup> Delegacioni serb mungoi. Ai

<sup>15</sup> *Courrier International*, Paris, 24shkurt 1999, përmbledhur në librin Kadare, Ismail, - *Mbi krimin në Ballkan*, Shtëpia botuese Onufri, – maj 2011.

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> Tekstet e marrëveshjeve të Rambujesë mund të gjenden edhe në dokumentacionin e Këshillit të Sigurimit të OKB, të cilit iu përcollën nga ambasadori francez me letërën e datës 4 qershor 1999.- S/1999/648 Français, Page 2 Annexe, *Accords de Rambouillet, Accord intérimaire pour la paix et l'autonomie au Kosova*.

<sup>18</sup> Gecaj, Bajram, - *Konferenca e Rambujesë*, AIKD, Prishtinë, 2009, f. 59.

nuk e firmosi me shpresë se mund t'i bënte bisht angazhimit juridik për respektimin e realiteteve të reja që ishin krijuar pas luftës në Kosovë dhe se do t'i shmangej përgjegjësisë për politikën e gjenocidit të ndjekur nga vendi i vet. Mungoi gjithashtu edhe përfaqësuesi i Rusisë.<sup>19</sup> Moska u rreshtua përkrah Beogradit jo vetëm nga ndjenja e solidaritetit sllavo-ortodoks, por edhe sepse dyshonte që Kosova mund të shndërrohej në precedent, për t'u ndjekur nga banorët e territoreve jo ruse që ndodheshin nën sundimin e saj dhe që luftonin për ndryshimin e statusit të tyre politiko-administrativ.

Duke e përshkruar këtë çast Kristofer Hill shprehet se “ishte një moment i ëmbël dhe i hidhur njëkohësisht, sepse të gjithë e dinim, sidomos unë dhe Wolfgang (Petritsch), se në mungesë të firmës serbe dhe me gjendjen e dhunshme që ekzistonte, do të kishte luftë. Por kishte diçka inkurajuese. Pas muajsh të tërë përpjekjesh, kishim arritur të bindnim udhëheqjen shqiptare të bashkëpunonte dhe kjo ishte një arritje. Mendova që ky ishte një ogur i mirë për të ardhmen, por takimi ishte një divorc nga propaganda serbe - pasi kisha dëgjuar disa here nga vetë Milosheviqi, se të bashkoje liderët kosovarë ishte e pamundur.”<sup>20</sup>

Disa nga protagonistët dhe personazhet më të rëndësishme politike të kohës janë shprehur për qëndrimin e Millosheviqit ndaj Konferencës, marrëveshjes dhe demarsheve të pafundme të amerikanëve dhe perëndimorëve për ta bindur që ta nënshkruante. Ollbrajt e cilësoi “një gënjeshtar të cilit nuk i besohej.”<sup>21</sup> Toni Bler tha se Milosheviqi vizionin e tij mesjetar e bëri ferr real në Evropën moderne.<sup>22</sup> Edhe ministri i Jashtëm rus, pas takimit me Milosheviqin shpërtheu duke thënë se te ai nuk kishte parë tjetër përveç se një idiot të gatshëm për të filluar luftën.<sup>23</sup> Toni Bleri dhe Joshka Fischer japin disa të dhëna që flasin për lojën që luante Milosheviqi me ndërkombëtarët. Sipas tyre ai nënshkroi 18 marrëveshje për armëpushim dhe nuk respektoi asnjërën prej tyre.<sup>24</sup> Nuk respektoi as edhe 73 rezolutat e miratuara nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së.<sup>25</sup>

<sup>19</sup> Fischer, Joschka,- *Vitet kuq-gjellbër*, Koha, Prishtinë, 2008, f. 146.

<sup>20</sup> Hill, Christopher, - *Pararojë, Jeta në vijën e frontit të diplomacisë amerikane*, UETPRESS, Tiranë, 2016, f. 193.

<sup>21</sup> Po aty, f. 121.

<sup>22</sup> Blair, Toni,- *Për Shqiptarët*, “ALBPAPER”, Tiranë, 2005,f. 66.

<sup>23</sup> Gecaj, Bajram,- *Konferenca e Rambujesë*, AIKD, Prishtinë, 2009, f. 57.

<sup>24</sup> Blair, Toni,- *Për Shqiptarët*, “ALBPAPER”, Tiranë, 2005,f. 37.

<sup>25</sup> Fischer, Joschka,- *Vitet kuq-gjellbër*, Koha, Prishtinë, 2008, f. 221.

Firmosjen e Marrëveshjes për Paqe kosovarët e identifikuan si aktin solemn të nënshkrimit virtual të aleancës ndërmjet Kosovës nga njëra anë dhe SHBA-së e Botës perëndimore nga ana tjetër. Delegacioni shqiptar, pas nënshkrimit publikoi një deklaratë ku theksohej se NATO konsiderohej zbatuesja thelbësore e marrëveshjes. Me këtë anëtarët e delegacionit dëshironin t'i jepnin publicitetin e nevojshëm veprimit që kishin ndërmarrë dhe, në të njëjtën kohë, t'iu dëshmonin atyre që kishin pas vetes, në Kosovë dhe në diasporë, se kishin vepruar në kushtet e *bona fides*. Synonin gjithashtu edhe që t'iu kujtonin publikisht përfaqësuesve të faktorit ndërkombëtar, angazhimet që ata kishin marrë ndaj shqiptarëve. Deklarata e bëri efektin e vet. Një ditë pas nënshkrimit, bashkë-kryesuesit francezë dhe britanikë deklaruan se "Marrëveshja e Rambujesë ishte e vetmja zgjidhje paqësore e problemit të Kosovës."

Konferenca e Rambujesë për Kosovën,- shkruan Jakup Krasniqi, një ndër pjesëmarrësit e saj, është një ngjarje e shënuar historike në raport me faktorin ndërkombëtar... Ngjarja ishte kryesisht për Kosovën, por në Rambuje dhe rreth saj ishin të gjithë shqiptarët, pa dallim kufijsh... delegacioni i UÇK-së kishte shkuar për të fituar përkrahjen dhe mbështetjen ndërkombëtare. Dhe mbështetja e fuqishme ndërkombëtare ndodhi.<sup>26</sup>

Pranimi nga ana e delegacionit shqiptar për të nënshkruar marrëveshjen, u mirëprit nga amerikanët dhe nga evropianët.<sup>27</sup> Kësaj here zhvillimet ecnin në të njëjtin kah me Kosovën dhe me kosovarët.

6.- Zhvillimi i bisedimeve të Rambujesë dhe nënshkrimi i marrëveshjeve përkatëse nga ana e delegacionit kosovar, u bë në kushte të vështira. Sepse duheshin kapërcyer jo vetëm divergjencat e thella ndërmjet delegacionit shqiptar dhe atij serb me ndihmën e faktorit ndërkombëtar, përfaqësuesit e të cilit ishin të pranishëm në negociata, por kërkohej gjithashtu të shmangeshin mospërputhjet e mendimeve dhe të afroheshin qëndrimet divergjente brenda tre grupeve përbërëse të delegacionit shqiptar. Ata nuk ndanin të njëjtat pozicione në raport me alternativat e propozuara gjatë negociatave. Mendime të ndryshme kishte edhe ndërmjet anëtarëve të grupit të UÇK-së. Fjala vjen, sipas njoftimeve të *Associated Press*, rezultoi se në një mbledhje të thirrur në zyrën përfaqësuese të UÇK-së në Prishtinë, zëdhënësi i atëhershëm i saj, Albin Kurti, u thoshte

<sup>26</sup> Jakup Krasniqi,- Konferenca e Rambujesë gjashtë vjet pas, citohet nga Forumi Shqiptar, 10 Janar 2005.

<sup>27</sup> Milo, Paskal - *Ditari i një ministri të jashtëm: Konflikti i Kosovës 1997-2001*, Shtëpia Botuese Toena, 2009, f. 173.

gazetarëve se çdo marrëveshje që arrihet duhet të ketë për bazë situatën në terren. Asnjë marrëveshje s’do të ishte e qëndrueshme nëse të dyja palët nuk do të përkushtoheshin në funksionimin e saj.<sup>28</sup> “Kërkesa e palës shqiptare, delegacionit shqiptar në Rambuje, është që së pari të nënshkruhet një marrëveshje armëpushimi, që do të jetë shenjë e vullnetit të mirë se të dyja palët janë të interesuara për një rezolutë politike për marrëveshje, që më vonë mund të shndërrohet në rezolute”.<sup>29</sup> Ishte *conditio sine quoi non* unifikimi i qëndrimeve, për të dalë me një platformë të përbashkët, të konsoliduar.

Përfaqësuesit e delegacionit shqiptar, që nënshkruan Marrëveshjen e Rambujesë, me përgjegjësinë e jashtëzakonshme historike të misionit që kishin marrë mbi vete, dëshmuar qytetari dhe vlera të larta europiane, treguan se ishin për dialog dhe paqe, se besonin te populli i tyre dhe te faktori ndërkombëtar. Lufta e UÇK-së, veprimtaria politike e Ibrahim Rugovës, diplomacia aktive e përfaqësuesve të saj dhe e personaliteteve të tjera politike dhe publike në Kosovë, ShBA, Evropë dhe Shqipëri, i dhanë Kosovës dimensionin e rëndësishëm të faktorit me rëndësi në marrjen e vendimeve për të ardhmen e saj. Konferenca e Rambujesë, ku, për herë të parë Perëndimi i njohu Kosovës të drejtën për të dialoguar dhe për të vendosur për fatin e vet, ishte shembulli më i mirë dhe më i qartë i këtij faktorizimi. Ndërkombëtarët respektuan përfaqësuesit e saj si palë të barabarta e partnere në marrjen e vendimeve kyçe në lidhje me të ardhmen e vet. Dhe ata e bënë këtë në kohën e duhur dhe në mënyrën e përshtatshme, sepse çastet nuk prisnin. Një hap i pamatur ose i gabuar mund të ishte me pasoja të pariparueshme për të ardhmen politike të Kosovës.

Beogradi, që nuk kishte hequr dorë nga terrori etnik në terren, vazhdonte të ndiqte taktikën e zvarritjes së negociatave në Rambuje. Përfundimisht, siç u tha, ai nuk e nënshkroi marrëveshjen, duke arsyetuar ndër të tjera se nënshkrimi i saj do të thoshte njohje e UÇK-së. U vërtetua kështu një rast i rrallë, gati paradoksal, kur keqdashja, urrejtja dhe armiqësia serbe, për herë të parë në histori, do të prodhonte pasoja pozitive për shqiptarët. Qëndrimi destruktiv, obstruksionist, antishqiptar i Milosheviqit i shprehur edhe në refuzimin e nënshkrimit të marrëveshjes u kthye në favor të Kosovës, të cilën Serbia e humbi përfundimisht.

7.- Bisedimet intensive në Rambuje rreth fatit të Kosovës, ku hidheshin mbi tavolinë projekte për alternativa të ndryshme të

<sup>28</sup> Citohet nga *Indeksonline*.

<sup>29</sup> Citohet nga *Gazeta Express*, e diel, 27 shtator 2015.

konstituimit dhe organizimit të saj të ardhshëm politiko-administrativ, ishin pjesë e një debati të gjithanshëm që zhvillohej dhe do të vazhdonte në shumë prej metropoleve të diplomacisë dhe politikës botërore. Në strukturat më të epërme të politikës dhe diplomacisë botërore, avancoheshin propozime e projekte që tregonin se ato, sikurse merrej me mend, nuk kishin qëndrime të njëjta për çështjen e Kosovës.

Presidenti Klinton deklaroi më 27 mars 1999 se operacionet ajrore të NATO-s në Jugosllavi do të vazhdonin “deri sa drejtuesi serb Slobodan Millosheviq, të pranojë paqen ose deri kur ne të kemi zvogëluar seriozisht aftësinë e saj për të bërë luftë”.<sup>30</sup> Ai shpjegoi se ShBA dhe aleatët e vet ishin shtrënguar të vepronin për “t’i hequr fitilin një fuçje baruti në zemër të Europës dhe për të shmangur një zgjerim të luftës”.<sup>31</sup>

Më 12 prill, 19 shtetet anëtare të NATO-s, u shprehën pothuajse të gjithë dakord rreth “daljes politike” nga lufta të Slobodan Millosheviqit dhe njohjes së një roli të rëndësishëm për Rusinë për ta bindur që të pranonte kushtet e Perëndimit, nevojën e dërgimit në vend të një force ushtarake mbrojtëse si garanci për zbatimin e angazhimeve etj.<sup>32</sup> Anëtarët e NATO-s nuk ishin në një mendje për sa i përkiste përbërjes së kësaj force, zgjedhjes së organizatës që do ta kontrollonte, OKB-së ose NATO-s. ShBA mendonin që kjo detyrë t’i ngarkohej NATO-s duke pranuar që pjesë të saj, me rol konsultativ (?) të ishin Rusia dhe OSBE-ja. Franca preferonte OKB-në. Ministri i saj i Jashtëm Hyber Vedrin shprehej për një formë kujdestarie, e cila do të përcaktohej më vonë dhe që do të ushtrohej nga bashkësia ndërkombëtare. Belgjika, përmes ministrit Erik Derycke, u shpreh për një lloj “protektorati” ndërkombëtar dhe organizimin politiko-shtetëror në formën e një konfederate, që do të përfshinte Kosovën, Serbinë dhe Malin e Zi. Sekretarja amerikane e shtetit, Ollbrajt, prezantoi variantin e krijimit të një “zone me status të mbrojtur ndërkombëtarisht”.<sup>33</sup> Më 15 prill 1999 presidenti Klinton nuk u shpreh për pavarësinë si opsion i zgjidhjes së konfliktit të Kosovës. Sipas tij kjo do të zgjidhej me vendosjen e një regjimi demokratik në Beograd.<sup>34</sup> Shkakun e këtij qëndrimi do ta ekspozonte më 30 qershor 1999, Sandy Berger, këshilltari për çështjet e sigurisë kombëtare të presidentit Klinton, i cili

<sup>30</sup> AFP 27.3.1999.

<sup>31</sup> Po aty.

<sup>32</sup> AFP 12.4.1999.

<sup>33</sup> Po aty.

<sup>34</sup> AFP, ATS 16.4.1999, 17.4.1999.

do të sqaronte se “ne vlerësojmë që një Kosovë e pavarur do të krijonte probleme të vërteta për sa i përket aftësisë së saj për të ekzistuar (viabilité), si dhe do të krijonte gjithashtu probleme të vërteta për qëndrueshmërinë e rajonit”.<sup>35</sup> Megjithatë e linte të hapur mundësinë e një zgjidhjeje tjetër për statusin e ardhshëm të Kosovës, kur shprehej se ajo iu përkiste kosovarëve dhe bashkësisë ndërkombëtare për t’u përcaktuar, edhe në varësi të zhvillimeve që nuk mund të parashikoheshin në atë kohë, siç ishte integrimi i Ballkanit në Europë dhe evoluimi politik në Europë.<sup>36</sup>

Ministri austriak i Punëve të Jashtme, Wolfgang Shusel (Wolfgang Schüssel), ishte për “një autonomi substanciale, të gjerë dhe sinjifikative”.<sup>37</sup>

8.- Pjesë thelbësore e diskutimeve ishte çështja e pranisë ose jo të forcave serbe në Kosovë pas lufte. ShBA ishin dakord që të lejohej një kontingjent i parëndësishëm, çka u kundërshtua nga Gjermania.<sup>38</sup>

Ministrat e Punëve të Jashtme të NATO-s, në mbledhjen e datës 12 prill 1999, u shprehën për idenë e “protektoratit ndërkombëtar” për të përshpejtuar kohën e rikthimit sa më të shpejtë të refugjatëve në shtëpitë e tyre. Në këto rrethana çështja e autonomisë, alternativës më të avancuar deri në atë kohë, u shty për më vonë, copëtimi, konfederata e entiteteve “etnikisht të pastra” dhe pavarësia ishin shmangur.<sup>39</sup>

Në këto rrethana zhvillimesh të brishta dhe të paqarta, ka shumë të ngjarë që nëse Milosheviqi do ta nënshkruante aktin e Rambujesë, Kosova mund të merrte vetëm statusin e një krahine me autonomi të zgjeruar, që, siç u tha, ishte projekti maksimal i asaj kohe.<sup>40</sup> Rasti e deshi që ai të ngurtësohej në obsesionin absurd, dëshirën për ta mbajtur Kosovën përgjithmonë nën thundrën e Serbisë, që ajo, në sajë të ndërhyrjes së NATO-s, gjakut të derdhur nga bijat dhe bijtë e saj në Luftën Çlirimtare, rezistencës paqësore të Ibrahim Rugovës, si dhe përkrahjes së gjerë ndërkombëtare, përfshirë edhe mbështetjen e fuqishme vëllazërore të Shqipërisë, të shpëtonte njëherë e mirë nga zgjedha serbe.

Ish presidenti i SHBA, Bill Clinton, lidhur me këtë çështje thotë ndër të tjera: “në janar të vitit 1999, serbët filluan të vrisnin sërish

<sup>35</sup> AFP 30.9.1999.

<sup>36</sup> Po aty.

<sup>37</sup> ATS, AFP 2.12.1999.

<sup>38</sup> AFP 12.4.1999.

<sup>39</sup> AFP 12.4.

<sup>40</sup> AFP, AP 13.4.

kosovarë të pafajshëm dhe kështu sulmet ajrore dukeshin të pashmangshme. Ne vendosëm të provonim diplomacinë edhe një herë, por nuk kishim shumë optimizëm. Objektivat e palëve ishin shumë larg njëra tjetrës. Shtetet e Bashkuara dhe NATO-ja donin që Kosova të gëzonte autonominë politike që kishte pasur nën kushtetutën jugosllave ndërmjet viteve 1974 dhe 1989 derisa ua hoqi Millosheviqi si dhe dëshironim një forcë paqeruajtëse të drejtuar nga NATO-ja që të garantonte paqen dhe sigurinë e civilëve kosovarë, duke përfshirë këtu edhe minoritetin serb. Millosheviqi dëshironte ta mbante Kosovën nën kontroll dhe ishte kundër vendosjes atje të trupave të huaja ushtarake. Shqiptarët kosovarë kërkonin pavarësi. Por ata ishin të ndarë edhe mes tyre. Ibrahim Rugova, kreu i qeverisë hije, ishte një burrë i butë, i dalluar për mbajtjen gjithmonë të një shalli rreth qafës. Unë isha i bindur që me të mund të arrinim një marrëveshje paqeje, por nuk isha aq i sigurt për faktorin tjetër, Ushtrinë Çlirimtare Kosovare (UÇK), të drejtuar nga një i ri i quajtur Hashim Thaci. UÇK -ja kërkonte pavarësi dhe e besonte se mund të ndeshej dhëmb për dhëmb me ushtrinë serbe.”<sup>41</sup>

Duke ndjekur rrjedhën e ngjarjeve që çuan në fillimin e bombardimeve në ish Jugosllavi, ai pohon gjithashtu se “në datën 24 (mars 1999), unë iu drejtova popullit amerikan për t’u treguar se çfarë isha duke bërë dhe arsyet pse po ndërmerrja një akt të tillë. U shpjegova atyre se Millosheviq-i u kishte zhvatur kosovarëve autonominë, duke u mohuar të drejtat e tyre të garantuara me kushtetutë për të folur gjuhën e tyre, për të pasur shkollat e tyre dhe për t’u vetëqeverisur. Unë iu përshkrova atyre masakrat serbe, vrasjen e civilëve, djegien e fshatrave, dëbimin e njerëzve nga shtëpitë e tyre, 60 mijë vetëm në pesë javët e fundit dhe gjithsej një çerek milioni. Më në fund unë kisha mundësi t’i vendosja ngjarjet aktuale në kontekstin e luftërave që Milosheviq-i kishte shpallur kundër Bosnjës dhe Kroacisë dhe në ndikimin shkatërrues të vrasjeve të tij mbi të ardhmen e Evropës.”<sup>42</sup>

Klinton shpjegon qëllimet kryesore të fushatës së bombardimeve, e cila, sipas tij, synonte “t’i tregonte Millosheviqit se ne e kishim seriozisht se donim të ndalonim një valë tjetër të spastrimit etnik, se donim të shmangnim një sulm akoma më të përgjakshëm kundër civilëve të pafajshëm në Kosovë dhe që, nëse Millosheviqi nuk do të dorëzohej së shpejti ne do të dëmtonim seriozisht kapacitetin ushtarak

<sup>41</sup> Klinton, Bill - “*Ne luftën, ju paqen*”, “Albania”, Tiranë 2000; Clinton, Bill - *Jeta Ime*, Dudaj, Tiranë, 2005; f. 714.

<sup>42</sup> Po aty. Klinton, Bill - *Jeta Ime*, Dudaj, Tiranë, 2005; f. 714.

të Serbisë”<sup>43</sup>, se “ne duam ta mbytim që në vezë këtë konflikt përpara se ai të destabilizojë gjithë Europën.”<sup>44</sup>

9.- ShBA dhe aleatët nuk e patën të lehtë të binin në marrëveshje për aksionin e bombardimit të Jugosllavisë, sepse kishte kundërshtime dhe komente të ndryshme që, në njëfarë mënyre, shkonin në dobi të Beogradit ose e lehtësonin pozitën juridiko-ndërkombëtare të veprimeve të ndërmarra prej tij ndaj Kosovës. Hezitohej t’i vihej emri i vërtetë asaj që po kryhej në Kosovë, kundërshtohej që të konsiderohej gjenocid. Interesante janë arsyetimet që bëheshin nga studiuesi i famshëm i marrëdhënieve ndërkombëtare Henri Kizinger, ish Sekretar i Shtetit i ShBA. Në një shkrim në *Newsweek* ai e akuzonte direkt Bill Klintonin se, nëpërmjet krahasimeve të dyshimta me praktikatat e Luftës së Dytë Botërore, barazonte Millosheviqin me Hitlerin.<sup>45</sup> Në të njëjtën linjë ishte edhe zëdhënësi i Human Rights Watch, i cili deklaroi se organizata në fjalë nuk e cilësonte gjenocid atë çka kishin kryer në Kosovë forcat ushtarake serbo-jugosllave. Përdorimi i këtij termi, sipas përcaktimeve të Konventës së vitit 1948 *Për gjenocidin*, insistonte ai, do të kërkonte detyrimisht ndërmarrjen e veprimeve për ta penguar atë, që nënkuptonte futjen e trupave këmbësore në Kosovë, si dhe nxjerrjen e personave përgjegjës, serbo-jugosllavë para Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Thuhet se përdorimi i këtij termi nga ana e administratës amerikane bëhej më tepër për të përlligjur sulmet e NATO-s si reagim ndaj praktikave serbe në Kosovë.<sup>46</sup>

Por nuk do të kalonin veçse disa ditë, kur më 27 maj 1999, kryeprokurorja e Tribunalit të Hagës, Louise Arbur, bëri publike padinë kundër Millosheviqit, duke e akuzuar për krime lufte. Pas kësaj, si një i pandehur për krime lufte, ai përjashtohej përfundimisht nga mundësia për t’u trajtuar si partner në negociatë.<sup>47</sup> Sepse një despot si ai, zhvishej nga e drejta për të mbajtur dhe përfaqësuar legjitimitetin e popullit të vet, për të ushtruar prerogativat që rrjedhin nga sovraniteti i vendit, në krye të të cilit ishte. Një e drejtë e tillë nuk mund të pretendohet dhe nuk mund të respektohet ndaj një individi të akuzuar për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe për krime lufte ose krime të tjera të kësaj natyre.<sup>48</sup>

<sup>43</sup> Po aty.

<sup>44</sup> AFP, AP 13.4.

<sup>45</sup> AFP 31.3.1999.

<sup>46</sup> Po aty.

<sup>47</sup> Fischer, 2008:227

<sup>48</sup> Ramonet, Ignacio - *Guerre dans les Balkans, Nouvel ordre global*, në *Le Monde diplomatique*, Juin 1999, pp.1,4-5.

10.- Në rrugëtimin e gjatë historik të popullit shqiptar të Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë, Marrëveshja e Rambujesë përbën një ndër hapat e rëndësishëm konstitutivë. Ajo vlerësohet si zanafilla e një procesi pararendës njohjeje, i cili do të inkurajonte nisma e veprimtari juridiko-kushtetuese dhe juridiko-ndërkombëtare, që do të çonin drejt një realiteti të ri në Kosovë, themelimit të shtetit të pavarur. Ky akt, produkt i një diplomacie intensive të faktorit relevant ndërkombëtar dhe i bashkëpunimit të elitës politike kosovare, forcoi bindjen e diplomacisë euro-atlantike se kishte ardhur koha e korrigjimit të padrejtësisë së madhe historike që iu ishte bërë shqiptarëve në fillimin e shek. XX. Pas gati 100 vjetëve, kur ajo u angazhua seriozisht për zgjidhjen e drejtë të së ardhmes së tyre politike, nisi “shlyerjen e borxhit të madh”. Formimi i shtetit të dytë të shqiptarëve, si përmbushje e aspiratës dhe përpjekjeve të tyre shekullore për flakjen e zgjedhës së huaj, është një hap gjigand drejt zgjidhjes së çështjes shqiptare, edhe pse jo zgjidhja tërësore. Me këtë ngjarje, që ishte po aq madhore sa 28 nëntori i 1912, nisi ringjallja dhe ringritja e shqiptarëve, fatet e ardhme të së cilëve shpresohen të jenë të mbara. Këtë herë, ndryshe nga më parë, ata patën përkrahjen dhe mbështetjen e fuqishme të aleatëve të botës euroatlantike, të ShBA-së dhe të vendeve të BE-së, me të cilët kanë institucionalizuar dhe zhvillojnë një bashkëpunim të ngushtë e të dobishëm.<sup>49</sup>

Platforma e Rambujesë, e cila përcaktonte qartë të drejtën e Kosovës për të vendosur për vete u bë baza e të gjithë dokumenteve të tjera të mëvonshme. Edhe nëse marrëveshja e nënshkruar në Rambuje – Paris, nuk ishte e përkryer, ajo është cilësuar si zgjidhja më e mirë për kohën. Pa të nuk do të ndodhte bombardimi i Aleancës Veriatlantike, liria e Kosovës do të vonohej, përndimi do të largohej nga kosovarët, që me apo pa vetëdije, do të vetizoloheshin. Pasojat, do të ishin tragjike për qytetarët e Kosovës dhe perspektivën e saj.

Fatmirësisht kësaj here fati ishte me Kosovën e lirë e të pavarur.

---

<sup>49</sup> Krisafi, Ksenofon, - *Lufta e Kosovës në labirintet diplomatike* (Gjenevë, 1998-2002), UMSHPRESS & ONUFRI, Tiranë, 2018, f. 368.

Ksenofon KRISAFI

RAMBOUILLET, A DECISIVE STEP  
TOWARDS KOSOVA'S INDEPENDENCE**Summary**

*The Rambouillet Accord constitutes one of the important constitutional steps in the long historical journey of the Kosova Albanian people towards freedom and independence. Therefore, our paper focuses on evidencing the undeniable importance, as well as analyzing some of the international legal aspects of this agreement. It is regarded as one of precursors, as the inception of an embryonic process of international recognition, which would encourage international legal and constitutional initiatives and activities that would lead to the establishment of the independent state of Kosova. This international act, the product of intense diplomacy on the part of the relevant international factor and the cooperation of the Kosovar political elite, strengthened the conviction of the internationals that the time had come to correct the great historical injustice of the 20th century against the Albanians. It seems that the great powers were already aware of the necessity of treating the Kosova Albanian people according to modern standards. They were convinced of the necessity to sever the unnatural ties with Serbia and the former Yugoslavia, to begin the process of its independence and to integrate Kosova into the community of nations and free political societies.*

*Kosova Albanians listened to their great allies, the US and EU, who insisted on the signing the Rambouillet Accord, and had the courage to disregard any paternalistic and threatening "advice" not to sign it, demonstrating admirable political intuition. Through their signing, they render their country the greatest service, turning the Rambouillet Conference and Accord into the prelude to Kosova's independence. They deserved all the blessings and appreciation for the foresight, courage, and prudence they demonstrated. The Rambouillet Accord Decisions paved the way for the legal formalization of Kosova's freedom and independence. The events took a lucky turn, which can be described, without hesitation, as magical. Serbia's obstructionist, anti-Albanian stance of not signing the agreement led to Serbia eventually losing Kosova, which was saved once and for all from its yoke.*

*In international law terms, the Rambouillet Accord became the starting point for the birth of the newest European state, as it legitimized for the first time the representatives of the people of Kosova as a party with equal rights. The Kosova issue that had been pending for about a century, has taken on new dimensions. Western diplomacy recognized and confirmed the parity of the dialogue parties. Kosovars enjoyed their natural right to defend political interests, to negotiate, and to decide their own destiny.*

**Key words:** *Rambouillet Accord, Kosova, Albanians, Diplomacy, US, EU*

# EVOLUIMI I OPINIONIT PUBLIK NDËRKOMBËTAR RRETH PAVARËSISË SË KOSOVËS

**Muhamedin Kullashi**

## **Përmbledhje**

*Evoluimin e opinionit publik ndërkombëtar rreth pavarësisë së Kosovës do ta saktësoja duke cekur se e kam parasysh ndërndikimin midis opinionit publik dhe qarqeve politike vendimmarrëse, në disa vende të Evropës Perëndimore. Këto vende, bashkë me SHBA-të, kanë marrë pjesë në intervenimin ushtarak me 1999, operacion ky që hapi rrugën për ta shtruar çështjen e statusit të Kosovës.*

*Shpjegimi i evoluimit të opinionit ndërkombëtar do të ketë parasysh procesin gradual të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe trajtimin e këtij procesi sa nga mediat, aq edhe nga qarqet politike zyrtare dhe analizat e ekspertëve dhe intelektualëve të vendeve të ndryshme perëndimore.*

*Lidhur me dallimet dhe ndryshimet e perceptimit të statusit të Kosovës, duhet pasur parasysh fakti se grilat përmes të cilave individët dhe grupet brenda shoqërive perëndimore, kanë shikuar çështjen e Kosovës, janë sajuar me të dhëna e njohuri që i ka selektuar çdonjëri prej tyre; se në këtë selektim kanë ndikuar afinitete psikologjike e njohëse të tyre. Supozimi se situata në Kosovë ka qenë e qartë dhe e kuptueshme, se shqiptimi i së “vërtetës” për këtë situatë ishte i lehtë, ngase është e qartë se kush është agresori e kush viktima, fjala vjen, është naiv dhe harron faktin se për situata të ngjashme në botë, gjithherë do të keni individë e grupe që do të elaborojnë hollësisht argumente të sofistikuar në favor të njëres apo palës tjetër ndërluftuese, duke selektuar fakte të ndryshme nga historia politike e atij vendi.*

***Fjalët çelës:*** *evoluim i opinionit publik, ndërkombëtar, pavarësia e Kosovës, Dayton*

### *Heshtja për Kosovën në Dayton*

Fakti se në Dayton, me 1995, nuk u bë fjalë për çështjen e Kosovës u interpretua në mënyra të ndryshme në Beograd e Prishtinë, si edhe nga vëzhguesit politik dhe nga zyrtarët politik të vendeve të ndryshme evropiane. Sipas disave, kjo heshtje vërtetonte sërish qëndrimin e përgjithshëm të bashkësisë ndërkombëtare ndaj kësaj çështje: indiferencën e saj. Për të tjerët, mos hapja e kësaj çështje shpjegohej me faktin se bashkësia ndërkombëtare e ka përqendruar vëmendjen e vet te kërkimi i një zgjidhjeje për Bosnjën, ku lufta mori përmasa të rënda gjatë tre vjetëve.

Kundrejt këtyre qëndrimeve që e mënjanonin çështjen e Kosovës nga rendi i ditës në agjendën e fuqive të mëdha, bashkë me disa intelektualë të shquar francezë (Paul Garde, Pierre Hassner, Georges-Marie Chenu, Antoine Garapon, Olivier Mongin, Patrice Canivez, Alain Joxe, Alain Finkelkraut etj.)<sup>1</sup> në paraqitjet tona publike shtronim kërkesa që situata e rëndë në Kosovë, të vihet në qendër të vëmendjes sa të BE-së aq edhe të SHBA-ve<sup>2</sup>.

Kemi theksuar se fillet e krizës së Jugosllavisë, e cila çoi te shpërbërja e saj, nëpërmjet konflikteve të armatosura, u manifestuan së pari në Kosovë në vitin 1981, dhe se kjo krizë markojë jetën politike të vendit, divergjencat e saj dhe luftërat politike gjatë një dekenie. Në fakt, shpërbërja e federatës jugosllave u hap me 1990 me suprimimin jolegal të autonomisë së Kosovës, si një njësi federale. Theksuam, se kjo krizë u cilësua mbi të gjithat me ushtrimin e formave të shumta të shkeljeve të së drejtave të njeriut ndaj shqiptarëve, si dhe me trajta të caktuara të terrorit dhe të diskriminimit që synonin të nxisin shpërnguljet e shqiptarëve dhe pastrimin etnik të Kosovës. Argumentin tjetër që kemi

<sup>1</sup> Në vitin 1992, në lokalet e revistës prestigjioze franceze *Esprit*, u themelua Komiteti i Kosovës, i cili tuboi një numër të konsiderueshëm të filozofëve, sociologëve, antropologëve, politologëve e juristëve të shquar francez, të cilët zhvilluan aktivitete të shumta lidhur me Kosovën, gjatë njëzet vjetëve, në Francë dhe në vendet e tjera perëndimore. Anëtarë nderi të këtij komiteti ishin edhe mendimtarët Paul Ricoeur, Claude Lefort, Edgar Morin, Pierre Hasner. Përveç paraqitjeve të shpeshta publike lidhur me problemet e Kosovës, në media e në konferenca, anëtarët e këtij Komiteti organizonin takime të rregullta me personalitete të larta politike franceze dhe të BE-së në Bruxelles et Paris.

<sup>2</sup> Në artikullin tonë “Heshtja rreth Kosovës” në librin *L'ex-Yougoslavie en Europe. De la faillite des démocraties au processus de paix (Ish-Jugosllavia në Evropë. Mbi dështimin e demokracive në procesin e paqës)*, L'Harmattan, Paris, 1997, f.221-230. Në këtë libër u botuan kumtesat e konferencës, me këtë titull, e cila u mbajt në Universitetin e Sorbonës I, dy vjet më parë, më 1995.

zhvilluar kishte të bëj me *sigurinë* e regjionit të Ballkanit, destabilizimi i të cilit doemos do të ndikonte në atë të Evropës në përgjithësi. Zaten, gjeostrategët dhe zyrtarët e lartë politik të bashkësisë ndërkombëtare, filluan të konstatojnë, në paraqitjet e tyre publike, se shpërthimi eventual i konflikteve në rajon, do të riaktivizonte tensionet latente midis vendeve të Ballkanit.

Në të njëjtën kohë, disa qarqe politike në Serbi e interpretuan mospërmendjen e çështjes së Kosovës në Dayton si provë të tezës se kjo çështje është “çështje e brendshme” e Jugosllavisë dhe se shqiptarët duhet ta braktisin shpresën për një *ndërkombëtarizim* të këtij problemi, duke iu nënshtruar vullnetit (diktatit) të shtetit serb. Në anën tjetër, pjesa më e madhe e opinionit kosovar shfaqti një dëshpërim të theksuar karshi “kësaj shurdhësie, indiference dhe cinizmi të faktorit ndërkombëtar” përball *aparteidit* dhe situatës së padurueshme që mbretëronte në Kosovë<sup>3</sup>.

Megjithatë, disa analiza gjeopolitike dhe disa deklarata të zyrtarëve evropianë, asokohe, tregonin se ende besohej në një zgjidhje politike të problemit të Kosovës. Kësisoj, nyja e Kosovës, brenda palëve të cilës mund të deshifrohej gjeneza e krizës jugosllave, sipas disave mund të zgjidhej me një pragmatizëm politik, pa e prerë nyjën. Pyetja e cila shtrohej, thënë më saktësisht, pyeste për mundësinë e ekzistimit të një zgjidhje politike, e cila do t’i pajtonte kërkesat e kundërta të Serbisë dhe atyre të Kosovës lidhur me statusin e Kosovës. Në këtë kontekst analizohej po kështu çështja e pozicioneve që mund të marrin shtete të ndryshme të bashkësisë ndërkombëtare si dhe instancave ndërkombëtare karshi këtyre kërkesave dhe qëndrimeve të kundërta.

Në analizat gjeopolitike që shpaloseshin nga mesi i viteve 90<sup>4</sup>i shekullit të kaluar, qoftë nga zyrtarët e shteteve të mëdha, qoftë nga ekspertët viheshin në pah *kundërshtitë* midis integritetit territorial të një shteti dhe të drejtës për vetëvendosje, midis të drejtave individuale dhe atyre kolektive të pakicave dhe të drejtave të njeriut, midis aspiratave politike të popujve dhe interesave gjeostrategjike të bashkësisë

<sup>3</sup> Ibidem, f.222.

<sup>4</sup> Lidhur me këto çështje të Kosovës, kemi shkruar edhe në artikujt e botuar në veprat e përbashkëta, me intelektualët francez: *Vukovar, Sarajevo*, Seul, Paris, 1993.

*La République, l'Europe et l'Universel*, Belfort, 1993, *De la question albanaise au Kosova*, Editions Complexes, Bruxelles, 1999, *Sur l'ex-Yougoslavie*, Collège International de Philosophie, Paris, 1993. Edhe këta libra ishin përmbledhje e kumtesave të konferencave të mbajtura paraprakisht në Paris, Bruxelles dhe Belfort.

ndërkombëtare. Kësisoj, fjala vjen, në disa tubime publike, zyrtarë të BE-së ishin të bindur se afirmonin si duhet parimet e të drejtave të njeriut, kur thoshin se ato duhet të trajtohen si të drejta të individëve, duke evituar që të kolektivizohen, “kolektivizim” ky i cili shpinte te “etnicizimi” i problemit në Kosovë. Kundrejt këtyre qëndrimeve kemi reaguar duke vënë në pah kufizimin thelbësor të kësaj *qasje*: mosmundësinë, duke u nisur nga kjo, për të kuptuar karakterin e problemit, realitetin e ngjarjeve dhe natyrën e aksioneve të qeverisë serbe karshi Kosovës. Kësodore, këta zyrtarë e ekspertë, pohonin se largimi i mjekëve ose profesorëve nga shkollat dhe Universiteti i Prishtinës duhet të shtrohej në rrafshin e të drejtave të individëve, duke evituar “etnicizimin”?! Këtë *qasje* e mbronin edhe disa gazetarë e intelektualë “demokratë” nga Serbia, në tribunat publike të vendeve perëndimore.

Në përgjigjet tona theksonim se kjo *qasje* mjegullon të kuptuarit e politikës së regjimit serb ndaj Kosovës. Në fakt, burimi i problemit kishte të bëjë me praktikat e shteti serb që “etnicizonin” të gjitha raportet brenda shoqërisë dhe institucioneve të Kosovës. Ky regjim i largonte mjekët, profesorët, zyrtarët e institucioneve të Kosovës, në vitet ‘80 dhe në vitet ‘90 me një kriter etnik: ai dëbonte nga këto institucione jo qytetarët e individët *abstrakt* të shoqërisë kosovare, madje jo aq për aksionet e tyre kundrejt masave të regjimit serb, por thjesht për faktin se ishin “shqiptarë”. Kësisoj, “pastrimi etnik” i institucioneve të Kosovës (në fushat e arsimit, të shëndetësisë, të ekonomisë, të mediave etj.) zuri të thellohej nga korriku i vitit 1990. Masat dhe aksionet e shtetit serb kundrejt Kosovës, nuk ishin thjesht aksione të një “shteti jodemokratik”, siç paraqitej kjo në ligjërimet e disa zyrtarëve të BE-së, ngase ato buronin nga një optikë dhe horizont thellësisht *etnik* i shtetit serb<sup>5</sup>.

Një *qasje* tjetër, shumë e përhapur sa në qarqet politike të vendeve perëndimore aq edhe në mediat e tyre, e trajtonte Kosovën ashtu siç e interpretonte regjimi serb: si pjesë e shtetit serb apo si “provincë” e Serbisë. Kjo *qasje* dhe ky pikëshikim mbi Kosovën ka vazhduar të jetë i

<sup>5</sup> Muhamedin Kullashi, në artikullin “La production de la haine” (Prodhimi i urrejtjes), i botuar në librin tonë *Humanisme et haine. Les intellectuels et le nationalisme en ex-Yougoslavie, L’Harmattan*, 1998, Paris. Artikulli mbi vendosjen e sistemit të *apartheidit* në Kosovë, u botua edhe në gjuhën spanjolle në një vepër të përbashkët, e cila u botua në Madrid: *Informe sobre el conflicto y la guerra de Kosova*, Ediciones del oriente y del mediterraneo, Madrid, 1999. Në vitin 2003 dhe 2004 këto qëndrime i kemi zhvilluar edhe në një Konferencë për Ballkanin në Universitetin e Madridit dhe një tjetër në Universitetin e Barcelonës.

pranishëm në opinionin e këtyre vendeve, madje edhe pas ndërhyrjes ushtarake të NATO-s, në Kosovë, me 1999. Mirëpo, për afirmimin e opsionit të pavarësisë së Kosovës, te këto vende me ndikim në politikën ndërkombëtare, ky interpretim i Kosovës si “pjesë e Serbisë” ishte pengesë e madhe që paraqitej, çdoherë rishtazi në debatet publike dhe i konvenonte sa Serbisë aq edhe qarqeve proserbe në vendet perëndimore. Së këndejmi, ishte e domosdoshme, që të vihen në pah, në këto debate, të dhëna e aspekte të specificitetit të problemit të Kosovës, duke filluar nga realiteti juridiko-kushtetues që Kosova kishte në Jugosllavinë federale. Ky ishte një aspekt i rëndësishëm në ndërtimin e një *sistemi të argumentimit* të legjitimitetit të pavarësisë së Kosovës, që mëtonte evitim të një afirmimi thjeshtëzues të vullnetit të popullit të Kosovës.

Kësisoj, prezantimi i strukturës federale të ish-Jugosllavisë dhe të statusit të Kosovës brenda saj, gradualisht do të zë një vend në shqyrtimet mbi ardhmërinë e saj. Ky prezantim i referohej sa Kushtetutës së fundit të ish-Jugosllavisë, asaj të vitit 1974, aq edhe realitetit të raportit të forcave politike në atë hapësirë. Në këtë Kushtetutë theksohej barazia kushtetuese e tetë njësieve federale, barazi e artikuluar në vetë strukturën e pushtetit. Në fakt, Kosova kishte të njëjtat organe shtetërore (Presidencën, qeverinë, parlamentin, ligjin kushtetues, gjykatën kushtetuese etj.) si dhe kompetencat thelbësisht të njëjta sikurse edhe republikat. Deputetët e Kosovës merrnin pjesë në *konstituimin* e të gjitha instancave federale dhe kishin të drejtën e vetos sa i takon ligjeve kryesore federale dhe vendimmarrjes në këto instanca.

Analiza e këtij *realiteti kushtetues-juridik* para qarqeve politike dhe opinionit ishte e rëndësishme edhe për faktin se kjo bënte të mundur që të nxirret në shesh kufizimi i pozicionit, shumë i përhapur, i cili e reduktonte çështjen e Kosovës në çështje të të Drejtave të njeriut. Por njëherazi, ky realitet kushtetues-juridik bënte të mundur të kuptuarit e *aksioneve të regjimit serb* kundrejt Kosovës: suprimimin e autonomisë së Kosovës në vitet 1989- 1990, aksion ky thjesht antikushtetues, aq më tepër pse u shoqërua me një ndërhyrje ushtarako-policore dhe vendosje të gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë. Ky suprimim ishte një akt i dhunshëm, ngase nuk ishte i paraparë si procedurë legale as në Kushtetutën e Jugosllavisë e as në atë të Serbisë. Mirëpo, siç konstatuan edhe disa ekspert jugosllav, ky suprimim i dhunshëm i autonomisë së Kosovës ishte akt i “vetsuprimimit juridiko-kushtetues të Jugosllavisë” si subjekt i të drejtës ndërkombëtare.

Ne theksonim, njëherazi, se edhe Parlamenti evropian e ka dënuar, me disa rezoluta, suprimimin e autonomisë së Kosovës si akt

arbitrar dhe jolegal. Paradoksalisht, qarqet politiko-diplomatike, por edhe shumica e mediave, të vendeve perëndimore, përkundrejt qëndrimit të Parlamentit evropian, ishin të prira të injorojnë këto fakte, dhe vazhdonin ta trajtojnë Kosovën si pjesë ose si “provincë” e Serbisë.

Megjithatë, kritika e suprimimit të autonomisë së Kosovës, ishte e pamjaftueshme në këto debate për ta shpjeguar shkallën e përkeqësimit të situatës në Kosovë. Mu për këtë, argumentimi i *legjitimitetit* të pavarësisë së Kosovës, duhej të ndriçonte objektivin strategjik të regjimit serb: krijimin e një shteti etnikisht të pastër serb. Në realizmin e këtij objektiv, ishin vënë në lëvizje masa dhe aksione edhe më radikale: pastrimi masiv i të gjitha institucioneve të Kosovës nga prania e shqiptarëve, krahas arrestimeve masive të shqiptarëve, për shkak të pamfleteve politike ose protestave politike.

Karakterit paradoksal dhe sfidues për BE-në shfaqej edhe në faktin se në momentin kur rënia e murit të Berlinit shënonte nismën e proceseve të demokratizimit të vendeve që kishin qenë nën sundimin e regjimeve totalitare, proces ky që shoqërohej me lirin e të burgosurve politikë dhe me masa të para të afirmimit të të drejtave të njeriut, në Kosovë Serbia zbatonte atë që disa ekspertë dhe intelektualë lucid e quajtën “apartheid”. Ishte e domosdoshme që ky kualifikim të argumentohet bindshëm: veç tjerash, fakti se më se 400.000 nxënës, studentë dhe profesorë shqiptarë u përjashtuan dhunshëm nga sistemi arsimor. Këtë operacion të “pastrimit etnik” të institucioneve pushteti serb e zgjeroi në të gjitha sferat e jetës shoqërore e politike të Kosovës: kësisoj, shqiptarët u dëbuan nga spitalet e klinikat, nga ndërmarrjet ekonomike, nga fusha e mediave dhe të kulturës etj<sup>6</sup>.

Në analizat tona kemi vënë në pah se këto aksione të pastrimit etnik të Kosovës kishin si objektiv jo thjesht mbajtjen e një gjendje të diskriminimit etnik por më tepër ndryshimin radikal të strukturës etnike të Kosovës<sup>7</sup>.

<sup>6</sup> Në artikullin “Kosova peng i regjimit serb”, i botuar në librin *Kosova, un drame annoncé* (Editions Michalon, Paris, 1999), patëm theksuar: “Me përjashtim të disa qarqeve të ngushta të intelektualëve dhe shoqatave të drejtave të njeriut, Evropa u tregua e shurdhër dhe e verbër ndaj apartheid-it dhe terrorit sistematik i cili shkonte duke u thelluar në Kosovë. Kjo Evropë fillon tani të zgjohet dhe të kuptojë, nëpërmjet masakrave masive dhe deportimeve të shqiptarëve, se çka i kishte paraprirë kësaj faze përfundimtare të “pastrimit etnik” në Kosovë. Ata që i quajnë këto praktika si “mesjetare” gabohen: plani i hollësishëm, dispozitivi i cili është aktivizuar, vendosmëria gjatë viteve për ta zbatuar atë janë specifike e këtij shekulli, i takojnë faqeve më të errëta të “shekullit tonë të tmerrshëm”. f.202.

<sup>7</sup> Njëra nga organizatat ndërkombëtare e cila përvetësoi disa elemente të kësaj analize ishte edhe *Konfederata e sindikatave të lira*, me seli në Bruxelles, në

Heqja e kësaj *përmbajtje* e realitetit politik dhe spektrit të aksioneve të shtetit serb në Kosovë e bënte të thjeshtëzuar paraqitjen e situatës në Kosovë, duke e reduktuar në një përplasje të thjeshtë të dy nacionalizmave, në përplasjen e dy projekteve, njësoj ekskluziviste. Në këtë mënyrë bëhej barazimi dhe simetria artificiale e përgjegjësive. Ky evakuim i kësaj përmbajtje të realitetit politik bënte që të mos kuptohej si duhet baza dhe motivimet e thella të shqiptarëve në kërkesat e tyre për Kosovën si republikë e pavarur. Kjo kërkesë, nuk ishte vetëm aspiratë e moçme e shqiptarëve, pas shembjes së Perandorisë otomane, e ngjashme me ato të popujve të tjerë të Ballkanit. Ajo është ushqyer nga praktika e një represioni total e të egër të pushtetit serb, në dy deceniet e fundit: me terrorin e dyfishtë, *terrorin e propagandës*, në të cilin shqiptarët paraqiteshin jo vetëm si armiq por edhe si “barbarë”, “dhunues primitiv” etj., dhe me terrorin e shumëfishtë policor<sup>8</sup>.

Në opinionin e disa vendeve perëndimore ishte mjaft e përhapur teza se Kosova e ka vendin brenda Jugosllavisë, ashtu si ishte dhe përkundër gjithë asaj që kishte ndodhur në Kosovë. Integriteti territorial dhe mosndryshimi i kufijve shikoheshin si të pakontestueshme, ndonëse kufijtë e Jugosllavisë kishin ndryshuar dukshëm. Mirëpo, derisa për Kroacinë dhe Slloveninë, opinionin publik në vendet perëndimore kishte filluar të mësohej disi ta pranojë pavarësimin e tyre dhe të familjarizohej me argumentin se ato kishin pasur statusin e republikave në ish-Jugosllavi, ky perceptim nuk vlente për Kosovën. Asokohe dominonte bindja se Kosova s’ishte veçse një provincë e Serbisë. Duhet të theksojmë këtu se nuk kanë qenë të shumtë ata që

---

raportin me titull “Licenciements et purifications ethnique”, Bruxelles, 1993. Në artikullin tonë “Kosova, peng i regjimit serb” i botuar në veprën e përbashkët *Kosova, un drame annoncée*, kemi theksuar: “Vullneti i regjimit serb për t’i fshirë të gjitha gjurmët e pranisë së shqiptarëve në Kosovë u bë edhe më i radikalizuar, ditët e fundit të muajit mars dhe muajit prill, pra pasi NATO kishte operacionin e bombardimit të caqeve ushtarake serbe. Me këto masa, del në shesh përmbyllja e procesit të *çrrënjosjes* së pranisë së shqiptarëve në Kosovë, i cili kishte filluar që nga vitet 1980 me “pastrimin etnik” të institucioneve, me shkatërrimin e monumenteve historike shqiptare, me *heqjen* e të gjitha mbishkrimeve në gjuhën shqipe si dhe të të gjitha emrave të personaliteteve historike e kulturore shqiptare që mbanin rrugët dhe institucionet.” f.201-202.

<sup>8</sup> Në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqatave kundër pastrimit etnik, e cila u mbajt në qytetin Nantes, në prill të vitit 1994, ku merrnin pjesë përfaqësuesit e 300 shoqatave nga të gjitha krahinat e Francës, kemi pasur rastin t’i zhvillojmë këto argumente. Këto shoqata kishin ndikim te deputetët e Parlamentit dhe të Senatit francez, si edhe te qarqet politike dhe te mediat.

problematizonin këtë qëndrim: në qarqe politike e diplomatike, por edhe në media, në fillimin e viteve 2000, ky qëndrim dilte i vetkuptueshëm dhe i “natyrshëm”.

Disa qarqe politike dhe media në vendet perëndimore e kontestonin kërkesën e shqiptarëve për pavarësinë e Kosovës, me kriterin e të drejtës ndërkombëtare, përkatësisht me integritetin territorial dhe sovranitetin e shtetit serb. Ky “argument”, i përsëritur shpeshkali në debatet publike dhe në komunikimet diplomatike, abstragonte së pari shkeljet e rënda të së drejtave të njeriut por njëherazi edhe specificitetin e Federatës jugosllave, brenda së cilës Kosova kishte pasur statusin e një njësie federale, si dhe kufijtë e definuar sipas Kushtetutës së vitit 1974<sup>9</sup>.

Në opinionin ndërkombëtar kishte zënë rrënjë edhe bindja se Kosova i takon serbëve. Këtë të drejtë *ekskluzive* të serbëve, diplomatë, ekspertë apo gazetarë e mbështetnin njëherazi mbi argumentin e “të drejtës historike”, mitin themelues të Kosovës si “djep i Serbisë”, si “tokë e shenjtë mesjetare” por edhe mbi argumentin e të drejtës ndërkombëtare, integritetin territorial të Serbisë. Përdorimi i këtyre dy argumenteve, që janë në *kundërshti* njeri me tjetrin, dëshmonte për një vullnet i cili synonte të përdorë çkado për ta mbështetur interesin e Serbisë në dëm të Kosovës.

Në kritikën e këtyre qëndrimeve kemi përkujtuar se pushteti serb dhe shumica e partive politike serbe gjithmonë kanë përdorë “argumentin historik” për ta mbështetur “të drejtën” *ekskluzive* të *pronësisë* mbi Kosovën<sup>10</sup>. Në anën tjetër, këto parti njëherazi kanë mbrojtur “të drejtën etnike” të serbëve në Vojvodinë dhe në “Krajinat” e Kroacisë dhe të Bosnjës. Ndonëse e drejta ndërkombëtare nuk e pranon as të ashtuquajturën “e drejtë historike” e as atë “etnike”, qarqe të ndryshme politiko-diplomatike si dhe media, ndonjëherë edhe ato prestigjioze, i mbështetnin këto “argumente” proserbe në kundërshtim jo vetëm me të drejtën ndërkombëtare por edhe duke flakur vlera të çmuara (si të drejtat e njeriut), si edhe duke banalizuar krimet masive

<sup>9</sup> Në artikullin tonë *Politiche dell'odio* (Politika e urrejtjes) i botuar në librin *Confini di Culture*, Fano të Italisë, 2001, pas ligjëratës me këtë temë, në muajin maj, në Kuvendin e Komunës Fano.

<sup>10</sup> Artikulli i ynë mbi Kosovën, në veprën e përbashkët *Extrémismes en Europe* (C.E.R.A.), Paris, 1997.f.226-227. Artikulli i ynë në librin *Kosova, six siècles de mémoires croisés*, INALCO, Paris, 2001, ku u botuan kumtesat e Konferencës me këtë titull, në Universitetin Sorbona 3.

mbi civilët, që ishin objekt i terrorit etnik. Këto qarqe i bënin të veta këto “argumente” të aktorëve politikë serb, ndonëse ishin në kundërshtim me kulturën politike evropiane<sup>11</sup>.

Një version i këtij “argumenti”, i zhvilluar nga politikanë e intelektualë perëndimorë, pohonte se “historia dhe kultura”, duke pasur parasysh kishat mesjetare ortodokse serbe, janë në anën e kërkesave serbe, duke i reduktuar kështu shqiptarët në një *numër*, në faktor “biologjik” ose “demografik”. Ithtarët e pikëpamjeve të tilla futnin në përdorim, në debatet publike për çështjen e Kosovës, një konceptcion të komprometuar që ndanë popujt në ata që janë “historik” dhe në ata “jo-historik”. Konceptcioni i tillë ka më së paku të bëjë me kulturën, pasi që në këtë rast monumentet kulturore e historike mesjetare përdoren si *instrumente të mohimit* të drejtave të një populli, e në veçanti të drejtave politike, duke mohuar kështu kulturën dhe historicitetin e një populli joserb.

Kësodore, brenda opinionit ndërkombëtar zhvillohej riprodhimi i *mitologjisë politike* serbe, e cila në vete përmbante jo vetëm mohimin e të drejtave politike e njerëzore të një populli, por ishte njëherësh në kundërshtim me kulturën politike evropiane. Aspekti paradoksal i përvetësimit të qëndrimeve të një nacionalizmi ekstrem nga një pjesë e elitave politike e intelektuale evropiane, dilte në shesh edhe me faktin se disa intelektualë e shoqata serbe nga Beogradi (si fjala vjen Komiteti i Helsinkit, Fondi për të Drejtën Humanitare), gjatë viteve, do t’i kritikojnë në mënyrë të themeltë ato qëndrime<sup>12</sup>.

Kërkesa e shqiptarëve të Kosovës për një shtet të pavarur kritikohej nga disa qarqe politike e intelektuale edhe me argumentin se kjo kërkesë shprehë “separatizmin, vullnetin e rrezikshëm për t’i shkëputur lidhjet me popujt e tjerë, të provokojë fragmentimin e shteteve ekzistuese<sup>13</sup>”. Përballë këtyre kritikave janë zhvilluar analiza

<sup>11</sup> Në intervistën për revistën e Fondacionit Alberto Moravia, “Quaderni” (2,1998), e cila botohet në Romë, me Attilio Scarpellini, me titullin “Kosova, la riconquista di Slobodan Milosevic”, kemi vënë në pah se si terrori i propagandës me urrejtje etnike ka përgatitur terrenin për pastrimet etnike të institucioneve e pastaj për luftën e cila u shoqërua me dëbimin masiv të shqiptarëve. f.155-164.

<sup>12</sup> Në artikullin tonë “Pastrimi etnik dhe gjenocidi në ish-Jugosllavi”, i botuar në veprën e përbashkët *Parler des camps, penser les génocides (Të flitet për kampet, të mendohen gjenocidet)* Albin Michel, Paris, 1999. Tekstet e botuara këtu ishin kumtesa të simpoziumit, me këtë temë, i mbajtur në Sorbonë, në muajin maj 1997. (Autorë ishin, veç tjerëve edhe Catherine Coquio, Tzvetan Todorov, Alain Brossat, Véronique Nahoum-Grapp etj.)

<sup>13</sup> *L'ex-Yougoslavie en Europe. De la faillite des démocraties au processus de paix*, f.228.

të cilat kanë vërë në pah, veç tjerash edhe disa aspekte të realitetit politik të ish-Jugosllavisë. U theksua se shembja e ish-Jugosllavisë, e shkaktuar nga konfliktet midis aktorëve politik e ushtarak të njësive federale, të cilat e themeluan Jugosllavinë si shtet i përbashkët i popujve sllavë të Jugut. E në veçanti me vullnetin hegjemonik të Serbisë, të cilën nuk e pranoi asnjë republikë, duke filluar nga Sllovenia e deri te Mali i Zi. Ndërkaq, shqiptarët e Kosovës u gjenden brenda Jugosllavisë pa vullnetin e tyre politik<sup>14</sup>. Së këndejmi vërejtja për vullnetin për separatizëm nuk mund t'u bëhej shqiptarëve, ndonëse kishin pësuar gjatë decenieve forma të ashpra të diskriminimit e shtypjes. Në anën tjetër, megjithëse Sllovenia, Mali i Zi e Maqedonia nuk kishin pësuar trajta të tilla të dhunës, ato megjithatë votuan për pavarësi në referendimet e organizuara në fillim të viteve 90<sup>15</sup>.

<sup>14</sup> Në artikullin tonë mbi luftën në Kosovë në librin *Letra brezave të ardhshme* (i botuar në gjuhën franceze dhe në atë angleze), botim i UNESCO-së (Paris, 1999) i drejtuar nga Federico Mayor, Sekretar i përgjithshëm i UNESCO-së. Autorë të artikujve të tjerë të këtij libri ishin edhe Kofi Anan, Nadine Gordimer, Richard Rorty, Luc Montagnier, Remo Bodei, Fernando Savater, Ilja Prigogine etj.

<sup>15</sup> Pas takimeve me deputetët francezë dhe me disa ministra, në fund të muajit qershor 1999, Presidenti i Francës Jacques Chirac na priti për herë të dytë në Pallatin Elysée. Takimin e parë e kemi pasur në muajin prill, gjatë bombardimeve të NATO-s. Garaponi ia kishte dërguar më parë librin që e kishim botuar po atë vit *Le Kosova, un drame anoncé*, përmbledhje e artikujve, kryesisht të anëtarëve të Komitetit të Kosovës. Veç disa anëtarëve të Komitetit të Kosovës, në takimin me Chirac-un ishin edhe Ismail Kadare, shkrimtari Jean d'Ormesson, e njëherësh edhe drejtori i të përditshmes *Le Monde* Edwy Plenel dhe editorialisti i të përditshmes *Le Figaro*, Gérard Slamma.

Chirac-u shprehu kënaqësinë që operacioni NATO-s përfundoi me sukses. Ai përkujtoi, megjithatë, se paralajmërimi i një ndërhyrje tokësore të NATO-s kishte shkaktuar kriza në koalicionet e majta të qeverive në Francë, Itali e Gjermani. Komunistët dhe të gjelbërit ishin kërcënuar se do ta braktisin qeverinë nëse lufta në Kosovë thellohet dhe zgjatet. Ai tha se Millosheviqi kishte kalkuluar me këto përçarje, mirëpo, paralajmërimi i një ndërhyrje tokësore megjithatë e kishte detyruar të tërhiqet, me qëllim të ruajtjes së pushtetit.

Biseda u soll, në këtë takim, sa rreth ardhmërisë së Kosovës, aq edhe asaj të Serbisë dhe Millosheviqit. Chirac-u shprehu rezervë ndaj opsionit të pavarësisë së Kosovës, duke theksuar se “duhet evituar të hapet kutia e Pandorës në Ballkan”. Në fjalën time, pasi e falënderova për mbështetjen që i dha ndërhyrjes së NATO-s, e cila solli çlirimin e Kosovës, përkujtova se “kutia e Pandorës” ishte çelur më herët, me shpërbërjen e Jugosllavisë në entitete të federatës. Shtova se pasi që popujt jugosllavë që e kishin krijuar Jugosllavinë vendosën të ndahen, shqiptarët nuk mund të mbeteshin në një strukturë të vdekur, në të cilën më parë u detyruan, përkundër vullnetit të tyre, të jetojnë. Bëra krahasimin edhe midis kërkesës së Malit të Zi për pavarësi, megjithëse atje nuk është shënuar ndonjë terror serb, me

### *Propozimet për ndarjen e Kosovës*

Disa qarqe politike e intelektuale në Beograd, karshi kërkesës së shqiptarëve të Kosovës për pavarësi, zhvillonin propozime të tjera. Derisa ishin fort të rralla mbështetjet e kësaj kërkesë të shqiptarëve për pavarësi (si Lazar Stojanovic, Natasa Kandic, C. Jovanovic etj.), në anën tjetër, Dobrica Cosic, Branislav Krstic dhe shumë të tjerë, zhvillonin tezën se është e rrezikshme që Kosova të mbahet më tutje brenda Serbisë. Kjo tezë arsyetohej me supozimin se nëse Serbia demokratizohet, shqiptarët mund të bëheshin “sundues të vërtetë” të Kosovës, jo vetëm për shkak të shkathtësive të tyre ekonomike e politike por edhe për shkak të natalitetit të tyre, i cili shikohej si “armë e pushtimit të tokave serbe”<sup>16</sup>. Prandaj, këto qarqe propozonin *ndarjen e Kosovës*, e cila do ta ndalte “ekspansionin” e tyre. Qarkullonin versione të ndryshme të *vijave ndarëse* të Kosovës. Disa qarqe politike të Beogradit, kanë komunikuar, gjatë viteve 90 por edhe në vitet 2000, me disa zyrtarë të Shqipërisë për realizimin e kësaj ndarje midis Serbisë dhe Shqipërisë. Presidenti i Serbisë Tadiq, veç të tjerëve, e mbështeste tezën se Kosova si subjekt politik i shqiptarëve “nuk ekzistonte” prandaj e konsideronte të arsyeshme që ta zgjidhë problemin me një marrëveshje me Shqipërinë për ndarjen e Kosovës.

Disa qarqe politike brenda BE-së por edhe në SHBA shtronin si zgjidhje të mundshme një status të “autonomisë së fortë”, sipas modelit të Kushtetutës së vitit 1974 të ish-Jugosllavisë. Disa përfaqësues politikë të shqiptarëve të Kosovës kishin lënë të kuptohet se do të mund të pranonin statusin e një republike të barabartë me republikat e mbetura (Serbia dhe Mali i Zi) brenda një unioni të ri të Jugosllavisë.

Ndërkaq, Ibrahim Rugova propozonte asokohe një zgjidhje të *përkohshme* të çështjes së Kosovës: një status special nën protektoratin e OKB-së, çmilitarizimin e Kosovës, përgatitjen e kushteve për zgjedhje të lira. Ky propozim i Rugovës nuk gjeti mbështetje te kancelaritë perëndimore, ndonëse ato vazhduan ta lavdërojnë “orientimin e tij paqësor e të moderuar”<sup>17</sup>.

Nga mesi i viteve 2000, përfaqësuesit politikë të SHBA-ve, të Britanisë së Madhe dhe të Gjermanisë mbështetnin opsionin e

---

kërkesën për pavarësi të Kosovës. Kadareja e Bernard-Henri Lévy mbështetën kërkesën për pavarësi të Kosovës.

<sup>16</sup> Branislav Krstic, *Kosova izmedju istorijskog i etnickog prava* (Kosova midis së drejtës historike dhe të drejtës etnike) Beograd, 1999.

<sup>17</sup> Marie-Françoise Alain-Xavier Galmiche, *La question du Kosova*, Entretiens avec Ibrahim Rugova, Fayard, 1994.

pavarësisë së Kosovës. Ndërkaq, së paku një pjesë e diplomacisë franceze si dhe asaj italiane, nuk ishin dakord për këtë opsion dhe në këtë drejtim përkujtonin kundërshtimin e Rusisë ndaj pavarësisë së Kosovës. Këto ndarje bënë që të shtyhet sërish vendimi për statusin e Kosovës, e kjo shtyrje shkaktoi efekte negative jo vetëm në Kosovë por edhe në regjion. Joefikasiteti në zgjidhjen e disa problemeve pas luftës, lidhet pjesërisht me ambiguitetet e rezolutës 1244 e OKB-së sa i takon suazës juridike (jugosllave, kosovare apo ndërkombëtare) brenda së cilës duhej të funksiononin institucionet e Kosovës.

Ambiguitetet e Marrëveshjeve të Rambouillet-së, të cilave u referohet Rezoluta 1244, reflektonin *hezitimet dhe oscilimet* e bashkësisë ndërkombëtare sa i takon statusit të Kosovës. Hezitime këto që cilësoheshin kryesisht me refuzimin e statusit të pavarësisë dhe mbështetjen e formave të ndryshme të autonomisë (« substanciale” etj.). Këto oscilime të qëndrimeve reflektonin perceptimin e këtyre vendeve për interesat e tyre gjeopolitike e ekonomike në raportet që kishin me Serbinë<sup>18</sup>.

Midis efekteve të tjera negative, kjo pavendosmëri te disa fuqi të mëdha shkaktoi disa pasoja. Te shumica e madhe popullsisë së Kosovës (te shqiptarët por edhe te disa pakica) u sforcua një ndjenjë e thellë e *pasigurisë* sa i takon ardhmërisë së tyre politike aq më tepër se rivendosja e pushtetit serb mbi Kosovën përmendej në disa qarqe politike evropiane si një opsion i mundshëm. Pakica serbe në Kosovë, vazhdonte të mbajë shpresa se pushteti serb do të kthehet në Kosovë. Dhe pikërisht për këtë arsye, serbët e Kosovës, në veçanti përfaqësuesit e tyre politikë, refuzonin të integroheshin brenda institucioneve të reja të Kosovë, të cilat i vendosi OKB-ja.

Mungesa e një qëndrimi të harmonizuar të fuqive të mëdha ndaj statusit të Kosovës *i hapi klasës politike të Serbisë hapësirë* për manipulime të reja, të frymëzuara sa nga nevojat e politikës së brendshme aq edhe të asaj të jashtme, me çështjen e Kosovës, e ngarkuar me një trashëgimi të rëndë të konflikteve.

Statusi i padefinuar i Kosovës ka ndikuar njëherazi në përkeqësimin e problemeve sociale e politike të saj. Bashkësia ndërkombëtare dhe organizmat e OKB-së, si dhe të BE-së kanë bërë përpjekje të konsiderueshme për rindërtimin e vendit të rrënuar nga lufta

---

<sup>18</sup> Në artikullin “Remarques sur le statut du Kosovo”, i botuar në librin tonë *Effacer l'autre. Identité culturelles et identités politiques dans les Balkans. (Të hiqet tjetri. Identitetet kulturore dhe identitetet politike në Ballkan*, L'Harmattan, Paris, 2005, f. 233-246)

e viteve 1989-1999, e njëherësh edhe nga pasojat shkatërrimtare të terrorizimit të Kosovës nga Millosheviqi gjatë një decenie. Megjithatë, pikërisht mungesa e një statusi shtetëror të Kosovës e pengoi që të ketë qasje te fondet që i japin instancat ndërkombëtare (Banka Botërore dhe Fondi monetar ndërkombëtar) për ta zbutur së paku shkallën e lartë të papunësisë, asokohe më e larta në Evropë me 60%.

Statusi i padefinuar i Kosovës ka penguar po kështu angazhimin e investitorëve të jashtëm, aq më tepër se procesi i privatizimit të ish-ndërmarrjeve “shoqërore” (rreth 600 ndërmarrje) ishte bllokuar. Njeri nga paradokset e situatës ekonomike të Kosovës, në veçanti në fushën energjetike, shfaqej me faktin se ajo jetonte që nga viti 1999, me ndërprerje të përditshme të rrymës elektrike, përdërisa në vitet 1970-1980 Kosova eksportonte më shumë se gjysmën e prodhimit të energjisë elektrike.

Një paradoks tjetër që manifestohej për shkak të mungesës së statusit të Kosovës, ka të bëjë me një *izolim* relativ të kësaj, në rrafshin politik e kulturor. Para vitit 1999, përfaqësuesit politikë të Kosovës priteshin nga kancelaritë e fuqive të mëdha si dhe nga instanca të ndryshme ndërkombëtare. Po kështu, në fushën e arsimit dhe të kulturës, Kosova pësonte rrjedhjat e mungesës së qasjes në instanca ndërkombëtare. Kësisoj, Kosova ishte i vetmi vend në Evropë i cili nuk bënte pjesë në procesin e kartës së Bolonjës, ndonëse kishte bërë përpjekje për reformimin e arsimit të lartë, e në anën tjetër prania e saj në këtë proces do të kishte qenë shumë e dobishme për rimëkëmbjen e arsimit të lartë. Studentët kosovarë, në ato rrethana, nuk mund të përfitonin nga programe të shumta evropiane të arsimit dhe kërkimit shkencor.

Sakaq, Kosova u gjend brenda një rrethi vicioz: gjatë gjashtë viteve 1999-2006, zyrtarët e lartë të bashkësisë ndërkombëtare kanë definuar standarde mjaft të larta, politike, ekonomike e juridike, si kushte të domosdoshme për hapjen e negociatave lidhur me statusin e Kosovës, pa ofruar qasje te mjetet për realizimin e këtyre standardeve. Situata u përkeqësua njëherësh nga të metat e shumta të institucioneve të reja kosovare, në veçanti të korrupsionit dhe papërgjegjësisë së drejtueseve të tyre.

Kriza sociale dhe politike çoi te shpërthimi i dhunës, me 17 dhe 18 mars 2004. Kjo dhunë mori edhe një tipar etnik: frustrimet, pakënaqësitë, mungesa e perspektivës së masave të të rinjve u keqpërdorë nga ekstremistët që e drejtuan atë kah serbët e Kosovës. Qindra shtëpi e disa dhjetëra kisha ortodokse u dogjën brenda dy ditëve.

Kjo dhunë etnike nxori në shesh sa të metat e shoqërisë politike e civile kosovare aq edhe ato të organizmave ndërkombëtare.

### *Pavarësia e kushtëzuar*

Fatkeqësisht, thujse pikërisht këto ngjarje lëkundën nga dremitja bashkësinë ndërkombëtare që të marr vendimin për hapjen e negociatave mbi statusin. Në fillim të vitit 2005, përfaqësuesit e BE-së dhe SHBA-ve e hapën procesin e negociatave midis përfaqësueseve politik të Kosovës dhe atyre të Serbisë. Ata përkufizuan pozicionin e tyre preliminar me përjashtimin e tri opsioneve: nuk ka kthim te situata para vitit 1999, nuk ka ndarje të Kosovës dhe nuk ka bashkim të Kosovës me ndonjërin nga shtetet e rajonit. Ky qëndrim kishte meritën e një sqarimi elementar i cili mënjanoi së paku disa pasiguri.

Pikërisht me 2005, dy organizmat prestigjioze që u shquan me analiza pertinente mbi Ballkanin dhe Kosovën, Grupi ndërkombëtar i krizave dhe Komisioni ndërkombëtar për Ballkanin (Goldstone), zhvilluan në raportin e tyre vjetor një argumentim që mbështet opsionin e *pavarësisë së kushtëzuar*, përmes një procesi gradual.

Komisioni ndërkombëtar thekson në raportet e veta përçarjen midis realitetit në teren (prania e KFORIT dhe UNMIK-ut, zgjedhja e një Parlamenti, presidenti e kryeministri) dhe *fiksionit juridik*, se Kosova sipas 1244 vazhdon të jetë pjesë e Jugosllavisë, tanimë e shpërbërë. Njëherësh autorët e këtyre raporteve mëtojnë t'i shtyjnë protagonistët që punojnë rreth Kosovës të reflektojnë për pasojat e opsioneve që përmendeshin si zgjidhje e mundshme e statusit të Kosovës: vazhdimi deri në pakufi i protektoratit ndërkombëtar, ndarja e Kosovës, apo mbetja e Kosovës brenda një federate jugosllave të modifikuar. Opsioni i ndarjes shikohej i rrezikshëm, për pasojat që mund t'i shkaktoj brenda strukturave të brishta që u sajuan me marrëveshjen e Daytonit për Bosnjën. Për këtë arsye, Komisioni i R. Goldstone-it do të propozojë një opsion të ndërmjetëm, atë të *pavarësisë së kushtëzuar*, si periudhë kalimtare.

Këta autorë, bëjnë pastaj analizën e objektivit të dytë të proklamuar të protektoratit ndërkombëtar, vendosjen e institucioneve të reja dhe procesin e tranzicionit kah demokracia. Këto institucione, kjo administratë dhe shërbimet publike shikoheshin si mungesë e qeverisjes ndërkombëtare. Këtu ceket kundërthënia midis nevojës për vendosjen e një shteti juridik, që do t'i siguronte të drejtat e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pavarësisht nga përkatësia e tyre, etnike a fetare, dhe evitimi i debatit për statusin final të Kosovës. Një aspekt paradoksal i kësaj

situatë, që u binte në sy këtyre ekspertëve, ishte se Parlamenti i Kosovës dhe qeveria, të formuar nga “suaza kushtetuese” e z. Hans Hakkerup, me 2001, flisnin për çështje të sigurisë, të cilat teorikisht duhej t’i takonin KFOR-it dhe administratës ndërkombëtare, por ata nuk mund të debatonin për çështjet (ekonomike, sociale) që ndikojnë në përvetësimin e përvojave demokratike. Këtij aspekti paradoksal i shtohet rreziku për konfliktin midis dy legjitimiteteve, të atij të bashkësisë ndërkombëtare dhe atij që ka të bëjë me instancat e reja të formuara nga zgjedhjet. Këtë qëndrim të bashkësisë ndërkombëtare, këta ekspertë e cilësojnë si mosbesim ndaj debatit demokratik, pasigurive të tij, lidhur me qëllimësinë e procesit.

Në këtë raport citohet po kështu një anketë sociologjike krahasimtare e cila flet për një kundërshti midis prioriteteve të elitave për çështjen nacionale dhe ato të popullsisë rreth çështjeve socio-ekonomike (papunësia, varfëria, korrupsioni).

Një kërkesë karakteristike e këtyre autorëve ka të bëjë me kërkesën që të hiqet tabuja për statusin final të Kosovës, i cili duhet të bëhet objektiv, si pikë orientim për koordinimin e veprimeve sa të instancave ndërkombëtare aq edhe atyre vendore. Ata e shihnin të udhës, njëherësh, t’ua përkujtojnë elitave të Kosovës se pavarësia e Kosovës s’ka të bëjë me sovranitetin e shekullit të XIX, por me atë të ndarë të shekullit XXI, (p.sh. bashkë me BE-në) aq më tepër pse pikërisht angazhimi ndërkombëtar kundrejt një shteti (i Millosheviqit) e ngatërronte sovranitetin me të drejtën për pandëshkueshmëri edhe për krimet mbi popullsi civile, e në veçanti ndaj atyre që kanë përkatësi tjetër. Këta autorë sugjerojnë në njëërën anë që të ushtrohet e të përvetësohet një sovranitet i kushtëzuar me heqje dorë nga dhuna dhe respektimi i pakicave e njëherësh që dalja graduale nga protektorati të përcillet me një proces të integritimit evropian.

Pozicioni nga i cili artikulohej, në disa qarqe politike evropiane, kontestimi apo problematizimi i opsionit të Pavarësisë së Kosovës, ndonjëherë buronte nga një frikë se ky opsion mund të shpie te *fragmentimi* i Ballkanit, në kohën kur BE-ja zgjerohej me një proces *integruës* të vendeve të reja anëtare. Ky pozicion mund të dukej legjitim sikur të liheshin anash disa fakte të mëdha politike të decenieve të fundit. Së këndejmi në reagimet tona theksojmë se njeri nga faktet e rëndësishme kishte të bëjë me shpërbërjen, gati në të njëjtën periudhë kohore, të tri federatave komuniste (BRSS, Çekoslovakisë dhe Jugosllavisë). Kjo shthurje u shkaktua edhe nga shterja e mundësive të

tyre strukturore, midis tyre në veçanti e ideologjisë së këtyre shteteve federale, e cila mbante *kohezionin* e tyre.

Megjithatë, ky fakt nuk e pengoi fare integrimin brenda BE-së të shteteve që dolën nga shpërbërja e këtyre strukturave federale (Letonia, Estonia, Sllovakia, Çekia, Sllovenia). Së këndejmi, përpjekjet për të mbrojtur opsionet që sajohen me zor, duke synuar të rikonstruktojnë mbetjet e strukturave federale, që kishin vdekur faktikisht, siç ishte rasti i propozimit të BE-së për ruajtjen e Unionit midis Serbisë dhe Malit të Zi, dështuan plotësisht. Mu për këtë, propozimi që Kosova të bëhet anëtare e tretë e këtij Unioni, ishte i paqëlluar dhe i dështuar.

Në kontekst të debateve dhe zhvillimit të argumenteve për opsionet e ndryshme të statusit të Kosovës, midis viteve 2005-2008, përsëritej shpesh *formula e kompromisit* nga përfaqësuesit sa të BE-së aq edhe atyre të SHBA-ve. Kjo formulë, që premtonte një qasje të drejtë midis palëve në konflikt, Kosovës dhe Serbisë, nuk ishte fort e qartë. Në fakt, kjo formulë përmbante në vete gracka që mund të shpinin te zgjedhje të dështuara, të cilat në vend se ta zbërthenin nyjën e Kosovës, kyçe për paqen në Ballkan, vetëm sa do ta ndërlikonin atë edhe më shumë<sup>19</sup>.

Njëra nga grackat qëndronte në afirmimin e *opsionit të ndarjes* së Kosovës, njeri version i të cilit implikonte bashkëngjijtjen e veriut të Kosovës me Serbinë. Ky opsion pëlqej nga një pjesë e qarqeve politike e diplomatike të Evropës kontinentale, si zgjidhje “e drejtë”, zgjidhje “pa fitues e të mundur”. Mirëpo, këtë opsion e zhvillonin dhe mbështetnin, gjatë viteve ‘80 e ‘90 në Serbi, në veçanti elitat politike dhe ato intelektuale rreth Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë, e cila u shqua me *Memorandumin* si projekt për një Serbi në të cilën do të bashkoheshin të gjithë serbët e ish-Jugosllavisë, në dëm të kufijve të njësive të saj federale, ashtu siç ishin definuar në Kushtetutën e fundit të Jugosllavisë (e vitit 1974). Sakaq, opsioni i ndarjes së Kosovës do ishte në kundërshtim me kriteret që Komisioni i Badenterit i zbatoi me rastin e njohjeve ndërkombëtare të shteteve që dolën nga shpërbërja e Jugosllavisë<sup>20</sup>.

<sup>19</sup> Ibidem, f. 242. Në parathënien tonë për librin *The case for Kosova. Passage to Independence* (grup autorësh), Anthem Press, London-New York, 2005, kemi shtruar disa argumente në favor të pavarësisë.

<sup>20</sup> Artikulli i ynë me titull “Ndarja etnike nuk është zgjidhje për Ballkanin”, botuar në të përditshmen franceze *Le Monde*, me 30 maj 2006. Këto teza i kemi kritikuar edhe në tekste të tjera që janë botuar në Francë, veç tjerash në artikullin “Kosova, otage du régime serbe” (Kosova, peng i regjimit serb), në veprën e përbashkët me autorë të tjerë *Kosova, un drame annoncée*.

Disa qarqe proserbe propozonin, në mesin e viteve 2000, “një zgjidhje të vetme” për ta zgjidhur “jostabilitetin e dukshëm” në Bosnjë dhe në Kosovë: ndarjen. Le të cekim se këtë qasje e zhvilluan, gjatë viteve, disa qarqe politike të BE-së, klasa politike e Serbisë dhe disa ekspertë për Ballkanin. Ndërkaq, udhëheqësit e BE-së si dhe ata atë SHBA-ve e kishin kundërshtuar shpesh ndarjen si të Bosnje dhe Hercegovinës po ashtu edhe atë të Kosovës.

Argumenti kryesor i atyre që mbështetin këto ndarje rezymohet me përqindjen e rëndësishme të popullatës serbe në Republikën serbe të Bosnjës dhe në tri komunat e veriut të Mitrovicës, si dhe në vështirësitë e bashkëjetesës ndëretnike. Mirëpo ky opsion, i cili paraqitej si “pragmatik dhe realist”, në fakt abstragonte, së pari, nga tiparet e shquara të shpërbërjes së federatës jugosllave në vitet 1991-1995. Kjo shpërbërje, në të vërtetë, u bë jo aq sipas linjave thjesht etnike por më shumë me ato që përcaktonin kufijtë e njësisve të federatës jugosllave (republikat dhe krahinat) në gjirin e të cilave ka përzierje etnike. Kësisoj, me gjithë luftërat e përgjakshme, shtetet e reja që dolën nga ish-Jugosllavia (Sllovenia, Kroacia, Bosnje dhe Hercegovina dhe Maqedonia) u pranuan nga bashkësia ndërkombëtare sipas kufijve që i kishin më parë, si njësi të federatës, në saje të Kushtetutës së vendit.

Kriteri i përmendur nga ata që mbështesin ndarjen e Bosnjës dhe të Kosovës, fatmirësisht nuk u pranua më parë nga bashkësia ndërkombëtare, fjala vjen, për Kroacinë ose për Maqedoninë. Në Kroaci, edhe pas luftës, vazhdon të jetojë një pakicë serbe e konsiderueshme (në Sllavoninë perëndimore dhe në Krajlinë), ndonëse bashkëjetesa nuk është pa probleme. Në Maqedoni gati një e treta e popullsisë së saj përbëhet nga shqiptarët, e cila jeton kryesisht në pjesën perëndimore të vendit, e cila kufizohet me Shqipërinë dhe Kosovën. Përballë konflikteve politike dhe të armatosura midis shqiptarëve me maqedonasve, që arritën kulmin me 2001, BE-ja dhe SHBA-t ditën të gjejnë një zgjidhje me Marrëveshjen e Ohrit, të cilat ofronin rruajtjen e integritetit të shtetit të Maqedonisë dhe një integrim më të mirë të shqiptarëve në institucionet publike.

Shtetet e reja që dolën nga ish-Jugosllavia, sikurse edhe ato që dolën nga dy federata të tjera komuniste (BRSS dhe Çekoslovakia), bazoheshin mbi një kombinim të kriterit etnik (shumica e popullsisë) dhe atij historiko-politik. Këto shtete të reja, kishin edhe më herët një identitet politik, gjatë disa dekadave, e cila u bënë të mundur edhe sot një qëndrueshmëri.

Opsionet e ndarjes së Bosnjës dhe të Kosovës, si zgjidhje politike ndaj problemeve të mbetura nga shthurja e ish-Jugosllavisë, me radikalizimin e kriterit etnik, mund të *shumëfishonin* fragmentimet dhe tensionet ndëretnike. Propozimi për bashkimin e Republikës serbe të Bosnjës me Serbinë do të kishte si pasojë të mundshme ndarjen e entitetit boshnjak nga ai kroat i Bosnjës, gjë që do të shpinte te zhdukja e thjesht e Bosnje dhe Hercegovinës. Pa harruar faktin se Republika serbe e Bosnjës u themelua mbi krimet masive të popullsisë civile nga regjimi i Millosheviqit dhe kolonelëve të tij, Radovan Karaxhiq dhe Ratko Mladiq. Ky entitet u pranua me Marrëveshjen e Dejtonit (1995), si kompromis i cili synonte ta ruajë ekzistimin e Bosnjës. Përndryshe, kualifikimi “artificial” i përgjigjet më shumë këtij entiteti se sa Bosnje dhe Hercegovinës ose të Kosovës, e cila kishte një qeveri, një parlament dhe një territor, si dhe një legjitimitet politik dhe një legalitet juridik e kushtetues, të garantuara me Kushtetutën e fundit të Jugosllavisë së dytë (1945-1991).

Ky opsion i ndarjes, me veçoritë që i përkasin, do t’i anulonte të gjitha përpjekjet e bëra, sa nga shumica e popullsisë së Bosnjës aq edhe të bashkësisë ndërkombëtare që të bëjë një shtet të qëndrueshëm, do të ndikonte në komplikimin e mëtejshëm të një situatë e cila edhe ashtu nuk është e thjesht. Në mënyrë të ngjashme, ndarja e Kosovës, për disa si “zgjidhje e vetme”, do të shkaktonte një varg të shpërbërjeve të reja dhe tensioneve, mbi linjat ekskluzivisht etnike, në vend se të sjellin stabilitet. Ata që propozojnë këtë opsion harrojnë se shumica e serbëve që jetojnë në Kosovë jetojnë në pjesën qendrore dhe perëndimore të Kosovës. Ata po kështu nuk e marrin parasysh faktin se Kosova, me territor prej 10.800km<sup>2</sup>, për 2 milion banorë, është njeri nga territoret me dendësinë më të madhe të popullsisë në Evropë (200 banorë për 1 km katror), dendësi kjo dy herë më e madhe se ajo e Serbisë (me 95 banorë në 1km<sup>2</sup>).

Përveç kësaj, sikur kriteri thjesht etnik të zbatohet, pa konsiderata të tjera, rryma të ndryshme politike nga jugu i Serbisë, i banuar me një pakicë shqiptare të konsiderueshme (në veçanti ajo në Luginën e Preshevës) do të mund të riaktivizonin kërkesën e tyre për t’iu bashkuar Kosovës. E njëjta kërkesë kësaj do të mund të ringjallej në Maqedoni sikur të bëhej ndarja e Kosovës. E në këtë rast, vështirë se do të mund të mbahej Maqedonia, ekzistenca e së cilës konsiderohet si njeri nga çelësit e rëndësishëm të stabilitetit të Ballkanit. Në mënyrë të ngjashme, afirmimi i të njëjtit kriter do të mund të shpinte te shpërbërja e republikës së Malit të Zi, e banuar edhe me një pakicë boshnjake-myslimane (10% e popullsisë), e cila jeton në zonat kufitare me Bosnjën, dhe me afro 7% të shqiptarëve.

Thënë shkurt, këto propozime për ndarje do të mund t'i jepnin fund një stabiliteti relativ, i realizuar gjatë viteve 2000 dhe do ta bënte të pamundur perspektivën e integritit të Ballkanit Perëndimor në BE.

### *Kosova si anëtare e tretë e Unionit Serbi-Mal i Zi?*

Klasa politike e Serbisë, si dhe disa qarqe politike në BE, që e mbështetnin këtë opion, ofronin si zgjidhje edhe një opion “më shumë se autonomi, më pak se pavarësi”. Ky propozim, i cili dukej realist për një pjese të opinionit në disa vende perëndimore (Francë, Itali, Spanjë etj.), në fakt ishte nën nivelin e statusit të njësisë federale në Kushtetutën e vitit 74. Disa zëdhënës të këtij opsioni, linin të kuptohet se me negociata ky opion mund të transformohej në një opion “më të lartë”, sipas së cilës Kosova do të mund të bëhej anëtarja e tretë, “e barabartë”, e Unionit Serbi-Mal i Zi.

Kundrejt këtij propozimi zhvillonim një argumentim i cili nxirrej nga realiteti historiko-politik i ish-Jugosllavisë. Personalitetet politike dhe ekspertët gjeopolitik perëndimor, që mbështetnin këtë opion, sikur harronin se Kosova kishte qenë njësi federale e Jugosllavisë, me status i cili i siguronte praninë në instancat më të larta të vendit. E megjithatë, ndonëse federata jugosllave kishte 8 njësi federale, Serbia arriti t'i shpërfillë mekanizmat e federatës dhe Kushtetutën në fuqi, duke e *suprimuar statusin e Kosovës me një dekret antikushtetues* dhe me përdorimin e dhunës ushtarako-policore<sup>21</sup>.

Propozimet që udhëhiqeshin me *kriterin e kompromisit*, duke e përjashtuar opsionin e pavarësisë, i bënë lëshime ambicieve të Serbisë për të mbajtur leva të fuqishme që do ta pengonin funksionimin normal të shtetit të ri. Qarqet politike serbe e proserbe kishin parasysh modelin e Bosnje-Hercegovinës që doli nga Marrëveshjet e Dejtonit, model ky funksionimi i të cilit varej nga vullneti i “Republika srpska”, përkatësisht i Beogradit, i cili drejtonte me sukses veprimet e kësaj. Meqë asnjë veprim i rëndësishëm shtetëror nuk mund të merrej pa konsensusin e tri njësisve konstitutive, Beogradi kishte në dorë levën me të cilën kurdo që kishte nevojë bllokonte të gjitha iniciativat e propozimet politike të cilat nuk i konvenonin.

Sipas njërit nga argumentet që duhej të legjitimonte opsionin e ndarjes së Kosovës, brenda shtetit të pavarur të Kosovës pakica serbe nuk do të kishte siguri dhe nuk do të mund t'i realizonte të drejtat e veta. Një analizë elementare e historisë politike e ish-Jugosllavisë dhe e relacioneve të Kosovës me Serbinë do të mund të vente në pah

<sup>21</sup> M. Kullashi, *Effacer l'autre*, f. 240.

paqëndrueshmërinë e këtij argumenti. Pakica serbe, si edhe pjesëtarët e minoriteteve të tjera, kanë qenë të integruara mirë brenda institucioneve të Kosovës. Ishte politika ekspansioniste e Serbisë, jo vetëm kundrejt Kosovës, por edhe kundrejt Kroacisë dhe Bosnje Hercegovinës, ajo që futi përçarje dhe nxiti konflikte të rënda. Në këto tri vende, Serbia, me mekanizma të ngjashme, gjatë viteve 80 e 90 *instrumentalizo*i pakicat serbe, në nxitjen e urrejtjes etnike e fetare. Agresionet ushtarake kundër këtyre vendeve Serbia i justifikoi me nevojën “për t’i shpëtuar nga rreziqet që u kanosen” nga kroatët, myslimanët dhe shqiptarët.

Disa qarqe politike në vendet perëndimore i kundërviheshin opsionit të pavarësisë së Kosovës me justifikimin se kjo zgjidhje do të shkaktonte një proces zinxhiror apo hapjen e *kutisë së Pandorës*. Kritikën e këtij pozicioni e kemi bërë duke vënë në pah se çështja e statusit të Kosovës ishte e pranishme si në fillimin e procesit të shthurjes së Jugosllavisë po ashtu edhe përfundimin e saj. Në fakt hapja e kësaj “kutie” kishte ndodhur tanimë: Sllovenia, Kroacia, Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina kishin shpallur pavarësinë e tyre, në vitet 1991-1992. (fusnotë: ndërkaq, suprimimi me dhunë i statusit të Kosovës nga ana e Serbisë u pat cilësuar nga disa ekspertë si *aneksim* i Kosovës nga Serbia si dhe si *vdekje juridike* e Jugosllavisë, e cila paralajmëroi vdekjen e sak faktike nëpërmjet agresioneve të përgjakshme që ndërmori regjimi i Millosheviqit.

Ata qarqe politike që mbështetnin kërkesat e Serbisë kundrejt Kosovës, me pohimin se pavarësia e Kosovës do të mund ta destabilizonte Ballkanin, lënë anash realitetin historik i cili vë në pah se *pikërisht dominimi i Serbisë mbi Kosovën ka qenë njeri nga burimet më të rrezikshme të jostabilitetit të Jugosllavisë dhe Ballkanit*. Pikërisht për këtë arsye, personalitete të shquara politike të Serbisë, si Cedomir Jovanovic dhe Latinka Perovic, theksonin se *Serbia qëmoti e ka humbur mandatin dhe legjitimitetin e sundimit mbi Kosovën*.

Më në fund, pas shumë konsultimeve dhe luhatjeve të fuqive të mëdha, me 17 shkurt 2008, në marrëveshje me fuqitë e mëdha, Kosova shpalli pavarësinë e saj me Deklaratën kushtetuese në Kuvend. Kështu, më në fund u tejkaluan shumë hezitime e ambiguitete në qëndrimet politike lidhur me statusin e Kosovës; njohja e pavarësisë së Kosovës, krahas theksimit të specifikave të Kosovës (*sui generis*), u bë në vijimësinë e njohjeve të njëjësive tjera të federatës jugosllave, me kriterin e Komisionit të Badinterit për mos ndryshimin e kufijve, ashtu si ishin cekur në Kushtetutën e fundit të ish-Jugosllavisë. Vendimi i GJND-së, më 2010, konfirmoi këto qëndrime, duke theksuar se Pavarësia e Kosovës nuk shkeli asnjë konventë ndërkombëtare.

Muhamedin KULLASHI

## THE EVOLUTION OF INTERNATIONAL PUBLIC OPINION ON KOSOVA'S INDEPENDENCE

### Summary

*The evolution of international public opinion on Kosova's independence can be depicted through the interplay between public opinion and political decision-making circles in certain Western European countries. These countries, along with the United States, participated in the military intervention in 1999, an operation that paved the way to raise the issue of Kosova's status.*

*The explanation of the evolution of international opinion will take into account the gradual process of the dissolution of the former Yugoslavia and the treatment of this process by both the media and official political circles and the analyses of experts and intellectuals in various Western countries.*

*Regarding the differences and changes in the perception of the status of Kosova, one should bear in mind the fact that the shades through which individuals and groups within Western societies have looked at the issue of Kosova have been fabricated with data and knowledge selected by each of them; and that their selection was affected by their psychological and cognitive affinities. The assumption that the situation in Kosova was clear and understandable, that it was easy to state the "truth" about this situation, because it was clear who the aggressor was and who the victim was, is naive and forgets the fact that in similar situation around the world, there will always be individuals and groups elaborating sophisticated arguments in favor of one or the other warring party, picking and choosing different facts from the political history of that country.*

**Key words:** *evolution of public opinion, international opinion, independence of Kosova, Dayton*



# KONSTITUCIONALIZMI KOSOVAR PAS SHPALLJES SË PAVARËSISË DHE SFIDAT E NDËRTMIT TË TIJ

**Arsim Bajrami**

## **Përmbledhje**

*Republika e Kosovës, ka filluar një realitet të ri kushtetues, që kishte rezultuar pas miratimit të deklaratës së pavarësisë në Kuvendin e Kosovës me 17 shkurt 2008. Ky realitet i ri kushtetues ishte derivat i një mbikëqyrje ndërkombëtare të Kosovës për tetë (8) vite me radhë nga misioni i veçantë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), që ishte një model krejt i veçantë i administrimit të një shteti nga ana e mekanizmave ndërkombëtar, në prizmin e praktikave krahasimore.*

*Pikërisht ky punim ka për qëllim të trajtojë disa aspekte të këtyre dimensioneve, që i japin përgjigje një pyetje themelore, dhe atë se çfarë konstitucionalizmi ka krijuar Kosova pas shpalljes së pavarësisë së saj. Natyrisht në kontekstin e konstitucionalizmit Kosovar, që është ndërtuar pothuajse dhjetë (dhjetë) vite pas shpalljes së pavarësisë, nuk mund të qëndrojmë indiferent nga zhvillimet kushtetuese dhe politike që i kanë paraprirë këtij konstitucionalizmi, këtu është fjala sidomos për ndikimin që ka pasur administrimi ndërkombëtar i Kosovës për krijimin e një niveli të konstitucionalizmit që ka Kosova sot.*

*Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të kushtetutës së Kosovës në vitin 2008, Kosova ka bërë hapin e parë drejt krijimit të një rendi kushtetues dhe konstitucionalizmi të saj. Funksionimi, zhvillimi dhe sfidat e konstitucionalizmit Kosovar pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të kushtetutës, është varur nga shumë faktor në shoqërinë Kosovare, sidomos faktorët politik. Andaj një dimension tjetër i rëndësishëm i punimit është edhe funksionimi, përparësitë por edhe sfidat që ka pasur zhvillimi i konstitucionalizmit Kosovar, në periudhën pas shpalljes së pavarësisë.*

*Siç dihet nga teoria kushtetuese, konstitucionalizmi nuk është një proces i thjeshtë që varet vetëm nga të pasurit një kushtetutë, por më tepër varet nga zbatimi, interpretimi dhe sidomos raporti i kushtetutës me politikën.*

*Ky punim do të trajtohet në tri pjesë kryesore. Pjesa e parë ka të bëjë me atë se si ka ndikuar mbikëqyrja ndërkombëtare dhe administrimi ndërkombëtar i Kosovës, në nivelin e konstitucionalizmit Kosovar. Pjesa e dytë e punimit do të trajtojë rrisitë, përparësitë dhe vlerat e konstitucionalizmit*

*Kosovar, kurse pjesa e fundit e punimit do t'i kushtohet sfidave të konstitucionalizmit në Kosovë, sidomos raportit me politikën.*

*Punimi po ashtu do të trajtojë me theks të veçantë, dy dimensione kryesore, në kuadër të përparësive të konstitucionalizmit Kosovar, e para rolin që ka luajtur Gjykata Kushtetuese në zhvillimin e konstitucionalizmit në Kosovës si dhe sfidat që ka hasur kushtetuta e Kosovës në zbatimin e saj, sfida këto që janë shfaqur kryesisht nga partitë politike.*

*Megjithatë pas këtyre viteve në të cilat do të kufizohet trajtimi i punimit, Kosova ka arritur që të krijojë disa shtylla të forta të konstitucionalizmit si dhe një identitet të qëndrueshëm kushtetues, i cili është duke e marrë vazhdimisht formën e tij.*

***Fjalët çelës:*** *Konstitucionalizëm, Kushtetutë, rend kushtetues Kosovar, identitet kushtetues, gjykatë kushtetuese, sfida të konstitucionalizmit.*

## *1. Hyrje*

Tema e këtij punimi ka të bëjë me konstitucionalizmin në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë, si dhe atë se sa ka arritur Kosova të ndërtojë një konstitucionalizëm të qëndrueshëm, dhjetë vjet pas krijimit të shtetit. Në këtë kontekst do të përmenden disa elemente që e karakterizojnë këtë tematikë. Para së gjithash, në këtë aspekt, duhet të kuptojmë dallimin në mes të kushtetutës dhe konstitucionalizmit, dallim ky që është i dukshëm.

Për sa i përket kuptimit të kushtetutës, duhet të theksohet që kuptimi i saj duhet të dallohet me termin Konstitucionalizëm. Përderisa kushtetuta është një akt, konstitucionalizmi është një doktrinë edhe ka një kuptim më të gjerë sesa kushtetuta. Pra konstitucionalizmi është doktrina e cila ka të bëjë me veprimet, si dhe parimet legjitime të qeverisë dhe qeverisjes të cilat janë të mishëruara në kushtetutën si aktin më të lartë. Doktrina e konstitucionalizmit nënkupton realizimin e çështjeve si në vijim: ushtrimin e pushtetit brenda kufijve kushtetues dhe ligjor bazuar në kompetencat e institucioneve kushtetuese; respektimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve dhe realizimin e të drejtave të tyre; ndarja dhe kontrolli i pushteteve me qëllim të shmangies së abuzimit të pushteteve; përgjegjësinë politike të qeverisjes përpara elektoratit etj<sup>1</sup>. Pra, konstitucionalizëm ka në një vend ku respektohet dhe zbatohet kushtetuta, si dhe parimet kushtetuese të mishëruara në kushtetutë<sup>2</sup>. Ky punim pikërisht do të bazohet në dy çështje

---

<sup>1</sup> Barnett H., “*Constitutional and Administrative Law*”, fourth edition, Cavendish Publishing Limited, 2002, fq .5-6.

<sup>2</sup> Sri. C.M. James, Dr. G. Sadanandan (Co-ordinator), “*WORLD CONSTITUTION : COMPARATIVE ANALYSIS*”, UNIVERSITY OF CALICUT, 2013, fq.12.

kryesore. E para në atë se si ka ardhur deri te hartimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që del se është qartazi derivat i negociatave politike, dhe e dyta, sfidat që i janë bërë kushtetutës së Republikës së Kosovës në vazhdimësi, që nga hyrja në fuqi e saj, në vitin 2008. Këto dy çështje bosht, do të nxjerrin në pah karakteristikat dhe sfidat e ndërtimit të konstitucionalizmit në Kosovë, pas shpalljes së pavarësisë.

## *2. Konteksti politik i bërjes së kushtetutës së Republikës së Kosovës 2008, dhe ndikimi në zhvillimin e konstitucionalizmit kosovar*

Procesi i kushtetutëbërjes si një procesi historik është shumë i rëndësishëm për një vend, ky proces, sa është i kombinuar me elemente juridike, aq është i veshur edhe me elemente politike. Së këndejmi është shumë i rëndësishëm edhe momenti politik i kushtetutëbërjes<sup>3</sup>.

Zakonisht kushtetua bëhet për krijimin e shtetit, për të plotësuar vakumin pas kalimit në një sistem tjetër të qeverisjes, për të bërë reforma në shoqëri, për të zgjedhur konfliktet në shoqëri etj<sup>4</sup>. Natyrisht bazuar në këto arsye të bërjes së kushtetutës përbëjnë edhe idenë e kushtetutëbërjes. Kosova pas zgjedhjes së statusit të saj politik, ka bërë edhe kushtetutën, natyrisht për të futur nën “ombrellën”, juridike zgjedhjet e reja politike që rrodhën nga deklarata e Pavarësisë 2008 dhe proceset e tjera që i paraprinë asaj. Në këtë kontekst është e arsyeshme që gjithnjë bërjes së një kushtetute i paraprinë momenti përkatës politik, p.sh. Nëse bashkohen ose ndahen dy vende të caktuara, atëherë domosdoshmërisht gjendja e krijuar politike, duhet të futet në kuadër të një kornize juridike, e kjo bëhet zakonisht me anë ta kushtetutës ose, krijimi i një shteti të ri, i cili paraprihet nga një deklaram i shtetit qoftë me referendum ose me anë të një deklarate, gjithnjë krijon situatë të caktuar politike e cila shtron nevojën e krijimit të kornizës juridike, konkretisht kushtetutës përkatëse. Në këtë kontekst, mund të marrim shembullin e Austro-Hungarisë, pas ndarjes të së cilëve janë krijuar dy shtete të reja, krijimi i këtyre dy shteteve ka shtruar nevojën që të bëhen dy kushtetuta, njëra për Austrinë e tjetra për Hungarinë, së këndejmi ndarja e këtyre dy vendeve është momenti politik kurse bërja e kushtetutave momenti politik.

Siç mund të shihet, nuk ka dilemë që momenti politik i paraprinë momentit juridik, të shkruarit të kushtetutës, por në këtë rast dilema është, se sa një kushtetutë bëhet pjesë e kompromiseve politike dhe

<sup>3</sup> Bajrami A., “Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës”, Prishtinë 2011, fq. 454.

<sup>4</sup> Bajrami A., “Draftimi i Kushtetutës”, Prishtinë 2007, fq. 25.

çfarë ndikimi kanë këto kompromise karshi rrethanave shoqërore dhe funksionalitetit të vet kushtetutës.

Krijimi i shtetit të Kosovës së bashku me kushtetutën që konsiderohet themeluese e shtetit, natyrisht ka një histori paraprake. Rruga e krijimit të shtetit, që u kurorëzua me miratimin e kushtetutës, në vitin 2008, fillon që nga viti 1999, konkretisht që nga miratimi i Rezolutës 1244. Fillimisht për të kaluar fazën tranzicionale, u miratua një Kornizë Kushtetuese, e cila ndihmoi në konsolidimin e institucioneve për të qeverisur vendin. Pas kësaj zhvillimet politike të mëtutjeshme, të cilët hapen rrugën për zgjedhjen e statusit final të Kosovës, u kurorëzuan me krijimin e grupit të unitetit<sup>5</sup>, i cili u proklamua në Raportin e Kai Eides. Ky ishte përcaktues në Bisedimet e Vjenës, ku edhe nisi ideja për bërjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, këtë të vitit 2008.

Shtrohet çështja, cili është momenti, ku realisht Kushtetuta e Republikës së Kosovës, fillon të bëhet pjesë e bisedimeve dhe kompromiseve politike. Janë pikërisht bisedimet e Vjenës, në të cilat u vendos arkitektura e shtetit të Kosovës, të njëjtat vendosën edhe arkitekturën e vetë kushtetutës, e cila themeloi shtetin e Kosovës. Në kuadër të këtyre bisedimeve u krijua edhe një grup i ekspertëve kushtetues, i cili kishte për qëllim unifikimin e standardëve përmes të cilëve do të shkruhej kushtetuta e ardhme.

Fakti që ka ekzistuar një grup i tillë i ekspertëve, tregon se së bashku me çështjet që janë biseduar në Vjenë, përfshirë decentralizimin, Trashëgiminë kulturore, të drejtat e Pakicave, është përcaktuar edhe rruga ose më mirë të themi janë vendosur kornizat se si do të duket Kushtetuta e Kosovës, kjo më së miri u vërejt edhe nga ajo që rezultoi nga bisedimet e Vjenës, konkretisht nga ajo që na solli Pakoja e Ahtisarit, sidomos në aspektin e kushtetutëbërjes.

### *3. Ndikimi i drejtpërdrejtë i bisedimeve të Vjenës në kushtetutën e republikës së Kosovës 2008 dhe në përmbajtjen e saj*

Vazhdimësia e ngjarjeve politike, në kuptimin e shtetkrijimit, rezultoi me hartimin e një dokumenti i cili vendosi bazat e shtetësisë së Kosovës, është fjala për Pakon e Ahtisarit, siç u quajt në zhargonin popullor. Në fakt ajo që u bisedua në bisedime për zgjedhjen e statusit final të Kosovës, u përmbledh e tëra në këtë dokument. Ajo që na

<sup>5</sup> Raporti i Kai Eides, “*Shqyrtim Gjithëpërfshirës i Gjendjes në Kosovës*”, Prishtinë 2005, në fund të raportit paralajmërohet krijimi i këtij grupi.

intereson në këtë rast është fakti që pjesë e këtij dokumenti është edhe Kushtetuta dhe procesi i kushtetutëbërjes në përgjithësi.

Kësisoj marrë parasysh faktin që Pakoja e Ahtisarit është produkt konkret i bisedimeve të Vjenës dhe në anën tjetër, Kushtetuta është pjesë e Pakos së Ahtisarit, i bie që kushtetuta si akt, përfshirë modalitetet e saj, është pjesë e bisedimeve politike të Vjenës, në këtë mënyrë, kushtetuta me ose pa dashje është bërë pjesë e bisedimeve politike, të cilat kanë determinuar bërjen e saj.

Vetëm të analizojnë aneksin e parë të Pakos së Ahtisarit, në të cilin flitet për Dispozitat Kushtetuese, por para kësaj është e udhës të përmendet fakti që Pakoja e Ahtisarit, ka përcaktuar edhe procesin paraprak, konkretisht procesin e kushtetutëbërjes. Në nenin 10 të dispozitave të përgjithshme në Pakon e Ahtisarit komisionin kushtetues, i cili do të krijohet për të shkruar kushtetutën me të cilin Kosova do të krijonte shtetin! Njëra prej fazave të procesit të bërjes së kushtetutës është krijimi i të ashtuquajturave “komisione apo trupa” të veçantë, për shkrimin e kushtetutës, roli i të cilëve është draftimi (shkrimi) i kushtetutës. Pakoja e Ahtisarit, e dalë nga bisedimet politike, ka ndërhyrë përveç në Kushtetutë edhe në momentin kryesor të kushtetutëbërjes, krijimin e komisionit përkatës kushtetues. “Komisioni Kushtetues do të përbehet nga 21 anëtarë, të cilët duhet të kenë kualifikimet relevante për arritjen e këtij qëllimi dhe duhet të pasqyrojë përbërjen shumë etnike të Kosovës”<sup>6</sup>. Kështu thuhet ndër të tjera në dispozitën e Pakos së Ahtisarit, e cila flet për krijimin e komisionit kushtetues, si pjesë e procesit të shkrimit të një kushtetute, ku ndër tjerash përcaktohen edhe parimet e punës së tij.

Derisa në njërën anë neni 10, në dispozitat e përgjithshme, përcakton themelimin e komisionit përkatës kushtetues, aneksi i parë siç e thamë më lartë përmban parimet kryesore në kuadër të së cilave duhej të ndërtohet kushtetuta e ardhme. Madje në hyrje të këtij aneksi thuhet, “Kushtetuta e ardhme do të përfshijë por nuk do të jetë e kufizuar, në parimet dhe elementet në vijim...”, apo elementet e aneksit të parë<sup>7</sup>. Mund të vërehet, që në start instalohet varshmëria, që do të ketë kushtetuta e Republikës së Kosovës, karshi Pakos së Ahtisarit, e cila ka kufizuar në masë të madhe e vullnetin e kushtetutëvënësit, për të bërë një kushtetutë sa më funksionale, profesionale dhe të

---

<sup>6</sup> Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjedhjen e Statusit Final të Kosovës, 2007, neni 10, dispozitat e përgjithshme.

<sup>7</sup> Ibid, hyrja e Aneksit I.

përshtatshme për rrethanat. Çka në të vërtetë kufizoi aneksi i parë i Pakos së Ahtisarit?, ky aneks bëri kufizime në shtyllat kryesore të funksionimit të shtetit dhe sistemit kushtetues, mbi të cilat shtylla kryesore aludon edhe vetë vullneti i atyre që e shkruajnë kushtetutën e një vendi. Aneksi në fjalë ka përcaktuar që kushtetuta e Kosovës, duhet t'i përmbante detyrimisht këto dispozita:

1. Dispozitat që rregullojnë fomin e qeverisjes;
2. Dispozitat që përcakton që Kosova është shoqëri shumë etnikë;
3. Dispozitat që përcaktojnë karakterin jofetar të shtetit të Kosovës;
4. Dispozitat që përcaktojnë të drejtat e komuniteteve;
5. Dispozitat që rregullojnë dyshtetësinë e banorëve të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë, të cilët kanë qenë banorë të Kosovës, me 1 Janar 1998;
6. Dispozitat që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e qytetarëve dhe akceptimin e konventave ndërkombëtare, karshi mbrojtjes së këtyre të drejtave;
7. Dispozitat për mbrojtje gjyqësore të lirive dhe të drejtave të njeriut;
8. Dispozitat që kanë të bëjnë me Kuvendin e Republikës së Kosovës, sidomos përfaqësimin e pakicave në kuvend;
9. Dispozitat që kanë të bëjnë me legjislacionin me interes vital, nga neni 81 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
10. Dispozitat që kanë të bëjnë me presidentin e Republikës së Kosovës;
11. Dispozitat që kanë të bëjnë me Qeverinë e Republikës së Kosovës, përfshirë përfaqësimin e komuniteteve në të;
12. Dispozitat që kanë të bëjnë me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
13. Dispozitat që kanë të bëjnë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;
14. Dispozitat që kanë të bëjnë me qeverisjen Lokale dhe Decentralizimin;
15. Dispozitat që kanë të bëjnë me ekonominë, ndryshimet kushtetuese dhe dispozitat kalimtare<sup>8</sup>.

---

<sup>8</sup> *Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjedhjen e Statusit Final të Kosovës, 2007, Aneksi I.*

Nga kjo ekspozitë e çështjeve që përcaktohen në aneksin e parë të Pakos së Ahtisarit, mund të vërehet varshmëria e Kushtetutës me Pakon e Ahtisarit, sepse këto dispozita është dashur patjetër të bëhen pjesë e kushtetutës. Nga ky fakt rrjedh përfundimi se kushtetutëbërësit, realisht nuk kanë mundur të dalin jashtë kërkesave të këtij aneksi dhe kanë qenë të kufizuar që të veprojnë në kontekstin e zgjidhjeve të tjera adekuate kushtuese. Nuk është vetëm aneksi i parë i Pakos së Ahtisarit ai i cili ka vendosur kufizime karshi kushtetutës, por është komplet fryma e saj, me të cilën nuk duhej të ishte në kundërshtim kushtetuta e Republikës së Kosovës e vitit 2008. Fakti që nuk i është lënë në tërësi komisionit të krijuar për shkrimin e kësaj kushtetute, që të vendosë për përmbajtjen e saj, nënkupton që shumica e dispozitave kushtuese janë të kontekstit politik, sepse kanë qenë të përcaktuara më herët përmes Pakos së Ahtisarit.

Raporti i varësisë në mes të Kushtetutës që e kemi sot dhe Pakos së Ahtisarit, në kuptimin e përshtatshmërisë së njëjës me tjetrën, transmeton dhe forcon bindjen, e elementëve politike të kësaj kushtetute dhe po ashtu forcon argumentin që këto elemente politike, të dala nga bisedimet e Vjenës, kanë ndikuar direkt në procesin e kushtetutëbërjes. Për të kuptuar më mirë këtë varshmëri të marrim edhe dy shembuj praktik, kur kushtetuta ka qenë pjesë e kompromiseve politike dhe vullneti i kushtetutëvenësit ka qenë jo relevant: Rasti i kushtetutës së Bosnje dhe Hercegovinës e cila ka dalë nga marrëveshja e Dejtonit ose edhe Kushtetuta e Qipros e cila ka dalë nga Marrëveshje e Cyrihut. Natyrisht rasti i Bosnjës dhe Hercegovinës ka qenë shumë më ekstrem sesa ai i Kosovës, në kuptimin e inkorporimit të elementëve politike. Në teorinë e të Drejtës Kushtetuese, zakonisht kushtetutat që derivojnë nga një marrëveshje ose dokument i ngjashëm politik quhen kushtetuta të oktruara ose të dhuruara, duke aluduar në faktin që të njëjtat vijnë “të gatshme”, në kuadër të paketës përkatës të një marrëveshje ose edhe të ndonjë dokumenti tjetër<sup>9</sup>.

Ashtu siç kemi analizuar më lart, rrugën deri te bërja e kësaj kushtetute që e kemi edhe sot në fuqi, mund të vërehet ndikimi që kanë pasur proceset politike për zgjidhjen e statusit në bërjen e kushtetutës së vitit 2008. E gjithë kjo mund të vërtetohet vetëm duke e krahasuar trekëndëshin: Bisedime të Vjenës-Pako e Ahtisarit-Kushtetutë. Nga analiza e këtij trekëndëshi qartazi vërehet varshmëria e njërit element nga tjetri. Së këndejmi, Bisedimet e Vjenës, janë bërë për zgjedhjen e statusit final të Kosovës, këto janë paraprirë nga Raporti i Kai Eides!

---

<sup>9</sup> Saliu K., “E Drejta Kushtetuese”, Prishtinë 2004, fq. 53.

Është e sigurt se bisedimet e Vjenës kanë qenë komplet politike, sepse edhe janë thirrur për të zgjedhur një çështje politike, në këtë kontekst, pa bisedime të Vjenës nuk do të kishte një Pako të Ahtisarit, e cila vendosi bazën e shtetit të Kosovës. Në anën tjetër, Pakoja e Ahtisarit duke qenë se ka dalë nga këto bisedime, pashmangshëm përbën një dokument të pastër politik! Pikërisht nga ky dokument politik ka derivuar edhe kushtetuta e Republikës së Kosovës, apo një pjesë e madhe e saj. Vështruar këtë anë të medaljes, nuk do koment që të shihet se sa ka pasur elemente politike në Kushtetutën e vitit 2008 të Republikës së Kosovës, por edhe në tërë procesin e kushtetutëbërjes dhe nuk do koment të shihet se sa kanë ndikuar bisedimet e Vjenës në këtë proces të rëndësishëm shtetëror.

#### *4. Sfidat e konstitucionalizmit dhe të kushtetutës në Kosovë, nga një perspektivë pozitive dhe analitike*

Të flasësh për sfidat e konstitucionalizmit në përgjithësi në Republikën e Kosovës nuk është edhe aq e lehtë, duke marrë parasysh faktin që vetë nga viti 2008, duhet të kujtojmë që vetë procesi i shkrimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka qenë i shkruar në një kontekst politik të kufizimeve ndërkombëtare të cilat kanë ardhur kryesisht nga plani Ahtisari por edhe nga ndërhyrja faktike ndërkombëtare, kjo njëherësh ka qenë një indikatorë i qartë, që Kushtetuta e Republikës së të ketë edhe vështirësi të qarta mbase në zbatueshmërinë e saj dhe vënien në jetë sidomos të disa rregullave të caktuara.

Është e natyrshme që të flasësh për sfidat e kushtetutës, nuk mund të kalosh në asnjë mënyrë burimin e sfidave, që i ka pamundësuar në disa raste Kushtetutës së Kosovës të jetë madje funksionale. Shqyrtohet pyetja pra cili është ky burim i sfidës? Pikërisht mënyra se si është shkruar dhe kufizimet që kanë ndodhur, në një proces i cili ka qenë madje i kombinuar me procesin politik të statusit përfundimtar. Ky kufizim i vullnetit të kushtetutëvënësit, siç e quan edhe profesori universitar Kurtesh Saliu, paraqet një mospërputhshmëri në mes të asaj që mund të shkruhet në Kushtetutë dhe asaj që përbën realitetin faktik<sup>10</sup>.

Kur flasim për kushtet në të cilat është shkruar në fakt Kushtetuta e Republikës së Kosovës, për të kaluar më pas në sfidat praktike që ka hasur ajo, assesi nuk kemi të drejtë të lëshohemi në krahasimin e Kushtetutës aktuale, në raport me zhvillimin e konstitucionalizmit dhe rregullave kushtetuese që janë aplikuar në Kosovë në periudhën e

---

<sup>10</sup> Për më tepër Kurtesh Saliu, “E Drejta Kushtetuese”, Prishtinë 2004.

UNMIK-ut, respektivisht Kornizën Kushtetuese dhe aktet e tjera që janë zbatuar në Kosovë, para se të shkruhet kushtetuta që është tani në fuqi<sup>11</sup>. Këtë qasje e bazojmë në faktin notor, që rrethanat në të cilat janë shkruar, Kushtetuta aktuale respektivisht korniza Kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme. Ideja e trajtimit të kësaj çështje në këtë mënyrë, qëndron në faktin e dallimit të rrethanave faktike në të cilat është shkruar Kushtetuta aktuale e Kosovës dhe Korniza Kushtetuese në anën tjetër. Nuk ka asnjë dilemë që, që nuk mund të shmangësh proporcionin që ka vullneti i vërtetë i kushtetutëvënësit, më faktin e zbatimit të suksesshëm në praktikë të një akti siç është Kushtetuta. Në rastin konkret, kur po flasim për pengesat, procesin, ndikimet faktike dhe juridike në procesin e bërjes së kushtetutës së Republikës së Kosovës, nuk mund ta shmangim faktin se pikërisht të njëjtat mund të kenë ndikuar në zbatueshmërinë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës por njëherësh edhe në nevojën për ndryshimet dhe plotësimet e shpejta, me të cilat kushtetuta e Republikës së Kosovës u përballua në më pak se dy vjet të hyrjes së saj në fuqi. Së këndejmi në kuptimin e kësaj qasje, do t'i shtjellojmë edhe sfidat e konstitucionalizmit në Kosovë, respektivisht sfidat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht në këtë rrafsh janë të rëndësishme dy drejtime, pra qasjen burimore, konkretisht kontekstin politik të bërjes së kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ndikimin e saj, me theks të veçantë në ndryshimet e shpejta, si dhe sjelljen e zyrtarëve të lartë, bartësve të institucioneve karshi kushtetutës. Janë këto dy dimensionet, që mund të vënë në pah sfidat ndaj kushtetutës, në kuptimin e zbatimit në veçanti, por edhe konstitucionalizmit në Kosovë në përgjithësi.

##### *5. Sfidat e zbatimit në praktikë të kushtetutës së Republikës së Kosovës*

Në kohën kur po shkruhet ky punim, Kushtetuta e Republikës së Kosovës i ka bërë tanimë gati dhjetë vjet nga miratimi i saj dhe njëherësh nga hyrja në fuqi. Përpos dimensionit që trajtuam më lart përmes të cilit u bë përpjekje që të vërtetohet se konteksti politik ka qenë i rëndësishëm dhe njëherësh ka krijuar vështirësi në zbatimin e Kushtetutës, natyrisht ka pasur edhe aspekte të tjera, që në njëfarë forme kanë qenë të varura në kuptimin e zbatimit nga vetë institucionet e Republikës së Kosovës. Për të analizuar më mirë këtë çështje është mbase e nevojshme të lëshohemi në dispozitat konkrete kushtetuese në të cilat Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka hasur vështirësi në zbatim.

---

<sup>11</sup> Kushtetuta aktuale, 2008.

Në asnjë mënyrë nuk mund të mohohet që Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk është zbatuar që nga hyrja në fuqi në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Që nga paslufta ka pasur probleme serioze në shtrirjen e sovranitetit të Republikës së Kosovës në tërë territorin, andaj së këndejmi konsiderohet që nuk është realizuar në tërësi neni 1.1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili proklamon se “Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm”<sup>12</sup>. Kur flasim për këtë qasje përsëri nuk mund të anashkalohet konteksti i bërjes së kësaj Kushtetute për faktin që nuk janë menduar pasojat në përputhje me realitetin, prandaj ka ndodhur që të ketë dhe ka ende vështirësi në zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës në pjesën veriore të vendit. Pra, gjendja e krijuar në raport me zbatimin e nenit 1.1 varej kryesisht nga çështjet politike, siç ishte politike edhe një pjesë e kushtetutëbërjes në kuptimin e kufizimit të vullnetit të atyre që e kanë shkruar këtë Kushtetutë.

Në kontekstin e frymës së nenit 1.1 të Kushtetutës, në vitin 2012 serbët që banonin në pjesën veriore dhe strukturat e ashtuquajtura ilegale kishin tentuar që të zhvillonin një referendum në vitin 2012 të cilin referendum Kuvendi i Republikës së Kosovës, përmes një deklarate të miratuar në shkurt të vitit 2012 e kishte cilësuar si cenim të rendit kushtetues dhe njëherësh edhe në kundërshtim me Pakon e Ahtisarit<sup>13</sup>. Përpos me veprime konkrete, Kushtetuta e Republikës së Kosovës pikërisht në dimensionin e diskriminimit pozitiv sidomos nga ana e serbëve, shpesh është sfiduar edhe me deklarata të caktuara të cilat në një formë ose formën tjetër kanë nënkuptuar edhe sfidim të rendit kushtetues dhe të konstitucionalizmit në përgjithësi. Të kujtojmë vetëm deklaratat e partisë politike “Lista Srpska” e cila garoi në zgjedhjet e fundit lokale të mbajtura në Kosovë në vitin 2013 dhe e cila pas zgjedhjeve fitoi nëntë komuna. Ndërkohë, disa kryetarë të komunave që vijnë nga radhët e kësaj partie madje refuzuan që të japin betimin në përputhje me rregullat kushtetuese dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës<sup>14</sup>. Kjo me të vërtetë shihet si një sfidë serioze në raport me zbatimin e Kushtetutës në veçanti dhe rregullave të tjera në përgjithësi.

Shihet qartë se dimensionit të zbatimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i takon më shumë një realiteti faktik dhe politik të krijuar, i cili duhet t’i përshtatet kësaj Kushtetute në çfarëdo forme

---

<sup>12</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 1.1.

<sup>13</sup> Deklarata e Kuvendit të Republikës së Kosovës e miratuar në shkurt të vitit 2012 e shpall referendumin si një veprim që cenon rendin kushtetues.

<sup>14</sup> <http://www.dw.de/komunat-veriore-sfida-e-institucioneve-qendrore-te-kosoves/a-17335630>. Qasur së fundmi me 21.10.2017.

qoftë, madje edhe duke e sfiduar atë. Një dëshmi më shumë për këtë janë edhe bisedimet të cilat po zhvillohen ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Së këndejmi, ka pasur një varg çështjesh të cilat janë debatuar në kontekstin e përshtypjeve se a janë ato në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës apo jo dhe njëra ndër to ka qenë edhe krijimi i asociacionit të komunave të parapara me marrëveshjen e 19 prillit 2013 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, e ratifikuar po ashtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës<sup>15</sup>. Brenda këtij realiteti, që lidhet me komunitetin serb në Kosovë pa prekur fare në realitetin e krijuar në pjesën veriore, e cila pjesë akoma është e paintegruar plotësisht në institucionet e Republikës së Kosovës, nuk mund të anashkalohej edhe neni respektiv i Kushtetutës që ka të bëjë me simbolet e Republikës së Kosovës<sup>16</sup>. Ky nen konkret shpeshherë është sfiduar sidomos nga komunat me shumicë serbe në pjesën jugore të dala nga procesi i krijimit të komunave të reja sipas Pakos së Ahtisarit. Shpeshherë shumica nga komunat i kanë injoruar me ose pa qëllim simbolet shtetërore dhe para tyre kanë preferuar ato kombëtare. Ajo që vlen të përmendet në kuadër të këtyre situatave është indiferenca e institucioneve të Republikës së Kosovës karshi këtyre shmangieve të Kushtetutës.

Përpos shmangieve të caktuara të Kushtetutës, të cilat lidhen me realitetin politik dhe komunitetin serb në Kosovë, nuk mund të mohohet edhe fakti tjetër që Kushtetuta e Republikës së Kosovës është sfiduar edhe në forma të tjera, në kuptimin e moszbatimit apo shmangies nga dispozitat konkrete, me zbatimin e të cilave kanë qenë të lidhura drejtpërdrejt institucionet e Republikës së Kosovës.

Një rast të anashkalimit të dispozitës konkrete përpos neneve të lartpërmendura përbën edhe neni 13 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili i dedikohet kryeqytetit<sup>17</sup>. Në kuadër të këtij neni, ndër të tjera, rregullohet me ligj çështja e kryeqytetit. Gjashtë vjet e gjysmë të hyrjes në fuqi të Kushtetutës, Republika e Kosovës nuk ka një ligj për kryeqytetin.

Përpos kësaj dispozite konkrete vështirësi në zbatim ka hasur edhe kapitulli që ka të bëjë më të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre. Në përgjithësi të gjitha dispozitat kushtetuese, edhe ato që jashtë kapitullit në fjalë janë zbatuar në një mënyrë selektive në kuptimin e dhënies më shumë hapësirë për komunitetin serb dhe kjo ka

---

<sup>15</sup> Shih Marrëveshjen në fjalë, e ratifikuar më 27 qershor 2013.

<sup>16</sup> Neni 6 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 2008.

<sup>17</sup> Neni 13, p.2, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.

qenë qartazi e dukshme në horizont edhe në kohën kur bëhej kjo Kushtetutë.

Për të mos e përsëritur atë që thamë më lart, përsëri në kuptimin e dispozitave konkrete të caktuara, institucionet e Republikës së Kosovës nuk kanë lëvizur fare në kuptimin e zbatimit të nenit kushtetues i cili ka të bëjë me parimet e përgjithshme të punës së Qeverisë<sup>18</sup>. Ndër të tjera, ky nen organizon punën e pushtetit ekzekutiv përmes ligjit, pra në këtë rast ligjit për Qeverinë, por Republika e Kosovës edhe pse gjashtë vjet e gjysmë pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së saj, ende nuk ka një ligj për Qeverinë. Kjo padyshim na jep të drejtë të konstatojmë që Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk është zbatuar në dispozita të caktuara në kuptimin e plotë të fjalës, e këtë mund ta quajmë edhe një sfidim të Kushtetutës, sepse moszbatimi në njëfarë forme mund të kuptohet edhe si sfidim i aktit më të lartë.

#### *6. Qasja ndaj respektimit të kushtetutës së Republikës së Kosovës në raport me veprimet institucionale*

Më lart e trajtuam çështjen e sfidimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në kuptimin e moszbatimit të dispozitave konkrete kushtetuese. Në përgjithësi mund të konstatojmë që një numër dispozitash të kësaj Kushtetute nuk janë zbatuar për shkak të rrethanave objektive dhe kjo rrjedhimisht lidhet me situatën politike në veri të Kosovës, qasjen institucionale sidomos ndaj serbëve të Kosovës, por njëherësh edhe qasjen e serbëve ndaj sistemit kushtetues në përgjithësi. Në disa raste, tendencat për degradimin e rendit Kushtetues është dashur të menaxhohen në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar për faktin që Republika e Kosovës kishte një periudhë të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë, andaj si faktor kjo është mjaft e rëndësishme për t'u përmendur. Ndër të tjera, nuk mund të anashkalohej edhe varësia e Kushtetutës me Pakon e Ahtisarit, e cila varësi rrjedhimisht ka ndikuar edhe në qasjen praktike ndaj Kushtetutës. Mirëpo së këndejmi, mund të vërehet qartë që ka edhe dispozita të tjera konkrete zbatimi i të cilave është varur nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe një gjë e tillë ka qenë e pamundur përkundër që ka kaluar një kohë nga kur Kushtetuta ka filluar të prodhojë efekte.

Veçmas kësaj qasjeje në kuptimin e sfidave të konstitucionalizmit ia vlen të trajtohet edhe qasja e institucioneve ndaj Kushtetutës dhe koncepti institucional për rëndësinë e saj. Në përgjithësi Republika e

---

<sup>18</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 92.

Kosovës nuk ka treguar ndonjë kujdes institucional për Kushtetutën këto vite të saj të ekzistimit si shtet. Përkundër që kjo Kushtetutë në analet e shtetkrijimit do të mbetet Kushtetuta e cila krijoi shtetin, në kuptimin e sjelljeve institucionale dhe mënyrës së zbatimit nuk është demonstruar një kujdes ndaj peshës së kushtetutës ashtu siç bëjnë vendet e tjera me traditë. Edhe vetë Dita e Kushtetutës, e shpallur si festë zyrtare me ligj, në shumicën e rasteve ka kaluar pa ndonjë organizim të mirëfilltë institucional. Natyrisht, kjo qasje e zbehtë ndaj rëndësisë së Kushtetutës të jep një imazh jo fort të mirë në kuptimin e trajtimit të aktit më të lartë.

Në kontekst të kësaj, nëse mund ta quajmë si sfidë të konstitucionalizmit në përgjithësi, ka pasur disa momente të ngërçit kushtetues, të cilat e kanë cenuar peshën, së pari Kushtetutën dhe më pas i kanë dhënë një goditje të qartë konstitucionalizmit në Kosovë. Pavarësisht që në këtë studim janë trajtuar edhe momentet e tjera që shënojnë arritje të konstitucionalizmit në Kosovë, që padyshim Kosova ka krijuar një identitet të saj kushtetues dhe ka nisur të ndërtojë konstitucionalizmin vetëm pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së vitit 2008.

Nisur nga momentet të cilat do t'i vëmë në spikamë, si momente përmes të cilave është sfiduar Kushtetuta dhe kushtetutshmëria është interesante që të gjitha këto momente lidhen në një formë ose tjetrën me vullnetin e partive politike si akterë të krijimit të institucioneve dhe njëherësh në këtë kuptim edhe zbatues të Kushtetutës në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ende është në kujtesën e qytetarëve momenti kur në vitin 2009 Partitë Politike në pushtet në Republikën e Kosovës, respektivisht njëra prej tyre kishte kërkuar prishjen e koalicionit<sup>19</sup> dhe në kuadër të kësaj prishje njëherësh edhe ndarjen e posteve, duke përfshirë edhe atë të Presidentit. Ndërkohë ishte e qartë që Presidenti atëbotë kishte një mandat kushtetues dhe një gjë e tillë nuk mund të bëhej me një prishje të një marrëveshjeje politike. Kjo qasje e partive politike në njohësit e kushtetutës një qasje e tillë ishte konsideruar e ngutshme dhe pa një logjikë kushtetuese dhe ndër të tjera edhe një moskujdes ndaj konceptit të kushtetutës, meqë ishte kërkuar nga partitë në fjalë që në rast të prishjes së koalicionit, pjesë e kësaj të futej edhe posti i Presidentit.

Pas kësaj, një situatë e dytë, e vërtetuar me aktgjykim nga ana e Gjykatës Kushtetuese ishte rasti i ish-Presidentit Sejdiu. Në rastin e tij, që do ta shtjellojmë më gjerësisht në vijim, u konstatua se presidenti kishte bërës shkelje të vazhdueshme të rënda të nenit 88.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, meqë njëkohësisht kishte mbajtur dy poste, atë të Presidentit

---

<sup>19</sup> Koalicioni PDK-LDK.

dhe atë të kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Megjithëkëtë, në rastin konkret ish-Presidenti Sejdiu, edhe pse i kualifikuar si “shkelës” i aktit më të lartë, demonstroi një kujdes ndaj aktit më të lartë, duke respektuar vendimin e Gjykatës. Njëherësh, përmes kësaj sjelljeje ai kishte vënë në pah cilësitë kushtetuese të një presidenti, duke dhënë dorëheqje për t’i dhënë një zgjidhje kushtetuese situatës së krijuar.

Vështirësi tjetër dhe njëherësh sfidë në kuptimin e transmetimit të një vullneti jo tipik partitë politike në kuptim të respektimit të Kushtetutës kishin shfaqur edhe në rastin e zgjedhjes së Presidentit në vitin 2010. Pas zgjedhjeve të mbajtura në vitin 2010 u shtrua nevoja edhe e krijimit të institucioneve, në këtë rast pjesë e krijimit të institucioneve ishte edhe posti i Presidentit, i cili duhet t’i takonte njërit prej partnerëve të koalicionit<sup>20</sup>, në këtë rast kandidat për president u propozua z. Behgjet Pacolli. Së këndejmi, meqë Kushtetuta e Republikës së Kosovës kërkon një president konsensual në kuptimin e shumicës së kërkuar për ta zgjedhur<sup>21</sup> presidentin, atëbotë partitë që nuk ishin konsultuar për kandidaturën në fjalë parimisht nuk preferonin që të qëndronin në sallë për ta votuar Presidentin, prandaj një gjë e tillë krijoi huti se a mund të vazhdohet në rundet e votimit përderisa nuk ka kuorum të mjaftueshëm për të arritur në 2\3 e votave.<sup>22</sup> Edhe pse nuk ishte numërimi minimal i nevojshëm, u vazhdua procesimi në dy rundet e para. Kjo atëbotë krijoi përshtypjen e një shmangie me vetëdije të Kushtetutës nga ana e deputetëve të Kuvendit. Më vonë qasjen dhe faktin që nuk kishte kuorum në dy rundet e para e kishte vërtetuar edhe Gjykata Kushtetuese në rastin e ashtuquajtur “Rasti Pacolli”, të cilin po ashtu do ta detajojmë më poshtë si rast që ka hyrë na analet edhe shkencore të së drejtës kushtetuese<sup>23</sup>.

Përpos kësaj, ka pasur edhe raste të tjera kur është sfiduar kushtetuta, ose më mirë thënë ndaj saj nuk ka pasur një sjellje dinjitoze institucionale në kuptimin e zbatimit. Rasti në praktikë i Ushtruesit të Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, i cili në vitin 2011, në cilësinë e ushtruesit të detyrës kishte dekretuar dhe refuzuar një numër të gjyqtarëve të Republikës së Kosovës. Në kontekst të kësaj ishte diskutuar se deri ku mund të shkojnë

<sup>20</sup> Koalicioni PDK-AKR.

<sup>21</sup> 2\3 e votave në dy rundet e para, neni 86 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

<sup>22</sup> Pas braktisjes së sallës nga shumica e deputetëve, në sallë në seancën e zgjedhjes së z. Pacolli president kishin mbetur vetëm 67 deputetë, ndërkaq që për t’u zgjedhur në këtë post Kushtetuta e Republikës së Kosovës kërkon në dy rundet e para minimalisht 81 vota. Dilemat kanë të bëjnë me atë se meqë ishin prezentë 67 deputetë, rrjedhimisht më pak sesa numri minimal i nevojshëm a mund të vazhdohej tutje?!

<sup>23</sup> Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim, rasti KO29/11.

kompetencat e ushtruesit të detyrës në emërimin e gjyqtarëve. Më vonë në mënyrë indirekte, në kuadër të kontrollit preventiv të amendamenteve kushtetuese për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit, Gjykata Kushtetuese i kishte dhënë të drejtë Ushtruesit të Detyrës së Presidentit, në kuptimin e asaj që edhe ushtruesi i detyrës ka kompetenca të plota sipas nenit 84 sikur presidenti i zgjedhur.<sup>24</sup>

Një rast tjetër që nuk mund të anashkalohet në kuptimin e kualifikimit si sfidë të Kushtetutës së Kosovës është rasti i moskompletimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Që nga viti 2012 kur përfundoi mandati i dy gjyqtarëve femra të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, edhe pse në dy përpjekje Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk kishte arritur të kompletonte përbërjen e Gjykatës<sup>25</sup>, meqë në të dyja konkurset e shpallura për gjyqtarë Kuvendi kishte arritur të zgjidhte vetëm njërin prej tyre. Vetë dështimi për zgjedhjen e gjyqtarit të mbetur që nga vitit 2012 e deri më tani në kohën kur po shkruhet ky studim, nënkupton një mosgatishmëri për zbatimin e Kushtetutës në kuptimin e ngushtë të saj, nëse i referohemi përbërjes së plotë të Gjykatës Kushtetuese.

Një rast pothuajse shumë publik, madje sfidë për të gjithë rendin kushtetues dhe shtetin në përgjithësi ishte problemi që është krijuar me moszbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në lidhje me të drejtën që kishin fituar punëtorët e Fabrikës së Tubave në Ferizaj, meqë ky aktgjykim ua kishte njohur atyre të drejtën e kompensimit të dëmit të shkaktuar pas privatizimit të kësaj fabrike. Në fakt, mosrespektimi dhe njëherësh neglizhenca ndaj zbatimit të këtij vendimi, i cili vazhdon edhe më tutje, cilësohet si një sfidë serioze për Republikën e Kosovës si shtet i ri, me synime të qarta për integrim në Bashkimin Europian<sup>26</sup>.

Një krizë tjetër, ku ishte sfiduar në masë të madhe konstitucionalizmi kosovar dhe kushtetuta po ashtu, ishte ajo e vitit 2014, ku partitë politike për shkak të gjoja paqartësive kushtetuese, lidhën një marrëveshje politike<sup>27</sup>, për të krijuar institucionet kushtetuese, e cila marrëveshje më vonë prodhoi pasoja kundërkushtetuese, për shkak të zgjedhjes së gabuar të kryetarit të parlamentit, si dhe vonesave në zgjedhjen e qeverisë. Në këtë krizë kishte ndërhyrë presidenti dhe gjykata kushtetuese, meqë rast shpalli jo kushtetues

<sup>24</sup> Shih më tepër aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastet KO29/12 dhe KO48/12.

<sup>25</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka paraparë në përbërjen e Gjykatës Kushtetuese nëntë gjyqtarë.

<sup>26</sup> Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Aktgjykim, rasti, KI08/09.

<sup>27</sup> Marrëveshja politike e lidhur më mes të LDK, AAK, NISMA (që të tria parti politike), me datë 9 Qershor 2014.

zgjedhjen e kryetarit të parlamentit si dhe u sqarua çështja e zgjedhjes së qeverisë<sup>2829</sup>. Me rastin e kësaj krize, institucionet e Republikës së Kosovës u mbajtën të bllokuara për rreth gjashtë muaj, nga politike, si pasojë e mosgatishmërisë për t'i zgjedhur ato, periudhë kjo që siç e thamë ishte shoqëruar me shkelje të kushtetutës nga ana e parlamentit të Republikës së Kosovës.

Një situatë tjetër krize, ku kushtetuta ishte sfiduar në masë të madhe ishte nënshkrimi i marrëveshjes së parimeve për asociacionin e komunave me shumicë serbe. Pas dërgimit të rastit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në vitin 2015, e njëjta gjeti që marrëveshja mbi parimet është në kundërshtim me një numër të madh të neneve të kushtetutës, pra në disa segmente e shpalli marrëveshjen si kundërkushtetuese<sup>30</sup>. Shkelja e një numri të madh të dispozitave kushtetuese, sipas gjetjeve të Gjykatës Kushtetuese përbën një fakt mjaft shqetësues, për një vend si Republika e Kosovës, që pretendon të krijojë një konstitucionalizëm të qëndrueshëm.

Përgjatë viteve 2014 dhe 2017 në moszbatim të kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht në sfidim të saj kishin hasur edhe institucionet e drejtësisë, konkretisht Këshilli Prokurorial dhe ai Gjyqësor. Në vitin 2014 për shkak të shkeljeve të parimeve thelbësore që burojnë nga kushtetuta, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës e kishte shpallur si jo kushtetuese garën për kryeprokurorin e shtetit. Konkretisht ishte vlerësuar që ishin shkelur parimet e barazisë së votës si dhe e drejta për gjykim të drejtë, në kuadër të garës për kryeprokuror<sup>31</sup>. Po ashtu për të njëjtat parime të shkelura, në vitin 2017 Gjykata Kushtetuese e Kosovës kishte kthyer në pikën zero garën për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Supreme dhe atë të Gjykatës së Apelit, meqë rast u vlerësua që ishin shkelur po ashtu disa parime të rëndësishme kushtetuese nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës<sup>3233</sup>.

Shikuar në aspektin e përgjithshëm, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përpos që është sfiduar përmes veprimeve institucionale, ajo ndër të tjera edhe është keqkuptuar, a edhe keqinterpretuar dhe në këtë kuptim shpeshherë kanë ndodhur edhe veprime që në një formë a tjetrën janë cilësuar si shmangie ndaj Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

---

<sup>28</sup> Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim, rasti KO103/14.

<sup>29</sup> Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim, rasti KO119/14.

<sup>30</sup> Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim, rasti KO130/15.

<sup>31</sup> Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim, rastet KI99/14 dhe KI100/14.

<sup>32</sup> Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim, rasti KI31/17.

<sup>33</sup> Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim, rasti KI55/17.

Nga shtjellimi i bërë më lart mund të vërehet se për dhjetë vite të ekzistimit të saj, kushtetuta e Republikës së Kosovës ka pasur mjaft sfida, në kuptimin e zbatimit të saj por edhe sjelljes së institucioneve, respektivisht politikës, në përputhje me kërkesat që burojnë nga kjo kushtetutë. Një sjellje, kushtimisht në kundërshtim me kërkesat që dalin nga kushtetuta e Republikës së Kosovës në këtë rast, më shumë se një mosrespektim i kushtetutës është një mungesë e kulturës politike, që përbën një element shumë të rëndësishëm të kushtetutshmërisë.

### *7. Ndryshimet në kushtetutë dhe legjislacion në efekt të përmbylljes së mbikëqyrjes së pavarësisë*

Procesi i përmbylljes së mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë prodhoi ndryshime në Kushtetutën dhe Ligjet e Republikës së Kosovës<sup>34</sup>. Këto ndryshime, kishin për qëllim që të zbatonin tërësisht Pakon e Ahtisarit dhe të integronin njëkohësisht në sistemin kushtetues të Kosovës. Reforma kushtetuese e përmbylljes ndërkombëtare të pavarësisë prodhoi tërësisht 22 amendamente si dhe ndryshimin e mbi 20 ligjeve, të cilat u ndryshuan përmes Ligjit për Përmbylljen e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë. Ndryshimet në kushtetutë dhe në legjislacion u votuan në Kuvendin e Republikës së Kosovës me 7 shtator 2012.

Në kuptimin e përmbylljes së pavarësisë dhe zbatimit e integritit të plotë të Pakos së Ahtisarit, Qeveria e Republikës së Kosovës, e ngarkuar për zbatimin e agjendës për përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë ka propozuar ndryshime në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të cilat do të bëjnë të mundur që edhe formalisht Pakoja e Ahtisarit të zbatohet, por një gjë e tillë bën të mundur edhe heqjen e mekanizmave ndërkombëtar, që kanë zbatuar mbikëqyrjen dhe që njëherësh kanë pasur cilësinë e subjekteve kushtetuese.

Ndryshimi i parë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që lidhet me pavarësinë e mbikëqyrur është neni 58.4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili nen është riformuluar nga teksti aktual që ka Kushtetuta në këtë mënyrë: “Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratojë masa adekuate për të promovuar barazi të plotë dhe efektive

<sup>34</sup> Flamur Hyseni & Florent Muçaj, “Përfundimi i pavarësisë së mbikëqyrur dhe ndryshimet kushtetuese”, më detajisht në vegzën: [http://www.2lonline.com/index.php?option=com\\_content&view=article&id=4565:perfundimi-i-pavaresise-se-mbikeqyrur-dhe-ndryshimet-kushtetuese&catid=102&Itemid=611](http://www.2lonline.com/index.php?option=com_content&view=article&id=4565:perfundimi-i-pavaresise-se-mbikeqyrur-dhe-ndryshimet-kushtetuese&catid=102&Itemid=611), qasur së fundmi më 02.09.2017.

të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore dhe **pjesëmarrjen efektive të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje**. Masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit”. Siç mund të shihet, për dallim nga teksti aktual i Kushtetutës, shtohet **fjalja** si vijon “**pjesëmarrjen efektive të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje**”, krejt kjo për të futur brenda Kushtetutës, konkretisht kapitullit të parë të saj, frymën dhe gjuhën e Pakos së Ahtisarit<sup>35</sup>.

Bazuar në këtë logjikë, propozuesi i amendamenteve kushtetuese, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka dhënë edhe arsyetimin për shtesën që është futur në këto amendamente, ku me theks të veçantë dominon kërkesa e përshtatjes së Kushtetutës së Republikës së Kosovës me Pakon e Ahtisarit<sup>36</sup>.

Përveç kësaj, në kuadër të këtyre ndryshimeve kushtetuese ka hyrë edhe neni 81, paragrafi 1 i Kushtetutës i cili bën fjalë për legjislacionin me interes vital dhe në kuadër të këtij neni tanimë ka ndryshuar komplet formula e votimit të kësaj kategorie të ligjeve, përderisa deri në hyrjen në fuqi të këtyre amendamenteve kjo formulë ka kërkuar që legjislacioni me interes vital të miratohet me shumicën e deputetëve të pranishëm dhe që votojmë, përshirë shumicën e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë të deputetëve që mbajnë vende të rezervuara, pas hyrjes në fuqi të këtyre amendamenteve kjo formulë është rritur dhe për votimin e kësaj kategorie të ligjeve duhet shumica e deputetëve, përshirë edhe shumicën e atyre që mbajnë vende të rezervuara; me siguri shumica e deputetëve nënkuptohet nga numri i përgjithshëm i të gjithë deputetëve<sup>37</sup>. Përveç kësaj, amendamenti 3 i këtyre ndryshimeve në listën e ligjeve me interes vital ka futur edhe ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura, i cili është miratuar në vitin 2012 në Kuvendin e Republikës së Kosovës, si ligj që dilte nga Pakoja e Ahtisarit<sup>38</sup>.

<sup>35</sup> Amendamentet Kushtetuese për përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë, amendamenti 1 dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 58.4.

<sup>36</sup> Ndër të tjera në arsyetim thuhet “Në Propozimin Gjithëpërfshirës shkruhet në mënyrë koncize për krijimin e kushteve për pjesëmarrje të komuniteteve në jetën publike dhe në vendimmarrje. Kushtetuta duhet të ketë përmbajtje të ngjashme për të pasqyruar këtë.

<sup>37</sup> Amendamentet kushtetuese për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë, amendamenti 2.

<sup>38</sup> Arsyetimi i Qeverisë për futjen e këtij ligji në rangun e legjislacionit me interes vital është si vijon: “Ligji mbi zonat e veçanta të mbrojtura teknikisht është ligj

Në vazhden e ndryshimeve që lidhen me pavarësinë e mbikëqyrur ka hyrë edhe neni 143 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili njëherësh ka kultivuar raportin ndërmjet Pakos së Ahtisarit dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konkretisht elementin e supremacisë kushtetuese. Sipas këtij neni Pakoja e Ahtisarit kishte fuqi supreme ndaj Kushtetutës, gjë që me këto ndryshime ekziston për shkak të fshirjes së nenit përkatës 143. Dy nene, përfshirë nenin 144 dhe 145 të cilat flasin për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht vazhdimësinë e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe legjislacionit të aplikueshëm, sipas këtyre amendamenteve zhvendosen nga kapitulli XIII që i përket edhe neni i fshirë 143 dhe barten te kapitulli i pare, ai i dispozitave themelore, që ka edhe logjikë për shkak të rëndësisë së çështjeve që rregullojnë këto nene. Në anën tjetër, përpos logjikës dhe rëndësisë së çështjes, këto dy nene 144 dhe 145 ishin propozuar të fshihen mund të analizohen edhe në një anë tjetër të medaljes. Zhvendosja e nenit 144 te dispozitat themelore është në fakt edhe jashtë praktikës së shumicës së kushtetutave të vendeve që kanë traditë kushtetuese, sepse te dispozitat themelore kanë vendosur vetëm çështjet kryesore shtetërore. Po citojmë vetëm disa nga kushtetutat moderne të cilat kanë vendosur amendamentimin në fund, madje jo vetëm si nen i veçantë, por edhe si kapitull i veçantë. Disa prej kushtetutave në vijim e kanë titulluar amendamentimi, disa ndryshimi e disa të tjera rishikimi i kushtetutës, varësisht nga koha në të cilën janë shkruar (P.sh. Kushtetuta e SHBA-së, e Austrisë, e Mbretërisë së Holandës, e Kroacisë, e Maqedonisë, e Malit të Zi, e Norvegjisë, e Federatës Ruse, e Sllovenisë, e Spanjës, e Bullgarisë, e Francës, e Greqisë, e Italisë, e Kanadasë, e Rumanisë, e Shqipërisë). Në anën tjetër, neni 145 që flet për marrëveshjet ndërkombëtare që kanë qenë në fuqi para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, i njëjti është propozuar të zhvendoset te dispozitat themelore. Në fakt në përmbajtje ky nen është kalimtar dhe dihet që një ditë do të përfundojë procesi i rivlerësimit të marrëveshjeve ndërkombëtare sipas fuqisë së Kushtetutës dhe jo gjithmonë do të ketë marrëveshje të kategorisë që kanë qenë në fuqi para hyrjes në fuqi të vet Kushtetutës, e ky proces ciklik një ditë do të mbyllet dhe dispozita do të shpenzohet; me zhvendosjen e saj te dispozitat themelore priset balancimi i neneve të kapitullit I të Kushtetutës dhe njëherësh e të gjithë Kushtetutës, prandaj kjo dispozitë

---

për planifikimin hapësinor. Ky amendament sqaron që ligjet për zonat e veçanta të mbrojtura, Qendrën Historike të Prizrenit dhe Hoçën e Madhe konsiderohen të jetë “me interes vital”.

në çfarëdo rrethane është dispozitë me përmbajtje kalimtare dhe aty duhet të mbetej.

Ndryshimet e tjera në Kushtetutë lidhen me kapitullin e fundit atë të dispozitave përfundimtare, në kuadër të të cilit kapitull në funksion të përmbylljes së pavarësisë janë fshirë shumica e neneve, duke qenë se shumica prej tyre bëhen inekzistente për shkak të largimit të faktorit ndërkombëtar dhe mekanizmave relevant ndërkombëtarë që kanë mbikëqyrur pavarësinë. Në këtë kontekst, neni 146 i Kushtetutës i cili flet për përfaqësuesin civil ndërkombëtar tanimë nuk eksiton në Kushtetutën e Republikës së Kosovës së bashku me nenin 147 i cili flet për autoritetin përfundimtar të përfaqësuesit civil.

Ndryshimi i nenit 148, i cili nuk do të ketë kurrfarë efekti juridik edhe nëse do të ekzistonte pas ndryshimeve lidhet me mekanizmin e shndërrimit automatik të vendeve të rezervuara në vende të garantuara, ndryshim ky që ka qenë i paraparë të ndodhë pas kalimit të dy mandateve në Kuvendin e Republikës së Kosovës si një lloj elementi korrektues. Njëherësh, amendamenti 9, që kërkon fshirjen e nenit 148 është pikërisht amendamenti i cili i ka “shqetësuar” komunitetet<sup>39</sup>, sepse ky nen flet për vendet e rezervuara, përfshirë edhe vendet që deputetët e pakicave do t’i fitojnë gjatë zgjedhjeve që do të jenë vende shtesë, përpos 20 vendeve. Ky është i ashtuquajtimi mbipërfaqësim. Neni që me këtë amendament fshihet, në paragrafin 2 thotë si vijon: *“Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, mandati ekzistues në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute do të konsiderohet si mandati i parë zgjedhor i Kuvendit në rast se ky mandate zgjat për së paku dy vjet nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute,”* që nënkupton se pas kalimit të mandatit të kësaj legjislature kalon edhe mandati i dytë i Kuvendit nga hyrja në fuqi e Kushtetutës, sepse konkretisht paragrafi 1 i nenit 148 i lejon këto vende shtesë vetëm në dy mandatet e para (*Kemi parasysh që mandati i parë ka qenë mandati i legjislaturës së vitit 2007-2010, që ka zgjatur më shumë se dy vjet dhe është llogaritur si mandat i plotë, kurse mandati i dytë është mandati i legjislaturës 2010-2014*). Kjo nënkupton shndërrimin automatik të këtyre vendeve në kuotën e vetëm 20 vendeve, pavarësisht pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje.

Arsyetimi i këtij amendamenti e ka bazën edhe në Pakon e Ahtisarit, sepse vetë neni 3.3 dhe 3.3.2 i aneksit të parë të Pakos i

<sup>39</sup> Kemi parasysh deklaratën e zëvendëskryeministrit të Republikës së Kosovës, Slobodan Petroviq dhënë medieive më 4.9.2012, që miqtë ndërkombëtarë kanë premtuar se vendet e rezervuara do të mbesin edhe për dy mandate.

referohet vendeve të rezervuara pas kalimit të dy mandateve. Një vazhdim i garantimit të vendeve të rezervuara do të thotë tejkalim i këtyre dispozitave të Pakos së Ahtisarit! Logjika e përmbylljes së pavarësisë është implementimi i Pakos dhe këto dy dispozita të Pakos janë zbatuar<sup>40</sup>.

Ndryshimi i radhës i Kushtetutës lidhet me fshirjen e nenit 149, i cili është krejt teknik, sepse ky nen bën fjalë për miratimin fillestar të legjisllacionit me interes vital. Fshirja e nenit 149 përmes amendamentit 10 është e arsyeshme pasi që neni 149 flet për miratimin fillestar të ligjeve me interes vital dhe si i tillë ky proces është kryer, pra neni është i shpenzuar<sup>41</sup>. Fshirja e nenit 150 përmes amendamentit 11 është e arsyeshme, sepse neni 150 po ashtu është i shpenzuar dhe flet vetëm për procesin fillestar të emërimit dhe të gjyqtarëve e prokurorëve. Tani kjo çështje rregullohet me kapitullin VII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me ligjet aplikative dhe si i tillë ky nen nuk ka nevojë të ekzistojë<sup>42</sup>. Edhe fshirja e nenit 151 përmes amendamentit 12 është e arsyeshme, sepse neni 151 flet për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe pas përfundimit të pavarësisë ky organ nuk do të ketë më përbërje të përkohshme, përbërja e përhershme është e rregulluar me ligjin për Këshillin Gjyqësor<sup>43</sup>. Edhe fshirja e nenit 153 përmes amendamentit 13 po ashtu është e arsyeshme, sepse neni 152 flet për përbërjen e përkohshme të Gjykatës Kushtetuese dhe pas përfundimit të mbikëqyrjes po ashtu ka vetëm përbërje të përhershme të Gjykatës Kushtetuese e cila rregullohet në kapitullin VIII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës<sup>44</sup>. Përveç këtyre amendamenteve teknike është edhe amendamenti 4 dhe 15, që po ashtu vetëm kërkon fshirjen e një neni tashmë të shpenzuar.

---

<sup>40</sup> Partitë, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës do të kenë numrin e ulëseve në Kuvend të fituar përmes zgjedhjeve të hapura, me minimum dhjetë (10) ulëse të garantuara në rast se numri i ulëseve të fituara është më i vogël se dhjetë (10) dhe neni që thotë: Partitë, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet tjera, do të kenë numrin e ulëseve në Kuvend të fituara përmes zgjedhjeve të hapura, me minimumin e ulëseve të garantuara siç parashihen me nenin 3.2, nëse numri i ulëseve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i ulëseve të parashikuara me nenin 3.2.

<sup>41</sup> Amendamenti 10 për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

<sup>42</sup> Amendamenti 11 për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

<sup>43</sup> Amendamenti 12 për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

<sup>44</sup> Amendamenti 13 për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

## 8. Përfundime

Duke parë të gjitha rrethanat e trajtuara më lart lidhur me konstitucionalizmin në Kosovë, pas shpalljes së pavarësisë, duhet theksojmë që për dhjetë vite të ekzistimit të kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka pasur zhvillime mjaft interesante, dhe rrjedhimisht ka pasur mjaft batica dhe zbatica. Dy janë aspektet të cilat e identifikojnë konstitucionalizmin në Kosovë për këto vite, e para: konteksti në të cilin është shkruar kushtetuta e Republikës së Kosovës, kontekst ky që ka bërë që të krijohet një identitet kushtetues kosovar i veçantë, dhe e dyta, sfidat dhe shkeljet e shumta të kushtetutës së Republikës së Kosovës, të cilat i kishte konstatuar Gjykata Kushtetuese. Një karakteristikë e veçantë e konstitucionalizmit kosovar për dhjetë vjet ishin edhe krizat e shumta politike, që pashmangshëm e sfiduan kushtetutën.

Mënyra e hartimit të kushtetutës së Kosovës, e dalë tërësisht nga një proces i negociimit politik në Vjenë dhe e ndikuar nga derivatet e këtij procesi, krijoj rrethanat që Kosova të ndërtojë një realitet krejt të ri kushtetues, me mjaft specifika. Ky realitet i ri, i krijuar si pasojë e Pakos së Ahtisarit, sot e kësaj dite po e sfidon konstitucionalizmin, sidomos për shkak të garancive jashtëzakonisht të gjëra të komuniteteve jo shumicë.

Një ndikim të madh që ka lënë gjurmë në zhvillimin e konstitucionalizmit kosovar e kanë pasur edhe rastet e shkeljes së kushtetutës, nga ana e institucioneve, të cilët përbëjnë një zhvillim negativ dhe janë një tregues që në demokracitë e reja, zakonisht nuk mund të presim zbatim të mirëfilltë të kushtetutës.

Rëndësi në zhvillimin e konstitucionalizmit në Kosovë, për këto vite të ekzistimit të kushtetutës kanë pasur edhe krijimi i krizave politike, si pasojë e sjelljes së partive politike ndaj normave kushtetuese. Një zhvillim pozitiv në këtë aspekt duhet përmendur rolin që ka pasur presidenti i Republikës së Kosovës, si dhe Gjykata Kushtetuese, të cilat kanë arritur të krijojnë një stabilitet kushtetues si dhe standarde të qëndrueshme kushtetuese me veprimet e tyre.

Për dhjetë vjet të ekzistimit mund të vlerësojmë që konstitucionalizmi në Republikën e Kosovës është zhvilluar me rënie dhe ngritje, si dhe mjaft sfida të cilat kanë rrjedhur kryesisht nga politika. Elemente pozitive të konstitucionalizmit kosovar për këto dhjetë vjet mund të cilësohen: Krijimi i identitetit kushtetues kosovar si dhe roli i Gjykatës Kushtetuese në krijimin e standardëve të qëndrueshme kushtetuese, që janë shndërruar në një udhërrëfyes të

konstitucionalizmit në Kosovës. Si aspekte negative të zhvillimit të konstitucionalizmit kosovar për këto vite mund të cilësohen: Shkeljet e kushtetutës, moszbatimi i kushtetutës nga institucionet kushtetuese si dhe krizat politike, të cilat kanë krijuar probleme jashtëzakonisht të mëdha kushtetuese, si dhe kanë ndikuar në nivelin e kulturës politike dhe sjelljes së institucioneve në raport me kushtetutën.

## Referencat

- Bajrami A., *“Draftimi i Kushtetutës”*, Prishtinë 2007;
- Bajrami A., *“Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës”*, Prishtinë 2011;
- Barnet H., *“Constitutional and Administrative Law”*, fourth edition, Cavendish Publishing Limited, 2002;
- Deklarata e Kuvendit të Republikës së Kosovës e miratuar në shkurt të vitit 2012 e shpall referendumin si një veprim që cenon rendin kushtetues;
- Gjykata Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastet KO29/12 dhe KO 48/12;
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Aktgjykim, rasti, KI 08/09;
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim, rastet KI99/14 dhe KI100/14;
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim, rasti KI31/17;
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim, rasti KI55/17;
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim, rasti KO103/14;
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim, rasti KO119/14;
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim, rasti KO130/15;
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim, rasti KO29/11;
- <http://www.dw.de/komunat-veriore-sfida-e-institucioneve-qendrore-te-kosoves/a-17335630>. Qasur së fundmi me 21.10.2017;
- Intervistë me Prof. Arsim Bajramin, pjesëmarrës në bisedimet e Vjenës, 21.10.2017;
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008;
- Marrëveshja politike e lidhur më mes të LDK, AAK, NISMA (që të tria parti politike), me datë 9 Qersh02 2014;
- Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjedhjen e Statusit Final të Kosovës*, 2007;
- Raporti i Kai Eides, *“Shqyrtim Gjithëpërfshirës i Gjendjes në Kosovës”*, Prishtinë 2005;
- Saliu K., *“E Drejta Kushtetuese”*, Prishtinë 2004;
- Sri. C. M. James, Dr. G. Sadanandan (Co-ordinator), *“WORLD CONSTITUTION: COMPARATIVE ANALYSIS”*, UNIVERSITY OF CALICUT, 2013.

Arsim BAJRAMI

## KOSOVA'S CONSTITUTIONALISM AND THE CHALLENGES AFTER THE DECLARATION OF INDEPENDENCE

### Abstract

*The Republic of Kosova has begun a new constitutional reality after the adoption of the Declaration of Independence, in the Kosova Assembly on 17 February 2008, which was a derivative of an international supervision of Kosova by the United Nations Special Mission (UN) for eight (8) years. In the prism of comparative practices, this was a special model of administering a state by international mechanisms.*

*This paper aims to address some aspects of these dimensions that refer to the fundamental issue, and the level of constitutionalism the Republic of Kosova has established after declaring its independence. Of course, in the context of Kosova's constitutionalism – built almost ten (10) years after the declaration of independence, it may not have indifferent attitudes to the constitutional and political developments that preceded this constitutionalism, especially the influence that international administration has had in Kosova – in creating the constitutionalism that Kosova today has.*

*The first step towards establishing a constitutional order and its constitutionalism, the Republic of Kosova has done after the adoption and entry into force of the Kosova Constitution in 2008. As it is known from the constitutional theory, constitutionalism is not a simple process that depends exclusively on the existence of a constitution, but rather it depends on the implementation, interpretation, and especially the relationship of the constitution with politics. The functioning, development, and challenges of Kosova's constitutionalism after the adoption and entry into force of the constitution has been influenced by many factors; especially by political factors. So, another important dimension of the paper is the function, the advantages, and the challenges of the development of Kosova constitutionalism – after the declaration of independence.*

*This paper is divided into three main parts; the first part deals with how the international supervision and international administration has influenced on the level of Kosova's constitutionalism; the second part of the paper will address the innovations, advantages, and values of constitutionalism, while the final part of the paper will discuss the challenges of constitutionalism in Kosova, especially the relationship with politics. Moreover, this paper will discuss the role of the Constitutional Court in the development of constitutionalism in Kosova, as well as the challenges that have arisen in the implementation of the Constitution of Kosova, the challenges that have appeared mainly from the political parties.*

**Keywords:** *constitutionalism, constitution, constitutional order of Kosova, constitutional court, challenges of constitutionalism*

# PIKËPAMJA HUNGAREZE MBI PAVARËSINË E KOSOVËS

**Laszlo Markusz**

## **Përmbledhje**

*Që nga fillimi i konfliktit të armatosur në Kosovë në shkurt 1998, ushtria dhe policia serbe zemëruan opinionin publik perëndimor me dhunën e tyre të vazhdueshme kundër popullatës civile. NATO ndërhyri ushtarakisht më 24 mars 1999. Serbia dëboi me dhunë rreth 850,000 kosovarë para kamerave të shtypit botëror nga marsi deri në qershor. Disa nga refugjatët shqiptarë përfunduan në Hungari. Pas përfundimit të luftës, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1244 (1999), e cila e autorizoi OKB-në të administrojë Kosovën. Mes aktorëve kyç perëndimorë kishte një konsensus në rritje se status quo-ja ishte e paqëndrueshme dhe se statusi përfundimtar i Kosovës duhej të zgjidhej brenda një kohe të shkurtër.*

*Hungaria filloi një veprimtari diplomatike më energjike në Ballkan. Tradicionalisht, Ambasada e Hungarisë në Tiranë kishte mbuluar ngjarjet në Kosovë. Më 1 nëntor 2005, Ministria e Punëve të Jashtme e Hungarisë hapi një Zyrë diplomatike Ndërlidhëse në Prishtinë dhe transferoi ekspertin e vjetër të Ballkanit, Zoltan Imecs, nga ambasada hungareze në Tiranë për të drejtuar zyrën e re. Ndërkohë ministri i Jashtëm Somogyi shprehu mendimin e tij se për të arritur stabilitet rajonal, Kosova duhet të bëhet një entitet i pavarur.*

*Qeveria hungareze mori vendimin për njohje më 19 mars 2008. Në atë kohë, rreth 30 vende e kishin njohur tashmë Kosovën, përfshirë Shtetet e Bashkuara dhe vendet kryesore të BE-së, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania.*

*Ministria e Punëve të Jashtme vendosi marrëdhënie diplomatike me Kosovën. Hungaria e emëroi shefin e Zyrës Ndërlidhëse si ambasadorin e saj të parë në Kosovë. Në ndërkohë Kosova e emëroi ambasadorin e parë të saj në Budapest.*

**Fjalët çelës:** Serbia, Kosova, NATO, Hungaria, diplomacia hungareze, Pavarësia e Kosovës, Ambasada Hungareze.

### *Sfondi historik*

Më pak se një vit pas vdekjes së Josip Broz Titos në një spital të Lubjanës, një grup studentësh në Universitetin e Prishtinës filluan një protestë për cilësinë e dobët të ushqimit që u jepej në mensën e kampusit. Shumë shpejt protesta u shndërrua në dhunë nëpër rrugë dhe trazira të mëdha politike. Demonstratat e dhunshme të shqiptarëve të Kosovës në pranverën e vitit 1981, me kërkesa për ngritjen e statusit të Provincës Autonome të Kosovës në atë të një Republike, ishin kriza e parë e madhe politike në Jugosllavinë pas Titos. Shumë analistë dhe politikanë vendorë më vonë pohuan se kjo ishte çështja që më në fund kishte helmuar atmosferën politike të “Bashkim Vëllazërimit” dhe që përfundimisht çoi në shpërbërjen e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (RSFJ) një dekadë më vonë. Sipas mendimit tim, kishte shumë forca centrifugale në veprim brenda vendit, dhe të gjitha kontribuuan në mënyrë komplekse në rezultatin përfundimtar dramatik. Sidoqoftë, nuk ka dyshim se konflikti i Kosovës luajti një rol madhor në shpërbërjen e Jugosllavisë në vitet 1991-1992.

Pas ndarjes së Jugosllavisë, pushtetin në Beograd e mori Partia Socialiste Serbe, e cila e mbajti fort gjatë gjithë viteve 1990 përballë luftërave brutale etnike në Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, sanksioneve ndërkombëtare dhe një turrjeje të rëndë ekonomike. Presidenti serb Slobodan Millosheviq ishte negociator me përvojë dhe manipulues dinak i partnerëve të tij perëndimorë. Suksesi i tij ishte më spektakolar në Dejton, dhe ai e ktheu në jetën politike Republikën Serbe të Bosnjës të mposhtur ushtarakisht. Teknika e tij e zgjuar e shoqërimit të provokimeve dhe kërcënimeve me sulme sharmi u tolerua shumë gjatë nga Perëndimi, dhe u kthye në burim të një perceptim të rremë të suksesit në mesin e ish kuadrove komuniste të udhëheqjes serbe.

Këto rezultate ishin të pjesshme dhe të përkohshme. Në nivelin strategjik, për habi udhëheqja e Beogradit demonstroi se shumë pak e kuptonte “rendin e ri botëror” pas Luftës së Ftohtë. Në rastin e Kosovës, Serbia bëri disa gabime themelore në arenën ndërkombëtare për shkak të injorancës së saj të plotë për natyrën e politikës në demokracitë perëndimore pas rënies së Murit të Berlinit. Abuzimi në shkallë të gjerë i të drejtave të njeriut në Kosovë kishte tërhequr vëmendjen e disa ligjvënësve me ndikim në Uashington DC në fund të viteve 1980. Vendosja e një sistemi të tipit të aparteidit në vitin 1991, për shtypjen e popullsisë së shumicës etnike shqiptare, ishte e garantuar se do të shkaktonte efekte negative afatgjata në perceptimet perëndimore për Serbinë. Dalëngadalë, situata u kthye në luftë pozicionesh të zhvilluar

nga shtypi dhe diplomatët perëndimorë kundër Beogradit. Një konflikt i këtij lloji ishte humbur edhe nga Afrika e Jugut, pavarësisht se në kuptimin strategjik ishte e organizuar shumë më mirë.

Beogradi nuk nxori asnjë mësim nga luftërat në Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë. Që nga fillimi i konfliktit të armatosur në Kosovë në shkurt 1998, ushtria serbe dhe veçanërisht njësitë policore zemëruan opinionin publik perëndimor me dhunën e tyre të vazhdueshme kundër popullatës civile. Deri në verë, veprimet e tyre ishin të barabarta me spastrimin e paramenduar etnik. Gabimi i fundit strategjik ishte dëbimi i organizuar i dhunshëm i 850,000 kosovarëve para kamerave të shtypit botëror dhe mes fushatës ajrore të NATO-s nga marsi deri në qershor 1999.

Të gjitha këto ngjarje ndikuan shumë në vendimmarrjen politike në Uashington DC dhe në kryeqytetet evropiane gjatë periudhës 2006-2008 kur u vendos për fatin e statusit të Kosovës.

NATO ndërhyri ushtarakisht në 1999 sepse sjellja e autoriteteve serbe në Kosovë ishte bërë burim madhor destabilizimi në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë edhe një krizë refugjatësh. Për më tepër, raportet e mediave po ushtronin një ndikim politik në rritje jashtë rajonit, madje edhe në vendet anëtare të NATO-s. Disa nga refugjatët shqiptarë përfunduan në Hungari, por pjesën më të madhe të barrës e mbajti Gjermania dhe vendet e tjera të Evropës Perëndimore. Sidoqoftë, Hungaria ishte një nga ato vendet fqinje me Serbinë që mbarti rreziqet më të mëdha politike dhe të sigurisë gjatë fushatës ajrore të NATO-s.

Komuniteti etnik hungarez në provincën veriore serbe të Vojvodinës, madje edhe popullsia e vetë Hungarisë, ishin të ekspozuar potencialisht ndaj hakmarrjes serbe. Në fund, Beogradi u përmbajt nga përshkallëzimi i konfliktit eventual me Hungarinë. Sidoqoftë, punët mund të kishin shkuar ndryshe nëse fushata e NATO-s do të hynte në fazën tjetër. Përkundër faktit se Hungaria doli praktikisht e padëmtuar, politikanët dhe diplomatët në Budapest nxorën përfundime afatgjata nga viti 1999: stabiliteti duhet të ruhet në rajonin e ish-Jugosllavisë me të gjitha mënyrat; dhe Hungaria duhet të bëjë gjithçka në fuqinë e saj për të parandaluar çdo përsëritje të konfliktit të armatosur afër kufirit hungarez.

Pas ndërhyrjes së NATO-s, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1244 (1999), e cila e autorizoi OKB-në të administrojë Kosovën në një periudhë të përkohshme derisa të zgjidhej statusi përfundimtar politik dhe ligjor i Kosovës. Pas ndërhyrjes ushtarake, vendet perëndimore financuan me bujari një projekt ambicioz të rindërtimit dhe të shtetndërtimit me qëllim që të shuanin rreziqet ndaj

sigurisë siç janë krimi i organizuar, varfëria dhe radikalizmi politik. Sidoqoftë, rezultatet ishin të përziera, pavarësisht nga fakti se gjatë dy dekadave vijuese Kosova mori ndihma të shumta ndërkombëtare.<sup>1</sup>

UNMIK-u,<sup>2</sup> të cilit iu besua të administronte territorin dhe të vinte themelet për vetëqeverisje të ardhshme, kurrë nuk arriti ta bënte për vete popullsinë e Kosovës. Ai nuk ishte në gjendje t'i siguronte popullatës kosovare vizionin strategjik që shqiptarët kishin dëshiruar prej kohësh. Performanca e administratës ndërkombëtare ishte veçanërisht problematike në sferën ekonomike. Vendit i duheshin dëshpërimisht investitorët e huaj strategjikë për të krijuar vende pune dhe për të zvogëluar nivelin e lartë të papunësisë, veçanërisht në mesin e të rinjve. Sidoqoftë, u bë e qartë se pa një zgjidhje të qëndrueshme politike, investitorët privatë do ta shmangnin Kosovën përgjithmonë. Në rastin e shumë vendeve, përfshirë Hungarinë, ky u pranua si një argument serioz për pavarësinë kur erdhi momenti.

Trazirat e dhunshme ndëretnike në mars 2004 demonstuan brishtësinë e situatës së përgjithshme në ish provincën serbe, përkundër pranisë së forcave paqeruajtëse (KFOR).<sup>3</sup> Mes aktorëve kyç perëndimorë kishte një konsensus në rritje se *status quo*-ja ishte e paqëndrueshme dhe se statusi përfundimtar i Kosovës duhej të zgjidhej brenda një kohe të shkurtër. Bisedimet për të ardhmen e Kosovës, të ashtuquajturat “bisedime për statusin”, filluan në janar 2006 së pari simbolikisht në rezidencën e Presidentit Ibrahim Rugova në lagjen Velania në Prishtinë, por pastaj u vazhduan në Vjenë.

<sup>1</sup> ‘Edicioni i Xhepit i Botës në Shifra 2012’ The Economist (2012): 44.

<sup>2</sup> Këshilli i Sigurimit i OKB-së krijoi Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në rezolutën 1244 për administrimin e aspekteve civile të jetës në Kosovën e shkatërruar nga lufta pas qershorit 1999. Që nga themelimi i tij, Misioni drejtohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP). Fillimisht, Përfaqësuesi Special gëzonte kompetenca të gjera ekzekutive civile sipas rezolutës 1244. Që nga viti 2008, misioni nuk ka ushtruar funksione ekzekutive dhe në përgjithësi ka mbajtur një profil të ulët politik.

<sup>3</sup> Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së gjithashtu vendosi një mision ushtarak të quajtur Forca e Kosovës (KFOR) për të ruajtur armëpushimin në ish provincën serbe, siç u ra dakord në Marrëveshjen e Kumanovës në qershor 1999. Forca shumëkombëshe ushtarake prej 50,000 ushtarakësh nën komandën e NATO-s mori kontrollin e territorit të Kosovës në mes të qershorit 1999 nga Forcat e Armatosura Federale Jugosllave (Vojska Jugosllavije). Paqeruajtësit iu nënshtruan kritikave serioze për shkak të dështimeve të tyre të përsëritura për të mbrojtur serbët dhe pakicat e tjera nga sulmet e dhunshme të ekstremistëve shqiptarë. Teksa situata politike po bëhej gjithnjë e më e qëndrueshme, numri i personelit ushtarak gradualisht zbriti në 4,500 deri në vitin 2015.

Për fat të keq, bisedimet për statusin kthyen në luftë mes përfaqësuesve diplomatik të Shteteve të Bashkuara dhe Ruisisë. Ekzistonte një hendek i madh midis pikëpamjeve të palëve serbe dhe shqiptare gjatë bisedimeve, sepse ata kishin besim në forcën e mentorëve të tyre dhe nuk panë arsye për të bërë kompromis. Gjatë vizitës së tij në Budapest në janar 2006, kreu i UNMIK-ut Soren Jessen-Petersen parashikoi qartë që shqiptarët e Kosovës do të zgjedhin pavarësinë e plotë të provincës, ndërsa serbët do të insistonin në diçka nën formulën “më shumë se autonomi, por më pak se pavarësi” që ta ruajnë sovranitetin e tyre mbi Kosovën së paku zyrtarisht. Diplomacia hungareze - përkundër optimizmit të detyrueshëm publik të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për perspektivat e kompromisit - mori mesazhin se bisedimet për statusin kishin më shumë të ngjarë të prodhonin një ngërç sesa një marrëveshje.

Gjatë bisedimeve për statusin, Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe vendet e tjera drejtuese të BE-së synonin shmangien e tre skenarëve:

Së pari, kontrolli i shtetit serb nuk duhej të rivendosej në Kosovë, madje as në formën e një autonomie të gjerë. Qeverisja e keqe nga Beogradi konsiderohej si rrënja e të gjitha problemeve. Ajo dëshmoi se ishte joefektive brenda Jugosllavisë, veçanërisht në periudhën 1981-1991. Ajo tregoi një karakter çnjerëzor, madje racist, dhe në fund një personazh vrastar si Millosheviqi në vitet 1990. Politika serbe pas Millosheviqit, përkundër karakterit thelbësisht demokratik, shfaqti tendenca kaotike, korruptive dhe nacionaliste. Në mungesë të qeverisjes me të vërtetë të mirë në Serbi, cila mund të jepte shpresa se Beogradi nuk do të bënte sërish gafa ndaj shumicës shqiptare të Kosovës? Për më tepër, nën dritën e të gjitha vrasjeve masive dhe përdhunimeve ndaj popullatës shqiptare në pranverën e vitit 1999, ky skenar ishte tërësisht i padiskutueshëm për shqiptarët e Kosovës, si dhe për Uashingtonin.

Së dyti, Kosova nuk duhej të ndahej përgjatë lumit Ibër. Sado që dukej tunduese që nyja gordiane e Kosovës të shthurej me një ndarje etnike vendimtare duke ia dhuruar Serbisë katër komunat me shumicë serbe, shumica e politikanëve dhe diplomatëve perëndimorë panë një rrezik të madh të pashmangshëm në këtë plan. Ai do të kishte inkurajuar më tej tendencat separatiste në rajon dhe më gjerë. Politikanët perëndimorë donin të stabilizonin rajonin dhe të shkëputeshin ngadalë. Përkundër sfondit të luftërave të reja në Irak dhe Afganistan, ata shpresuan të parandalojnë thirrje të mëtejshme për shpërbërje etnike

dhe të shmangin përfshirjen nga angazhimet e pafund ushtarake dhe politike në Ballkan.

Së treti, Kosova nuk duhej të bashkohej me Shqipërinë. Miratimi i unifikimit të shqiptarëve do të kishte sjellë tri pasoja të mëdha negative. Imazhi i forcave perëndimore për neutralitetin do të kishte marrë një goditje të madhe, duke hapur kështu hapësirë për ofensivat diplomatike ruse dhe serbe. Bashkimi shqiptar do të përbënte një kërcënim të madh për Kornizën e Dejtonit<sup>4</sup> në Bosnjë-Hercegovinë, pasi që do të ishte edhe më e vështirë të argumentohej kundër shkëputjes së Republikës Serbe të Bosnjës dhe bashkimit të saj eventual me Serbinë. Së fundmi, bashkimi i Kosovës dhe Shqipërisë do të hapte çështjen e kufijve etnik në të gjitha shtetet fqinje: Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, madje edhe Greqi në lidhje me “shqiptarët çamë”.

#### *Mjedisi ndërkombëtar në të cilin po mendohej pavarësia e Kosovës*

Justifikimi i pavarësisë së Kosovës sipas ligjit ndërkombëtar ishte një detyrë mjaft sfiduese. Siç shprehet një studiues amerikan i drejtësisë: Kosova paraqet një “rast të rëndë” kuintencial, duke demonstruar mënyrat me të cilat interesat politike të shteteve ndikojnë në mënyrën si i jepet fuqi të drejtës ndërkombëtare<sup>5</sup>. E drejta ndërkombëtare zakonore nuk kishte qenë veçanërisht mbështetëse për rastet e secesionit, dhe as praktika ndërkombëtare nuk ishte e qartë. Edhe paraqitja e Kosovës si një çështje legjitime politike për pavarësi ishte një mision më i diskutueshëm në vitet 2006-2008 sesa do të kishte qenë në vitin 1999 ose 2000, në vijim të brutalitetit marramendës të ushtrisë, policisë dhe grupeve paramilitare serbe, të cilat sapo ishin dëshmuar nga gjysma e botës.

<sup>4</sup> Nënshkruar në 1995, Marrëveshja e Paqes në Dejton ndaloi luftën në Bosnjë (1992-1995) me një strukturë kushtetuese të ndërlikuar dhe delikate. Serbët secesionistë të Bosnjës pranuan të mbeteshin brenda kufijve të Bosnjës dhe Hercegovinës, por në këmbim arritën një autonomi të gjerë në entitetin e quajtur Republika Serbe e Bosnjës (Republika Srpska). Kroatët boshnjakë gjithashtu pranuan bashkëjetesën me myslimanët boshnjakë brenda entitetit të Federatës. Megjithatë, që nga viti 1995, të tri palët kanë bërë përpjekje për të provuar kufijtë e Marrëveshjeve të Dejtonit dhe t’i përdorin në avantazhin e tyre politik. Kishte retorikë të ashpër kundër vetë ekzistencës së shtetit boshnjak nga kryeministri serb i Bosnjës Milorad Dodik që në 2006.

<sup>5</sup> Borgen, Christopher J. ‘Deklarata e Pavarësisë e Kosovës: Vetëvendosje, secesion dhe njohje.’ Shoqëria Amerikane e së Drejtës Ndërkombëtare 12, Numri (2008): <https://www.asil.org/insights/volume/12/issue/2/Kosovas-declaration-independence-self-determination-secession-and> (shkarkuar: 10 mars, 2018).

Së pari, hakmarrja e shqiptarëve të Kosovës ndaj serbëve etnikë në Kosovë në verën e vitit 1999 ishte tashmë një goditje e rëndë për “imazhin humanist” që Ibrahim Rugova kishte ndërtuar me sukses në vitet 1990, por prapëseprapë u përball me një farë tolerance ndërkombëtare. Së dyti, veprimtaria e armatosur e disa grupeve të ndara nga Ushtria Çlirimtare të Kosovës (UÇK) brenda dhe jashtë (Maqedoni, Serbi Jugore) Kosovës gjatë viteve 2000-2004 shkaktoi acarim ndërkombëtar në rritje dhe u bë burim i përmendjes së “terrorizmin shqiptar”.<sup>6</sup> Së treti, pogromet dhe shkatërrimet e kishave të marsit 2004 përsëri nxorën në pah intolerancën agresive të disa qarqeve shqiptare të Kosovës, dhe justifikimi ishte edhe më i vështirë. Shqetësimi më i madh u shfaq, megjithatë, rreth qëndrueshmërisë së një shteti të ri të pavarur të Kosovës, veçanërisht nëse do të kapet nga një elitë e korruptuar politike e lidhur me krimin e organizuar. Sipas mendimit tim, kjo përbente problemin kryesor të legjitimitetit për kauzën e pavarësisë, përveç shqetësimeve për shkeljen e parimeve ligjore ndërkombëtare.

Ndërkohë që drama e shpërbërjes së Jugosllavisë po shpalosej mes rrebesheve të gjaku në 1991, Këshilli i Komuniteteve Ekonomike Evropiane formoi një komision të studiuesve të drejtësisë me detyrën për të dhënë përgjigje për dilemat e reja juridike ndërkombëtare. Ibrahim Rugova, Presidenti i zgjedhur i Kosovës, i dërgoi një letër Komisionit Badinter<sup>7</sup> në të cilën ai kërkoi njohjen e së drejtës së Kosovës për t’u shkëputur. Sidoqoftë, Komisioni nuk publikoi kurrë ndonjë opinion për këtë çështje, ndryshe nga rasti i Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë, Kroacisë ose Sllovenisë. Heshtja e Komisionit për Kosovën u interpretua gjerësisht si një reagim negativ.

Përmbajtja e “të drejtës së vetëvendosjes” dhe mënyra se si duhet të ushtrohet ka qenë një dilemë veçanërisht e diskutueshme që nga Lufta e Parë Botërore, kur Presidenti i SHBA Wilson<sup>8</sup> e renditi vetëvendosjen

<sup>6</sup> Steiner, Michael. ‘Ushtria Kombëtare Shqiptare është Organizatë Terroriste’. Burimet: [Balkanblog.org/2010/01/30/steiner-albanian-national-army-is-a-terrorist-organization-2/](http://Balkanblog.org/2010/01/30/steiner-albanian-national-army-is-a-terrorist-organization-2/) (shkarkuar: 10 mars, 2018); World Briefing/Europe/Kosova: Grupi rebel i etiketuar për terrorizëm, 18 prill 2003 [www.nytimes.com/2003/04/18/world/world-briefing-europe-Kosova-rebel-group-labeled-terrorist.html](http://www.nytimes.com/2003/04/18/world/world-briefing-europe-Kosova-rebel-group-labeled-terrorist.html) (shkarkuar: 10 mars, 2018).

<sup>7</sup> Komuniteti Evropian themeloi Komisionin e Arbitrazhit Badinter në gusht 1991, për të dhënë opinion juridik për vendimmarrësit politikë të KE-së për një sërë çështjesh që lindën nga shpërbërja e Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë. Komisioni i drejtuar nga Robert Badinter, kreu i Gjykatës Kushtetuese Franceze, dha 15 opinione juridike në periudhën 1991-1993.

<sup>8</sup> Woodrow Wilson (1856-1924): Burrë shteti dhe akademik amerikan, Presidenti i 28-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (1913-1921).

si një objektiv të rëndësishëm politik pas luftës në Katërmbëdhjetë Pikat e tij, dhe për pasojë Austro-Hungaria u shpërbë në shtete më të vogla kombëtare. Pas Luftës së Dytë Botërore, parimi i vetëvendosjes u përqendrua në popujt e nënshtruar ndaj sundimit kolonial. E drejta për vetëvendosje u përcaktua nga Kombet e Bashkuara si e drejtë e një populli që ta konstitujë veten në një shtet ose ta përcaktojë ndryshe lirisht formën e asociimit të tij me një shtet ekzistues. Pas procesit të dekolonizimit dhe formimit të “shteteve kombëtare” dhe më shpesh vendeve shumëgjuhëshe dhe shumë-etnike në “Botën e Tretë”, bashkësia ndërkombëtare u përball me rrezikun e paqëndrueshmërisë dhe copëzimit të këtyre subjekteve të reja ndërkombëtare. Lufta në Biafra (Nigeri),<sup>9</sup> pavarësia e Bangladeshit (Pakistani Lindor),<sup>10</sup> dhe konflikti i Qipros në vitet 1960 dhe 1970 ishte vetëm disa shembuj të potencialit shkatërrues të parimit të vetëvendosjes dhe interpretimit të tij. Përgjigja e bashkësisë ndërkombëtare ishte më shumë e natyrës pasive: fushëveprimi i së drejtës së vetëvendosjes dhe parakushtet e ushtrimit të kësaj të drejte nuk ishin përcaktuar kurrë qartë. Kjo rriti pasigurinë, por në të njëjtën kohë lejoi më shumë hapësirë manovrimi për fuqitë e mëdha në çështjet konkrete (Eritrea në 1993, Timori Lindor në 2002 dhe Sudani i Jugut në 2011).<sup>11</sup>

Skena më e gjerë evropiane në epokën e pas Luftës së Ftohtë ishte gjithashtu e ndotur me konflikte të ngrira<sup>12</sup> si në Nagorni-Karabak,

<sup>9</sup> Lufta e Biafrës (Lufta Civile e Nigerisë) shpërtheu në 1967 pasi udhëheqja politike e popullit Igbo kishte shpallur pavarësinë e Republikës së Biafrës. Konflikti i armatosur mes qeverisë qendrore Nigeriane dhe shtetit secesionist u zvarrit për gati tre vjet në vitet 1967-1970. Humbjet ushtarake kapën shifrën e 100,000 personave, ndërsa 0,5-2 milionë civilë vdiqën nga uria. Shikoni një kronikë të hollësishme në: Baxter, Peter. *Lufta Civile e Nigerisë 1967-1970*. Solihull: Helion & Company Limited, 2014.

<sup>10</sup> Nacionalistët bengalë, me mbështetjen e Indisë, krijuan shtetin e Bangladeshit në 1971 nga ish provinca e Pakistanit Lindor. Myslimanët që flisnin urdu dhe ushtria pakistaneze kryen vrasje masive dhe përdhunime të bengalëve që luftonin për vetëvendosje dhe pavarësi. Lufta Çlirimtare e Bangladeshit përfundoi në dhjetor 1971 me ndihmën e Indisë, e cila ndërhyri ushtarakisht në konflikt. Bibliografia: Sisson, Richard dhe Rose, Leo E. *Lufta dhe Secesioni, Pakistani, India dhe Krijimi i Bangladeshit*. Berkeley et al., California University Press, 1990.

<sup>11</sup> Për një përshkrim si ndikoi në çështjen e Kosovës mungesa e përkufizimeve ligjore, shihni në hungarisht: Valki, Laszlo. ‘Valaszolhatott volna maskent Haga? A Nemzetkozi Biroslag tanacsado velemenye Koszovo fuggetlensegerol.’ *Kulugyi Szemle* 42, no. 4 (2010): 46-62, 55-59.

<sup>12</sup> Në marrëdhëniet ndërkombëtare, një “konflikt i ngrirë” është një situatë në të cilën konflikti aktiv i armatosur është përfunduar, por asnjë traktat paqeje ose kornizë tjetër politike nuk e zgjidh në formë të kënaqshme konfliktin për

Abkazi, Osetinë e Jugut dhe Transdnistria. Disa ishin të trashëguar nga periudha e Luftës së Ftohtë, siç ishte ekzistenca de facto e Qipros së Veriut, e njohur vetëm nga Turqia që në të vërtetë e pushtoi ushtarakisht gjysmën e ishullit. Së fundmi, madje edhe vendet e zhvilluara të Evropës Perëndimore anëtare të Bashkimit Evropian u përballën me lëvizjet secesioniste në Kataloni, territorin Bask, Flandër, Skoci dhe Irlandë të Veriut. Konflikti nacionalisto-fetar-sektar i Irlandës së Veriut i kishte angazhuar ushtrinë, zbatimin e ligjit dhe politikën britanike për dekada deri në Marrëveshjen e së Premtes së Mirë në 1999.

Një dilemë legjitime për vendimmarrësit e politikës së jashtme kishte të bënte me shkallën në të cilën pavarësia e Kosovës do të ndikonte në konfliktet e tjera të ngrira etnike. Akti Final i Helsinkit i vitit 1975 nënvizoi parimin e integritetit territorial të shteteve, paprekshmërinë e “kufijve të të gjitha shteteve në Evropë”, dhe përcaktoi qartë se e drejta e vetëvendosjes duhej të ushtrohej “në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe me normat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë ato që lidhen me integritetin territorial të shteteve”.<sup>13</sup> Nëse ky parim injorohet një herë, si mund të ndalohej efekti domino?

Rusia, një aleat tradicional i Serbisë, ishte e qëndrimit se të njëjtat parime duhet të zbatohen për të gjitha konfliktet ndërkombëtare. Në një takim të Grupit të Kontaktit në Nju Jork më 20 shtator 2006, ministri i jashtëm rus Sergei Lavrov deklaroi se çështja e Kosovës do të shërbente si një precedent për Ballkanin dhe Evropën në tërësi. Në përgjithësi, politikanët dhe akademikët rusë kanë pohuar me forcë se dhënia e pavarësisë dhe njohja e Kosovës do të jepte një shembull për konflikte të ngjashme në hapësirën post-sovjetike, siç janë Abkazia, Osetia e Jugut, Transnistria dhe Nagorno- Karabaku.<sup>14</sup>

Siç kanë treguar ngjarjet pasuese, kjo shërbeu si shembull, por vetëm kur Moska dëshironte ta bënte këtë. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe sulmit gjeorgjian ndaj Osetisë së Jugut separatiste,

---

luftëtarët. Prandaj, ligjërisht konflikti mund të fillojë përsëri në çdo moment, duke krijuar një mjedis të pasigurisë dhe paqëndrueshmërisë. Mund të shtohet se pas mungesës së zgjidhjes ligjore, zakonisht ekziston një ngërç politik dhe ushtarak; palët kundërshtarë nuk kanë forcë dhe as interes për ta ndryshuar status quo-në.

<sup>13</sup> Konferenca për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, AKTI FINAL Helsinki 1975 Parimi VIII, <https://www.osce.org/helsinki-final-act?download=true> (shkarkuar: 20 gusht, 2018).

<sup>14</sup> Lauka, Islam. Kosova, një çështje Universale apo Sui Generis? Tiranë: Kristalina-KH, 2007. 24.

Rusia e mbrojtji ushtarakisht dhe njohu Osetinë e Jugut dhe Abkazinë si shtete të pavarura. Sidoqoftë, e njëjta nuk vlente për Transnistriinë ose Nagorno-Karabakun, edhe pse në rastin e fundit sulmet azerbajxhane në vitin 2016 do të kishin siguruar një mundësi në parim. Sidoqoftë, Moska zbatoi precedentin e Kosovës në vitin 2014 për okupimin dhe aneksimin e Gadishullit të Krimesë, pasi që i përshtatej në mënyrë të përsosur Ruisë për të kundërshtuar argumentet përëndimore.

Pozicioni serb prirëj të ndiqte argumentin e dhënë nga Moska. Presidenti serb Boris Tadiq pohoi se dhënia e pavarësisë së Kosovës do të inkurajonte lëvizjet terroriste dhe do të çonte në pretendime destabilizuese midis grupeve nacionaliste në vendet e tjera të rajonit si Maqedonia dhe Bosnja dhe Hercegovina<sup>15</sup> Ky pozicion përmbante edhe një element të së vërtetës. Kryeministri serb i Bosnjës Milorad Dodik deklaroi disa herë që, nëse Kosova shpallte pavarësinë, ai do të kërkonte pavarësi për Republikën Serbe të Bosnjës, e cila ishte njohur si pjesë e Bosnjës dhe Hercegovinës me Marrëveshjen e Paqes të Dejtonit të vitit 1995. Megjithatë, Maqedonia ishte më e qetë për Kosovën dhe ishte e gatshme ta njohë pavarësinë e fqinjit “të porsalindur” në tetor 2008, së bashku me Malin e Zi. Politikanët kryesorë shqiptarë në Maqedoni nuk pranuan të kërkojnë të drejtën e shkëputjes. Më e shumta që kërkonin ishte zbatimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit<sup>16</sup> dhe njohja e shqipes si gjuhë zyrtare, çka u materializua përfundimisht në mars 2018.

Kina, India, Brazili, madje edhe disa shtete anëtare të BE-së, si Spanja, Rumania, Sllovakia, Greqia dhe Qiproja, kishin rezerva në lidhje me idenë e pavarësisë së Kosovës. Qipriotët grekë kishin frikë se pavarësia e Kosovës mund të shihej si një precedent për Qipron turke të Veriut. Spanja kishte arsye të fortë për të qenë e shqetësuar me separatistët në Kataloni, si dhe në rajonin bask. Sa për të ilustruar situatën, policia spanjolle arrestoi 23 drejtues të Lëvizjes së ndaluar Batasuna<sup>17</sup> pas një takimi sekret të paligjshëm në qytetin Segura në rajonin bask në tetor.

Arrestimet e mëtutjeshme pasuan në shkurt 2008 dhe si pasojë, shpërthyen përleshje në rrugë mes radikalëve politikë dhe njësisive të

<sup>15</sup> Po aty, 26

<sup>16</sup> Marrëveshja Kornizë e Ohrit përmbylli konfliktin e armatosur të vitit 2001 mes maqedonasve sllavë dhe shqiptarëve etnikë në IRJ të Maqedonisë.

<sup>17</sup> Lëvizja Batasuna ishte një parti politike nacionaliste baske që u ndalua në vitin 2003 pas një vendimi të gjykatës se kishte lidhje financiare dhe politike me organizatën terroriste ETA.

zbatimit të ligjit në ditët e para të shkurtit 2008, pak para shpalljes së pavarësisë së Kosovës.<sup>18</sup>

Rumania ishte në ankth për çështjen e Kosovës për një larmi arsyesh. Mendohej se pavarësia e Kosovës do të inkurajonte separatistët pro-rusë në rajonin e Transdnistrisë së Moldavisë fqinje, ku Bukureshti mbështeste qeverinë qendrore në Kishinev. Rumania tashmë po ushqente ëndrrat për bashkimin me Moldavinë, shumica e popullsisë së të cilës është me identitetet etnik rumun. Disa pretendojnë se për këtë arsye pavarësia e Kosovës ishte gati të jepte një mesazh që Rumanisë nuk i pëlqente aspak në këndvështrimin historik: një komb mund të jetojë në dy shtete. Sidoqoftë, problemi kryesor ishte pakica e madhe etnike hungareze e Rumanisë. Hungarezët etnikë në Rumani nuk kishin as vullnetin dhe as mundësi të shkëputeshin, pasi territoret e tyre etnikisht homogjene janë në pjesën lindore të Transilvanisë, qindra kilometra nga kufiri me Hungarinë. Pavarësisht kësaj, Bukureshti ishte i shqetësuar se çështja e pavarësisë së Kosovës do të inkurajonte kërkesat për autonomi territoriale të hungarezëve në rajonet Muresh (hungarisht Maros), Harghita (hungarisht Hargita) dhe Covasna (hungarisht Kovaszna), ku jeton shumica e pakicës hungareze në Transilvani.<sup>19</sup>

Në pamje të parë, Sllovakia duhej të shqetësohej edhe më shumë. Hungarezët etnikë jetojnë kryesisht përgjatë kufirit jugor në afërsi të menjëhershme me vetë Hungarinë. Sidoqoftë, politikanët sllovakë e dinin mirë se nuk duhej ta lidhnin publikisht çështjen e Kosovës me atë të hungarezëve etnikë në Sllovaki. Zëvendëskryeministri Dusan Caplovic kishte një reputacion se nuk përmbahej të bënte deklarata të guximshme, të cilat i bënte në një farë mase në kurriz të Hungarisë dhe hungarezëve. Por kur erdhi pavarësia e Kosovës në vitin 2008, ai thjesht tha se duke shpallur pavarësinë pa pëlqimin serb, Kosova theu ligjin ndërkombëtar dhe krijoi një precedent. Kur donte të tregonte se gjuha e helmuar nuk ishte e huaj për të, Caplovic shkoi më tej dhe haptas iu referua Kosovës si një pikë e nxehtë e krimit të organizuar, “një rrugë për drogë, trafikim të qenieve njerëzore dhe armëve për t’u hedhur në Evropë.”<sup>20</sup>

<sup>18</sup> Burnett, Victoria. ‘Udhëheqësit baskë u arrestuan në Spanjë.’ New York Times, 6 tetor, 2007; ‘Radikálisok tiltakozása Baszkföldön’, Magyar Nemzet, 13 shkurt, 2008.

<sup>19</sup> ‘Kosovë: Pavarësia rezonon me hungarezët e Evropës Lindore’. Stratfor, 18 shkurt, 2008. Burimi: <https://worldview.stratfor.com/article/Kosova-independence-resonates-eastern-europes-hungarians> (shkarkuar: 14 mars, 2018).

<sup>20</sup> ‘Sllovakët të ndarë në lidhje me Kosovën’. Spektatori Sllovak, 25 shkurt 2008. Burimi: <https://spectator.sme.sk/c/20028428/slovaks-divided-on-Kosova.html> (shkarkuar: 16 mars, 2018).

Koncepti mbizotërues përëndimor për pavarësinë e Kosovës ishte se kjo përbënte një “rast unik”. Siç u shpreh një studim i Qendrës Evropiane të Politikave: “Arsyetimet e atyre që kanë mbështetur pavarësinë e Kosovës rrjedhin nga të kuptuarit e situatës së saj unike që rrjedh nga persekutimi i fundit të viteve 1980 dhe 1990”.<sup>21</sup> Në njoftimin e njohjes së Kosovës nga Shtetet e Bashkuara, Sekretarja e Shtetit Condoleezza Rice dha një shpjegim më të hollësishëm:

“Kombinimi i pazakontë i faktorëve që gjenden në situatën e Kosovës - përfshirë kontekstin e shpërbërjes së Jugosllavisë, historinë e spastrimit etnik dhe krimet kundër civilëve në Kosovë, dhe periudhën e zgjatur të administrimit të OKB-së - nuk gjenden askund tjetër, dhe prandaj e bëjnë Kosovën një rast të veçantë. Kosova nuk mund të shihet si një precedent për çdo situatë tjetër në botë sot.”<sup>22</sup>

Sekretari i Jashtëm i Mbretërisë së Bashkuar David Miliband i tha BBC Radio në shkurt 2008: “Ajo që e bën unike është se për nëntë vjet ka pasur një protektorat të OKB-së brenda vendit të pavarur të Serbisë. ... Unë mendoj se nuk është një që mund të barazohet me çështjen e baske ose disa nga çështjet e tjera që janë ngritur”.<sup>23</sup> Edhe kryeministri kanadez Stephen Harper e kundërshtoi çdo krahasim të Kebekut me Kosovën kur u arrit në pikën që qeveria e tij po njihte deklaratën e njëanshme të pavarësisë, duke thënë: “Situata në Kosovë është shumë unike.”<sup>24</sup>

Pozicioni i Shqipërisë natyrisht i përkiste këtij grupi të fundit. Në një intervistë në vitin 2006, Presidenti shqiptar Alfred Moisiu e karakterizoi si “të padrejtë dhe të pasaktë” që të thuhej se “Pavarësia e Kosovës mund të hapë derën e aplikimit të zgjidhjeve analoge për çështjet që ekzistojnë sot në vende dhe rajone të ndryshme.”<sup>25</sup>

### *Politika hungareze ndaj Kosovës deri në njohje*

Hungaria pësoi një traumë vërtet tronditëse pas Luftës së Parë Botërore, kur si pasojë e traktatit të paqes të nënshkruar në pallatin e

<sup>21</sup> Balfour, Rosa. ‘Ballkani në Evropë: kontroll apo transformim? Dymbëdhjetë ide për veprim.’ Dokument Pune i EPC-së nr. 31, qershor (2008). 22.

<sup>22</sup> [www.europarl.europa.eu/meetdocs/2004\\_2009/.../dv/.../dsee\\_200-80505\\_09\\_en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/meetdocs/2004_2009/.../dv/.../dsee_200-80505_09_en.pdf) (shkarkuar: 8 maj, 2008).

<sup>23</sup> ‘Rasti kosovar unik, thotë Miliband’, BBC News, 19 shkurt 2008. Burimi: [news.bbc.co.uk/2/hi/uk\\_news/politics/7252212.stm](http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk_news/politics/7252212.stm) (shkarkuar: 27 shkurt 2018).

<sup>24</sup> ‘Harper kundërshton krahasimin e Kosovës me Kebekun’, CTV News, 19 mars 2008. Burimi: <https://www.ctvnews.ca/harper-rejects-Kosova-quebec-comparison-1.283771> (shkarkuar: 27 shkurt 2018).

<sup>25</sup> Lauka, Kosova një çështje Universale ose Sui Generis, 31.

Trianon në Versajë, ajo humbi dy të tretat e territorit dhe popullsisë së saj të mëparshme, përfshirë miliona hungarezë etnikë. Në atë kohë, shumë hungarezë e perceptuan si një zbatim tallës të parimit të vetëvendosjes. Për ta dukej se kombeve që gëzonin mbështetjen e fuqive të mëdha fitimtare u jepej një mundësi historike për ta ushtruar të drejtën, ndërsa hungarezëve dhe të tjerëve (p.sh. gjermanëve dhe ruthenëve etnikë) u ofrohej vetëvendosje vetëm në një shkallë të kufizuar, ose aspak. Ndarja e pjesëve të mëdha të Hungarisë solli të njëjtat pyetje, siç bëri shpërndarja e Jugosllavisë 70-80 vjet më vonë. Nëse popullsia etnike serbe dhe ajo rumune e Vojvodinës dhe Transilvanisë kishin të drejtën e vetëvendosjes, a nuk kishin hungarezët etnikë të njëjtën të drejtë, ku ata përbënin një shumicë absolute në pjesë të caktuara të këtyre rajoneve? Me një përjashtim të vogël (referendumi për statusin e Sopron) përgjigja ishte negative. Kjo bëri që hungarezët gjatë gjithë shekullit t'i simpatizojnë në përgjithësi ata që ishin privuar nga e drejta e tyre reale ose e perceptuar e vetëvendosjes.

Shqiptarët e Kosovës përshtateshin shumë mirë me këtë kategori. Për më tepër, ata ndanin fatin e hungarezëve etnikë në ish Jugosllavi si qytetarë të rangut të dytë pas shumicës sllave. Këto dy grupe etnike nuk kishin asnjë republikë të tyre dhe gjuhësisht ishin të dy të ndara nga bashkëqytetarët e tyre të gjuhëve sllave. Kjo krijoi një lloj solidariteti midis anëtarëve të dy bashkësive etnike, veçanërisht kur të rinjtë shërbyen së bashku në ushtri. Megjithëse hungarezët e Vojvodinës ishin më të asimiluar dhe nuk kishin plane për ndarje, perspektiva e pavarësisë së Kosovës krijoi një simpati spontane mes tyre dhe midis hungarezëve në vetë Hungari.

Hungaria filloi një veprimtari diplomatike më energjike në Ballkan, pasi ajo kishte fituar anëtarësimin në Bashkimin Evropian në maj 2004. Tradicionalisht, Ambasada e Hungarisë në Tiranë kishte mbuluar ngjarjet në Kosovë për shkak të aftësive në gjuhën shqipe të diplomatëve që shërbenin atje. Kështu, deri diku ishte logjike që ambasadori hungarez në Tiranë mori udhëzime nga Budapesti diku në 2004 për të vendosur kontakte personale me udhëheqjen shqiptare të Kosovës. Ai vazhdoi ta bëjë këtë në periudhën vijuese duke kryer vizita çdo dy muaj në ish provincën serbe të udhëhequr nga UNMIK. Ai madje pati takime me Ramush Haradinaj, Kryeministrin e atëhershëm të Kosovës, gjatë një periudhe të shkurtër midis dhjetorit 2004 dhe marsit 2005. Ky hap nënkupton një pragmatizëm të madh, sepse ishte ambasadori hungarez në Beograd ai që u akreditua zyrtarisht në territorin e Kosovës. Por atij do t'i ishte dhënë një pritje më e ftohtë nga

politikanët shqiptarë të Kosovës. Sidoqoftë, ky ishte supozimi i bërë në Budapest, dhe ma gjasë mjaft korrekt.

Më 12 prill 2005, ministri i jashtëm hungarez Ferenc Somogyi u nis për një vizitë në një vend që ekzistonte vetëm prej disa vitesh dhe që e quante veten Bashkimi Shtetëror i Serbisë dhe Malit të Zi. Ai e filloi turneun e tij në Beograd, vazhdoi në Podgoricë dhe përfundoi në Prishtinë. Protokollu ishte një gjest i qartë për Qeverinë e Serbisë; Somogyi u takua jo vetëm me Ministrin e Jashtëm Vuk Draskoviç, por edhe me Kryeministrin Vojislav Kostunica. Në Prishtinë, ai u prit nga Kryeministri i sapo zgjedhur Bajram Kosumi si dhe nga Presidenti tashmë i sëmurë Rugova. Një ish diplomat që shërbente në Tiranë në atë kohë kujtoi më vonë se Somogyi kishte zhvilluar konsultime me Oliver Ivanoviç, një politikan serb me ndikim nga Mitrovica e Veriut, i cili u bë viktimë e atentatit në janar të vitit 2018. Në atë kohë, pushteti i vërtetë qëndronte me kreun e UNMIK-ut Soren Jessen-Petersen, me të cilin ministri hungarez i Punëve të Jashtme u takua zyrtarisht. Një takim i mëtejshëm ishte me Komandantin e KFOR-it gjeneralin francez Yves de Kermabon (COMKFOR),<sup>26</sup> pasi kishte një kontigjent hungarez që shërbente me paqeruajtësit. Kermabon më vonë u bë Shefi i parë i Misionit EULEX<sup>27</sup> pas shpalljes së pavarësisë.<sup>28</sup>

Vizita pati dy pasoja. Së pari, dy javë më vonë, në takimin e Ministrave të Jashtëm të BE-së, Hungaria ofroi Budapestin si vend të bisedimeve për statusin e Kosovës që do të fillonin për nëntë muaj.<sup>29</sup> Sugjerimi nuk u pranua; në vend të tij u zgjodh Vjena.

Së dyti, më 1 nëntor 2005, Ministria e Punëve të Jashtme e Hungarisë<sup>30</sup> hapi një Zyrë diplomatike Ndërlidhëse në Prishtinë dhe transferoi ekspertin e vjetër të Ballkanit, Zoltan Imecs, nga ambasada hungareze në Tiranë për të drejtuar zyrën e re dhe për të krijuar marrëdhënie me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë. Sidoqoftë, është

<sup>26</sup> COMKFOR: Komandanti i KFOR-it, aktualisht një gjeneral me dy yje i cili e merr këtë pozitë për një vit.

<sup>27</sup> EULEX Bashkimi Evropian nisi një Mision për Sundimin e Ligjit në Kosovë në vitin 2008 në mes të procesit të pavarësisë, me qëllim të përmirësimit të funksionimit të gjyqësorit në shtetin e porsalindur.

<sup>28</sup> Magyar Külpolitikai övkönyv 2005, redaktuar nga Endréné Torda, 45-46. Budapest: Magyar Külügyminisztérium, 2005. Intervistë me diplomatun hungarez në pension Zoltán Imecs, i cili shërbeu si shef i Zyrës Ndërlidhëse Diplomatiqe në Prishtinë në 2005-2008 dhe si ambasadori i parë hungarez në Kosovë në 2008-2010. (Intervistë e realizuar nga autori në Budapest, Hungari, më 25 shkurt 2018.)

<sup>29</sup> Magyar Külpolitikai Évkönyv 2005, 50.

<sup>30</sup> MPJ: Ministria e Punëve të Jashtme e Hungarisë.

e rëndësishme të theksohet se dekreti i qeverisë që autorizoi Ministrin e Punëve të Jashtme për të hapur zyrën iu referua rreptësisht “Provincës së Kosovës të Bashkimit Shtetëror të Serbisë dhe Malit të Zi”.<sup>31</sup>

Siç kujtoi Imecs në një intervistë, edhe interesat ekonomike e nxitën vendimin për hapjen e Zyrës Ndërlidhëse. Sektori i telekomunikacionit në Kosovë ishte gati të privatizohej, dhe Telekom hungarez, i cili ishte vetë një degë e Deutsche Telekom, shfaqte interes të madh për të hyrë në treg. Disa vjet më vonë, ish ministri i punëve të jashtme, Somogyi, do ta vizitonte Kosovën si përfaqësues i Telekomit hungarez. Tregtia regjistroi një rritje të moderuar pas vitit 2005 dhe Linja Ajrore hungareze MALEV filloi të operojë një lidhje fluturimi shumë të popullarizuar midis dy kryeqyteteve.<sup>32</sup>

Udhëheqja shqiptare e Kosovës më në fund pati një bashkëbisedues hungarez për të biseduar. Një nga përpjekjet kryesore të disa politikanëve vendas, siç kujton Imecs, ishte të krijonin një paralele midis hungarezëve etnikë në Serbi dhe shqiptarëve të Kosovës me qëllim të sigurimit të mbështetjes shtesë për kauzën e Kosovës nga Budapesti. Kjo taktikë ishte vetëm mesatarisht e suksesshme, pasi Hungaria nuk po kërkonte telashe të reja me Serbinë. Kur bëhej fjalë për shtypjen e hungarezëve të Vojvodinës, qeveria në Budapest e përdori levën e saj në Bruksel dhe Strasburg me rezultate të mjaftueshme. Kontaktet bilaterale midis Hungarisë dhe autoriteteve të Kosovës nuk u bënë veçanërisht intensive në vitet në vazhdim, por të paktën u bënë disa vizita, përfshirë ato të udhëheqjes së Ministrisë së Mbrojtjes për të takuar kontingjentin hungarez të KFOR-it. Ushtria hungareze kishte një reputacion të mirë në KFOR dhe në mesin e popullatës lokale, kështu që Kosova ishte një destinacion i popullarizuar i politikanëve që kërkonin disa reagime pozitive.

Duhet të merret një vendim për statusin e Kosovës, i cili sjell normalizimin dhe stabilizimin jo vetëm në provincë, por në tërë rajonin e Ballkanit”- deklaroi Soren Jessen-Petersen, kreu i Misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK) në janar 19, 2006, pas bisedimeve të tij me ministrin e jashtëm hungarez në Budapest.<sup>33</sup> Hungaria ishte shumë e

---

<sup>31</sup> Magyar Külpolitikai Évkönyv 2005, 336.

<sup>32</sup> Intervistë me diplomatin hungarez në pension Zoltán Imecs. (Intervistë e realizuar nga autori në Budapest, Hungari, më 25 shkurt 2018.)

<sup>33</sup> Ferenc Somogyi negocioi me Søren Jessen-Petersen në Budapest në 20 janar 2006; ish-faqja në internet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Hungarisë [http://www.kulugyminiszterium.hu:80/kum/en/bal/actualities/visits\\_and\\_events/060120\\_somogyi\\_jessenpetersen.htm](http://www.kulugyminiszterium.hu:80/kum/en/bal/actualities/visits_and_events/060120_somogyi_jessenpetersen.htm) (shkarkuar: 12 shkurt 2018).

interesuar për stabilitetin e rajonit dhe ministri i jashtëm Somogyi shprehu mendimin e tij se për të arritur një stabilitet të tillë Kosova duhet të bëhet një entitet i pavarur si rezultat i bisedimeve për statusin. Hungaria paralajmëroi se Kosova nuk duhet të kthehet në shtet të dështuar dhe nuk duhet të bjerë viktimë e krimit të organizuar, veçanërisht në format e tij transnacionale, siç është trafikimi i drogës. Një ekonomi e qëndrueshme dhe një administratë e efektshme shtetërore kishin rëndësi tepër të madhe për këtë entitet të ri. Shqetësimi tjetër hungarez ishte e ardhmja e pakicave etnike në Kosovë.

E gjithë kjo u theksua në fjalimin që ministri i jashtëm Somogyi mbajti në Nju Jork në Asambleshën e Përgjithshme të OKB-së në shtator 2005:

“Pavarësisht nga statusi i saj i ardhshëm, është thelbësore që Kosova të shndërrohet në një entitet të realizueshëm, i aftë të ushtrojë kontroll të vendosur administrativ me një situatë të qëndrueshme të ligjit dhe rendit, dhe një ekonomi transparente, të besueshme. Duke pasur parasysh historinë e trazuar të Ballkanit, nuk mund të mendohet asnjë zgjidhje afatgjatë pa vendosur marrëdhënie harmonike ndëretnike. Të drejtat e pakicave të përcaktuara mirë dhe të zbatuara në mënyrë rigorozë janë parakushti kryesor për paqen, stabilitetin dhe prosperitetin, si në Kosovë ashtu edhe më gjerë në Ballkanin Perëndimor.”<sup>34</sup>

Në pranverën e vitit 2006, koalicioni socialist-liberal i fitoi sërish zgjedhjet parlamentare në Hungari. Ferenc Gyurcsany formoi një qeveri të re në të cilën ai emëroi disa gra politikane të reja si ministre, dhe një prej tyre ishte ministrja e jashtme Kinga Goncez. Ajo bëri një vizitë në Kosovë në fillim të gushtit dhe u takua me Presidentin Fatmir Sejdiu, Kryetarin e Kuvendit Kolë Berisha dhe Kryeministrin Agim Çeku, si dhe me Joachim Ruecker (Kreu i Administratës së OKB-së në Kosovë). Ministrja e jashtme Goncez theksoi rëndësinë e stabilitetit në rajon për Hungarinë si një pikënisje. Siguria e komunitetit serb në Kosovë dhe decentralizimi ishin gjithashtu çështje shqetësuese për të. Ajo gjithashtu zbuloi se Hungaria do të mbante një qasje të kujdesshme dhe se nuk do ta njihte pavarësinë e Kosovës në valën e parë.<sup>35</sup>

<sup>34</sup> ‘Fjalimi i SHTZ Ferenc Somogyi, ministër i punëve të jashtme të Republikës së Hungarisë në Sesionin e gjashtëdhjetë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara’, 22 shtator 2005 Burimi: <http://www.un.org/webcast/ga/60/statements/hun050922eng.pdf> (shkarkuar: 20 mars 2008).

<sup>35</sup> Intervistë në Prishtinë më 19 shkurt 2018 me ish Presidentin e Kosovës z. Fatmir Sejdiu, i cili qëndroi në detyrë në mandatin 2006–2010.

Ndërkohë që bisedimet për statusin iu afruan ngërçit, qeveria hungareze duhej të hartonte politikën e saj për pavarësinë e afërt të Kosovës. Vlerësimi i interesave hungareze dhe rekomandimet e nevojshme të politikës ishin prodhuar me ardhjen e vjeshtës, nën udhëheqjen e Drejtorit për Evropën Lindore dhe Juglindore në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Pikat më të rëndësishme ishin këto:

1. Stabiliteti i qëndrueshëm i Ballkanit Perëndimor ka rëndësi thelbësore për Hungarinë.
2. *Status quo*-ja aktuale në Kosovë nuk është e qëndrueshme për një kohë të gjatë.
3. Mund të rezultojë e mundshme të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme për Kosovën përmes një kombinimi të ofrimit të standardeve të larta për të drejtat e pakicave dhe perspektivës së integrimit evropian.
4. Çështja e Kosovës është një test i rëndësishëm për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë së BE-së.

Politikëbërësit e politikës së jashtme hungarezë e kuptuan deri në nëntor 2007 se Beogradi dhe Prishtina nuk do të mund të gjenin një marrëveshje të pranueshme reciprokisht për statusin, përkundër raundit të ri të mbështetur nga Grupi i Kontaktit. Për shkak të kundërshtimit të fortë nga Rusia dhe Kina, një rezolutë e re e Këshillit të Sigurimit të OKB-së që sanksiononte pavarësinë e Kosovës ishte gjithashtu e padiskutueshme. Sidoqoftë, ende kishte një shpresë të fortë në atë pikë në Budapest që BE-ja dhe vendet anëtare të NATO-s do të dilnin me një qasje të unifikuar politike, ashtu siç kishin bërë në rastin e pavarësisë së Malit të Zi në vitin 2006.<sup>36</sup>

Kjo shpresë dukej se erdhi gjatë bisedimeve të kryera midis kryeministrit hungarez Ferenc Gyurcsany dhe homologut të tij serb Vojislav Kostunica në Budapest në 13 nëntor 2007. Marrëdhëniet politike dhe ekonomike të dy vendeve fqinje ishin përmirësuar shumë dukshëm që nga rënia e Sllobodan Millosheviqit në 2000. Hungaria ishte investitori i gjashtë më i madh në Serbi në atë kohë dhe tregtia ishte gjashtëfishuar në këtë periudhë, me një eksport të dukshëm hungarez.<sup>37</sup> Prandaj, Hungaria rrezikonte shumë në një konflikt me

<sup>36</sup> Intervistë me znj. Marianne Berez, ish Drejtore për Evropën Lindore dhe Juglindore në MPJ të Hungarisë në periudhën 2007-2008. Intervistë e realizuar në Banja Luka, Bosnjë dhe Hercegovinë, 8 Mars 2018.

<sup>37</sup> Po aty.

Serbinë në lidhje me statusin e Kosovës. Nuk është për t'u habitur që Gyurcsany u përpoq të tregojë mirëkuptim për ankesat serbe, duke përshkruar traumën hungareze pas Luftës së Parë Botërore. Në të njëjtën kohë, ai u bëri të qartë kolegëve të tij se Hungaria do të ndiqte partnerët e saj perëndimorë. Ai theksoi bindjen e tij - që tani e dimë se ishte e gabuar - se në mungesë të një marrëveshje Beograd-Prishtinë, BE-ja do të dilte me një qëndrim unanim për pavarësinë e Kosovës.<sup>38</sup>

Për Hungarinë do të kishte qenë shumë më e preferueshme t'i bashkohej një politike të bazuar në konsensus të BE-së. Ministria e jashtme Kinga Góncz e shprehu publikisht shpresën e saj për një pozicion të unifikuar të BE-së, deri në mes të janarit 2008.<sup>39</sup> Sidoqoftë, kjo rezultoi të ishte thjesht dëshirë. Shtetet anëtare u përçanë qartazi për këtë çështje. Spanja, Greqia dhe Qipro, si dhe Sllovakia dhe Rumania (të cilat janë fqinjët e Hungarisë), nuk ishin të gatshëm ta mbështesin pavarësinë e Kosovës. "Pamundësia e një përfundimi të përbashkët të BE-së që jep mbështetje të qartë për pavarësinë e Kosovës, ishte bërë tashmë e qartë midis ekspertëve në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Hungarisë kur erdhën kërkshëndellat e vitit 2007", deklaroi Marianne Berez, e cila mbikëqyrte hartimin e raporteve dhe rekomandimeve të politikave në atë kohë. Hungaria duhej të vendoste cilit grup t'i bashkohej: atyre që e njohën apo atyre që nuk e njohën.<sup>40</sup>

Nuk kishte shumë dilema për çështjen kryesore politike: Hungaria ishte padyshim për njohje. Nevoja e vërtetë ishte për vlerësime profesionale në skenarë të ndryshëm dhe për kufizimin e dëmeve përballë Beogradit. Ekspertët e Ministrisë së Jashtme të Hungarisë e shihnin qartë se Kosova nuk ishte ende një shtet i realizueshëm, por gjithashtu e kuptuan që UNMIK-u nuk ishte në gjendje të kontribuonte më tej në zhvillimin e strukturave shtetërore.

<sup>38</sup> Po aty. Statistikat e tregtisë të disponueshme publikisht ndryshojnë pak në burime të ndryshme, por tendencat dhe proporcionet janë të njëjta, shiko: 'A külkereskedelmi termékfoglalom forintban, országok szerint (2001–). Zyra Hungareze e Statistikave (KSH). Burimi: [http://www.ksh.hu/docs/hun/xstadat/xstadat\\_eves/i\\_qkt009a.html?down=6372](http://www.ksh.hu/docs/hun/xstadat/xstadat_eves/i_qkt009a.html?down=6372) (shkarkuar: 24 mars 2018). Të dhëna nga këndvështrimi serb: Jeftic-Sarcevic, Nevenka. "Korrelacioni gjeopolitik midis Serbisë dhe Hungarisë - Rëndësia e lidhjeve midis rajoneve të Danubit Detit të Zi". *Mediterrán és Balkán Fórum* 6 (15), no. 1 (2012): 20–29, 27.

<sup>39</sup> Zalán, Eszter. 'Koszovó: lehet közös uniós álláspont, Góncz Kinga éwertékelő sajtótájékoztatója.' *Népszabadság*, 15 janar, 2008. 8.

<sup>40</sup> Intervistë me znj. Marianne Berez (Banja Luka, Bosnjë dhe Hercegovinë, 8 mars 2018).

“Ne menduam mbi baza profesionale se do të kishim ndikim më të efektshëm në procesin e shtetndërtimit, nëse Kosova bëhet një shtet i pavarur. *Status quo*-ja kërcënonte të kthehej në vrimës së zezë ku thjesht derdhen para dhe nuk shihen rezultate.”<sup>41</sup>

Sidoqoftë, qasja mbizotëruese në Budapest ishte e kujdesshme, sepse askush nuk ishte i gatshëm të rrezikonte marrëdhëniet e përmirësuara të Hungarisë me Beogradin, ose t'i shkaktonte dëme komunitetit të konsiderueshëm hungarez në Serbi. Kjo frikë nuk ishte e pabazë: pakicat etnike dhe veçanërisht hungarezët kishin vuajtur nga shtypje të vazhdueshme në të kaluarën, dhe autoritetet serbe shpesh kishin dështuar që ta parandalonin dhunën dhe përhapjen e mbishkrimeve kundër pakicave, veçanërisht në periudhën 2003-2005. Diplomacia hungareze ishte gjithashtu e shqetësuar për një migrim të mundshëm të serbëve nga Kosova në Vojvodinë, si pasojë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Analistët parashikuan se kjo do të ndryshonte ekuilibrin etnik dhe se të ardhurit do të provokonin incidente të reja që prekin hungarezët etnikë; diçka e ngjashme kishte ndodhur pas vitit 1995. Një frikë e madhe ishte fitorja e mundshme zgjedhore e Partisë Radikale Serbe, e cila pritej të ishte një partner shqetësues në një pozicion qeverisës.<sup>42</sup>

Njohja ishte një përfundim i ditur për qeverinë hungareze, por koha kur do bëhej kjo ende paraqiste një dilemë përgjatë janarit dhe shkurtit 2008. Ministrja e jashtme hungareze Kinga Gönz kishte prirje të qëndronte në pozicionin e saj të mëparshëm, të shprehur gjatë vizitës së saj në Kosovë në 2006, se Hungaria nuk do të ishte ndër vendet e para që do ta njihnin. Në fund të shkurtit 2008, në një konferencë për shtyp ajo tha: “Hungaria do të përpiqet të presë për momentin që do të rrezikojë më së paku hungarezët që jetojnë atje (në Serbi) dhe marrëdhëniet hungareze-serbe.”<sup>43</sup>

Kujdesi dukej se ishte shumë i justifikuar në ditët që pasuan shpalljen e pavarësisë në fund të shkurtit 2008. Sulmet e dhunshme ndaj

<sup>41</sup> Po aty.

<sup>42</sup> Po aty. Për incidentet e mëparshme, shihni rezolutën e Parlamentit Evropian mbi Vojvodinën B6 0534/2005: Napolitano, Pasqualina et al. “Mocioni për një Rezolutë të paraqitur për debatin mbi rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit.” 26 shtator 2005. Burimi: [http://www.europarl.europa.eu/RegData/seance\\_pleniere/textes\\_deposes/prop\\_resolution/2005/0534/P6\\_B\(2005\)0534\\_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/seance_pleniere/textes_deposes/prop_resolution/2005/0534/P6_B(2005)0534_EN.pdf) (shkarkuar: 25 mars 2018).

<sup>43</sup> Gönz, Kinga. ‘Ki kell várni Koszovó elismerését.’ HVG, 27 shkurt 2008). Burimi: [http://hvg.hu/itthon/20080227\\_koszovo\\_goncz\\_kinga](http://hvg.hu/itthon/20080227_koszovo_goncz_kinga) (shkarkuar: 11 shkurt 2018).

ambasadave të huaja në Beograd ishin tituj kryesorë në shtypin botëror. Publiku hungarez dhe qeveria monitoruan situatën në qytetet veriore të Serbisë ku jetojnë shumë hungarezë etnikë. Vitrinat e furrave shqiptare u thyen në Suboticë (hungarisht Szabadka) dhe në Temerin gjatë ditëve të para të zemërimit popullor. Grafitet shqetësuese u shfaqën duke paralajmëruar shqiptarët dhe hungarezët që ata të largoheshin nga vendi. Nacionalistët e indinjuar serbë marshuan madje edhe drejt konsullatës së përgjithshme hungareze në Suboticë. Ata nuk shkaktuan dëme, por atmosfera ishte e nderë.<sup>44</sup>

Edhe drejtuesit e hungarezëve të Vojvodinës kërkuan një qasje të ngadaltë dhe vigjilente nga Budapesti dhe, siç kujtoi znj. Berecz, fjala e tyre u mor në konsideratë. Ata vetë ishin mjaft të ndarë në lidhje me atë që duhet të bëhej dhe cilat do të ishin pasojat e njohjes. Disa politikanë lokalë hungarezë thanë se “Hungaria ka marrëdhënie më të forta me Serbinë sesa me Kosovën” dhe për këtë arsye interesat hungareze kërkonin një qasje të ngadaltë dhe të kujdesshme. Mendime të tjera fokusoheshin në autonomi. Bela Csorba, një nënkryetar i Partisë Demokratike të Hungarezëve të Vojvodinës (Vajdasagi Magyar Demokrata Part - VMDP), argumentoi se “koncepti i autonomisë së Planit të Ahtisarit, i cili u përpunua nën kujdesin e Bashkimit Evropian, duhet të sigurojë një precedent për hungarezët e Vojvodinës”.<sup>45</sup>

Në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Hungarisë shpresonin se kushtetuta e Kosovës do të siguronte një precedent të fortë ligjor për njohjen e të drejtave kolektive të pakicave. Kjo aspiratë shqetësoi Rumaninë dhe Sllovakinë, pasi që të dyja kanë pakica të konsiderueshme hungareze. Ndoshta kjo bëri që kryeministri sllovak Robert Fico të pretendonte në shkurt 2008 se shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës ishte një gabim që mund t'i përkeqësonte tensionet.<sup>46</sup> Për mosnjohjen e Kosovës kishte një konsensus të gjerë midis partive sllovaqe në Parlament, duke kaluar linjat partiake. Përjashtimi i vetëm ishte Partia e Koalicionit Hungarez që e mbështeste publikisht idenë e pavarësisë së Kosovës, dhe kjo e ktheu çështjen e Kosovës në një mosmarrëveshje përgjatë linjave etnike.<sup>47</sup>

Edhe presidenti rumun Traian Basesku në shkurt 2008 shpalli një politikë të mosnjohjes. Një nga arsyet që ai përmendi ishte se shteti i ri po

<sup>44</sup> Tanács, István. ‘Megérti-e Magyarország Szerbiát?’ Népszabadság, 1 mars, 2008. Hétféle melléklet 2–3.

<sup>45</sup> Po aty.

<sup>46</sup> ‘Sllovakët të ndarë në lidhje me Kosovën’. Spektatori Sllovak, 25 shkurt 2008.

<sup>47</sup> Po aty.

u jepte të drejta kolektive pakicave të veta etnike. Meqenëse Aleanca Demokratike e Hungarezëve (Romaniai Magyar Demokrata Szovetseg - RMDSZ) në Rumani e mbështeti hapur pavarësinë e Kosovës, disa parti politike rumune e sulmuan me forcë dhe bënë thirrje që hungarezët të largohen nga koalicioni qeverisës.<sup>48</sup> Edhe disa vjet më vonë, në 2013, presidenti rumun shprehu mendimin se Bukureshti nuk duhet ta njohë Kosovën, sepse kjo do të ndihmojë kauzën e “ekstremistëve hungarezë”.<sup>49</sup>

Synimi i qeverisë hungareze për ta njohur Kosovën nuk u përball me rezistencë nga opozita e krahut të djathtë. Zsolt Nemeth, kryetar i Komisionit për Punë të Jashtme dhe një anëtar i gardës së vjetër të FIDESZ, i cili kishte simpatizuar gjatë me kauzën e Kosovës, ishte shumë i bindur se Hungaria duhet të shkojë krah për krah me shumicën e shteteve anëtare të BE-së në mbështetjen e njohjes. Ai mendonte se diplomacia hungareze duhej të përfitonte nga rast i paprecedent i një autonomie territoriale të zbatuar për një pakicë kombëtare në historinë e diplomacisë ndërkombëtare.

### *Njohja dhe zbatimi i vendimit*

Për të zvogëluar nivelin e hakmarrjes së mundshme serbe, Hungaria vendosi të veprojë në bashkëpunim me Kroacinë dhe Bullgarinë. Zagrebi dhe Budapesti kishin mbajtur marrëdhënie mjaft të përzemërta që nga viti 1991 dhe ishte disi e natyrshme që ata bashkuan forcat në këtë përpjekje. Marrëdhëniet me Sofjen ishin përmirësuar pjesërisht sepse gruaja e kryeministrit hungarez ishte me origjinë bullgare. Tre fqinjët e Serbisë shpresuan që përpjekjet e tyre të përbashkëta do të zvogëlonin vendosmërinë serbe për t'u hakmarrë ashpër. Sidoqoftë, shqetësimet vazhduan deri në momentin e fundit; Budapesti madje u kërkoi të dy partnerëve të prisnin për njoftimin deri pas festës kombëtare hungareze më 15 mars, në mënyrë që t'u lejohej hungarezëve etnikë në Serbi të festonin në mënyrë paqësore.

---

<sup>48</sup> ‘Bukarestnek már Markó is radikális.’ Magyar Nemzet, 19 shkurt, 2008. 8. Në rumanisht, shiko: Basescu, Traian. ‘Romania nu va recunoaste independenta Kosova.’ HotNews, 18 shkurt, 2008. Burimi: <https://www.hotnews.ro/stiri-politic-2387838-traian-basescu-romania-nu-recunoaste-independenta-Kosova.htm> (shkarkuar: 27 mars 2018).

<sup>49</sup> “România nu trebuie să recunoască Kosova pentru că ar da apă la moară extremiștilor maghiari. Declarația INCENDIARĂ a unui deputat PSD.” Libertatea, 12 shkurt, 2013. Burimi: <https://www.libertatea.ro/stiri/stiri-interne/romania-nu-trebuie-sa-recunoasca-Kosova-pentru-ca-ar-da-apa-la-moara-extremistilor-maghiari-declaratia-incendiara-a-unui-deputat-psd-846979> (shkarkuar: 27 mars 2018).

Zyrtarisht, qeveria e mori vendimin për njohje më 19 mars 2008, gjatë një mbledhjeje të rregullt të së mërkurës. Në atë kohë, rreth 30 vende e kishin njohur tashmë Kosovën, përfshirë Shtetet e Bashkuara dhe vendet kryesore të BE-së, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania. Sekretari i Shtetit i Ministrisë së Punëve të Jashtme Marta Horvath Fekszij njoftoi vendimin e qeverisë hungareze duke argumentuar se “ishte bërë e qartë se *status quo*-ja në Kosovë ishte e paqëndrueshme. [...] Është bërë gjithashtu e qartë se nuk kishte asnjë zgjidhje optimale të pranueshme nga të dy palët, dhe potenciali për negociata të mëtutjeshme ishte ezauruar.” Meqenëse ishte e qartë se zgjidhja ishte absolutisht e nevojshme për hir të stabilitetit të qëndrueshëm dhe perspektivave ekonomike të Ballkanit, Hungaria arriti në përfundimin se “pavarësia e mbikëqyrur ndërkombëtarisht e Kosovës mund të ofrojë mënyrën më të mirë për dalje nga kriza”.<sup>50</sup> Ish drejtori për Evropën Juglindore në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Hungarisë, Berecz, e shprehu si vijon: “Në politikën ndërkombëtare ne zakonisht nuk marrim vendimet më ideale, por pranojmë ato më pak të këqija.”<sup>51</sup>

Hungaria e kishte shqetësim të theksonte se ndan pikëpamjet e shprehura nga shumica e vendeve anëtare të BE-së dhe NATO-s: “Kosova përbën një rast *sui generis* që nuk paraqet asnjë precedent për konflikte të tjera të pazgjidhura.”<sup>52</sup> Kjo ishte e rëndësishme për të qetësuar Rumaninë dhe Sllovakinë, megjithëse këto përpjekje nuk dhanë rezultate të mjaftueshme. Por të paktën Budapesti u përpoq.

Zbatimi i Planit të Ahtisarit,<sup>53</sup> domethënë demokracia, sundimi i ligjit, një ekonomi funksionale e tregut dhe veçanërisht të drejtat e

<sup>50</sup> 'Hungaria njeh Pavarësinë e Kosovës më 19 mars 2008.' Burimi: [http://www.mfa.gov.hu:80/kulkepviselet/Pristina/en/en\\_Hirek/080319\\_kozovo\\_hu.htm](http://www.mfa.gov.hu:80/kulkepviselet/Pristina/en/en_Hirek/080319_kozovo_hu.htm) (shkarkuar: 28 mars 2018).

<sup>51</sup> Intervistë me znj. Marianne Berecz (Banja Luka, Bosnjë dhe Hercegovinë, 8 mars 2018).

<sup>52</sup> 'Hungaria njeh Pavarësinë e Kosovës më 19 mars 2008.' Burimi: [http://www.mfa.gov.hu:80/kulkepviselet/Pristina/en/en\\_Hirek/080319\\_kozovo\\_hu.htm](http://www.mfa.gov.hu:80/kulkepviselet/Pristina/en/en_Hirek/080319_kozovo_hu.htm) (shkarkuar: 28 mars 2018).

<sup>53</sup> Marti Ahtisari, ish Presidenti i Finlandës, mori përsipër, nën një mandat ndërkombëtar (nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së), detyrën e përpilimit të kushteve të pavarësisë së Kosovës. Ai e paraqiti planin e tij, të quajtur zyrtarisht Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, në mars 2007. Aty ai përshkroi një shtet multi-etnik me institucione të forta demokratike që siguronin garanci të gjera për pakicat etnike. Për zbatimin e planit të tij, ai sugjeroi një periudhë të përkohshme të quajtur “pavarësi e mbikëqyrur”, gjatë së cilës aktorët ndërkombëtarë do të kishin më shumë bazë ligjore për të ndërhyrë në legjislaturën e Kosovës dhe në politikën e brendshme.

komuniteteve pakicë kombëtare, ishin shumë të rëndësishme për Hungarinë. Si ish drejtori për Evropën Juglindore ashtu edhe shefi i misionit në Prishtinë konfirmuan se Sekretari i Shtetit Feksz, jurist me profesion, po shqyrtonte me javë të tëra draftin e kushtetutës së Kosovës, në mënyrë që të përcaktonte nëse përmbante garanci të mjaftueshme për komunitetet jo-shqiptare. Pjesëmarrja në Grupin Drejtues Ndërkombëtar (ISG) dha një mundësi për ta monitoruar procesin. Ministria e Punëve të Jashtme të Hungarisë caktoi një diplomat të lartë në vitin 2010, ish drejtorin për Ballkanin Perëndimor në Zyrën Civile Ndërkombëtare, i cili më pas u bë pjesë e menaxhmentit të lartë.

Për dallim nga Polonia, e cila nuk e ndoqi njohjen me hapa konkretë, Hungaria veproi shumë shpejt. Ministrin të punëve të jashtme iu kërkua menjëherë t'i paraqiste një propozim presidentit hungarez për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Kosovën. Kjo nuk kërkonte teknikisht një përpjekje të madhe, pasi që Zyra Ndërlidhëse në Prishtinë ishte vendosur që nga fundi i vitit 2005. Hungaria e emëroi shefin e Zyrës Ndërlidhëse si ambasadorin e saj të parë në Kosovë, dhe pajtimi nga autoritetet e Prishtinës erdhi shumë shpejt. Ambasada hungareze në Prishtinë filloi me shpejtësi të lëshojë viza Shengen për qytetarët e Kosovës, një detyrë që ishte bërë më herët vetëm në Shkup dhe Tiranë.

Në Kroaci, vetë kryeministri Ivo Sanader u ndal para kamerave për ta njoftuar vendimin për njohjen e Kosovës. Vendimi për ta ngritur komunikimin publik në një nivel më të lartë ishte i lidhur me të kaluarën e përbashkët të të dy vendeve. Në vitet 1980 Kosova ishte një çështje e brendshme politike për qytetarët e Kroacisë dhe shumë prej tyre kishin përvojë direkte me Kosovën. Kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi iu përgjigj këtij gjesti duke bërë një deklaratë për televizionin shtetëror kroat në të cilin ai mirëpriti njohjen e “miqve”, e cila “ishte një vendim i mirë në një moment të mirë”.<sup>54</sup> Kosova e hapi ambasadën e saj në Zagreb më 19 shkurt 2010. Pas njohjes dhe vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mbërriti në Budapest ambasadorja e parë e Kosovës, Shkëndije Geci Sherifi.<sup>55</sup>

Reagimet e para nga Beogradi ndaj aktit të përbashkët të njohjes nuk ishin veçanërisht miqësore, por kjo ishte e parashikueshme. Vetëm disa ditë para njoftimit, pakica serbe e Kroacisë ishte bashkuar me

<sup>54</sup> ‘Elismertük Koszovó függetlenségét’, Népszabadság online, 19 mars, 2008. Burimi: <http://nol.hu/archivum/archiv-485616-285856> (shkarkuar: 28 mars 2018).

<sup>55</sup> ‘Zagreb: Otvorena ambasada Kosova.’ Večernje novosti online, 19 shkurt, 2010. Burimi: <http://www.novosti.rs/vesti/planeta.70.html:265665-Zagreb-Otvorena-ambasada-Kosova> (shkarkuar: 22 shkurt 2018).

presidentin serb Boris Tadiq duke e paralajmëruar Zagrebin kundër masës: “Politikanët kroatë duhet t’i shqyrtojnë seriozisht pasojat reale të një njohjeje të tillë.” Ministri i jashtëm Vuk Jeremiq paralajmëroi gjithashtu nga bisedimet e tij në Athinë se

“Çdo vend që vendos ta njohë shtetin e shpallur në mënyrë të paligjshme të Kosovës shkel ligjin ndërkombëtar dhe kështu nuk mund të llogarisë në marrëdhënie të mira me Serbinë. [...] Unë shoh me trishtim tani që ka shtete në rajonin tonë që e kanë njohur ose do ta njohin atë, [...] Unë them mos e bëni. Mos e prekni sovranitetin e Serbisë duke njohur Kosovën.”<sup>56</sup>

Diplomatët hungarezë kujtojnë se në bisedimet dypalëshe, ministri i jashtëm serb madje tha që midis Kosovës dhe Bashkimit Evropian, Beogradi do të zgjidhte të parën. Diplomatët dhe ekspertët e Ballkanit u përpoqën t’i qetësonin disa politikanë të tronditur hungarezë në bisedimet e brendshme, duke thënë se deklarata të tilla nuk duhet të merren fjalë për fjalë.<sup>57</sup>

Serbia dorëzoi nota proteste diplomatike në Budapest dhe Zagreb. Në përputhje me planin e veprimit të Ministrisë së Jashtme serbe, ambasadori serb në Kroaci Radivoje Cvetičanin dhe ambasadori serb në Hungari Predrag Čudić duhej të linin postet e tyre brenda 48 orëve pas dorëzimit të notave. Sidoqoftë, në Budapest notën e dorëzoi i ngarkuari me punë, pasi Ambasadori Cudić ishte larguar tashmë nga kryeqyteti hungarez, pra disa muaj para se t’i mbaronte mandati i tij. Pasardhësi i tij Dejan Sahoviç ishte ende duke u përgatitur për postin e tij në Beograd; prandaj, masa nuk pati pasojë shumë praktike për Budapestin në momentin e veçantë. Hungaria heshti dhe nuk bëri asnjë reagim që do ta provokonte më tej Serbinë. Respekti dhe përmbajtja dhanë rezultate: Serbia e dërgoi ambasadorin e ri në Budapest në verën e vitit 2008. Marrëdhëniet dypalëshe nuk stagnuan për shumë kohë; Kryeministri Gyurcsany e vizitoi Beogradin në nëntor 2008.<sup>58</sup>

<sup>56</sup> ‘Bullgaria, Kroacia dhe Hungaria njohin Kosovën.’ ABC News, 19 mars 2008. Burimi: <http://www.abc.net.au/news/2008-03-19/bulgaria-croatia-hungary-recognise-Kosova/1078136> (shkarkuar: 26 shkurt 2018).

<sup>57</sup> Intervistë me znj. Marianne Berez (Banja Luka, Bosnjë dhe Hercegovinë, 8 mars 2018).

<sup>58</sup> Rreth kësaj dhe në lidhje me dinamikën e marrëdhënieve hungareze-serbe në përgjithësi, shihni në gjuhën serbe me abstraktin në anglisht: Juhas, Jožef. ‘Lojalnost zapadu I pragmatizam prema Srbiji politika Mađarske prema Srbiji nakon 1989.’ Rymat e Historisë, Revistë e Institutit për Historinë e Re të Serbisë 22, nr. 2 (2013): 211-224.

Qeveria hungareze, si dhe ajo kroate dhe bullgare u përpoqën të komunikonin me Serbinë dhe ofruan mbështetje për Beogradin në rrugën drejt integritet evropian dhe për një çështje më aktuale: arritjen e statusit pa viza në zonën Shengen, një çështje që kishte qenë shqetësim i madh për qytetarët e saj. U deshën gati dy vjet që Serbia të merrte liberalizimin e vizave, dhe Hungaria, si fqinji i vetëm anëtar i Shengenit, siguroi mbështetje efektive politike gjatë këtij procesi. Budapesti ishte gjithashtu një përkrahës kryesor për t'i dhënë Serbisë statusin e kandidatit, të cilin vendi e mori përfundimisht në mars 2012.

Fitimet e politikës dhe pritjet e paplotësuara që nga njohja

Marrëdhëniet hungareze me Shqipërinë dhe me shqiptarët kanë qenë tradicionalisht të përzemërta dhe të parënduara nga luftërat ose mosmarrëveshjet territoriale. Përkundrazi, Austro-Hungaria luajti një rol vendimtar në krijimin e shtetit shqiptar në 1912, dhe shumë e mbajnë mend këtë fakt, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë. Sidoqoftë, emocionet ose detyrimet sentimentale që rrjedhin nga marrëdhëniet e kaluara nuk ndikuan shumë në vendimin e qeverisë hungareze në vitin 2008 për njohjen e Kosovës.

Ky vendim u bazua në konsideratat e realpolitikës dhe pritjet e caktuara se do të promovonte disi interesat hungareze (rajonale) në të ardhmen. Diplomatat dhe udhëheqësit politikë hungarezë në 2006-2007 kuptuan se pavarësia e Kosovës ishte e pashmangshme. Së pari, sepse aktorët e fuqishëm në rajon, si Shtetet e Bashkuara dhe tre vendet anëtare më të mëdha të BE-së, përkatësisht Franca, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar, zgjodhën këtë opsion, dhe asnjë aktor tjetër ndërkombëtar nuk ishte aq i fortë sa të kundërshtonte vullnetin e tyre. Së dyti, sepse nuk kishte ndonjë alternative të realizueshme përveç pavarësisë. Ky ishte edhe përfundimi i vlerësimit të brendshëm të bërë nga Ministria e Punëve të Jashtme e Hungarisë. Hungaria dëshironte të mbetej aleate me fuqitë kryesore perëndimore në Ballkan, sepse stabiliteti në rajon nuk ishte i mundur pa përfshirjen e tyre, dhe Hungaria kishte një interes jetik për ta ruajtur paqen. Kjo aleancë politike nuk ishte e panatyrshme, pasi që Budapesti ndante vlerësimin dhe konkluzionet e tyre për Kosovën.

Interesat hungareze të cilave pritej t'u shërbente ky vendim ndahen në tre grupe:

1. Stabiliteti i rajonit pritej të forcohej nga pavarësia e Kosovës. Shteti i ri i e ka vërtetuar këtë pritje në përgjithësi, sepse nuk rezultoi të jetë një burim kryesor i destabilizimit në rajon. Sidoqoftë, vëmë re disa çështje, dhe një vlerësim real duhet të pastrohet nga ndikimi i

propagandës. Informacioni i vërtetuar sugjeron që treqind xhihadistë u larguan nga Kosova për në Siri dhe Irak në periudhën 2012-2015. Sidoqoftë, ai nuk ishte një shembull i izoluar në rajon, madje edhe disa shtete anëtare të BE-së ishin burim i xhihadistëve, dhe autoritetet e Kosovës bënë një përpjekje të fortë për ta luftuar këtë fenomen në vitin 2014, dhe vazhdojnë ta bëjnë që atëherë. Incidenti i armatosur në Kumanovë, Maqedoni në maj 2015, me disa pjesëmarrës nga Kosova, ishte një ngjarje shumë shqetësuese. Sidoqoftë, ky rast mbeti i izoluar dhe nuk minoi stabilitetin as në Maqedoni, e as në Ballkanin Perëndimor. Kosova u kthye në burim madhor të migrantëve ilegalë ekonomikë në Hungari dhe në BE në përgjithësi në periudhën midis tetorit 2014 dhe marsit 2015. Por, kur qeveria e re e Kosovës hyri në veprim në janar 2015, brenda disa muajve migracioni u zvogëluar në nivel minimal.

2. Shpresa se të drejtat kolektive që u janë dhënë pakicave të Kosovës do të krijojnë një precedent ndërkombëtar nuk është përmbushur ende. Njëzet vendet e garantuara në Kuvend u ndanë për përfaqësuesit e pakicave. Decentralizimi u zbatua në bazë të Planit të Ahtisaarit, por vetëm në të mirë të serbëve; kërkesat e boshnjakëve dhe goranëve për komunat e tyre janë injoruar plotësisht. Ne duhet gjithashtu të konkludojmë se të drejtat politike në Kosovë nuk e kompensojnë mungesën e perspektivave ekonomike për komunitetet jo-shqiptare.

Është gjithashtu shqetësuese që koncepti i përgjithshëm i autonomisë serbe në Kosovë është bërë një temë politike shumë e diskutueshme. Marrëveshjet e nënshkruara nga Kosova dhe Serbia në 2013 dhe 2015 mbi Asociacionin e Komunave me shumicë serbe ndeshën në kundërshtim të ashpër nga disa parti politike shqiptare të Kosovës për shkak të frikës se ai do të kthehet në mjet efektiv në duart e shtetit serb për të prishur dhe përçarë Kosovën. Shumë aktorë ndërkombëtarë e ndajnë këtë shqetësim, sepse Serbia ka mbajtur një administratë paralele shtetërore në komunat serbe në dekadën e fundit edhe pa kornizën e duhur ligjore. Qeveria në Beograd financon arsimin dhe kujdesin shëndetësor në komunat serbe dhe emëron kryetarë paralelë për të kontrolluar punën e të zgjedhurve edhe në vitin 2018. Për më tepër, Beogradi qartazi kërkon të mbajë nën kontroll të ngushtë politikën serbe të Kosovës dhe të përdorë deputetët dhe ministrat serbë në Kosovë për t'i shërbyer interesave të qeverisë serbe në luftën e tyre kundër autoriteteve të Prishtinës. Këto rrethana e bëjnë të pamundur

paraqitjen e të drejtave të gjera të pakicave në Kosovë si “praktikë të mirë” në ndonjë forum ndërkombëtar.

Ekzistenca dhe funksionimi i pashqetësuar i Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë siç parashikohet nga Plani i Ahtisarit është një kusht i zbatuar, por jo pa të meta. Sulmet fizike të profilit të lartë mbi kishat ortodokse nuk kanë ndodhur që nga marsi 2004, dhe shumica e atyre që u shkatërruan janë rikonstruktuar gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit. Sidoqoftë, nëse flisni me murgjit serbë në Kosovë, dëgjoni histori për “ngacmim me intensitet të ulët” që nuk është i organizuar, por përkundrazi tolerohet nga autoritetet lokale. Pati një sfidë të hapur nga qarqet më të larta politike të Prishtinës në prill 2015 kur qeveria e Kosovës paraqiti një projektligj për trashëgiminë kulturore. Kjo përcaktonte që emri i Kishës Ortodokse Serbe të ndryshohej në Kishën Ortodokse të Kosovës, çka shkatërroi besimin që po lindte midis Kishës dhe qeverisë. Kjo shpjegon pse Kisha serbe e kundërshtoi publikisht dhe me shumë forcë anëtarësimin e Kosovës në UNESCO në vjeshtën e vitit 2015. Kjo marrëdhënie nuk është një shembull që Hungaria mund të paraqiste për Rumaninë dhe Kishën Katolike në Transilvani.

Ajo që është arritja e madhe është se pozicioni i komunitetit hungarez në Serbi është përmirësuar shumë në dekadën e fundit; pjesërisht, kjo ishte pasojë e pavarësisë së Kosovës. Serbia shpejtoi përpjekjet për të zgjeruar autonominë për pakicat kombëtare dhe ligjvënësit e saj miratuan ligjin për Këshillat Kombëtarë në vjeshtë 2009.

3. Përmirësimi i ngadaltë i marrëdhënieve dypalëshe ekonomike me Kosovën mbeti prapa shpresave të mëparshme hungareze. Midis viteve 2007 dhe 2017 eksportet hungareze u rritën nga 25.5 milion euro në 43 milion euro, që është rritje neto prej 70%. Mund të duket premtuese, por eksportet hungareze në të njëjtën periudhë në Serbi u rritën nga 860 milion euro në 1.6 miliardë, që është afërsisht një rritje prej 86%. Në vlerë nominale, Kosova ka mbetur një partner marginal për tregtinë hungareze, ndërsa Serbia është rritur në një partner kryesor. Investitorët hungarezë ende e shmangin Kosovën, sepse disa nga dispozitat e Planit të Ahtisarit nuk janë zbatuar. Ekonomia e tregut ekziston në letër, por korrupsioni endemik dhe sundimi i dobët i ligjit e komplikojnë mjedisin e biznesit.

Një nga pritshmëritë e Hungarisë ishte që njohja nuk do t’i prishte marrëdhëniet me Serbinë. Falë përpjekjeve të diplomacisë hungareze dhe qasjes konstruktive të Beogradit, çdo pengesë e tillë u shmang. Sidoqoftë, çështja e Kosovës është një problem i ndjeshëm për

Budapestin nga ky këndvështrim për shkak të mungesës së ndonjë normalizimi thelbësor të marrëdhënieve Beograd-Prishtinë. Kurdoherë që Kosova kërkon të bëhet anëtare e një organizate ndërkombëtare, mbështetja hungareze mbart rrezikun e konfliktit me Beogradin dhe i vendos diplomatët hungarezë në një situatë të vështirë. Shembulli më i mirë për këtë ishte përpjekja e Kosovës për anëtarësim në UNESCO në vjeshtën e vitit 2015.

Shqipëria, Kosova dhe komunitetet shqiptare në Mal të Zi dhe Maqedoni janë partnerë të rëndësishëm për Hungarinë. Edhe në terma rreptësisht realpolitik ato paraqesin një vlerë të mundshme, pasi që marrëdhëniet historikisht të mira ofrojnë një tokë pjellore për bashkëpunim. Sidoqoftë, qëndron fakti se bashkëpunimi hungarez tani është më i prekshëm dhe spektakolar me Serbinë dhe Maqedoninë. Në praktikën e përditshme diplomatike, Hungaria e sheh gjithnjë e më të rëndë që të sigurojë mbështetje për shqiptarët në konflikte politike, pasi kjo mund të ndikojë drejtpërdrejt në interesat e rëndësishme të politikës së jashtme të vendit në Beograd dhe Shkup. Normalizimi i marrëdhënieve Beograd-Prishtinë si dhe bashkëpunimi harmonik midis shqiptarëve dhe maqedonasve sllavë në Maqedoni nuk janë vetëm parulla diplomatike, por interesa domethënëse të politikës së jashtme të Budapestit.

Të parashikosh të ardhmen është gjithmonë një përpjekje e rrezikshme intelektuale. Politika e jashtme hungareze duhet të përshtatet herë pas here me ndryshimet në mjedisin gjeopolitik. Megjithatë, dy linja kryesore të politikës hungareze të Ballkanit duket se janë të parashikueshme. E para është kërkesa për të përmirësuar marrëdhëniet e mëtejshme ekonomike me Kosovën dhe me të gjitha vendet e tjera të rajonit. E dyta është mbështetja parimore e qeverisë hungareze për aspiratat e integritimit evropian të Ballkanit Perëndimor. Hungaria do ta shihte me kënaqësi rajonin brenda kufijve të BE-së deri në vitin 2030, por kjo është realiste vetëm për sa kohë që Gjermania dhe Franca janë dakord me këtë politikë. Ne duhet ta shohim qartë se Kosova është çështja më problematike në grupin e aspirantëve, sepse pesë shtete anëtare të BE-së ende nuk e njohin pavarësinë. Kjo nuk do të ndodhë përpara se të arrihet një zgjidhje politike përfundimtare midis Beogradit dhe Prishtinës. Edhe pas kësaj, Spanja duket se do të jetë tepër e vështirë për diplomacinë kosovare, kur t'ia nisë kësaj pune.

Laszlo MARKUSZ

## HUNGARIAN POINT OF VIEW ON KOSOVA'S INDEPENDENCE

### Summary

*Since the start of the armed conflict in Kosova in February 1998, Serbian military and police have outraged the Western public opinion with their continued violence against the civilian population. NATO intervened militarily on March 24, 1999. Serbia forcibly expelled about 850,000 Kosovans in front of world press cameras from March to June. Some of the Albanian refugees ended up in Hungary. Following the end of the war, the UN Security Council adopted Resolution 1244 (1999), which authorized the UN to administer Kosova. There was a growing consensus among key Western actors that status quo was unstable and that Kosova's final status had to be resolved within a short time.*

*Hungary embarked on a more energetic diplomatic activity in the Balkans. Traditionally, the Hungarian Embassy in Tirana covered the events in Kosova. On November 1, 2005, the Hungarian Ministry of Foreign Affairs opened a Diplomatic Liaison Office in Pristina and transferred the senior Balkans expert, Zoltan Imecs, from the Hungarian Embassy in Tirana to run the new office. Meanwhile, Foreign Minister Somogyi expressed his opinion that in order to achieve regional stability, Kosova must become an independent entity.*

*The Hungarian government took the decision on recognition on March 19, 2008. By that time, some 30 countries had already recognized Kosova, including the United States and key EU countries, France, the United Kingdom and Germany.*

*The foreign minister established diplomatic relations with Kosova. Hungary appointed the head of the Liaison Office as its first ambassador to Kosova. In a meantime, Kosova appointed its first ambassador in Budapest.*

**Keyword:** *Serbia, Kosova, NATO, Hungary, Hungarian diplomacy, Kosova Independence, Hungarian Embassy.*



# SFIDAT REGJIONALE PËR SHTETNDËRTIMIN E KOSOVËS

**Sonja Biserko**

## **Përmbledhje**

*Legjitimiteti ndërkombëtar i Kosovës edhe më tej do të jetë vendimtar për procesin e shtetndërtimit në Kosovë. Për fat të keq, UNMIK-u e ka humbur legjitimitetin në ndërtimit e shtetësisë, e po ashtu edhe akterët lokalë kanë dështuar. Rezistenca e komunitetit serb për të pranuar autoritetin e institucioneve kosovare, posaçërisht në veri, minon përpjekjet për ndërtimin e shtetit multi-etnik stabil në Kosovë. Për shkak të kundërshtimeve të brendshme (komuniteti serb) dhe për shkak të kundërshtimeve të jashtme të shtetit të Kosovës përkundër përfshirjes së thellë të bashkësisë ndërkombëtare dukshëm është dëmtuar procesi i ndërtimit të shtetit Kosovës. Qëndrimi i Serbisë është vendimtar, se nga ai varet sjellja e Ruisë e cila tash është vendosur si mbrojtëse e interesave serbe karshi bashkësisë ndërkombëtare, para së gjithash në Këshillin e Sigurimit.*

***Fjalët çelës:*** Kosova, UNMIK, Rusia, Serbia.

Ndërtimi i shtetit të Kosovës përballët me sfida të shumta, të brendshme dhe të jashtme.

Komuniteti serb në Kosovë është sfida më e madhe e brendshme për shtetin e Kosovës pasi kundërshton legjitimitetin e shtetit të Kosovës. Nuk ka nevojë të theksohet se politika e Beogradit është pas kësaj. Komuniteti serb kundërshton pavarësinë e Kosovës dhe pretendon se i përket Serbisë, ndërsa për këtë arsye refuzon të përfshihet në ndërtimin e shtetit të Kosovës. Me dëshirën për të kënaqur komunitetin serb, UNMIK-u ka bërë përpjekje për të krijuar presupozimin e një shoqërie multi-etnike, në të cilën të gjitha grupet etnike do të kënaqnin interesat e tyre, para se gjithash duke ndarë vende të garantuara në parlament e duke pritur se kështu do të fitonin besimin e komunitetit serb. Si KFOR-i, ashtu edhe Eulexi më vonë, u përqendruan në promovimin e një shoqërie multikulturore, por pa shumë sukses. Faktori i jashtëm i cili pas ndërhyrjes së NATO-s ishte

vendimtar për ndërtimin e shtetit përmes UNMIK-it, KFOR-it, e më pas edhe EULEX-it, ishte i përcaktuar për shoqëri multikulturore të cilën nuk ia dolën ta bënin. Kjo nuk kishte mbështetjen as të popullatës shqiptare, e as asaj serbe.

Serbët e Kosovës vazhdojnë të mos tregojnë dëshirë për t'u bërë pjesë e shoqërisë multietnike të Kosovës, por vazhdojnë me politikën që dikton Beogradi. Argumentet kryesore për refuzimin e integritimit janë vuajtjet e serbëve pas ndërhyrjes dhe dhuna në mars të vitit 2004. Duke u nisur nga propaganda e vazhdueshme me të cilën Beogradi pengon edhe më shumë integritimin e serbëve në shoqërinë kosovare, në kontekstin e paraqitur perspektiva e një shoqërie multietnike në Kosovë nuk ka shumë gjasa.

Serbët e Kosovës praktikisht kanë minimizuar pjesëmarrjen e tyre në institucionet qendrore të Kosovës. Për shkak të përqendrimit të serbëve në enklavat e ndara dhe ndihmës nga Beogradi, ata kanë qenë në gjendje të mbajnë institucione paralele, siç janë arsimi dhe shëndetësia, ndërsa për siguri mbështeten te KFOR-i.

Në vitin 2009 serbët në jug të Ibrit treguan gatishmëri për t'u përfshirë në institucionet e Kosovës, por nuk duhet të anashkalohej fakti që për këtë ata morën dritën e gjelbër nga Beogradi. E gjithë kjo dëshmon faktin se Beogradi gjithmonë ka pritur mbështetjen për ndarjen e Kosovës, respektivisht që veriu i Kosovës të mbetet nën autoritetin e Beogradit dhe se përpjekjet do të drejtohen drejt ndarjes.

Marrëveshja e Brukselit e vitit 2013, e nënshkruar me ndërmjetësimin e BE-së, parashikon një autonomi më të madhe për komunitetin serb në Kosovë. Marrëveshja u zbatua ngadalë, me një rezistencë të madhe nga të dy palët. Shqiptarët e Kosovës kanë frikë të humbasin sovranitetin, kështu që Gjykata Kushtetuese në vitin 2015 pezulloi zbatimin. Marrëveshja e Brukselit u ndal më së shumti për shkak të interpretimeve të ndryshme në lidhje me statusin e serbëve të Kosovës.

Rezoluta 1244 e KB-së ka lënë të hapur çështjen e statusit përfundimtar të Kosovës sepse nuk kishte pajtueshmëri ndërmjet anëtarëve të Këshillit të Sigurimit, kryesisht Rusisë dhe Kinës. Edhe para Deklaratës së Pavarësisë, bashkësia ndërkombëtare në Kosovë ishte e angazhuar në ndërtimin e shtetit të Kosovës pa implikimin e njohjes së Kosovës. Deklarata e Pavarësisë, megjithatë, ndau bashkësinë ndërkombëtare në këtë drejtim. Gjatë dekadës së kaluar, 114 nga 192 vende kanë njohur pavarësinë e Kosovës, përkundër kundërshtimit të këtij numri nga Serbia. Përveç kësaj, ende ka shumë

pengesa për anëtarësimin e Kosovës në OKB, kryesisht për shkak të qëndrimeve të Ruisë dhe Kinës. Implikimet e sfidimit të legjitimitetit ndërkombëtar minojnë dhe ngadalësojnë procesin, jo vetëm të ndërtimit të shtetit, por edhe të anëtarësimit në BE.

Pas miratimit të Deklaratës së Pavarësisë, UNMIK-u transferoi një numër funksionesh tek EULEX-i, i cili kishte marrë mandatin për të mbikëqyrur pavarësinë e Kosovës. Roli i BE-së në Kosovë ka tri elemente - stabilizimin dhe procesin e asociimit (ASP) me theks në shtetndërtim, dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në funksion të normalizimit të marrëdhënieve dhe sundimin e ligjit në Kosovë. Pavarësisht faktit se pesë shtete anëtare të BE-së nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, BE-ja pranoi rolin për të marrë pjesë në procesin e shtetndërtimit.

Roli i Ruisë, përveç Serbisë, është gjithashtu një nga faktorët më të rëndësishëm të jashtëm që sfidon legjitimitetin e Kosovës. Rusia paraqitet si mbrojtëse e Serbisë para bashkësisë ndërkombëtare, veçanërisht në Këshillin e Sigurimit.

Për Rusinë, Kosova është vetëm një nga çështjet në interesat e saj më të gjerë në Ballkanin Perëndimor. Nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë për Rusinë, as ekonomikisht dhe as ushtarakisht. Rusia, kur është fjala për Kosovën, ndjek politikën e Serbisë. Çështja e statusit të Kosovës dhe mbështetja që Rusia i jep Serbisë në parandalimin e Kosovës për të fituar legjitimitetin e mëtejme ndërkombëtar është një nga levat e ndikimit rus në Serbi. Dhe kjo është ajo që Moska po përpiqet ta mbajë.

Në kontekstin aktual, Rusia shfrytëzon Ballkanin për tu matur me SHBA-të, NATO-n dhe BE-në. Sa më i madh presioni ndaj Ruisë, aq më i madh është interesi i saj për Ballkanin. Interesi i saj është kryesisht të minojë BE-në dhe të tregojë dobësinë e saj.

Ndikimi i Ruisë në zgjidhjen e statusit të Kosovës varet kryesisht nga qëndrimi i Serbisë. Për Serbinë, nuk është problem Rusia, por dilema e thelbësore se ku përket. Rusia me mjeshtëri shfrytëzon zhgënjimin, ortodoksizmin dhe mungesën e vizionit për të ardhmen e saj.

Veprimi i Ruisë në Kosovë shihet më së miri në veri të vendit. Lidhjet midis partive politike nga komuniteti serb dhe partisë politike Rusia e Bashkuar po zhvillohen vazhdimisht, ndërsa formimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe mund të paraqesë një terren të ri për nxitjen e nacionalizmit lokal rus në Kosovë. Faktori fetar është gjithashtu një element i rëndësishëm në ndikimin rus në Kosovë,

i zbatuar me ndërmjetësimin e Kishës Ortodokse Serbe. Me mbështetjen politike për institucionet fetare, Rusia kërkon të ruajë dhe të forcojë praninë e saj emocionale në mesin e komunitetit serb në Kosovë.

Beogradi ka filluar dialogun e brendshëm për të blerë kohë pasi gjithnjë e më shumë po bëhet e qartë se pritjet për ndryshimin e rrethanave ndërkombëtare, e me këtë edhe perspektivat për ndarjen e Kosovës, po zbehen. Nacionalistët serb, kur është fjala për Kosovën, presin që Presidenti Vuçiq të thotë "JO-në historike" pavarësisë së Kosovës. Paralelisht me përpjekjet për të zgjidhur nyjën e Kosovës, bashkësia ndërkombëtare po përballet edhe me sjellje gjithnjë e më radikale të Republikës Serbe dhe kërcënimin që, nëse njihet Kosova, edhe RS do të kërkojë pavarësi. Pra, fjala është për përpjekjen e fundit të elitës serbe për të kthyer përmbys humbjen nga vitet 1990 në fitore me mjete të tjera.

Mangësitë e brendshme, e brendshme, siç janë sundimi i ligjit dhe korrupsioni, janë pengesa për anëtarësimin e Kosovës në BE. Megjithatë, siç qëndrojnë gjërat, pa njohje të plotë ndërkombëtare të Kosovës, mbi të gjitha nga të gjithë anëtarët e BE-së, anëtarësimi në BE mbetet i hapur.

Pa një drejtim të qartë për zhvillimin e mëtutjeshëm të Kosovës do të jetë e vështirë të mbahet edhe mbështetja e brendshme politike për një proces që kërkon reforma të shumta themelore. Sidomos nëse rezulton se vetë anëtarësimi në BE është skajshmërisht i paqartë.

Pa përpjekje serioze për të rritur motivimin e BE-së, procesi i shtetndërtimit të Kosovës me siguri do të ngadalësohet. Përpjekjet për të ndërtuar një shtet të fortë do të pengohen përderisa territori i shtetit të mos jetë nën kontroll të plotë. Prandaj, në planin afatgjatë, është e qartë se mungesa e legjitimitetit të plotë ndërkombëtar do të paraqesë një problem serioz në ndërtimin e shtetësisë së Kosovës.

Në tërësi, pavarësisht nga të gjitha këto pengesa, faktorët rëndues, të brendshëm dhe të jashtëm, në ndërtimin e një shteti të qëndrueshëm demokratik, shoqëria kosovare dhe, në veçanti, elita politike dhe intelektuale kanë një përgjegjësi historike për zhvillimin e vendit në përputhje me vlerat evropiane të bashkimit në diversitet, unitetit multietnik dhe multikulturor.

Pritjet e qytetarëve të Kosovës, si dhe të akterëve ndërkombëtarë, për ritmin e përparimit drejt demokracisë dhe stabilitetit ishin tejet joreale në të kaluarën. Megjithatë, nuk duhet harruar se në Kosovë nuk

ka ndodhur një revolucion demokratik por kombëtar, respektivisht ushtrimi i së drejtës për vetëvendosje dhe çlirim.

Një udhëheqës i madh botëror (Mandela) ka thënë se vetëm pasi të kalojmë një bjeshkë shohim sa shumë bjeshkë janë para nesh. Çlirimi kombëtar ishte një bjeshkë e tillë. Sundimi i ligjit, siguria, zhvillimi ekonomik, lufta kundër korrupsionit - këto do të ishin sfida të mëdha edhe në rrethanat më të mira. Por, pa marrë parasysh gjithçka, Kosova me çdo kusht duhet të shmang stagnimin. Çdo hap në drejtimin e duhur, qoftë edhe më i vogli, është një hap drejt një shoqërie më të mirë dhe më të drejtë, si dhe shtetit për të gjithë qytetarët.

Sonja BISERKO

## REGIONAL CHALLENGES OF STATE-BUILDING OF KOSOVA

### Summary

*Kosova's international legitimacy will continue to be crucial to the process of state-building in Kosova. Unfortunately, UNMIK has lost its legitimacy in statehood building, and local actors have also failed. The resistance of the Serb community to accept the authority of Kosova's institutions, especially in the north, undermines efforts to build a stable multiethnic state in Kosova. Due to internal opposition (the Serb community) and external opposition to the state of Kosova, despite the deep involvement of the international community, the process of building the state of Kosova has been significantly undermined. Serbia's stance is decisive, as on it hinges Russia's behavior, which now stands as a defender of Serbian interests towards the international community, above all in the Security Council.*

**Key words:** *Kosova, UNMIK, Russia, Serbia.*

# **SHPALLJA E PAVARËSISË SË KOSOVËS DHE NJOHJA NDËRKOMBËTARE**

**Frashër Demaj**

## **Përmbledhje**

*Pas 78 ditë sulmesh ndaj qaceve të ushtrisë serbe më 9 qershor 1999 u nënshkrua marrëveshja politiko-ushtarake në mes të forcave të NATO-s dhe RFJ e njohur si Marrëveshja e Kumanovës. Në ndërkohë edhe Këshilli i Sigurimit të OKB-së miratoi rezolutën 1244 sipas të cilës do të administrohej Kosova. Për të përfunduar me statusin e Kosovës filloi një proces i gjatë negociator me ndërmjetësim ndërkombëtar. Këto negociata u zhvilluan në Vjenë me organizimin e Grupit të Kontaktit i cili nën mandatin e KS të OKB-së autorizoi Presidentin finlandez Marti Ahtisari, që të përgatiste një plan gjithëpërfshirës për statusin e ardhshëm të Kosovës.*

*Më 17 shkurt të vitit 2008 në një atmosferë festive, Kuvendi i Kosovës shpalli Kosovën shtet sovran dhe të pa varur. Në këtë seancë parlamentare morën pjesë 109 nga gjithsej 120 deputetë të Kuvendit të Kosovës të cilët në unanimitet të plotë votuan pro shpalljes së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran.*

*Shpallja e pavarësisë së Kosovës, u krye në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me faktorët vendimmarrës dhe aleatët ndërkombëtar, të drejtuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Njohjet e para filluan vetëm disa orë pas shpalljes. Hapin e parë për njohjen zyrtare të Kosovës e bëri e Republika e Kostarikës më 17 shkurt 2018 pastaj më 18 shkurt 2008 SHBA, Franca, Shqipëria, Turqia, Britania e Madhe dhe Afganistani. Deri tani (2018) Kosova është njohur nga 116 shtete. Republika e Kosovës duhet të intensifikoj më shumë përpjekjet diplomatike përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Integritimit, Ministrisë së Diasporës, ambasadave dhe konsullatave, miqve të Kosovës sidomos SHBA dhe shteteve të fuqishme të Bashkimit Evropian të fitoj sa më shumë njohje për të përmbushur numrin e nevojshëm që do t'i hapte rrugë integrimit ndërkombëtar, daljes nga izolimi dhe pozicionimin e Kosovës në mesin e demokracive të zhvilluara perëndimore.*

**Fjalë çelës:** *Kosova, NATO, KFORI, OKB, GJND, Kuvendi i Kosovës, shtet sovran dhe i pavarur, Ministria e Punëve të Jashtme.*

Fushata e bombardimeve të NATO-s i dha fund spastrimit etnik, vrasjeve, masakrave, burgosjeve, kidnapimeve, vjedhjes dhe shkatërrimit të pronës publike dhe private të shqiptarëve nga ana e ana policisë, ushtrisë dhe njërive tjera të uniformuara të Serbisë. Pas 78 ditë sulmesh ndaj caqeve të ushtrisë serbe, më 9 qershor 1999 u nënshkrua marrëveshja politiko-ushtarake në mes të forcave të NATO-s dhe RFJ e njohur si Marrëveshja e Kumanovës. Këtë marrëveshje e firmosën gjenerali Michael Jackson, komandanti i parë i KFOR-it në Kosovë dhe shefi i Shtabit të Armatës së Serbisë, gjenerali Nebojsa Pavković. Pas nënshkrimit, Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, më 10 qershor 1999 kishte lëshuar urdhrin për ndalimin e bombardimeve mbi caqet policore dhe ushtarake serbe. Në ndërkohë edhe Këshilli i Sigurimit të OKB-së miratoi rezolutën 1244 sipas të cilës do të administrohej Kosova dhe do të fillonte ngritja dhe funksionimi i institucioneve politike, administrative dhe atyre të sigurisë. Sipas Marrëveshjes së Kumanovës Serbia detyrohej të tërheqë forcat e saj policore dhe ushtarake nga Kosova në afatin e përcaktuar dhe në vend të tyre do të pozicionoheshin trupat e KFOR-it të cilat do të ishin përgjegjëse për sigurinë e vendit.<sup>1</sup>

Marrëveshja e Kumanovës i hapi rrugë vendosjes në Kosovë të rreth 37.200 trupave nga 36 shtete në misionin ushtarak që u quajt KFOR. Ky mision u nda në pesë zona të përgjegjësisë të drejtuara nga misioni amerikan, anglez, francez, gjerman dhe italian. Trupat e KFOR-it u mirëpritën nga popullsia shumicë e Kosovës e cila i konsideronte si shpëtimtarë. Përjashtim bënë trupat ruse që kishin arritur në Kosovë nga Bosnja dhe shiheshin si aleatë dhe përkrahës të Serbisë.

Me hyrjen e trupave të NATO-s dhe atyre civile ndërkombëtare filloi një etapë e re e zhvillimeve politike dhe ushtarake në Kosovë. Vendi filloi të administrohej në bazë të rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Kjo rezolutë interpretohej në mënyra të ndryshme nga qarqe të ndryshme politike vendore dhe ndërkombëtare, varësisht nga politikat dhe

<sup>1</sup> Më gjerësisht shih: <https://www.nato.int/Kosova/docu/a990609a.htm>, military technical agreement between the international security force ("Kfor") and the governments of the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Serbia, hulumtuar më 3 maj 2019.

gjeopolitikat që mbronin në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit. Partitë Politike në Kosovës, prezencën e OKB-së e trajtonin si një fazë kalimtare deri sa të krijohen kushtet për të organizuar një referendum për përcaktimin e të ardhmes politike të Kosovës, përderisa Serbia e interpretonte këtë situatë si një gjendje të përkohshme dhe mundësi të rikthimit politik e ushtarak në Kosovë.<sup>2</sup> Serbia pavarësisht se e kishte humbur luftën shpresonte se do të arrinte të rikthehej në territorin e Kosovës përmes përkrahjes diplomatike të miqve të saj si Rusia, Kina, Greqia, dhe aleatë të tjerë të vegjël.

Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Kofi Anan<sup>3</sup> në kuadër të kompetencave të tij e emëroi një përfaqësues special (fillimisht ishte Sergio Viera De Melo e pastaj Bernard Kushner) i cili do të administronte Kosovën dhe do të ndihmonte në përgatitjen e terrenit politik për ndërtimin e institucioneve të vendit. Pushteti i përfaqësuesit special ishte i kufizuar por që kishte autoritet ekskluziv dhe vendimmarrës mbi institucionet e Kosovës që po themeloheshin gradualisht.<sup>4</sup>

Në gjendjen e krijuar midis një dypushteti të autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare u arrit që të krijohen IPVQ (institucionet e përkohshme vetëqeverisëse) qendrore dhe lokale të cilat me kalimin e kohës filluan të marrin përgjegjësitë e nevojshme për ndërtimin e kapaciteteve institucionale të nivelit lokal dhe qendror. Marrja e kompetencave nga vendorët shtoi ambicjet që sa më shpejtë të gjendej mundësia për definimin e statusit përfundimtar të Kosovës. “Kosovën shtet sovran dhe të pavarur”, shumë shqiptarë e konsideronin si kërkesë minimaliste dhe kompromis me bashkësinë ndërkombëtare. Nga ana tjetër, krijesa e përbashkët shtetërore Serbi e Mali i Zi e quajtur Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ) ishte bërë pengesë serioze jo vetëm për statusin e Kosovës por edhe për të ardhmen e Malit të Zi që pretendonte të shkëputej nga “RFJ” dhe të funksiononte si shtet i pavarur. Pavarësinë e Malit të Zi e përkrahnin SHBA e BE dhe njëkohësisht “shpërbërjen e RFJ” e shihnin si mundësi të mirë për ti hapur rrugë zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës. Në këto

---

<sup>2</sup> Denis Macshane, *Why Kosova still matters*, First published in Great Britain in 2011 by Haus publishing Ltd 70 Cadogan Place London swix 9AH, f. 44.

<sup>3</sup> Kofi Atta Annan ishte një diplomat nga Gana që shërbeu si Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara nga Janari 1997 deri në Dhjetor 2006. Anan ishte bashkë marrës me Kombet e Bashkuara i çmimit Nobel për Paqen në vitin 2001.

<sup>4</sup> Dario Malnar, *SHBA-ja dhe KOSOVA*, Koha, Prishtinë 2013, f. 261.

rrethana të komplikuar politike brenda “RFJ” dhe kuadrit ballkanik Mali i Zi e shpalli pavarësinë nga “RFJ” me 21 maj 2006.<sup>5</sup> Menjëherë pas shpalljes u njoh nga shtetet që përbënin grupin e fuqive të mëdha për ti hapur rrugë mundësisë për njohjen e pavarësisë nga shtetet e pavarura nga të gjitha kontinentet e botës. Me pavarësimin e Malit të Zi pushoi së ekzistuari RFJ si entitet politik, ekonomik, gjeografik. Nga RFJ tani u formuan dy entitete shtetërore, politike dhe etnike Serbia dhe Mali i Zi. Ky fakt i lehtësoi Kosovës rrugëtimin e vet drejt pavarësisë meqë edhe bashkësia ndërkombëtare nuk shihte ndonjë perspektivë përveç Kosovës si një shtet te pavarur pa asnjë alternativë.<sup>6</sup> Për SHBA dhe shtetet kryesore të BE tani ishte e pa mundur dhe e pa kuptimtë të flitej për ndonjë variant tjetër përveç modaliteteve si do të dukej dhe do të funksiononte shteti i pavarur i Kosovës dhe cila do të ishte pozita e serbëve dhe minoriteteve tjera në Kosovë.

Për të përfunduar me statusin e Kosovës filloi një proces i gjatë negociator me ndërmjetësim ndërkombëtar. Këto negociata u zhvilluan në Vjenë me organizimin e Grupit të Kontaktit i cili kishte për qëllim të ndërmjetësonte dhe të lehtësonte bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe ta menaxhonte procesin deri në përafrimin e një marrëveshje përfundimtare në mes palëve.

Grupi i Kontaktit kërkoi nga të dy palët që të emëronin përfaqësuesit e tyre politik që do të dialogonin me ndërmjetësimin ndërkombëtar për zgjidhjen e çështjeve konkrete politike dhe jo politike. Kosova e udhëhequr nga Presidenti Ibrahim Rugova e kishte krijuar një grup negociatorësh që e quajti Grupi i Unitetit<sup>7</sup> meqë aty përfaqësoheshin pothuajse të gjitha grupimet politike. Në këtë grup që udhëhiqej nga Rugova do të merrnin pjesë Kryetari i Kuvendit, Nexhat Daci, kryeministri Bajram Rexhepi, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryetari i Partisë “Ora”, Veton Surroi ndërsa koordinator i grupit u caktua Blerim Shala.<sup>8</sup>

Me vdekjen e presidentit Rugova më 2006 grupi i unitetit pësoi rënie në kuptimin cilësor meqë i mungonte autoriteti i pa kontestueshëm i Rugovës i cili kishte edhe eksperiencë ndërkombëtare në takimet bilaterale dhe multilaterale. Vendin e presidentit Rugova e zuri tashmë

<sup>5</sup> [www.bbc.com/serbian/lat/balkan-48344699](http://www.bbc.com/serbian/lat/balkan-48344699), hulumtuar me 21.5.2018.

<sup>6</sup> Stefan Karastojanov, *KOSOVA (një analizë gjeopolitike)*, Grafostil, Shkup 2007, f. 242.

<sup>7</sup> Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në konfliktin e Kosovës*, Instituti i Studimeve të Evropës Juglindore-Tiranë 2012, f. 280.

<sup>8</sup> *Po aty*.

presidenti i ri i Kosovës Fatmir Sejdiu i cili do të menaxhonte politikisht grupin e unitetit.

Kosova dhe Serbia u futën në procesin negociator me qëndrime krejtësisht të kundërta për çështje të njëjta dhe për statusin final të Kosovës. Kosova insistonte se Pavarësia e saj do të ishte një kompromis (kishte kërkesa edhe për bashkim kombëtar), në anën tjetër Serbia ngulte këmbë që Kosova të trajtohej si pjesë integrale e Serbisë. Pjesë e bisedimeve intensive do të ishin edhe të drejtat e serbëve, themelimi i komunave të reja kryesisht në vendbanime ku jetonin serbët, decentralizimi, zbulimi i fatit të pagjeturve, kthimi i kufomave të varrosura në Serbi, kthimi i dokumentacionit kadastral, njohja e dokumenteve të UNMIK-ut dhe dokumenteve tjera të Kosovës të dala nga viti 1999 etj.

Më 24 qershor të vitit 2006, në Vjenë, u organizua një takim i drejtpërdrejtë i presidentit të Kosovës, Fatmir Sejdiu, dhe kryeministrit Agim Çeku me presidentin serb, Boris Tadiç, dhe kryeministrin Vojislav Kostunica.<sup>9</sup> Ishte takimi i parë i drejtpërdrejtë ndërmjet të dyja palëve në nivelin më të lartë politik por që nuk dha ndonjë rezultat meqë të dyja palët mbetën të “betonuara” në pozicionet e tyre fillestare. Mirëpo pavarësisht rezultateve formale të munguara, në kuptimin praktik dhe jo formal ishte takim në mes presidentëve dhe kryeministrave të dy vendeve fqinjë që nënkupton njohjen reciproke të autoriteteve respektive.

Bisedimet ishin të gjata dhe të mundimshme për të dy palët dhe të vështira edhe për palën ndërmjetësuese që kosovarët e quanin “pala e tretë”. Pas përfundimit të procesit negociator, palët nuk ranë dakord për pranimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të ofruara, prandaj Grupi i Kontaktit nën mandatin e KS të OKB-së autorizoi Presidentin finlandez Marti Ahtisari, që të përgatiste një plan gjithëpërfshirës për statusin e ardhshëm të Kosovës.

Me 2 shkurt të vitit 2007, Ahtisari udhëtoi në Prishtinë dhe Beograd për t’ua paraqitur draft- propozimin e tij qeverive përkatëse. Në ndërkohë ai i ftoi të dy palët në Vjenë për një varg takimesh lidhur me këtë draft propozim. Gjatë rrethit të parë të bisedimeve të mbajtura prej 21 shkurtit deri më 2 mars, delegacionet e rishikuan dokumentin e Ahtisarit dhe patën mundësi të japin mendimin e tyre lidhur me dokumentin.<sup>10</sup> Në draftin e “Pakos së Ahtisarit” thuhej se Kosova do të

<sup>9</sup> Dario Malnar, vep e cit. f. 304-305.

<sup>10</sup> Po aty

jetë shoqëri shumë etnike, e cila qeveriset në mënyrë demokratike dhe me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.<sup>11</sup> Në Pakon e Ahtisarit përfshiheshin edhe interesat e komunitetit serb. Ai nxori një formulë e cila do të lejonte serbët e Kosovës që të kenë institucionet e tyre lokale dhe jetën komunale me lidhje të vazhdueshme me Serbinë, por brenda kornizës së një Kosove multietnike. Plani bëri thirrje për komuna të reja me shumicë serbe – përfshirë Mitrovicën e Veriut – me elemente bazë të vetëqeverisjes në shëndetësi, arsim dhe çështje sociale, plus një rol në zgjedhjen e krye shefit të policisë lokale.<sup>12</sup> Presidenti Ahtisari kishte rekomanduar që Kosova të jetë shtet i pavarur, por që pavarësia e saj të mbikëqyrej dhe vëzhgohej nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, kryesisht nga ana e Bashkimit Evropian.

Në rrethanat e pajtueshmërisë së politikës kosovare dhe kundërshtimit të politikës serbe u përgatit hapi i rëndësishëm politik dhe vendimmarrja e pritur një kohë të gjatë për statusin final të Kosovës. Dita e shpalljes së Pavarësisë në Kuvendin e Kosovës mbeti e pa njohur për opinionin publik të vendit për arsye të rrezikut të eskalimit të situatës sidomos në veri të Kosovës ku praktikisht ndihej mungesa e autoritetit të institucioneve kosovare.

Gjithsesi shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte hap i rëndësishëm dhe vendimtar i institucioneve dhe përfaqësuesve politik të popullit të Kosovës i koordinuar me faktorët e rëndësishëm të diplomacisë ndërkombëtare si SHBA, Britania e Madhe, Gjermania, Franca dhe shtete tjera të rëndësishme të Bashkimit Evropian. Më 17 shkurt të vitit 2008 në një atmosferë festive, Kuvendi i Kosovës shpalli Kosovën shtet sovran dhe të pa varur. Në këtë seancë parlamentare morën pjesë 109 nga gjithsej 120 deputetë të Kuvendit të Kosovës të cilët pas leximit të deklaratës kushtetuese nga ana e Kryeministrit të Kosovës Hashim Thaçi, në unanimitet të plotë votuan pro shpalljes së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran dhe nënshkruan tekstin e Deklaratës së Pavarësisë.

Shpallja e pavarësisë së Kosovës u krye në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me faktorët vendimmarrës dhe aleatët ndërkombëtar, të drejtuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kosova shpalli shtetin pavarur, demokratik e sovran të saj, duke jetësuar, me këtë akt, përpjekjet e pa reshtura dhe aspiratat shekullore të popullit të Kosovës,

<sup>11</sup> [www.transconflict.com/10/wp-content/uploads/2011/11/...](http://www.transconflict.com/10/wp-content/uploads/2011/11/...) Plani i Ahtisarit dhe Veriu i Kosovës.

<sup>12</sup> [www.transconflict.com/10/wp-content/uploads/2011/11/...](http://www.transconflict.com/10/wp-content/uploads/2011/11/...) Plani i Ahtisarit dhe Veriu i Kosovës.

për liri, pavarësi, demokraci, prosperitet e dinjitet njerëzor.<sup>13</sup> Ky akt sublimoi përpjekjet e brezave të shumtë që vepruan në mënyra të ndryshme për lirinë e vendit të tyre por që nuk arritën ta përjetojnë ndjesinë e të qenit i lirë dhe i pavarur..

Pavarësia e Kosovës nxiti reagime në opinionin e brendshëm dhe të jashtëm. Në rrafshin e brendshëm pavarësia e Kosovës i dha fund diskutimit dhe pritshmërisë së tej zgjatur rreth statusit përfundimtar. Kurse në planin e jashtëm, me shpalljen e pavarësisë së Kosovës iu dha fund vartësisë së saj dhe u hap mundësia për ta njohur atë si shtet të pavarur e sovran. Duke kuptuar peshën e situatës së pavendosmërisë së një pjese të madhe të vendeve, të cilat kishin opinion asnjane, Serbia ndërmoi hapa pengues gjithëpërfshirës diplomatik, ekonomik, të sigurisë dhe ndërtimit të institucioneve paralele në Kosovë<sup>14</sup> përmes instrumentalizimit të serbëve lokal madje duke i nxitur ata edhe në veprime të pa pranueshme dhe kriminale që qonin jo vetëm në shkelje kushtetuese por edhe në inkriminim e tyre në vepra penale.

Qeveria e Kosovës njoftoi qeveritë e shteteve të pavarura të botës me vendimin që kishte marrë Kuvendi i Kosovës dhe kërkoi njohjen formale të Kosovës si shtet sovran dhe të pavarur. Njohjet e para filluan vetëm disa orë pas shpalljes. Hapin e parë për njohjen zyrtare të Kosovës e bëri e Republika e Kostarikës më 17 shkurt 2018 pastaj më 18 shkurt 2008 SHBA, Franca, Shqipëria, Turqia, Britania e Madhe dhe Afganistani për të vazhduar pastaj njohjen edhe nga shtetet tjera.

Me 18 shkurt 2008, Sekretarja e shtetit Kondoliza Rajs njoftoj se SHBA –ja e njohu Kosovën shtet sovran dhe të pavarur, ndërsa presidenti Bush pranoi lutjen e presidentit të Kosovës Fatmir Sejdiu, për vendosjen e marrëdhënieve të plota diplomatike ndërmjet SHBA-së dhe Republikës së Kosovës.<sup>15</sup> Sekretarja Rajs në deklaratën e saj me rastin e njohjes së Kosovës tha se pavarësia është e vetmja zgjidhje praktike për përmirësimin e stabilitetit në rajon. Kurse diplomati Nikolas Burns, menjëherë pas njohjes zyrtare doli me një konferencë dhe paraqiti argumentet e rëndësishme për arsyen e njohjes nga SHBA. Burns deklaronte se “*njohja e pavarësisë së Kosovës është kulmi i politikës amerikane i mbështetjes së popullit të Kosovës për një dhjetëvjetësh*”.<sup>16</sup>

<sup>13</sup> Bashkim Rama, *Faktori shqiptar dhe siguria rajonale*, Geer, Tiranë 2011, f. 233.

<sup>14</sup> Samet Dalipi, *Ndërtimi i paqes në Kosovë*, Prishtinë, 2014, f. 196.

<sup>15</sup> Dario Malnar, *vep e cit.* f. 331.

<sup>16</sup> *Po aty.*

Pas njohjes nga SHBA dhe disa vende të fuqishme perëndimore brenda një periudhe të shkurtër kohore e njohën shtetin e ri të Kosovës edhe aleatët e vegjël të SHBA, Gjermanisë, Britanisë së Madhe dhe vendeve tjera të grupit të fuqive perëndimore.<sup>17</sup>

Presidenti Bush më 19 mars 2008 nxori një vendim presidencial me të cilin lejonte pajisjen e Kosovës me teknikë ushtarake dhe mjete të motorizuara. Në përputhje të plotë me politikën e presidentit Xhorxh Bush, ambasadori Wisner vlerësoi se SHBA-ja kishte investuar shumë për të arritur pavarësinë e Kosovës, prandaj Kosova nuk do të ishte e pavarur pa përfshirjen e fuqishme të SHBA-së.<sup>18</sup>

Serbia në planifikimet e veta në raport me Kosovën kishte vënë para vetes tre detyra që i vlerësoi shumë të rëndësishme për politikën e saj në Kosovë. E para ishte të pengonte me çdo kusht shpalljen e pavarësisë (që nuk arriti ta bënte) dhe njohjen ndërkombëtare, e dyta të instrumentalizonte serbët lokal për qëllimet e veta politike dhe e treta të mos lejonte që Kosova të funksiononte si shtet normal. Pasi nuk mundi të ndalonte shpalljen e pavarësisë së Kosovës, Serbia ndërmoi hapa konkret për pengimin e njohjes ndërkombëtare. Kështu për të penguar njohjen e Kosovës, politika serbe e mbështetur nga diplomacia ruse kërkoi mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi legjitimitetin dhe legalitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë me 22 korrik 2010 mori vendimin mbi bazën e të cilit Kosova kishte të drejtë të përcaktonte të ardhmen e vet politike. Pra GJND vendosi pro shpalljes së pavarësisë duke e konsideruar vendimin plotësisht legjitim dhe legal me 10 vota pro 3 abstenime dhe një kundër vendimin e saj. Menjëherë pas kësaj informate, Presidenti i Serbisë Boris Tadiq tha se Serbia nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës.<sup>19</sup>

Vendimi i GJND-së ishte një goditje e rëndë për politikën agresive serbe e cila ishte në ofensivë diplomatike duke shfrytëzuar kapacitetet e plota të saj në gjithë botën.

Në anën tjetër pas vendimit të GJND-së u intensifikua procesi i njohjes së Pavarësisë së Kosovës dhe ofensiva diplomatike kosovare. Deri tani (viti 2018) pavarësinë e Kosovës e kanë njohur 116 shtete, prej të cilave janë 108 shtete nga 193 anëtare të OKB-së. Gjithashtu shumica e vendeve të Bashkimit Evropian e kanë njohur Kosovën (23

---

<sup>17</sup> Samet Dalipi, *Ndërtimi i paqes në Kosovë*, Botime Artini, Prishtinë, 2014, f. 195

<sup>18</sup> *Po aty*.

<sup>19</sup> Samet Dalipi, *vep e cit.* f. 197

nga 28). Nga shtetet e BE-së që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës për arsye të ndryshme janë: Spanja, Greqia, Rumania, Qipro dhe Sllovakia të cilat kanë ndikuar që Kosova të vonohet edhe në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian.<sup>20</sup>

Ndër arsytet pse Spanja nuk e ka njohur Kosovën përmenden sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës Federale të Jugosllavisë në Rezolutën 1244, statusi i Kosovës si krahinë e Serbisë (dhe jo si republikë e federatës jugosllave) në Jugosllavi, mungesa e marrëveshjes ndërmjet palëve ose një rezolutë e KB-së.<sup>21</sup> Por në të vërtetë mosnjohja e Spanjës është e ndërlidhur me rajone brenda saj që kërkojnë mëvetësi nga Madridi dhe në rast të njohjes së Kosovës do të krijohej precedenti për rajonet që kërkojnë shkëputje nga Spanja.

Greqia nga ana e saj pavarësisht se nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës ka krijuar rrugë zyrtare të komunikimit me Prishtinën dhe ka njohur dhe pranuar dokumentet e lëshuara nga autoritetet e Kosovës, ka lehtësuar komunikimin dhe transportin e qytetarëve ndërmjet Kosovës dhe Greqisë dhe ka përkrahur tregtinë dhe investimet ndërmjet dy palëve.<sup>22</sup> Greqia ka hapur edhe Zyrën e saj Ndërlidhëse në Prishtinë.

Shteti rumun përveç që nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës, kishte paraqitur “argumente” kundër Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND).<sup>23</sup> Bukureshti nuk ka vendosur kurrfarë marrëdhëniesh diplomatike dhe nuk ka pasur ndonjë komunikim zyrtar institucional, përveç një zyre ndërlidhëse nën mandatin e Kombeve të Bashkuara. Nga arsytet kryesore të mosnjohjes konsiderohet problemi i saj me pakicën hungareze që jeton në Rumani.

Qipro është njëri prej pesë shteteve anëtare të BE-së që nuk e njeh Kosovën e as dokumentet e lëshuara nga institucionet kosovare. Madje ky shtet ka treguar inferioritet edhe në misionet e rëndësishme evropiane siç ishte EULEX.

Sllovakia nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës por ka zyrën ndërlidhëse në Prishtinë që tregon se ka interesim për kontakte dhe marrëdhënie në mes dy vendeve.

Nga institucionet e rëndësishme ndërkombëtare politike dhe të sigurisë nga 28 shtete të NATO e kanë njohur pavarësinë e Kosovës deri me tani 24 prej tyre. Kurse shtetet anëtare të përhershme të Këshillit

---

<sup>20</sup> [www.kipred.org/doc/kosova](http://www.kipred.org/doc/kosova), hulumtuar me 15 janar 2019.

<sup>21</sup> *Po aty.*

<sup>22</sup> *Po aty.*

<sup>23</sup> *Po aty.*

të Sigurimit, janë ndarë në dysh sa i përket pavarësisë së Kosovës. SHBA, Britania e Madhe dhe Franca, si anëtare të përhershme dhe me të drejtë veto në Këshillin e Sigurimit (KS) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) njohën pavarësinë e Kosovës, ndërsa Federata Ruse dhe Kina janë deklaruar kundër<sup>24</sup>.

Nga vendet fqinjë të Kosovës, Shqipëria është një nga vendet e para<sup>25</sup> e cila më 18 shkurt 2008 e ka dërguar notën verbale dhe ka njohur Republikën e Kosovës<sup>26</sup>. Shteti shqiptar gjithashtu ka dhënë kontribut të çmuar në lobimin ndërkombëtar për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Madje Tirana fillimisht ka ofruar edhe infrastrukturën e saj fizike dhe diplomatike në ndihmë të kapaciteteve diplomatike kosovare që nisën të krijoheshin nga fillimi.

Tani kur Kosova po konsolidohet si shtet me subjektivitet ndërkombëtar, rolin kryesor në fushatën e njohjeve e ka Ministria e Punëve të Jashtme, ambasadat dhe konsullatat e Republikës së Kosovës të akredituara në vendet mike që kanë njohur shtetësinë e Kosovës. Politika e Jashtme e Kosovës vazhdon të kushtoj një vëmendje dhe rëndësi të veçantë krijimit dhe thellimit të raporteve të gjitha vendeve të rajonit me qëllim forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të saj.

Strategjia për arritjen e njohjes së plotë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës ka për qëllim hapjen e rrugëve dhe krijimin e mundësive për integrimin e Kosovës në institucionet ndërkombëtare në mënyrë që brenda një afati të caktuar kohor të bëhet anëtar i barabartë në bashkësinë e shteteve të lira.<sup>27</sup>

Procesi i njohjes ndërkombëtare të shtetit të Kosovës është kushtëzuar nga rrethanat e veçanta politike dhe diplomatike dhe nga interesat e shumta në rajonin e Ballkanit. Praktika ndërkombëtare e legjitimitetit ndërkombëtar të shteteve të reja që nga krijimi i OKB-së, dëshmon se ky proces është realizuar, kryesisht, përmes njohjes në bllok dhe anëtarësimit në OKB. Njohja kolektive ka ndikuar pozitivisht duke shmangur përpjekjet e pa reshtura dhe duke e bërë të panevojshme njohjen nga secili shtetet veç e veç.

Rasti i Kosovës përbën përjashtim meqë shtetet më të fuqishme të globit janë ndarë në pro dhe kundër njohjes së shtetit të Kosovës dhe

<sup>24</sup> [www.mfa-ks.net](http://www.mfa-ks.net), hulumtuar me 20.05.2019.

<sup>25</sup> Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës. Nota verbale e aktit të njohjes. 18 shkurt 2008. Nr. 005.

<sup>26</sup> Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës. Nota verbale nga Zyra Ndërlidhëse e Shqipërisë në Kosovë. Nr. 70. 18 shkurt 2008.

<sup>27</sup> *Po aty*.

ky fakt e vështirëson edhe më shumë rrugëtimin ndërkombëtar të Kosovës dhe komplikon synimet e saj për integrim në Bashkimin Europian dhe në NATO. Mungesa e konsensusit në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për mbështetjen e propozimit të të dërguarit të posaçëm të OKB-së për statusin e Kosovës, Presidentit Martti Ahtisaari, për shkak të kundërshtimit të Rusisë, e ka detyruar Kosovën që të ndjekë rrugën e njohjeve individuale, për të arritur integrimin e plotë në bashkësinë ndërkombëtare. Rruga për sigurimin e njohjeve individuale është rruga më e vështirë dhe merr më shumë kohë. Kjo po dëshmohet edhe sot në dhjetëvjetorin e pavarësisë së Kosovës sepse deri më tani ka arritur 116 njohje formale që janë të pa mjaftueshme për realizimin e pretendimeve të këtij shteti të ri. Asnjë nga fqinjët e Kosovës nuk kanë arritur më shumë se disa dhjetëra njohje formale bilaterale sepse njohjen e kanë siguruar nëpërmjet Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Kosova duhet të përcjellë rrugët paralele për të arritur – një nga një, numrin më të madh të mundshëm të njohjeve, por po ashtu për t'i përmbushur obligimet në mënyrë që vendi të bëhet anëtar i barabartë i OKB-së dhe BE-së.<sup>28</sup>

Politika e jashtme e Republikës së Kosovës duhet të jetë e orientuar drejt avancimit të vazhdueshëm të pozicionit ndërkombëtar të saj dhe forcimit e përkrahjes ndërkombëtare për sovranitetin e Kosovës dhe njohjen e shtetësisë së saj. Bazuar në deklaratat dhe dokumentet publike të MPJ-së, siguri i njohjes së shtetit të Kosovës është një ndër objektivat kryesore strategjike të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës.<sup>29</sup> Përveç njohjeve, objektivi tjetër strategjik i politikës së jashtme është anëtarësimi i Kosovës në organizatat kryesore ndërkombëtare në të cilat nuk ka arritur ende të anëtarësohet. Imazhi pozitiv ndihmon në forcimin e pozitës së Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe në forcimin e partneritetit strategjik me vendet më të fuqishme demokratike të botës.<sup>30</sup>

MPJ krahas synimeve të saja në drejtim të njohjes ka listuar edhe vështirësitë e shfaqura në këtë proces të cilat ndikojnë në mungesën e rezultateve konkrete. Në bazë të përvojës së MPJ-së ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i pengesave në rrugëtimin diplomatik dhe njohjen ndërkombëtare të shtetit të Kosovës. Ndër pengesat kryesore janë:

---

<sup>28</sup> www.mfa-ks.net, Synimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, hulumtuar me 11.02.2019.

<sup>29</sup> *Po aty..*

<sup>30</sup> *Po aty.*

1. Kundërshtimi i Pakos së Ahtisarit nga anëtarja permanente e Këshillit të Sigurimit-Rusia dhe pamundësia e arritjes së konsensusit në Këshillin e Sigurimit të OKB-së;
2. Mungesa e unitetit në BE rreth pavarësisë së Kosovës, ka krijuar përfytyrimin se Kosova është çështje e pazgjidhur evropiane. Kjo, për shkak të mosnjohjes së deritanishme nga pesë shtetet anëtare: Greqia, Qiproja, Rumania, Sllovakia dhe Spanja;
3. Vlerësimi i gabuar i disa shteteve se pavarësia e Kosovës është rezultat i "shkëputjes" nga një shtet sovran;
4. Kërcënimi i Serbisë ndaj shteteve të vogla me "konsekuenca" në rast të njohjes dhe krijimi i precedentit për shtete me probleme interne;
5. Mungesa e interesit të qartë për njohje nga një numër i madh i vendeve që ende nuk kanë qëndrim të prerë për pavarësinë e Kosovës, të cilat janë larg gjeografikisht dhe politikisht me Kosovën dhe Ballkanin;
6. Zhvendosja e Kosovës nga prioritetet e larta të politikës së jashtme të vendeve mbështetëse dhe zbehja e kujtesës për të kaluarën e Kosovës;
7. Largimi nga skena politike ndërkombëtare e personaliteteve me ndikim gjatë procesit për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës, etj.<sup>31</sup>

Duke analizuar këta faktorë mund të nxjerrim përfundime se shtetet që nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës mund të kategorizohen në disa grupe:

- Shtetet të cilat vazhdojnë të kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës;
- Shtete që shfaqin qëndrime pro dhe kontra brenda kuadrit të BE për Pavarësinë e Kosovës;
- Shtete që nuk e kanë njohur në esencë problemin e Kosovës;
- Shtete aleate tradicionale të Jugosllavisë dhe Serbisë që nuk duan për shkak të Kosovës tu luhatin marrëdhëniet e mira me shtetin serb;

---

<sup>31</sup> [www.mfa-ks.net](http://www.mfa-ks.net), Synimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, hulumtuar me 11.02.2019.

- Shtete të “pa interesuar” për Ballkanin për shkak të largësisë gjeografike;
- Shtetet të cilat kanë dhënë sinjale për njohjen e Kosovës;
- Shtetet që nuk e kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës, por ende nuk kanë dhënë shenja të qarta për njohje;
- Shtetet që kanë qëndrim asnjës;
- Shtetet që nuk janë deklaruar fare <sup>32</sup>

Për të pasur mundësi për të krahasuar numrin e njohjeve, shtetet që na kanë njohur, rajonet prej nga vijnë dhe kontinenteve që ju takojnë do të japim më poshtë në mënyrë tabelore statistikat e hulumtuara në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës.<sup>33</sup>

Tabela e shteteve që kanë njohur Pavarësinë e Kosovës

Nr.	Country	Date of Recognition
1.	Republic of Costa Rica	17.02.2008
2.	United States of America	18.02.2008
3.	French Republic	18.02.2008
4.	Republic of Albania	18.02.2008
5.	Republic of Turkey	18.02.2008
6.	United Kingdom	18.02.2008
7.	Islamic Republic of Afghanistan	18.02.2008
8.	Commonwealth of Australia	19.02.2008
9.	Republic of Senegal	19.02.2008
10.	Federal Republic of Germany	20.02.2008
11.	Republic of Latvia	20.02.2008
12.	Kingdom of Denmark	21.02.2008
13.	Republic of Estonia	21.02.2008
14.	Italian Republic	21.02.2008
15.	Grand Duchy of Luxembourg	21.02.2008
16.	Republic of Peru	22.02.2008
17.	Kingdom of Belgium	24.02.2008
18.	Republic of Poland	26.02.2008
19.	Swiss Confederation	27.02.2008

<sup>32</sup> www.mfa-ks.net, Synimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, hulumtuar me 11.02.2019.

<sup>33</sup> Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës.

20.	Republic of Austria	28.02.2008
21.	Republic of Ireland	29.02.2008
22.	Kingdom of Sweden	04.03.2008
23.	Netherlands	04. 03.2008
24.	Iceland	05. 03.2008
25.	Republic of Slovenia	05. 03.2008
26.	Republic of Finland	07. 03.2008
27.	Japan	18. 03.2008
28.	Canada	18. 03.2008
29.	Principality of Monaco	19. 03.2008
30.	Republic of Hungary	19. 03.2008
31.	Republic of Croatia	19. 03.2008
32.	Republic of Bulgaria	20. 03.2008
33.	Principality of Liechtenstein	25. 03.2008
34.	Republic of Korea	28. 03.2008
35.	Kingdom of Norway	28. 03.2008
36.	Marshall Islands	17.04.2008
37.	Burkina Faso	23.04.2008
38.	Republic of Nauru	23.04.2008
39.	Republic of Lithuania	06.05.2008
40.	Republic of San Marino	12.05.2008
41.	Czech Republic	21.05.2008
42.	Republic of Liberia	30.05.2008
43.	Republic of Sierra Leone	11.06.2008
44.	Republic of Colombia	04.08.2008
45.	Belize	07.08.2008
46.	Republic of Malta	22.08.2008
47.	Independent State of Samoa	15.09.2008
48.	Portuguese Republic	07.10.2008
49.	Montenegro	09.10.2008
50.	Republic of Macedonia	09.10.2008
51.	United Arab Emirates	14.10.2008
52.	Malaysia	30.10.2008
53.	Federated States of Micronesia	05.12.2008
54.	Republic of Panama	16.01.2009
55.	Republic of Maldives	19.02.2009

56.	Republic of Palau	06.03.2009
57.	Republic of Gambia	07.04.2009
58.	Kingdom of Saudi Arabia	20.04.2009
59.	Union of the Comoros	14.05.2009
60.	Kingdom of Bahrain	19.05.2009
61.	Hashemite Kingdom of Jordan	17.07.2009
62.	Dominican Republic	10.07.2009
63.	New Zealand	09.11.2009
64.	Republic of Malawi	14.12.2009
65.	Mauritania	14.09.2010
66.	Kingdom of Swaziland	12.04.2010
67.	Republic of Vanuatu	28.04.2010
68.	Republic of Djibouti,	08.05.2010
69.	Federal Republic of Somalia	19.05.2010
70.	Republic of Honduras	03.09.2010
71.	Republic of Kiribati	29.10.2010
72.	Tuvalu	18.11.2010
73.	State of Qatar	07.01.2011
74.	Republic of Guinea-Bissau	10.01.2011
75.	Sultanate of Oman	04.02.2011
76.	Principality of Andorra	08.06.2011
77.	Central African Republic	22.07.2011
78.	Republic of Guinea	12.08.2011
79.	Republic of Niger	15.08.2011
80.	Republic of Benin	18.08.2011
81.	Saint Lucia	19.08.2011
82.	Gabonese Republic	15.09.2011
83.	Republic of Côte d'Ivoire	16.09.2011
84.	State of Kuwait	11.10.2011
85.	Republic of Ghana	23.01.2012
86.	Republic of Haiti	10.02.2012
87.	São Tomé and Príncipe	13.03.2012
88.	Brunei Darussalam	25.04.2012
89.	Republic of Chad	01.06.2012
90.	Democratic Republic of Timor-Leste	20.09.2012
91.	Independent State of Papua New Guinea	03.10.2012

92.	Republic of Burundi	16.10.2012
93.	Republic of Fiji	19.11.2012
94.	Saint Kitts and Nevis	28.10.2012
95.	Commonwealth of Dominica	11.12.2012
96.	Islamic Republic of Pakistan	25.12.2012
97.	Co-operative Republic of Guyana	16.03.2013
98.	United Republic of Tanzania	29.05.2013
99.	Republic of Yemen	11.06.2013
100.	Arab Republic of Egypt	26.06.2013
101.	Republic of El Salvador	29.06.2013
102.	Kingdom of Thailand	24.09.2013
103.	Grenada	25.09.2013
104.	State of Libya	25.09.2013
105.	Kingdom of Tonga	15.05.2014
106.	Kingdom of Lesotho	11.02.2014
107.	Togolese Republic	02.07.2014
108.	Solomon Islands	05.08.2014
109.	Cook Islands	18.05.2015
110.	Antigua and Barbuda	19.05.2015
111.	Niue	23.06.2015
112.	Republic of Suriname	08.07.2016
113.	Republic of Singapore	01.12.2016
114.	People's Republic of Bangladesh	27.02.2017
115.	Madagascar	24.11.2017
116.	Barbados	15.02.2018

Kosova duhet të intensifikojë më shumë përpjekjet e veta diplomatike përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Integritimit, Ministrisë së Diasporës, ambasadave dhe konsullatave, miqve të Kosovës sidomos SHBA dhe shteteve të fuqishme të Bashkimit Evropian, t'i luftojë sa më shumë faktorët pengues në rrugëtimin ndërkombëtar të saj në mënyrë që të fitojë sa më shumë njohje për të përmbushur numrin e nevojshëm që do t'i hapte rrugë integritit ndërkombëtar, daljes nga izolimi dhe pozicionimit të Kosovës në mesin e demokracive të zhvilluara perëndimore.

Frashër DEMAJ

## DECLARATION OF KOSOVA'S INDEPENDENCE AND THE INTERNATIONAL RECOGNITION

### Summary

*After 78 days of attacks on the Serbian army targets, on June 9, 1999 a political-military agreement was signed between NATO forces and the FRY, known as the Kumanovo Agreement. In the meantime, the UN Security Council adopted Resolution 1244, under which Kosova would be administered. To settle Kosova's status, a long negotiation process began with international mediation. These negotiations took place in Vienna, hosted by the organization of the Contact Group, which under the mandate of the UN Security Council authorized Finnish President Martti Ahtisaari to prepare a comprehensive plan for the future status of Kosova.*

*On February 17 2008, in a festive atmosphere, the Assembly of Kosova declared Kosova a sovereign and independent state. This parliamentary session was attended by 109 of the 120 members of the Assembly of Kosova, who voted unanimously in favor of declaring Kosova an independent and sovereign state.*

*The proclamation of Kosova's independence was carried out in full cooperation and coordination with decision-making factors and international allies led by the United States of America. The first recognitions began just hours after the announcement. The first step for the official recognition of Kosova was made by the Republic of Costa Rica on February 17, 2008 and then on February 18, 2008 by USA, France, Albania, Turkey, UK and Afghanistan. So far (2018), Kosova has been recognized by 116 countries. The Republic of Kosova should intensify its diplomatic efforts further through the Ministry of Foreign Affairs, the Ministry of Integration, the Ministry of Diaspora, embassies and consulates, Kosova's friends, especially the US and the powerful states of the European Union, to gain the recognitions necessary to pave the way for international integration, break the isolation, and position Kosova among the developed western democracies.*

**Key words:** *Kosova, NATO, KFOR, UN, ICJ, Kosova Assembly, sovereign and independent state, Ministry of Foreign Affairs.*



# LIRIA DHE DEMOKRACIA NË REALITETIN E KOSOVËS NË DEKADËN E PARË DHE SFIDAT PËR TË ARDHMEN

Esmeralda Osmani-Kolaneci

## Përmbledhje

*Në fokus të këtij punimi është trajtimi i karakterit demokratik të shtetit të Kosovës dhe sfidat e tij për realizimin e standardeve moderne të qeverisjes, për t'iu bashkuar familjes politike evropiane. Gjithashtu, merret në analizë progresi i padiskutueshëm në zhvillimin dhe promovimin e demokracisë si dhe në ndërtimin e shtetit të së drejtës. Me gjithë entuziazmin e përligjur të orës kulminante të historisë së vet, shteti i Kosovës, edhe pse rendit me krenari një sërë arritjesh substanciale, disa dimensione të jetës shtetërore të tij kërkojnë doemos angazhim tërësor për të konsoliduar respektimin e parimeve universale demokratike dhe sundimin e shtetit të së drejtës. Suksesi i vitalitetit të një shteti bazohet inter alia tek forca e demokracisë dhe lirisë dhe si detyrë e misioni i shenjtë i shteteve post-modernë del gjetja dhe implementimi i modaliteteve, mekanizmave e procedurave që strukturat shtetërore duhet të përfshijnë në politikën e tyre për krijimin dhe garantimin e hapësirave të lirisë për shtetasit, si dhe të parametrave moralë dhe racionalë të njeriut të lirë, mungesa e të cilave përbën pengesë për progresin e integritet evropian.*

*Nuk mund të mos evidentohen përpjekjet serioze të klasës politike të Kosovës për stabilitet politik, qeverisje të qëndrueshme dhe konsolidim institucional. Megjithatë, dekadën e parë të shtetit të tyre të pavarur kosovarët e festuan në një mjedis politiko-social të karakterizuar edhe nga disa shfaqje të mungesës së hapësirave të lirisë së dëshiruar. Shtetet nuk janë qenie perfekte, andaj mangësitë që dallohen hera-herës në mikrokozmosin e demokracisë së Kosovës, kanë bërë që demokracia më e re evropiane të vlerësohet si një demokraci e brishtë, hibride, sui generis. Duhet theksuar se politikëbërja nuk është një makinë deterministe e përsosur. Ajo konsiderohet si një proces evolutiv organizimi dhe administrimi, që zhvillohet dhe përparon duke mbledhur përvojat e veta. Si e tillë shndërrohet në një organizëm vital, ku shtetasit me aftësinë e tyre kritike korrektojnë çdo shfaqje spontane privuese kundrejt progresit të pandalshëm kah standardeve modernë të lirisë e demokracisë autentike. Ky jubile i pavarësisë ka si lejtmotiv për të gjithë shoqërinë politike të Kosovës se liria duhet të hedhe shtat e të forcohet dhe se*

*qytetarët e vendit të shqiptonjave nuk janë spektatorë, por aktorë aktivë në formësimin e një shoqërie të mirëorganizuar në themel të së cilës qëndron koncepti universal i lirisë, drejtësisë, dhe demokracisë.*

**Fjalët çelës:** *Kosova, Liria, Demokracia, Drejtësia, Shtetësia, Politika, Psikologjia Evropiane.*

Të gjithë ne shqiptarët kremtuam dekadën e parë të triumfit të pavarësisë së Kosovës. Akti monumental i shpalljes së saj vlerësohet njëkohësisht si një ndër hapat crucial drejt triumfit të çështjes shqiptare që gjallon prej vitit 1878, vit kur kombi shqiptar hodhi themelin e themeleve të jetës së tij politike moderne.

Në këtë 10 vjetor të pavarësisë së fituar në sajë të përpjekjeve mbinjerëzore të popullit të Kosovës dhe mbështetjes së faktorit ndërkombëtar, kemi gjithë të drejtën e ligjshme të vlerësojmë madhësinë dhe simbolikën e shenjtë të kësaj ngjarjeje, që e ka vendin në piedestalin e historisë së shqiptarëve. Por, bashkë me festën, duhet të ndalemi dhe të trajtojmë me objektivitet e realizëm, arritjet e nivelin e përmbushjes së aspiratave dhe ëndrrave të shndritshme të atyre që luftuan dhe u sakrifikuan, jo vetëm për një shtet të pavarur, por edhe për Kosovën si shoqëri me kulturë demokratike dhe standarde bashkëkohore lirie.

Natyrisht këtë duhet ta bëjmë pa komplekse, duke abstraguar nga entuziazmi folklorik, ekcesiv, apo duke lënë mënjanë flamujt e interesave partikulariste e partiake. Në këtë kumtesë jam ndalur posaçërisht në këto aspekte, me logjikën se një panoramë e realitetit nën llupën e së vërtetës i shërben një të ardhmeje më të begatë dhe prosperitetit social.

Me gjithë euforinë e përlijur të orës kulminate të historisë së vet, shteti i Kosovës, edhe pse rendit me krenari një sërë arritjesh substanciale, disa dimensione të jetës së tij shtetërore kërkojnë doemos angazhim tërësor për të konsoliduar respektimin e parimeve universale demokratike dhe sundimin e shtetit të së drejtës. Suksesi i vitalitetit të një shteti bazohet *inter alia* tek forca e demokracisë dhe lirisë dhe si detyrë e misioni i shenjtë i Kosovës, në këtë fillimdekadë të dytë të ekzistencës së saj, del gjetja dhe implementimi i modaliteteve, mekanizmave e procedurave që strukturat shtetërore duhet të përfshijnë në politikat e tyre për krijimin dhe garantimin e hapësirave të lirisë për shtetasit, si dhe, të parametrave moralë dhe racionalë të njeriut të lirë, mungesa e të cilave përbën pengesë për progresin e qytetërimit dhe për integrimin në strukturat euro-atlantike.

Në nyjat e universit të ligjërimit akademik dhe politik, liria përherë ka qëndruar si kryefjala apo bërthama e ekzistencës së çdo bashkësie shoqërore. Ajo prezantohet si imperativi kategorik i funksionimit dhe kontinuitetit të saj. Liria është kërkesë e perefuzueshme e arsyes praktike dhe njëkohësisht konstitutivja e të vepruarit autonom në realizimin e botës së qëllimeve individuale apo kolektive. Pa garantimin e këtij komponenti *conditio sine qua non*, “lirisë”, pra pa themelin mbi të cilën ngrihet begatia jonë, nuk mund të përfytyrohet respektimi e gëzimi i tërësisë së të drejtave të njeriut. Populli i Kosovës, frymëzuar nga shpresa dhe ëndrra për liri dhe për një jetë më të mirë, më njerëzore, kapërceu kufirin mes lirisë dhe robërisë për t’iu bashkuar shoqërive moderne dhe modelit të demokracive liberale. Demokracia është rendi juridik nëpërmjet të cilit garantohet dhe mbrohet liria e individit, pra formon individin autonom dhe mbi këtë arrihet konsenti shoqëror për të krijuar autonominë dhe lirinë e vetë shoqërisë. Prandaj në shoqëritë moderne liberale ky parim vlerësohet si eleksiri i lirisë dhe autoriteti publik ushtrohet për të lehtësuar procesin e sendërtimit të lirisë së individit.

Por, përgjatë evolucionit politiko-social, si çdo shoqëri në tranzicion, edhe qytetarët e Kosovës në përditshmërinë e tyre kanë hasur deformacione të konsiderueshme në gëzimin e lirisë së shumëpritur. Shkak duket se kanë qenë ambiciet agresive për më shumë pushtet të disa prej eksponentëve të klasës politike apo mentaliteti i tyre, që mbështetet në doktrina fantazmë të politologjisë, duke rrezikuar ta shndërrojnë demokracinë, si sistem politik dhe kulturë sjelljeje, në një fikSION. Demoskopia e opinionit publik tregon pa ekuivoqe se shoqëria kosovare ende e pakonfiguruar dhe e pastrukturuar plotësisht në përmasat dhe standardet e dhura bashkëkohore, po vuan simptomat e një farë ftohtësie sociale, mungese solidariteti dhe po përballon me privacione vështirësitë e rrugës së thepisur e të mundimshme të demokracisë.

Deziluzioni që krijohet hera-herës nga ndodhi dhe zhvillime të caktuara, të cilat krijojnë përshtypjen ireale dhe hedhin hije dyshimi mbi efikasitetin e demokracisë, doemos nuk mund të zbehin progresin e jashtëzakonshëm të shoqërisë kosovare në procesin e fuqizimit e modernizimit të shtetit dhe përpjekjet serioze të klasës politike të saj për stabilitet, qeverisje të qëndrueshme dhe konsolidim institucional. Çfarë ka përshkruar shteti i Kosovës në 10 vite ekzistencë jemi të gjithë koshiente, por interesi i qytetarëve është e ardhmja e tyre. Shqiptarët nuk duan të ndihen qytetarë të dorës së dytë në komunitetin europian,

prandaj dëshirojnë që përfaqësuesit e tyre politikë të mos shpërdorojnë besimin e dhënë, por të përqendrohen në reforma konkrete që përmirësojnë mirëqenien e munguar si dhe kualitetin e jetës sociale.

Megjithatë, shtetet nuk janë qenie perfekte dhe mangësitë që dallohen në mikrokozmosin e demokracisë së Kosovës, kanë bërë që demokracia më e re europiane të vlerësohet si një demokraci e brishtë, hibride, *sui generis*. Vihet re që segmente të strukturave drejtuese që operojnë në mjedisin e demokracive të brishta, me veprimet apo mosveprimet e tyre të papërgjegjshme kanë kontribuar në krijimin e (imazheve) perceptimit se po jetojnë në një demokraci jo demokratike, në një demokraci demagogjike. Duhet theksuar se politikëbërja nuk është një makinë deterministe e përsosur. Ajo konsiderohet si një proces evolutiv organizimi dhe administrimi, që zhvillohet dhe përparon duke mbledhur dhe përgjithësuar përvojat e veta. Si e tillë shndërrohet në një organizëm vital, ku qytetarët me aftësinë e tyre kritike korrektojnë çdo shfaqje spontane privuese kundrejt progresit të pandalshëm kah standardeve modernë të lirisë e demokracisë autentike.

Ecja drejt lirisë është prirje permanente e njerëzimit dhe shoqëritë perëndimore kanë njohur tronditje dhe zhgënjime të mëdha deri në realizimin e saj. Pas përpjekjesh të shumta shekullore njerëzimi mundi të identifikonte e të pranonte lirinë si vlerë universale humane dhe mbi të gjitha të vlerësonte si një zhvillim substancial demokratizimin e saj, por pavarësisht kësaj, jo të gjitha shoqëritë e kanë adoptuar këtë vlerë e virtyt njerëzor dhe kanë kuptuar se liria është atribut inherent i individit, pra thelbi i tij. Filozofi gjerman i shekullit të 20-të, Erich Fromm, theksonte se nuk mjafton vetëm liria politike, por edhe liria si vetërealizim i njeriut, sepse në shpirtin e çdo qenie njerëzore nuk ka gjë më të fortë sesa dëshira instiktive për të qenë i lirë dhe i pavarur. Nuk mund të mohohet se në Kosovë në vetëm një dekadë shtet janë bërë kapërcime epokale, por as edhe nuk mund të pohohet se qytetarët nuk meritojnë më shumë nga politika dhe drejtuesit e tyre. Shumë indikatorë evidentojnë se qytetarët e saj përballen me defiçite lirie e demokracie. Si shqiptare ndiej përgjegjësi, por edhe revoltë kur në përmbajtjen e raporteve të përvitshëm të Freedom House për gjendjen e lirisë në botë vendi shtetase e të cilit jam, por edhe shteti tjetër i kombit tim, kategorizohen me një progres të ngadaltë në indeksin e lirisë, pra në vendet pjesërisht të lira. Në analizën e kësaj organizate, viti 2017 në Kosovë është konsideruar konvulsiv, pasi kriteret vlerësues dhe përcaktues për nivelin e lirisë dëshmojnë për një respekt relativ të lirive politike dhe civile, për një mjedis të ngarkuar nga shfaqje korrupsioni,

nepotizmi, kriminaliteti, etj. Në përmbajtjen e tyre nënvizohet paaftësia e sistemit për të krijuar mekanizma të frytshëm për ta luftuar atë, ndërkohë flitet edhe për një politikë të zhvilluar në një kornizë të ndërsjellët konfliktualiteti. Për rrjedhojë deduktojmë se kosovarët e kremtuan 10 vjetorin e lirisë së tyre politike në një mjedis të karakterizuar nga shfaqje të mungesës së hapësirave të lirisë së dëshiruar, sepse liria, origjina e vetme e vlerave njerëzore, si koncept nuk mund të shkëputet nga trualli pragmatik dhe rrethanat e saj. Kultura qeverisëse e politikës në Kosovë dhe në Shqipëri jo rrallë herë kërkon të imponojë pikëpamjen se njerëzit duhet ta shikojnë lirinë te premtimet dhe fjalimet e tyre klishe dhe jo ta jetojnë. Por liria nuk shihet, ajo duhet të jetohet, sepse është pjesë e pandashme e strukturës tërësore të individit. Qytetarët nuk mund të jenë të lirë kur në vend ka krizë institucionale, ku drejtësia pengohet në përmbushjen e misionit të saj, apo kur funksionarë me peshë të kosiderueshme në qeverisjen e vendit kanë një vizion të deformuar dhe subjektiv për shtetin e së drejtës, lirinë dhe normalitetin. Këto janë dëshmi e gjendjes stacionare të lirisë në të dyja shtetet e shqiptarëve, apo një prelud modest dhe i druajtur cenimesh të lirisë në shkallë më të gjerë.

Realiteti në Kosovë, ashtu si edhe në shumë vende të tjera, tregon se proklamimi dhe garantimi formal i lirive dhe i të drejtave të njeriut nuk nënkupton realizimin e tyre faktik, kur realiteti nuk përputhet me normat ekzistuese. Për kultivimin e lirisë dhe të drejtave të qytetarëve të stipuluara në aktin themeltar juridiko-konstitucional është i nevojshëm krijimi i kushteve të caktuara shoqërore e politike, si dhe zbatimi në mënyrë konsekuente i sistemit të institucionalizuar në tërësinë e tij për mbrojtjen e tyre. Evidentimi i mungesave e vakumeve të tilla, apo ballafaqimi me mohimin dhe shkeljen e hapësirave të lirisë si dhe mbrojtjen efikase të saj në një shtet, e kategorizon atë si një regjim politik jodemokratik ose *quasi*-demokratik. Në shoqërinë kosovare shpesh dëgjohen zëra, këto të artikuluara edhe në segmente të caktuara mediatike, të cilat nëpërmjet fetishizimit të papërligjur të pushtetit, argumentojnë me analiza irracionale se tranzicioni imponon vetvetiu, që për t'u vendosur rregulli, pushteti qeverisës nuk mund t'i shmanget kufizimit të lirisë. Ihtari i demokracisë dhe i të drejtave të njeriut, Thomas Jefferson, theksonte se “një shoqëri që tregton pak liri për pak rregull do t'i humbasë të dyja”. Konstatohet qartë se këto ide, mendime apo pikëpamje të ushqyera nga interesa klienteliste përbëjnë devijim nga standardet moderne të shoqërive të lira.

Populli i Kosovës, me gjithë kalvarin e mundimshëm të përpjekjeve për t'u shkëputur nga ngrica e ferri i politikës diskriminuese, përjashtuese dhe dhunuese serbe, ka përpara sfida të rëndësishme. Ai duhet të manifestojë në vijueshmëri maturitet në kulturën demokratike dhe të ketë si filozofi të jetës politike sentencën monumentale të Abraham Linkoln se demokracia rregullohet me më shumë demokraci. Ne nuk kemi mundësi të ndryshojmë të kaluarën, por mundemi të përmirësojmë të sotmen dhe të projektojmë një të ardhme pa gabimet e mëparshme dhe të metat e identikuara. Në këtë fillim të dekadës së dytë të jetës shtetërore, Kosova ka si pikësynim tejkalimin e këtyre handikape të konstatuara që kërcënojnë demokracinë e saj të cilësohet si demokraci pa liri. Elita politike duhet të impenjohet akoma më shumë në zgjidhjen adekuate të problematikave të shfaqura, të minimizojë mëkatet dhe padrejtësitë e saj, si dhe të mundësojë respektimin e kornizës restriktive ligjore mbi të cilën funksionon sistemi i institucioneve të pavarura. Mjetet dhe rrugët arbitrare që përdoren për të realizuar me makiavelizëm interesat personale janë karakteristikë modelesh të shoqërive që Europa perëndimore dhe bota moderne i konsideron të tejkaluara. Shoqëria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë, të cilat aspirojnë të ecin në një hap me demokracitë funksionale europiane, duhet të instalojnë një sistem efikas që ka si bosht funksionimi lirinë e individit dhe atë institucionale. Shoqëria kosovare, si pjesë e bashkësisë dhe e kulturës kontinentale, aspiro drejt psikologjisë europiane të lirisë. Ajo vlerëson me objektivitet se situata aktuale nuk është veçse një *modus vivendi* provizor, që kapërcehet duke kuptuar (gjykuar) se liria duhet të jetë koncepti bazë i mendimit, arsytimit dhe i kulturës politike të çdo qytetari. Ky jubile i pavarësisë ka si lajtmotiv për të gjithë shoqërinë politike të Kosovës se liria duhet të hedh shtat e të forcohet dhe se qytetarët e vendit të shqiptonjave nuk janë spektatorë, por aktorë aktivë në formësimin e një shoqërie të mirëorganizuar në themel të së cilës qëndron koncepti universal i lirisë, drejtësisë dhe demokracisë.

## **Referencat**

- Andrea Lorenzo Capussela, *State-Building in Kosova - Democracy, Corruption and the EU in the Balkans*, I. B. Tauris and Co Ltd, London, 2015
- Besnik Pula, *Demokracia e Kosovës në rrezik? Paqëndrueshmëria e sistemit partiak, kohëzgjatja e qeverisë dhe kriza institucionale në Kosovë*, Instituti Demokraci për zhvillim, Seria: Zgjedhjet dhe partitë politike, Nr. 11, Prishtinë, 2018
- Edgar Morin, *Europa në mëndje*, Botime ORA, Tiranë 2001
- Erich Fromm, *Arratisje nga Liria*, Shtëpia Botuese “Fan S. Noli”, Tiranë 2016
- Frank Karsten & Karel Beckman, *Beyond Democracy: Why democracy does not lead to solidarity, prosperity and liberty but to social conflict, runaway spending and a tyrannical government*, Published by CreateSpace 2012
- 2016 Country Reports on Human Rights Practices: Kosova (<https://www.state.gov>)
- 2017 Country Reports on Human Rights Practices: Kosova (<https://www.state.gov>)
- Report/Freedom House - Nations in Transit 2018-Kosova* (<https://freedomhouse.org>)

Esmeralda OSMANI-KOLANECI

## FREEDOM AND DEMOCRACY IN KOSOVA'S REALITY IN THE FIRST DECADE AND FUTURE CHALLENGES

### Summary

*The focus of this paper is to address the democratic character of the state of Kosova and its challenges in the realization of modern standards of governance and joining the European political family. It also analyzes the undisputed progress in the development and promotion of democracy, as well as in building the rule of law. Despite the legitimate enthusiasm of the pinnacle of its history, the state of Kosova, while proudly listing a number of substantial achievements, must fully engage to consolidate respect for universal democratic principles and rule of law. The success of a state's vitality is based inter alia on the strength of democracy and freedom, and it is a sacred task and mission for postmodern states to find and implement modalities, mechanisms and procedures that state structures must incorporate into their policies in order to create and guarantee the spaces of freedom for citizens, as well as the moral and rational parameters of free man, the absence of which constitutes to constitute an obstacle to the progress of European integration.*

*The serious efforts of Kosova's political class for political stability, sustainable governance, and institutional consolidation, cannot be overlooked. However, Kosovars celebrated the first decade of their independent state in a political and social environment characterized by some manifestations of the lack of space for desired freedoms. States are not perfect beings, and the deficiencies that are occasionally seen in the microcosm of Kosova's democracy make the newest European democracy to be regarded as a fragile, hybrid, sui generis democracy. It should be noted that policymaking is not a perfect deterministic machine. It is regarded as an evolutionary process of organization and administration, developing and progressing through its own experiences. As such, it is transformed into a vital organism, where citizens, with their critical ability, correct any spontaneous repressive behavior against the unstoppable progress towards modern standards of authentic freedom and democracy. This jubilee of independence must remind all of Kosova's political society that freedom must thrive and be strengthened, and that the citizens of the land of eagles are not spectators, but active actors in shaping a well-organized society on the foundations of the universal concept of freedom, justice, and democracy.*

**Key words:** *Kosova, Freedom, Democracy, Justice, Statehood, Politics, European Psychology.*

# SFIDAT DHE RITJA EKONOMIKE NË KOSOVË NË PERIUdhËN 2008-2018

**Justina Shiroka-Pula**

## **Përmbledhje**

*Ky studim do të shprehë ecuritë ekonomike të kësaj periudhe kohore, duke i analizuar potencialet ekonomike, trendët e zhvillimit të ndërmarrjeve, sfidat, perspektivën dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik. Objektivi kryesor i studimit është testimi i trendit të rritjes ekonomike në periudhën 2008-2018 në rastin e Kosovës, duke përdorur disa nga indikatorët ekonomikë, si: Shpenzimet Publike, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB), Bilanci tregtar (eksport/import), të Ardhurat totale Buxhetore. etj. Metodologjia e përdorur në këtë punim përfshin analizat, të dhënat statistikore dhe krahasimin e rezultateve të arritura. Vlerësimet janë bërë për të dhënat e serive kohore që përfshijnë vitet prej 2008 deri në vitin 2018. Të dhënat për indikatorët ekonomikë vendorë janë marrë nga databaza e Bankës Qendrore, nga Ministria e Financave, Agjencia e Statistikave e Kosovës, Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Ky studim ofron dëshmi që disa indikatorë ekonomikë kanë ndikim të theksuar në rritjen ekonomike dhe janë faktorë shumë të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Pavarësisht këtyre indikatorëve ekonomikë, krijimi dhe zhvillimi i bizneseve të vogla duhet të konsiderohet faktor shtytës i dinamikës zhvillimore, duke rezultuar se ato vazhdojnë të jenë bartëse kryesore të gjenerimit të vendeve të reja të punës. Një nga sfidat me të cilat shteti i Kosovës po përballlet në periudha të ndryshme të zhvillimit është harmonizimi i legjislacionit vendor me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Për këtë arsye janë definuar mirë të gjithë mekanizmat për sigurimin e përshtatshmërisë së Legjislacionit të Kosovës me Acquis-Communaire të Bashkimit Evropian. Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, më 17.02.2018, Kosova u anëtarësua në shumë institucione ndërkombëtare, si në Bankën Botërore (BB), në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Anëtarësimi në këto institucione ka mundur që Kosova të krijojë siguri ekonomike dhe ta rrisë imazhin e saj në tregjet financiare.*

**Fjalët çelës:** Rritja ekonomike, Bilanci tregtar, Mjedisi biznesor, Institucionet Ndërkombëtare

## 1. Dinamika e kategorive ekonomike

Për shkak të nivelit relativisht të ulët të integritimit të Kosovës në ekonominë globale dhe politikave të dobëta fiskale, ekonomia e Kosovës ka qenë e mbrojtur nga kriza ekonomike globale, qe ne vitin 2008 e përfshiu ekonomin botërore.

### 1.1. Ecuritë ekonomike

Përkundër zhvillimit të ekonomisë botërore, sipas raportit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ekonomia e Kosovës në vitin 2007 përjetoi një rritje ekonomike të GDP-së prej 8,3 për qind (e cila rritje në vitin 2008 u karakterizua me 4.5 për qind). Kjo rritje kryesisht u gjenerua nga rritja e konsiderueshme e shpenzimeve publike (qeveritare) e veçanërisht atyre kapitale, edhe pse bilanci tregtar i jashtëm vazhdon të mbetet i lartë.<sup>1</sup> Një pjesë e madhe e progresit ekonomik në ato vite ka qenë i bazuar në ndihmën e donatorëve, asistencat e jashtme, konsumin privat, si dhe flukset e ndihmës së huaj dhe remitancave, të cilat nuk janë bazë për strategji të qëndrueshme ekonomike.<sup>2</sup>

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB ose GDP) është një ndër treguesit kryesorë makroekonomikë për të matur rritjen ekonomike.<sup>3</sup>




Figura 1: GDP-ja reale në Kosovë sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN)

<sup>1</sup> Komisioni Evropian (KE), 2010, *Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën*, për vitin 2010

<sup>2</sup> Shiroka –Pula, J (2013), *Sfida dhe Perspektiva e NVM-ve në Kosovë (Analizë Krahasuese dhe Hulimtim Empirik)*, Republika e Kosovës: MASHT-Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë, fq 54

<sup>3</sup> Produkti i Brendshëm (PBB) përfaqëson vlerën totale të të gjitha mallrave dhe shërbimeve të prodhuara gjatë një periudhe të caktuar kohore, shifrat vjetore të GDP-së shpesh konsiderohen si pikë referimi për madhësinë e ekonomisë.

Pavarësisht rënies së ekonomisë botërore prej 0.8 për qind, Produkti i Brendshëm Bruto në ekonominë e Kosovës në vitin 2009 ishte 3.6 për qind. Pas recesionit ekonomik të vitit 2008-09, në vitin 2010 ekonomia botërore shënoi një kthesë me një rritje vjetore rreth 5 për qind, Produktit i Brendshëm Bruto i ekonomisë së Kosovës ishte rreth 3.3 për qind, ndërsa vlera nominale e GDP-së arriti në 4.2 miliardë euro.

Zhvillimi ekonomik gjatë periudhës 2008-2016, ka qenë brenda parametrave makroekonomik, që pasqyrojnë një situatë stabile si në sektorin fiskal ashtu edhe atë financiar. Gjatë këtyre viteve, Kosova kishte një rritje të aktiviteteve ekonomike, ku vlera nominale e GDP-së ishte rreth 5.73 miliardë euro, me një normë reale të rritjes prej 3.5 për qind, që ishte kryesisht rezultat i rritjes së kërkesës, konsumit privat dhe investimeve.<sup>4</sup>

Ekonomia e Kosovës ka pasur një rritje të vazhdueshme, ku GDP-ja (PBB-ja) e Kosovës për frymë u rrit nga 2,930 euro në 2013, në 3,149 euro në vitin 2016 dhe në 3,285 euro në vitin 2017.




Figura 2: GDP-ja për kokë banori, EUR, për vendet e Ballkanit (2013 - 2019)<sup>5</sup>

Kosova pati rritje të ekonomisë dhe rritje të të ardhurave për kokë banori. Megjithatë, ajo mbetet vendi më i varfër në Evropë në vitin 2017 (pas Malit të Zi 6,262; Serbisë 4,968; Maqedonisë 4,764; Shqipërisë 4,266; Bosnjës dhe Hercegovinës 4,089) dhe larg GDP-së për kokë banori (5,069 euro) për vendet e Ballkanit.<sup>6</sup>

<sup>4</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK): Republika e Kosovës

<sup>5</sup> Po aty: Cia.gov. (2016). *The World Factbook — Central Intelligence Agency*. [online] Available at: <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/kv.html>

<sup>6</sup> Cia.gov. (2016). *The WorldFactbook — Central Intelligence Agency*. [online] Available at:

Çrregullimi i proceseve ekonomike dhe financiare midis ofertës dhe kërkesës së mallrave dhe të shërbimeve, i cili shprehet me rritjen e çmimeve dhe me zhvlerësimin e parasë, është inflacion,<sup>7</sup> i cili në këtë periudhë tranzitore 2008-2018 ka lëvizur nga viti në vit.




Figura 3: Inflacioni në Kosovë (çmimi i konsumit mesatar) sipas FMN (2001 – 2018)

Sipas FMN dhe parashikimeve të tij, inflacioni në vitin 2007 ishte 4.4, në vitin 2008 (9,8), në 2009 (-2.4) dhe në vitin 2017 (1.4).<sup>8</sup> Inflacioni i viteve të fundit është në kuadër të parametrave të arsyeshëm dhe të pranueshëm.

## 1.2. Sektori fiskal

Sa i takon zhvillimit fiskal në vitin 2008, të hyrat e përgjithshme të Qeverisë së Kosovës ishin 942,5 milionë euro, duke pasur një rritje prej 4.4 për qind. Të hyrat buxhetore nga viti 2008 dhe në vazhdimësi u rritën prej 2-4.0 për qind,<sup>9</sup> kështu që në vitin 2017 arritën rreth 1,8 miliard, në vitin 2018 pritet të rritet në më shumë se 2 miliardë (sipas planifikimit të Ministrisë së Financave). Në këta dhjetë vjetët e fundit, pjesëmarrja e të hyrave në GDP-në nominale ishte 37.7 për qind (rreth 35 për qind). Ndërsa, vetëm në vitin 2010 raporti i të hyrave në GDP arriti 26,77 për qind, që shënon nivel më të ulët se mesatarja e rajonit.

<https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/kv.html>

<sup>7</sup> Të gjitha definicionet theksojnë se rritja e qarkullimit të parasë dhe rritja e çmimeve janë dy elemente të kushtëzuara në mes veti, të cilat e përkufizojnë inflacionin

<sup>8</sup> Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN); (<http://www.imf.org/en/Countries/UVK#countrydata>)

<sup>9</sup> Krahasuar me vitin 2007, rritja ishte 25,9 për qind krahasuar me vitin paraprak, në të cilën ndikoi fakti se buxheti përfitoi 75 milionë nga licencimi i operatorit të dytë të telefonisë mobile.

Sa i përket sektorit fiskal,<sup>10</sup> Kosova që nga viti 2008 e në vazhdim u karakterizua me një deficit buxhetor<sup>11</sup> dhe mbetet brenda parametrave të qëndrueshëm buxhetor, prej nga duhet të veçohet se sektori fiskal ka ruajtur disiplinën fiskale dhe kështu e ruajti stabilitetin makroekonomik.

Gjatë vitit 2008 totali i shpenzimeve publike buxhetore kishte një trend të rritjes relativisht të lartë dhe arriti në vlerën prej 950.1 milionë euro. Në këtë vit është rritur pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale në 347,1 milionë, me një pjesëmarrje prej 36.5 për qind.

Në vitin 2009, Kosova kishte filluar një politikë më aktive, në veçanti në fushën e shpenzimeve kapitale, që arritën vlerën prej 40 për qind, që kishin rritje vjetore 15 për qind. *E gjithë kjo erdhi si pasojë e miratimit të Ligjit për Borxhin Publik, që i mundësoi Kosovës të hyjë në obligime kreditore dhe në emetimin e letrave me vlerë, për të financuar deficitin eventual buxhetor.* E mira e këtij ligji ishte se Kosova nuk mund të kalojë shumën e buxhetit publik më shumë se 40 për qind të GDP-së nominale. Prandaj, që nga viti 2014 shpenzimet kapitale kishin rënie prej 22për qind dhe absorbuan rreth 28për qind të gjithsej shpenzimeve. *Zvogëlim i këtyre shpenzimeve ishte si rezultat i përfundimit të projektit Morinë-Merdare.*

Derisa në vitin 2007 pagat dhe mëditjet kishin pjesëmarrjen 31,5 për qind më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme publike, që nga viti 2008 kjo pjesëmarrje ra në 23,9 për qind në gjithsej shpenzime. *Ky rezultat ishte si rrjedhojë e rritjes së shpejtë të shpenzimeve kapitale, që konsiderohen si shpenzime publike. Mirëpo, efektet e shpenzimeve, nga ana tjetër, ndikuan edhe në balancimin e rritjes ekonomike, përkundër krizës financiare.*

Që nga viti 2014 shpenzimet për paga dhe mëditje arritën vlerën prej 485 milionë euro, me një pjesëmarrje të përgjithshme prej 33.15

---

<sup>10</sup> Sa i përket sektorit fiskal, viti 2007 karakterizohet me një suficit buxhetor prej 9,8 për qind të GDP-së ose 241,7 milionë euro, duke u konsideruar një ndër tepricat buxhetore më të larta në rajon. I gjithë ky suficit erdhi si rrjedhojë e politikave të qëndrueshme fiskale, duke mbrojtur një treg stabil të buxhetit të Kosovës.

<sup>11</sup> Buxheti i Kosovës që nga viti 2008 e në vazhdim u karakterizua me një deficit buxhetor 8.1 milionë euro, në kushtet e GDP-së nominale, deficiti buxhetor ishte 0.2 për qind të vlerës të GDP-së nominale, në vitin 2009 (prej 85.5 milionë euro ose 2.2 për qind të GDP-së nominale), në vitin 2010 (prej 93.2 milionë euro), në vitin 2014 (përfaqëson 0,29 për qind të GDP-së ose në vlerë monetare 15 milionë euro), në vitin 2015 (prej 136 milionë euro, që është 2.37 për qind GDP-së).

për qind, me në rritje paraprake për 16.5 për qind. *Kjo rritje erdhi si rezultat i rritjes së pagave nga vendimi i qeverisë i vitit paraprak.*

*Për të nxitur rritjen ekonomike si dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale, Qeveria duhet të jetë e përkushtuar në implementimin e politikave.*

### *1.3. Roli i politikave fiskale*

Politika fiskale janë instrument i rëndësishëm i Qeverisë së Kosovës, përmes të cilit përcaktohen modelet dhe instrumentet për grumbullimin e të hyrave me qëllim të mbulimit të shpenzimeve publike.

Për stabilizimin e rrjedhave politike ekonomike dhe institucionale, menjëherë pas çlirimit, u themelua Autoriteti Qendror Fiskal (AQK),<sup>12</sup> i cili veprimi nën autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve në Kosovë. Pas vitit 2008 është themeluar Këshilli për bartjen e kompetencave, ku AQK është shuar dhe kompetencat janë bartur te institucionet vendore. Në kuadër të transformimit u formua Këshilli Ekonomik dhe Fiskal. Këto dy autoritete (Autoriteti Qendror Fiskal dhe Këshilli Ekonomik dhe Fiskal) kanë ndërtuar një sistem të politikave fiskale,<sup>13</sup> si në shumë vende bashkëkohore.

#### *1.3.1. Tatimet*

Politika tatimore në Kosovë është e orientuar drejt rregulloreve të thjeshta, të cilat sigurojnë bazë të gjerë tatimore dhe parandalojnë evazionin tatimor. Administrata tatimore aplikon tri regjime kryesore të tatimeve: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh); Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK); Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP).

Norma e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) në vitin 2008 deri në vitin 2015 ka qenë 16për qind dhe nga dhjetori 2017 kjo normë paguhet në masën prej 18 për qind nga vlera e tatueshme e importit, hyrjeve brenda dhe furnizimeve të tjera të tatueshme, me përjashtim të furnizimeve të normës zero. Ndërsa, tatimi në të ardhurat e korporatave

---

<sup>12</sup> Autoriteti Qendror Fiskal (AQK) - mbikëqyrje e financave publike, u themelua më 25 korrik 1999

<sup>13</sup> Me terma ekonomikë, Politikat Fiskale janë mjet që shfrytëzojnë të hyrat qeveritare dhe shpenzimet publike me qëllim të sigurimit të barazisë dhe influencimin në parametrat makroekonomikë.

(TAK)<sup>14</sup>nga dhjetori 2017në Kosovë është 10 për qind,<sup>15</sup>tatimi mbi të ardhurën personale (TAP) që nga viti 2008-2009 përkatësisht edhe nga vitet 2010-2018 vazhdon të mbetet i njëjtë.<sup>16</sup>Gjithashtu tatimet dallojnë edhe në bazë të formës së biznesit dhe qarkullimit vjetor.

### 1.3.2. Tarifa doganore

Sistemi doganor i Kosovës paraqet një mekanizëm i rëndësishëm i rimbushjes së buxhetit. Tarifat doganore nga sistemi doganor në Kosovë, është 10 për qind, ndërsa tarifa doganore me CEFTA-n është 0 për qind. Produkteve të importuara i shtohet edhe tatimi mbi vlerën e shtuar prej 18 për qind (0-18 për qind - pemë dhe bimë) dhe 8 për qind (produkte bulmetore, drithëra, industri bluajtëse, produkte farmaceutike) nga vlera e tatueshme e importit.<sup>17</sup>

*Tarifa ngarkon veprimtaritë biznesore në Kosovë. Fushëveprimi i tyre, që nga fillimi, ngarkohet me kosto të lartë ende pa u realizuar-shitur produktet treg. Andaj, ky veprim nga ana e institucioneve qeveritare lidhur me politikat fiskale mund të nënkuptojë pasiguri financiare, investime jo të mjaftueshme dhe pakënaqësi buxhetore.*

## 2. Mjedisi i biznesit në Kosovë

Pavarësisht indikatorëve të tjerë ekonomikë, krijimi i bizneseve të vogla konsiderohet faktor shtytës i dinamikës zhvillimore dhe ato vazhdojnë të jenë bartëse kryesore të gjenerimit të vendeve të reja të punës.

### 2.1. Struktura e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe numrit të punëtorëve

Sipas Administratës Tatimore të Republikës së Kosovës (ATK), numri i bizneseve që është pajisur me numër fiskal që nga vitin 2010

<sup>14</sup> Administrata Tatimore e Kosovës (ATK): Tatimi mbi të ardhurat e korporatave (<http://www.atk-ks.org/tatimet-pensionet/tatimi-mbi-te-ardhurat-e-korporatave/>)

<sup>15</sup> Norma e tatimit në korporata paguhet çdo tre muaj (nga qarkullim vjetor mbi 50,000 euro), i cili është 10 për qind.

<sup>16</sup> Tatimi mbi të Ardhurën Personale (TAP) që nga viti 2008-2009 përkatësisht edhe nga vitet 2010- 2018 është (0 për qind deri në 960 euro/vit; 4 për qind mbi 960 dhe 3000 euro/vit; 8 për qind midis 3001 dhe 5400 euro/vit; 10 për qind mbi 5400 euro/vit)

<sup>17</sup> Portali shtetëror i Republikës së Kosovës (<https://www.rks-gov.net/sq-AL/Bizneset/FinancatTaksatDoganat/Pages/Doganat.aspx>) dhe Trading Economics – (<https://tradingeconomics.com/country-list/personal-income-tax-rate>)

ishte 103,755 biznese, numër ky i cili arrin të rritet në mbi160,000 biznese të regjistruara në vitin 2017.<sup>18</sup>

Një aspekt i rëndësishëm për t'u shqyrtuar është edhe numri i bizneseve të regjistruara dhe të shuara brenda vitit, nga tregu i bizneseve.

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve, gjatë këtyre viteve kemi pasur regjistrim të bizneseve të veprimtarive të ndryshme, që nga viti 2010, kur kishim gjithsej 7,372 biznese të regjistruara dhe 1,382 biznese të shuara, po në këtë vit, numër ky i cili arrin të rritet në 9,381 biznese në vitin 2012, kur janë shuar 1,072, etj.<sup>19</sup>




Figura 4: Numri i bizneseve të regjistruara dhe të shuara deri në vitin 2017

Nga kjo figurë vërejmë se kemi një rritje të vazhdueshme ndër vite të bizneseve të regjistruara në Kosovë, nga të cilat 98.37 për qind janë mikrobiznese, pra biznese që kanë 1-9të punësuar. Në lidhje me strukturën pronësore të ndërmarrjeve, bizneset individuale në mënyrë të qartë dominojnë me 90 për qind, pjesa tjetër janë ortakëri të përgjithshme 3,2 për qind dhe shoqëri me përgjegjësi të kufizuar 5,8 për qind.<sup>20</sup> Përgjithësisht, rreth 65 për qind e totalit të numrit të punonjësve janë të punësuar në bizneset e vogla dhe mikro dhe rreth 40 për qind e tyre operojnë në sektorin tregtar, me investime të vogla dhe joproductive.<sup>21</sup>

*Kjo kategori e bizneseve jo vetëm që nuk janë konkurrencte në tregun ndërkombëtar, por as në atë vendor. Në vitet e fundit, duke i vërejtur trendët ekonomikë dhe situatën aktuale në tregun vendor e sidomos në atë regional, bizneset po tentojnë të ndryshojë strukturën*

<sup>18</sup> Administrata Tatimore e Republikës së Kosovës (ATK); <http://ask.rks-gov.net>.

<sup>19</sup> Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), 2010, 2014, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI); [ask.rks-gov.net](http://ask.rks-gov.net).

<sup>20</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK): Republika e Kosovës; <http://ask.rks-gov.net>.

<sup>21</sup> Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), (2011), "Strategjia e zhvillimit të NVM-ve në Kosovë": Republika e Kosovës, fq.11

ekonomike të vendit, duke ngjallur kulturës kreative të ndërmarrësisë dhe konkurrencës të shëndoshë. Për shkak të mjedisit ende jo shumë të avancuar, institucionet Qeveritarë duhet te jene vigjilent, qe bizneset të përkrahen në forma të ndryshme (me subvencione, kredi të buta dhe me politika të tjera stimuluese), që të vazhdojnë të luajnë rol të rëndësishëm në rrugën drejt ekonomisë moderne dhe tregut të lirë.

## 2.2. Të bërit biznes në Kosovë

Duke ditur rolin dhe rëndësinë e të bërit biznes, institucionet vendore viteve të fundit i kanë kushtuar rëndësi të veçantë përmirësimit të përgjithshëm të ambientit afarist dhe kjo është pasqyruar me përmirësimin e pozitës së Kosovës në raporte të ndryshme. Ambienti i të bërit biznes (TBB – *Doing Business*) është një nga treguesit e gjendjes ekonomike të një vendi. Raporti i TBB është instrument monitorues i progresit dhe regresit vjetor të 183 deri 190 shteteve, që ka filluar të publikohet nga viti 2003 e deri më tani.

Tabela 1: Profili Ekonomik-Kosova, Raporti i të bërit biznes (2010 – 2017)

Indikatorët	2017	2016	2015	2014	2013	2012	2011	2010
Të bërit biznes	44	66	75	86	98	117	119	113
Themelimi i biznesit	13	47	42	100	126	168	163	164
Marrja e lejes për ndërtim	129	136	135	136	144	171	173	176
Marrja e energjisë elektrike	114	124	112	121	120	124	n/a	n/a
Regjistrimi i pronës	33	32	34	58	76	73	65	68
Marrja e kredisë	20	28	23	28	23	24	32	43
Mbrojtja e investitorëve	63	57	62	98	100	174	173	172
Pagesa e taksave	43	67	63	43	44	46	41	50
Tregtia përmes kufijve	51	71	118	121	124	131	130	132
Zbatimi i kontratave	44	48	138	138	138	157	155	157
Zgjidhja e paaftësisë paguese	163	163	164	83	86	31	31	28


Burimi: Banka Botërore (BB), (nga raporti i vitit 2010 deri në vitin 2018), “Raporti i të Bërit Biznes”- (*TBB-DoingBusiness*).

Duke e analizuar performancën e Kosovës me indikatorë TBB (Të Bërit Biznes) vërehet përmirësim i dukshëm i pozitës së saj nëpër vite. Në bazë të këtyre të dhënave, Kosova në të gjithë indikatorët ka pasur përmirësime në pozita krahasuese me ato të vitit paraprak. Më saktësisht, me indikatorin e parë - themelimi i biznesit, është përmirësuar renditja për 131 vende, ndërsa ka pasur shumë pak ndryshim në indikatorin - marrja e kredisë dhe atë vetëm për 23 vende.

Sipas Raportit të TBB për vitin 2018 për vendet e Ballkanit, Kosova radhitet në vendin e 40, Shqipëria në të 65, Maqedonia në të 11, Serbia në të 43, Sllovenia në të 37, Bullgaria në të 50, Kroacia në të 51, Greqia në të 67 dhe Mali i Zi në të 42.<sup>22</sup>

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet renditja e Kosovës dhe vendeve të rajonit në të bërit biznes në vitin 2018.


**Lehtësirat në të bërit biznes (1-190)**



*Figura 5: Renditja e Kosovës dhe vendeve të rajonit në të bërit biznes 2018 - Rangimi i Përgjithshëm*

### 2.3. Shkëmbimi tregtar në Kosovë

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkëmbimi tregtar i Kosovës është dominuar nga importi, me një nivel relativisht të vogël të eksportit, që rezulton me një deficit të lartë tregtar.<sup>23</sup> Rritja e konsiderueshme e importeve nuk është duke u përcjellë me rritjen adekuate të eksporteve. Bilanci tregtar është vetëm një nga problemet ekonomike me të cilat po ballafaqohet Kosova.



*Figura 6: Bilanci tregtar në Kosovë, sipas viteve*

<sup>22</sup> BB (Banka Botërore), (2018), “Raporti i Të Bërit Biznes”- (TBB-Doing Business), fq.4

(<http://www.doingbusiness.org/~media/WBG/DoingBusiness/Documents/Annual-Reports/English/DB2018-Full-Report.pdf>)

<sup>23</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK): Republika e Kosovës

Në bazë të të dhënave zyrtare, importet në Kosovë në vitin 2010 kanë shënuar vlerë prej 2.1 miliardë euro, në vitin 2011 (2,492 miliardë euro), në vitin 2012 (2,489 miliardë euro), ndërsa në 11 muajt e parë të vitin 2017 ka pasur më së shumti importe, në vlerë prej 2,749 miliardë euro (2.749.892.000 euro).

Ndërsa eksportet gjatë vitit 2010 kanë qenë 295 milionë euro, në vitin 2011 (319 milionë euro), ndërsa në vitin 2012 (268 milionë euro), nga ku shihet që ka një rënie të konsiderueshme për 15.8 për qind në raport me vitin 2011. Gjatë vitit 2012 është përkeqësuar edhe më tej gjendja e bilancit të tregtisë së jashtme, pasi që gjatë këtij viti është shënuar ulje e madhe e eksporteve, si rezultat i rënies së çmimit të metaleve në berzë. Eksporti më i madh gjatë gjithë këtyre viteve u realizuar gjatë 11 muajve të vitit 2017, me 348.5 milionë (348.529.000) euro. Një shumë të përafërt e ka pasur edhe gjatë vitit 2015, mirëpo gjatë vitit 2016 ka pasur një rënie të eksportit në krahasim me vitin 2015.<sup>24</sup>

Sipas këtyre të dhënave vërejmë se Kosova çdo vit e më shumë është në trend të rritjes së bilancit tregtar, që është një tregues shumë i mirë për ekonominë e një vendi, sepse, përveç qarkullimit të shtuar tregtar, ky trend tregon se vendi çdo herë e më shumë po e rrit bashkëpunimin me vende të ndryshme. Përmirësimi i bilancit tregtar në vitet e fundit nuk shpreh rritjen e vlerës së madhe të eksportit (pasi që vlera e eksporti ka bazë shumë të ulët), por nënkupton se, sado të vogla të jenë luhatjet apo ulja e vlerës në nivel të importit, është faktor përcaktues në raportet import/eksport në bilancin tregtar të Kosovës. Partnerë kryesorë të Kosovës në tregtinë e jashtme janë Bashkimi Evropian (BE) dhe vendet anëtare të CEFTA-as.

**Tabela 2:** Bilanci tregtar i Kosovës me BE-në, CEFTA dhe të tjerë (në %)

Grup-vendet	EXP/IMP	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
BE	eksp	47.8%	43.1%	44.5%	43.0%	38.4%	39.4%	30.2%
	imp	36.2%	39.0%	38.0%	38.0%	38.7%	41.3%	42.6%
CEFTA	eksp	30.9%	32.3%	23.5%	26.0%	36.8%	36.4%	39.2%
	imp	37.5%	35.7%	37.0%	35.0%	33.7%	30.6%	28.4%
Të tjerë	eksp	21.3%	25.2%	32.0%	31.0%	24.8%	24.1%	30.6%
	imp	26.2%	25.0%	24.5%	27.0%	27.6%	28.1%	29.0%

*Burimi:* Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), Republika e Kosovës.

<sup>24</sup> <http://ask.rks-gov.net/media/3750/statistikat-e-tregtis%C3%AB-s%C3%AB-jashtme-n%C3%ABntor-2017.pdf>

Gjatë vitit 2014 produktet e importuara nga vendet e BE-së arrinin vlerën e 42.6 për qind të GDP-së, krahasuar me 36.2 për qind në vitin 2008 ose 38.7 për qind në vitin 2012), nga vlera totale e importit, me rritje prej 2.6për qind në raport me 2008. Importet me pjesëmarrje më të lartë nga vendet e BE- së ishin nga: Gjermania (14.6%), Italia (5.7%), Rumania (3.0%), Greqia (2.8%), etj.<sup>25</sup>

Mirëpo,sa i përket eksporteve, pjesa më e madhe e mallrave ka shkuar drejt vendeve të BE-së, me 44.5 për qind në vitin 2010.Më pas ka trend të rënies, në vitin 2014 arrin 30.2 për qind, që do të thotë pëson rënie prej 14.3 për qind. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE-së janë: Gjermania (6.2%), Holanda (3.9%), Britania e Madhe (3.6 %), Bullgaria (2.7%), etj.

Eksporti në vendet e CEFTA-s pësoi një rënie të konsiderueshme nga viti 2008 (kur ishte 30.9 për qind), në 23.5 për qind në vitin 2010. Ky eksport më pas arrin vlerën 39.2 për qind në vitin 2014. Partnerë kryesorë për eksport në vendet e CEFTA-s janë: Shqipëria (17.7%), Maqedonia (9.6%), Serbia (5.5%), Mali i Zi (5.5%).<sup>26</sup>

Ndërsa importi nga vendet e CEFTA-s në të njëjtën periudhë arrin vlerën e 28.4për qind në vitin 2014, krahasuar me 37 për qind në vitin 2010. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import nga vendet e CEFTA-s ishin: Serbia (15.7%), Maqedonia (4.2%), Shqipëria (3.7%) dhe B&H (2.7%).<sup>27</sup> Importet e Kosovës me vendet e tjera arritën në 79,9 milionë euro ose 26.2 për qind për qindn ë vitin 2008, i cili import më pas arriti vlerën29për qind në vitin 2014. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Kina (9.6%) dhe Turqia (8.5%).<sup>28</sup>

Ndër vendet me pjesëmarrje më të lartë me import nga vendet e CEFTA-s, në vitin 2008, e kishim Kroacinë, Serbinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën, trend që vazhdoi edhe për vitin 2015. Importin më të ulët nga vendet e CEFTA-s po vazhdojmë ta kemi me Malin e Zi, Shqipërinë dhe Maqedoninë.

<sup>25</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK): Republika e Kosovës

<sup>26</sup> Në muajin dhjetor 2017, eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 11,9 milionë euro, ose 40.5% të eksporteve të përgjithshme, që është një rënie prej (-0.5%).

<sup>27</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK): Republika e Kosovës.

<sup>28</sup> Po aty, ASK




Figura 7: Importet me shtetet anëtare në Cefta dhe Turqinë (në milionë euro) <sup>29</sup>




Figura 8: Eksporti me shtetet anëtare në CEFTA dhe Turqinë (në milionë euro) <sup>30</sup>

<sup>29</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK): Republika e Kosovës, [http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata\\_\\_Country%20and%20regional%20data/rade\\_eurostat03.px/table/tableViewLayout1/?rxid=0b4e087e-8b00-47ba-b7cf-1ea158040712/](http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/askdata__Country%20and%20regional%20data/rade_eurostat03.px/table/tableViewLayout1/?rxid=0b4e087e-8b00-47ba-b7cf-1ea158040712/)

<sup>30</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK): Republika e Kosovës.

Ndër vendet me pjesëmarrje më të lartë me eksport me vendet e CEFTA-s, në vitin 2008, i kishim Kroacinë, Serbinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën. Ky trend vazhdoi edhe për vitin 2015. Eksportin më të ulët me vendet e CEFTA-s, që nga viti 2008 e deri në vitin 2015, po vazhdojmë ta kemi me Malin e Zi, Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Në përgjithësi, pjesëmarrja e Turqisë në portfolionë e përgjithshme tregtare të Kosovës është rritur nga 6.17 për qind në vitin 2008, në 7.66për qind në vitin 2012. Pjesëmarrja e Turqisë në portfolionë e eksportit të Kosovës është rritur nga 1.53për qind, sa ishte në vitin 2008, në 4.22për qind në vitin 2012. Një rritje e ngjashme ka ndodhur edhe me pjesëmarrjen e Turqisë në portfolion e importit të Kosovës, ku nga 6.65për qind në vitin 2008, pjesëmarrja e Turqisë në këtë portfolio u rrit në 8.04 për qind në vitin 2012.




Figura 9: Eksportet /Import - në milionë euro sipasviteve<sup>31</sup>

Turqia është i vetmi vend me të cilin Kosova e ka rritur integrimin si në importe ashtu edhe në eksporte. Kjo rritje në të dy treguesit lidhet me përpjekjet e Turqisë për të hapur tregjet drejt ekonomisë kosovare, por edhe ngjashmëria kulturore sjell qasjen e konsumatorëve nga produktet dhe shërbimet e ofruara reciprokisht.

Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 42.8 për qind të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre dhe 12.3 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, ndërsa 15.3 për qind të importit e përbëjnë produktet minerale; 14.2 për qind makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, 13.3 për qind ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani. 13.0 për qind e përbëjnë mjetet e transportit, etj.

<sup>31</sup> Po aty

### 3. Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare

Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, Kosova bëhet anëtare në shumë institucione ndërkombëtare: në Bankën Botërore (BB) më 29 qershor 2009, në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN)<sup>32</sup> më 6 maj 2009 dhe në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) më 17 dhjetor 2012. Anëtarësimi në dy institucione më të rëndësishme financiare (BB dhe FMN) do t'i mundësojë Kosovës të krijojë siguri ekonomike dhe ta rrisë imazhin e saj në tregjet financiare.

#### 3.1. Banka Botërore (BB)

Banka Botërore që nga fillimi ka financuar kryesisht projektet që kanë qenë të fokusuar në fushën e biznesit dhe të orientuar për të përmirësuar konkurrencën.<sup>33</sup> Ndërsa për projektet energjetike të Kosovës, ka qenë një strategji në vazhdimësi nga ana e Bankës për të nxitur zhvillimin ekonomik, si dhe për të përmirësuar dhe menaxhuar mjedisin.<sup>34</sup> Sidomos ishin në fokus Projektet e Eficiencës së Energjisë dhe Energjisë së Ripërtërishme, projekte të cilat synojnë të reduktojnë përdorimin e lëndëve djegëse fosile. Në këto projekte Kosova është përkrahur në përmirësimin e mjedisit politik dhe rregullator për energjinë e rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë.<sup>35</sup>

#### 3.2. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)

Fondi Monetar Ndërkombëtar siguron stabilitetin e sistemit monetar ndërkombëtar, sistemin e kursit të këmbimit dhe pagesat ndërkombëtare, si dhe monitoron politikat ekonomike dhe financiare.

---

<sup>32</sup> Nga 185 vende anëtare, rreth 100 vende kanë votuar për pranimin e Kosovës.

<sup>33</sup> Projektet aktive (US \$, milion) janë: Projekti i Kadastrit dhe Regjistrimit të Pasurive të Patundshme, Projekti i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Projekti i Eficiencës së Energjisë dhe Energjisë së Ripërtërishme, Projekti Shëndetësor i Kosovës, Projekti i Përmirësimit të Sistemit të Arsimit, Projekti për Sigurinë e Ujërave dhe Kanalizimeve, Projekti i Konkurrencës dhe Gatishmërisë së Eksportit.

<sup>34</sup> Të gjitha projektet e mbështetura nga Banka përpara anëtarësimit të Kosovës në Grupin e Bankës Botërore (WBG) në vitin 2009 u financuan përmes granteve nga një sërë burimesh, kryesisht të ardhurat neto të Bankës, Fondit të Mirëbesimit për Kosovën, Fondit pas Konfliktit dhe Zhvillimit Ndërkombëtar Shoqata (IDA). Që nga shtatori 2017, portofoli aktiv i kreditimit të IDA-s arriti në rreth 161 milionë dollarë për shtatë projekte në fushën e energjisë, arsimit, kadastrës, bujqësisë, shëndetësisë, konkurrencës dhe ujit.

<sup>35</sup> Po aty: Banka Botërore, Tetor 2017; (<http://www.worldbank.org/en/country/Kosova/overview#2>)

Pra, Fondi<sup>36</sup>përfshin të gjitha çështjet e sektorit makroekonomik dhe financiar që mbajnë stabilitetin global.

Fondi Monetar Ndërkombëtar do të ndihmojë Qeverinë e Kosovës në hartimin e politikave makroekonomike, hartimin e strategjisë për zhvillim ekonomik, e gjithë kjo me qëllim të zbutjes së papunësisë në Kosovë.<sup>37</sup> Qeveria e Kosovës, sipas këtij mekanizmi të lartë ndërkombëtar, po tenton të krijojë politika fiskale, në atë mënyrë që buxheti i konsoliduar i Kosovës, edhe ashtu i varfër, të jetë i qëndrueshëm. Gjithashtu, FMN mund ta ndihmojë Kosovën për investime afatgjata në të ardhmen.<sup>38</sup>

Ky mekanizëm përkrah dhe tenton t'i mbështesë iniciativat ekonomike në përgjithësi dhe me rastin e lejimit të kredive të ndryshme, duke tentuar që të bëhen reforma të caktuara në politikën fiskale, si për shembull me rastin e privatizimit të ndërmarrjeve apo me rastin e deficitit në bilancin e pagesave.

### 3.3. *Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)*

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)<sup>39</sup> është institucion financiar që mbështet projekte në shtetet e Evropës dhe ato të Azisë Qendrore.<sup>40</sup>BERZH është investitori më i madh në regjion, që përkrah zhvillimin konkurrues të sektorit privat, mundëson financim për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), për korporatat në Kosove, duke bashkëpunuar për këtë qëllim me bankat partnere lokale.

BERZH-i do të vazhdojë me vendosjen e kornizave të synuara, si për shembull: Programi i Grave në Biznes dhe Fondi i Financimit të Qëndrueshëm të Ballkanit Perëndimor, si dhe do të ofrojë shërbime këshillimore për biznesin.

Projektet e zhvilluara në Kosovë nga BERZH-i janë: 52 projekte me 226 milionë euro investime, prej të cilave 25 për qind (përfshijë 13 projekte) janë realizuar në sektorin privat. Nga numri i tërësishëm i projekteve, vetëm 27 projekte janë aktive me 150 milionë euro vlerë.<sup>41</sup>

<sup>36</sup> Sot Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka 189 shtete anëtare

<sup>37</sup> Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN); (<http://www.imf.org/en/About>)

<sup>38</sup> DeutscheWelle – (Albanian) Zhvillimi i Kosovës nga FMN (<http://www.dw.com/sq/fmn-synon-zhvillimin-ekonomik-t%C3%AB-kosov%C3%ABs/a-2589759>)

<sup>39</sup> Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka 66 shtete anëtare

<sup>40</sup> BERZH, Themelimi, Produktet dhe Shërbimet (<http://www.ebrd.com/what-we-do/products-and-services.html>)

<sup>41</sup> Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH); (<http://www.ebrd.com/Kosova-data.html>)

Projektet e investuara nga BERZH-i në Kosovë që nga viti 2012-2017 (39 projekte) janë: katër në vitin 2012, 10 në vitin 2013, gjashtë në vitin 2014, nëntë në vitin 2015, tetë në vitin 2016, ndërsa në vitin 2017 ka rënë në 2.<sup>42</sup>

#### 4. Harmonizimi i legjislacionit vendor me legjislacionin e BE-së

Kosova vazhdimisht ka punuar që sistemi legjislativ i vendit të jetë në përputhje me direktivat e BE-së. Për këtë arsye janë definuar mirë të gjithë mekanizmat për sigurimin e përshtatshmërisë së *Legjislacionit të Kosovës me Acquis-Communautaire të Bashkimit Evropian*.

Një nga sfidat me të cilat shteti i Kosovës po përballlet në periudha të ndryshme të zhvillimit është harmonizimi i legjislacionit vendor me legjislacionin e BE-së lidhur me politikat fiskale. Procesi i zhvillimit buxhetor duhet të ketë parasysh respektimin e rregullës fiskale, ku deficitin e përgjithshëm buxhetor nuk duhet të kalojë 2 për qind të Bruto Produktit Vendor (BPV).

Në kuadër të legjislacionit në Kosovë, do të cekim edhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), e cila u themelua si një organ i pavarur publik që ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në bazë Ligjit të Kuvendit të Kosovës Nr. 04/L-034, mbi AKP-në. Kjo agjenci është pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), e cila ka funksionuar që nga viti 2003, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, që kishte objektiv privatizimin e ish-ndërmarrjeve shtetërore. AKP, në përputhje me Ligjin e vjetër nr.03/L-067, më 26 gusht 2008, mbajti mbledhjen inauguruese ku të gjitha kompetencat e AKP-së i janë dhënë Bordit të Drejtorëve.

*AKP kishte dhe vazhdon të ketë në plan që të kryejë me sukses procesin e privatizimit, përmes spin-off-it ose likuidimit vullnetar dhe rivitalizimin e ekonomisë kosovare. Ky proces është duke u realizuar në mënyrë të ngadalshme dhe efektet e tij ekonomike nuk janë ato që ishin parashikuar në fillim.*

Kosova është nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE), që është një hap i rëndësishëm në harmonizimin e legjislacionit të Kosovës në sektorin e energjisë me atë të BE-së. Nënshkrimi i këtij traktati është detyrim i Kosovës që t'ju përmbahet obligimeve që vijnë nga direktivat e BE-së. *Gjithashtu, duhet potencuar se hartimi dhe zbatimi i infrastrukturës ligjore, sidomos në fushën e energjisë në*

---

<sup>42</sup> Po aty: BERZH; (<http://www.ebrd.com/Kosova-data.html>)

*Kosovë, është një ndër përparësitë më të mëdha në zhvillimin e politikave energjetike.*

Sipas Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), (2015), ende vazhdon të ketë mospajtime e sidomos pengesë politike në mospranimin e KOSTT-it si anëtar me të drejta të plota në European Network of Transmission System Operators for Electricity (ENTSO-E).

## 5. Kosova në proceset evropiane

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, më 17.02.2018, institucionet nuk patën përkushtim dhe një qëndrim të qartë sa i përket përfaqësimit të Kosovës në marrëveshjet ndërkombëtare. Kosova nuk kishte proces të njëjtë të anëtarësimit në BE sikur që e patën vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, për shkak të 5 vendeve që nuk e njohin pavarësinë e saj. Procesi i stërzgatur për Ballkanin Perëndimor po e vë në pyetje edhe kredibilitetin e vet procesit. *Prandaj, duhet të vazhdojmë dhe të kemi politika dhe angazhim proaktiv duke kërkuar mbështetje më të fortë nga BE-ja dhe angazhim serioz nga vendet kandidate, përkatësisht Ballkanit Perëndimor, për t'i propozuar Kosovës rrugë më të shpejtë për integrimin në BE.*

### *5.1. Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore- Central European Free Trade Agreement (CEFTA)*

CEFTA konsiderohet si një ndër marrëveshjet e para multilaterale. Kosova është pjesë e CEFTA-s që nga 26 korriku 2007.<sup>43</sup> Anëtarësimi në CEFTA paraqet një mekanizëm tranzitor drejt Bashkimit Evropian. Anëtarësimi në CEFTA, jo vetëm që zgjeron tregun për Kosovën, nga një treg prej 2 milionë banorësh në një treg prej 20 milionë banorësh, por është një mundësi shumë e madhe përthithjen e investimeve të huaja direkte. Anëtarësimi në CEFTA ishte një mundësi e madhe që iu ofrua, pasi që Kosova nuk ishte e obliguar t'i plotësojnë të gjitha kriteret, por vetëm të zotohet që këto kriteret do t'i plotësojnë në vazhdimësi.

*Kosova nënshkroi marrëveshjen e CEFTA-s pa asnjë kusht. Edhe pse është e lejuar që palët negociuese të vendosin kuota për produkte të caktuara, me qëllim që të mbrojnë prodhuesit vendorë, mosvendosja e kuotës që në fillim paraqiti problem tek prodhuesit vendorë, të cilët nuk*

<sup>43</sup> Marrëveshjen e CEFTA-s në emër të Kosovës atë kohë e nënshkroi UNMIK-u (më 19 dhjetor 2006), si autoriteti i vetëm i cili kishte të drejtë ta përfaqësojë Kosovën në marrëdhëniet me jashtë

ishin konkurrentë në tregun e tyre, meqenëse produktet e importuara ofrojnë çmime më konkurruese.<sup>44</sup>

### 5.2. Tregu i Përbashkët Ballkanik

Tregu i Përbashkët Ballkanik nënkupton marrëveshjen apo iniciativën midis CEFTA-s dhe MSA-së. Ky treg përfshin gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe është mekanizëm përmes të cilit mund të aktivizohen potenciale të reja të rritjes ekonomike. Prandaj, ky treg duhet të marrë për bazë iniciativat e deritashme të rajonit për të qenë pjesë e tregut nëpërmes CEFTA-s, harmonizimin e legjislacionit dhe strukturat e tyre institucionale me ato të BE-së.

### 5.3. Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim – MSA

Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim është marrëveshje ndërkombëtare e lidhur ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, qëllimi i së cilës është themelimi i marrëdhënies formale dhe kontraktuale ndërmjet dy palëve, me qëllim të anëtarësimit të Kosovës në BE. Kjo nënkupton arritjen e stabilitetit në rajon dhe krijimin e një tregu të lirë, si mundësi që ekonomitë e aftatë konkurrojnë në tregje evropiane. *Pra, MSA nënkupton efekte shumëdimensionale, si ato politike, juridike dhe ekonomike.*

Procesi negociator ka filluar më 28 tetor 2013, proces që u përshpejtua me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE-në, më tetor 2015. Nënshkrimi i MSA-së u bë më 27 tetor 2015 në Strasburg. Kuvendi i Republikës së Kosovës ratifikoi Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociim, më 2 nëntor 2015, dhe kjo marrëveshje hyni në fuqi që nga 1 prilli 2016.

### 5.4. Raporti i Progresit (RP)

Raporti i Progresit është një dokument i rëndësishëm nga Komisioni Evropian (KE) për secilin vend të Ballkanit Perëndimor drejt Bashkimit Evropian në kuadër të Procesit të Stabilizim Asociimit (PSA-së). Përmes këtij dokumenti vlerësohet gjendja ekonomike, politike dhe

---

<sup>44</sup> Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina, që nga 4 dhjetori 2008, jo vetëm që ndaluan eksportin e produkteve kosovare, por dhe shfrytëzimin e territorit të tyre për tranzit. Shkak për këtë u bë ndryshimi i vulave doganore të Kosovës, nga Doganat e UNMIK-ut në Doganat e Kosovës. Këtë ndërrim të vulave, këto dy shtete e konsideruan si shkelje të marrëveshjes së CEFTA-s. Me këtë bllokadë kompanitë u detyruan t'i shfrytëzonin vendet e treta për t'u integruar në tregun rajonal dhe kështu u ul niveli i eksportit për 9.8 për qind.

sociale në vend<sup>45</sup> për të gjitha vendet kandidate apo kandidatët potencialë për anëtarësim në BE.

Një kohë të gjatë marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe BE-së rregulloheshin përmes Raportit të Progresit (RP) dhe Procesit të Dialogut të Stabilizim Asociimit. Procesi i Stabilizim Asociimit (PSA) është politikë kyçe e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor, me qëllim të anëtarësimit të tij në BE.<sup>46</sup>

Instituti GAP kishte publikuar një analizë ku janë krahasuar Raportet e Progresit nëpër vite. Raporti më pozitiv për Kosovën ka qenë ai i vitit 2006, ku shumë fusha janë potencuar me progres të mirë, kurse raporti më negativ i paraqitur ndonjëherë për Kosovën është ai i vitit 2009. Raporti më pozitiv pas shpalljes së Pavarësisë është ai i

vitit 2010. Mirëpo, ky raport nuk merr të njëjtin nivel të vlerësimit sikurse ai i 2006 dhe 2007.<sup>47</sup>

Të gjitha dokumentet nga Komisioni Evropian (Raporti i Progresit për Kosovën), në masë të madhe ndjekin strukturën e njëjtë sikurse në vitet paraprake: Analizojnë gjendjen në Kosovë në kontekst të kriterëve politike dhe ekonomike, përshkruajnë marrëdhëniet mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian, si dhe shqyrtojnë kapacitetin e Kosovës për të zbatuar standardet evropiane, d.m.th për përafrimin gradual të legjislacionit dhe politikave me ato të *acquis*.<sup>48</sup>

Kosova në të gjitha dokumentet ka dëshmuar përkushtimin e saj për normalizimin e marrëdhënieve me shtetet fqinje, përmes arritjes së një numri marrëveshjesh të rëndësishme, siç është luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, zhvillimin dhe rritjen e ekonomisë, zbatimin e ligjeve dhe forcimin e sistemit të drejtësisë, etj. Kjo

<sup>45</sup> Raportet analizojnë situatën *politike* të këtyre vendeve për sa i përket fushave siç janë: demokracia, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut, mbrojtja e pakicave dhe çështjeve rajonale. Gjithashtu, situata *ekonomike* e secilit vend për zbatimin e standardeve evropiane, që do të thotë përafrimin e legjislacionit dhe politikave të saj me ato Acquis Communautaire të BE-së.

<sup>46</sup> Kosova ka qenë pjesë e procesit integruar të Ballkanit Perëndimor qysh nga viti 2002, kur ka filluar procesi i Mekanizmit Përcjellës të Procesit të Stabilizim Asociimit. Në vitin 2009, ky proces është avancuar në Dialogun e Procesit të Stabilizim Asociimit. Sidoqoftë, asnjëri nga këto dy mekanizma nuk kanë qenë instrumentet zyrtare të Bashkimit Evropian për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE.

<sup>47</sup> GAP, (nëntor 2010), ‘Raportet e Progresit për Kosovën’: Prishtinë

<sup>48</sup> Komisioni Evropian (KE), Raporti i vitit 2016 për Kosovën; (Bruksel, 8.10.2014)

nënkupton zotimin e institucioneve për përmbushjen e të gjitha kërkesave për liberalizimin e vizave dhe integrimin në këtë mekanizëm.

Mirëpo, Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2017<sup>49</sup> vazhdon të potencojë disa kushte, të cilat janë theksuar në vazhdimësi nga Komisioni Evropian. *Krimi i organizuar dhe korrupsioni vazhdojnë të jenë shqetësuese për vendin. Gjithashtu, shqetësuese janë edhe raportet e të drejtave të njeriut dhe mos avancimi i arsimit si një shtyllë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik.*

### Përfundim

Kosova është një ekonomi tranzitore, prandaj rekomandojmë që qeveria të fokusohet në shpenzimet publike, si një faktor ekzogjen për të përmirësuar në vazhdimësi mjedisin biznesor, në nxitjen e reformës ekonomike, në avancimin e infrastrukturën ligjore, e cila do të mundësojë përkrahjen e sektorit privat.

Me këtë analiza mund të arrijmë në përfundimin se ekzistojnë dy bazamente për të cilat duhet të angazhohemi:

- ❖ Nxitjen e parametrave makroekonomikë dhe shfrytëzimi i kujdesshëm i instrumenteve ekonomike, jo vetëm që do ta stimulojë rritjen ekonomike, por duhet të mbetet një prej prioriteteve me rëndësi të veçantë për politikëbërësit në Kosovë.
- ❖ Në anën tjetër, Kërkohe një vullnet politik dhe këmbëngulësi nga të gjitha institucionet e sidomos institucionet e shtetit të Kosovës të ndër marrin masa dhe të aktivizojnë të gjitha mekanizmat, në mënyrë që të investohet në fuqizimin e sundimit të ligjit në funksion të luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, për t'i plotësuar kushtet e vëna nga Komisioni Evropian (për Kosovën), i cili synim ka të bëjë me liberalizimin e vizave dhe me integrimin në Bashkimin Evropian.

### Referencat

- Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK): Republika e Kosovës; <http://ask.rks-gov.net>.
- ASK: Cia.gov. (2016). *The World Factbook — Central Intelligence Agency*. [online] Available at;

<sup>49</sup> Komisioni Evropian (KE), Raporti i vitit 2017 për Kosovën; (Bruksel, 2017)

<https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/kv.html>.

- Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), 2010, 2014, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI); [ask.rks-gov.net](http://ask.rks-gov.net).
- Administrata Tatimore e Republikës së Kosovës (ATK); <http://ask.rks-gov.net>.
- Administrata Tatimore e Kosovës (ATK): Tatimi mbi të ardhurat e korporatave; (<http://www.atk-ks.org/tatimet-pensionet/tatimi-mbi-te-ardhurat-e-korporatave/>).
- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Themelimi, Produktet dhe Shërbimet; (<http://www.ebrd.com/what-we-do/products-and-services.html>).
- Banka Botërore (BB), (2018), “Raporti i të bërit biznes”- (TBB-*Doing Business*); (<http://www.doingbusiness.org/~media/WBG/DoingBusiness/Documents/Annual-Reports/English/DB2018-Full-Report.pdf>).
- Banka Botërore (BB), Tetor 2017; (<http://www.worldbank.org/en/country/Kosova/overview#2>).
- Deutsche Welle – (Albanian) Zhvillimi i Kosovës nga FMN; (<http://www.dw.com/sq/fmn-synon-zhvillimin-ekonomik-t%C3%AB-kosov%C3%ABs/a-2589759>).
- Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN); (<http://www.imf.org/en/Countries/UVK#countrydata>).
- Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN); (<http://www.imf.org/en/About>).
- GAP, (nëntor 2010), ‘*Raportet e Progresit për Kosovën*’: Prishtinë.
- Komisioni Evropian (KE), 2010, Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën, për vitin 2010.
- Komisioni Evropian (KE), Raporti i vitit 2016 për Kosovën; (Bruksel, 8.10.2014).
- Komisioni Evropian (KE), Raporti i vitit 2017 për Kosovën; (Bruksel, 2017).
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), (2011), “*Strategjia e zhvillimit të NVM-ve në Kosovë*”: Republika e Kosovës.
- Portali shtetëror i Republikës së Kosovës; (<https://www.rks-gov.net/sq-AL/Bizneset/FinancatTaksatDoganat/Pages/Doganat.aspx>) dhe Trading Economics ; (<https://tradingeconomics.com/country-list/personal-income-tax-rate>).
- Shiroka –Pula, J., (2013), *Sfida dhe Perspektiva e NVM-ve në Kosovë (Analizë Krahasuese dhe Hulimtim Empirik)*, Republika e Kosovës: MASHT-Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë.

Justina SHIROKA-PULA

## CHALLENGES AND ECONOMIC GROWTH IN KOSOVA IN THE PERIOD 2008-2018

### Summary

*This paper will express the economic performance of this time period, analyzing the economic potentials, enterprise development trends, challenges, prospects, and their impact on economic development. The main objective of the paper is to test the economic growth trend in the 2008-2018 period in the case of Kosova, using some of the economic indicators, such as: Public Expenditures, Gross Domestic Product (GDP), Trade Balance (export/import), Total Budget Revenues, etc. The methodology used in this paper includes analysis, statistical data and comparison of the obtained results. Assessment are made for time series data covering the years 2008 to 2018. The data on local economic indicators is obtained from the database of the Central Bank, the Ministry of Finance, the Kosova Agency of Statistics, the World Bank and the International Monetary Fund. This paper provides evidence that some economic indicators have a significant impact on economic growth and are very important factors for Kosova's economic development. Despite these economic indicators, the creation and development of small businesses should be considered a driving factor of growth dynamics, with the result that they continue to be the main generators of new jobs. One of the challenges that the state of Kosova is facing in different periods of development, is the harmonization of the national legislation with the legislation of the European Union. For this reason, all mechanisms for ensuring the alignment of Kosova Legislation with the Acquis-Communautaire of the European Union, are well defined. Immediately after the declaration of independence of 17.02.2018, Kosova became a member of many international institutions, such as the World Bank (WB), the International Monetary Fund (IMF) and the European Bank for Reconstruction and Development (EBRD). Membership in these institutions has enabled Kosova to create economic security and enhance its image in the financial markets.*

**Key words:** *Economic Growth, Trade Balance, Business Environment, International Institutions*

PAVARËSIA E KOSOVËS DHE SFIDAT E SHTETNDËRTIMIT  
Simposium shkencor ndërkombëtar  
(17 maj 2018)

2019

*Botues:*  
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

*Redaktor teknik:*  
ASHAK

*Realizimi kompjuterik:*  
ASHAK

*Madhësia:* 12 tabakë shtypi

*Tirazhi:* 200 copë

*Formati:* 16x24 cm

*Shtypi:*  
Focus Print  
Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

323.17(496.51)(063)  
061(496.51)“2018”

Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit : simposium shkencor ndërkombëtar : (17 maj 2018) = Kosova Independence and State Building Challenges : International Scientific Symposium : (17 May 2018) / redaktore Justina Shiroka-Pula. – Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës : Seksioni i Shkencave Shoqërore, 2019. – 192 f. ; 24 cm.

1. Shiroka-Pula, Justina

**ISBN 978-9951-26-009-1**